



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

“Autoriteti i Mediave Audiovizive” (AMA)

MAJ, 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

“Autoriteti i Mediave Audiovizive”

<u>Nr.</u>	<u>Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-6
II	OPINIONI I AUDITIMIT	6-9
III	HYRJA	9
	1. Objektivat dhe qëllimi..... 2. Identifikimi i çështjes..... 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..... 4. Përgjegjësitë e audituesve..... 5. Kriteret e vlerësimit..... 6. Standardet e auditimit.....	
IV	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-185
V	GJETJET SIPAS DREJTIMEVE TE ANGAZHIMIT	186
VI	REKOMANDIMET.	187-208
VII	ANEKSE	209-210



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë. AMA vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë

- **Vizioni:** AMA, si institucion i pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, nxit: (i) shumëllojshmërinë dhe cilësinë e lartë e me risi të programeve nga OSHMA-të publike e private; dhe (ii) zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimeve në përputhje me dispozitat ligjore, për përmbajtje të paanshme në kuadrin e të drejtës për informim, në respektim të përkatësisë fetare dhe politike, personalitetit, dinjitetit, të drejtave dhe lirive të tjera themelore të njeriut, duke i mundësuar kështu publikut të krijojë opinionin e vet të lirë.
- **Misioni:** Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka misionin të sigurojë që të gjitha shërbimet audio dhe audiovizive të përmbushin nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe moralin qytetar, në përputhje me vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr.896/2, datë 03.11.2022 “Mbi auditimin financiar e të përputhshmërisë”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, ushtroi auditimin e përputhshmërisë në këtë institucion për periudhën nga 01.01.2019 deri në 30.06.2022, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në licensimin dhe monitorimin e subjekteve në fushën audiovizive, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e evidencës kontabile dhe respektimin e kriterëve për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, rregullshmërinë e procedurave të prokurimeve me fondet publike dhe zbatimin e kontratave, aspektet e menaxhimit financiar, kontrollit dhe qeverisjes, etj.

1.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJE TJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENC A ME RPA	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
I.	Nevoja e rishikimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore mbi statusin dhe trajtimin financiar të Sekretariatit Teknik të AMA. Sipas vlerësimit të grupit të audituesve të KLSH, mungon harmonizimi mes ligjit nr.97/2013 dhe akteve të dala në zbatim të tij dhe ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. 1.Caktimi pranë organit kolegjial të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i një Sekretariati Teknik, me 3 (tre) punonjës për periudhën objekt auditimi (1 Janar 2019 - 30 Qershor 2022), kurse për periudhën Mars-Prill 2021 me 4 (katër) punonjës në përbërjen e tij, është veprim në kundërshtim me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	1.1. Nga ana e AMA të merren masat për përmirësimin e kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke mbajtur parasysh miratimin me datë 13.04.2023, nga ana e Kuvendit të RSH-së, të projekt-ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, nëpërmjet përmirësimit /shfuqizimit të Rregullores së Autoritet të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 të Bordit, në cilin në Nenin 27 të saj ka të përfshirë “Sekretariatit teknik të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, dhe të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik të AMA-s dhe përcaktimin e masës së pagesës në Sekretariatit Teknik”, miratuar me Vendimin e AMA nr.248, datë 21.12.2016, duke i harmonizuar këto akte nënligjore me kërkesat e ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe të ligjit nr. 9584,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	administratës shtetërore dhe enteve publike", që shprehimisht ka përcaktuar se: "Çdo organ kolegjial ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. 2. Kryetari i organit kolegjial, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta...", si dhe në tejkalim të pozicioneve të strukturës organike të AMA-s, të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Ngritja e një Sekretariati me 3 (tre) punonjës, ku për periudhën objekt auditimi, për të cilin janë kryer pagesat për 95 mbledhje të kryera nga bordi i AMA-s për 2018-2022, (përkatesisht, 11 në vitin 2018, 19 në vitin 2019, 18 në vitin 2020 dhe 22 në vitin 2021 dhe 25 mbledhje gjatë vitit 2022), ku janë kryer pagesa prej 15,000 lekë/mbledhje për çdo anëtar të Sekretariatit Teknik, është në tejkalim të përcaktimeve ligjore të mësipërme, dhe përbën një kosto të pajustificuar dhe shpenzim pa efektivitet e ekonomicitet të fondeve publike.			datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj". 1.2. Nga ana e AMA të merren masat për shfuqizimin e Urdhrit nr. 111, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik", i ndryshuar dhe të kryhet veprimtaria e AMA në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 i ndryshuar si dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
II.	Mungesa e hartimit të planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave. Mos ushtrimi i të drejtës ligjore të AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira. Nga shqyrtimi i procedurave për dhënien e licencave të transmetimeve audio për periudhën objekt auditimi rezultoi se në asnjë rast nuk është ushtruar e drejta ligjore e AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira. Fakti i mungesës së planit të përdorimit të frekuencave, ka shërbyer si justifikim për të mos çelur asnjë garë kryesisht nga ana e AMA. Ligjvënisi ka përcaktuar si formë të konkurrencës shpalljen e garave nga AMA, duke garantuar në këtë mënyrë objektivitet, transparencë dhe mosdiskriminim. Në kushtet e një zbatimi rigoroz të dispozitave ligjore, duke hartuar planin e përdorimit të frekuencave, në zbatim me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, AMA duhet të kishte mundësinë e përcaktimit të saktë të frekuencave të lira dhe do të ushtronte të drejtën e çeljes së garave kryesisht, kjo nëpërmjet afishimit në fillim të çdo viti kalendarik të planit të përdorimit të frekuencave, duke i dhënë mundësi të gjithë palëve të interesuara për tu njohur me të. Çelja e garave vetëm pas kërkesave të subjekteve të interesuara nuk mund të jetë e vetmja formë e ushtrimit të kompetencave nga ana e AMA.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	AMA të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
III.	Mbledhje dhe vendimmarrje të panevojshme të AMA në rastet e autorizimeve dhe rinovimeve të autorizimeve. Nga auditimi konstatohet se AMA ka aplikuar një standard të dyfishtë në shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e autorizimeve dhe kërkesave për rinovim të autorizimeve. M konkretisht, ✓ Në rastin e kërkesave për marrje autorizimi, në mungesë të kuroumit, AMA i ka konsideruar të miratuara pas kalimit të afatit 30 ditor, sipas përcaktimeve ligjore. ✓ Në rastin e aplikimeve për rinovim autorizimi, AMA ka marr vendim pas kalimit të afatit 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jashtë afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	AMA të marrë masat për shqyrtimet e aplikimeve brenda afateve ligjore dhe të mos ketë vendimmarrje në tejkalim të afateve ligjore në fuqi.
IV.	Mungesa e propozimeve për masa administrative në rastet e shkeljes së detyrimeve të nenit 33 të ligjit të AMA nga ana e OSHMA. Vendimmarrje në tejkalim të kompetencave ligjore të Këshillit të Ankesave.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	AMA të marrë masat ligjore në rastet e evidentimit të shkeljeve në rastet e shqyrtimit të ankesave nga ana e Këshillit të Ankesave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Referuar periudhës objekt auditimi ka rezultuar se në 93 raste të ankesave të trajtuara, në të cilat janë konstatuar shkelje të detyrimeve nga ana e OSHMA-ve, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit, cenimin e të drejtave të fëmijëve, komunikime tregtare të ndaluara, Këshilli i Ankesave ka aplikuar si masë administrative “tërheqje vëmendje”, masë e cila nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Masa administrative “gjobë” është propozuar vetëm në 6 raste gjatë vitit 2019. Vendimmarrje e Këshillit të Ankesave nëpërmjet “tërheqjes së vëmendjes” është në tejkalim të kompetencave ligjore të këtij organi, pasi çdo vendimmarrje e AMA, në raport me shkeljet e evidentuara nga Këshilli i Ankesave, i përket Bordit të AMA-s.			
V.	Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nuk janë përmbushur detyrimet ligjore mbi depozitimin e Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore për vitet 2018-2021 në 36 raste gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, “Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar për OMSHA, (përkatesisht, 1 OMSHA për PF të vitit 2018, 26 të vitit 2019, 6 të vitit 2020 dhe 3 të vitit 2021), dhe nga ana e AMA për gjithë periudhën e audituar është mbajtur qëndrim nëpërmjet aplikimit të sanksioneve administrative (gjobë), vetëm në një rast në vitin 2019, për shumën prej 40 mijë lekë, duke sjellë mungesën e disiplinimit të ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore në kohë dhe mos aplikimi dhe mos arkëtimin e këtyre detyrimeve.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat për vendosjen e sanksioneve ligjore, duke mbajtur parasysh përcaktimet e Kreut XIV “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, Neni 132 “Masat për shkeljet”, pika 2 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, ku është sanksionuar se “AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes”, ndaj të fillojë procesi i dhënies së këtyre masave administrative për 3 (tre) subjekte me nga 40 mijë deri në 400 mijë lekë për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA që janë brenda këtij afati.
VI.	Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, 1.1.2019- 30.6.2022, Bordi i AMA-s, në 10 raste gjithsej ka shfuqizuar sanksionet administrative të dënimit me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, në shumën prej 12,240 mijë lekë, që përfaqëson rreth 20 % të numrit dhe vlerës së gjobave të vendosura gjatë asaj periudhe, ngaqë ka marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimes duke rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit / institucionit në vlerën prej 12,240 mijë lekë, që është vlera totale e gjobave të shfuqizuara.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësisë dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej 12,240 mijë lekë për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022.
VII.	Në 9 (nëntë) raste vendimmarrjet e AMA janë në tejkalim të parashikimeve të nenit 132/4 të ligjit 97/2013, pasi kapërcejnë afatin 30 ditor. Në shumë raste të analizuara, si arsye për heqjen e sanksioneve administrative me gjobë nga ana e bordit të AMA janë konsideruar shkaqe të tilla si, “pamundesia financiare”, “mosnjohja e ligjit”, etj, që në thelb nuk përbëjnë një argumentim ligjor për heqjen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e masës së kundërvajtjes administrative që ka ardhur si pasojë e shkeljes me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji ka parashikuar dënim	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e këtyre rasteve si dhe përgjegjësisë me qëllim eliminimin e efekteve negative të konstatuara në të ardhurat e munguara dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e veprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për periudhën objekt auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	administrativ; Rezultoni se, në 3 (tre) raste, për vlerat e gjobave prej 8 milionë lekë, kundër vendimit të AMA-s është vijuar serish me ankim në AMA, dhe jo në gjykatë.			
VIII.	Shfuqizim i pabazuar në ligj i masave administrative "gjoba". Mungesa e një akti nënligjor në lidhje me kërkesat për ndryshimet në pronësi. Vlera prej 1.360.000 lekë që rrjedh prej masave administrative të marra për 4 (katër) OMSHA, në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, do të konsiderohen efekt negativ financiar. Mosdijeni në raport me detyrim për të dhënë informacion, që rrjedh prej dispozitave ligjore, si dhe fakti se subjektet e justifikojnë me pretendimin se janë të ri në treg, nuk mund të jetë shkak për mosaplikimin e gjobës.	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Autoriteti i Mediave Audiovizive të analizojë me përgjegjësi procedurat e masave administrative të marra, në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, për periudhën 2019 - 2022, me qëllim eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën prej 1.360.000 lekë për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022. Autoriteti në vijim, në shqyrtimet e ankimeve administrative mbi masat administrative ndaj OSHMA të mbështet në dispozitat ligjore dhe të tregojë objektivitet në shqyrtimin e tyre. AMA të ndërmarr nismën për miratimin e një akti nënligjor për rastet e ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri.
IX.	Parregullsi në mbajtjen e kontabilitetit dhe ndjekjen e arketimit të detyrimeve debitoare	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	M-L	Rekomandimi është dhënë për çdo rast në raportin përfundimtar

1.3. OPINIONI I AUDITIMIT:

1.Opinionit për auditimin financiar¹: i kualifikuar²:

Në kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të AMA-s, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të këtyre pasqyrave financiare.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2021, referuar kuadrit rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj. Nga auditimi financiar, mbështetur në, ISSAI 200 "Parimet e auditimit financiar" dhe ISSAI 2000 "Aplikimi i Standardeve të Auditimit Financiar", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, nën gjykimin tonë, kontabiliteti dhe pasqyrat financiare të institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në përgjithësi, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Megjithatë, nga auditimi financiar u konstatuan edhe anomali e parregullsi apo raste të mospërputhshmërisë, të konsideruara **materiale** dhe **jo të përhapura**, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë, që nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, justifikojnë dhënien e një "**Opinionit të Kualifikuar**".

1 -Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

2-Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e auditimit e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

-nuk është evidentuar vlera e ndërtesave në kontabilitet, por vetëm vlera e shpenzimeve për rikonstruksionin e tyre;

*-mospasqyrim në kontabilitet i vlerës së drejtë të llogarisë 210 "toka troje e terrene", e evidentuar 0 lekë, kur vlera paraprake e përlllogaritur është **343,524 mijë lekë**;*

*- nivel i lartë detyrimeve debitorëve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuar dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA, dhe klientëve me trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht në shumën prej **442 milionë lekë** në vitin 2019, **450 milionë lekë** në vitin 2020, **446 milionë lekë** në vitin 2021 dhe **487 milionë lekë** në fund të 6-mujorit të parë 2022;*

*-dobësi në implementimin e kontrollit të brendshëm, të ardhura të munguara dhe shpenzime pa efektivitet nga kryerja e pagesave për Sekretariatit Teknik që për periudhën objekt auditimit arrin në **3,255 mijë lekë**;*

*-vendime gjyqësore të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së, si shpenzim në mospërputhje me parimet e efijçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej **4,181 mijë lekë**.*

-janë kryer pagesa të pambështetura me dokumentacionin e nevojshëm justifikues për orët jashtë orarit të punës;

*-nuk janë përmbushur detyrimet ligjore nga OMSHA mbi depozitimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitet 2018-2021 në **36 raste** gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nuk janë aplikuar sanksionet ligjore ndaj tyre;*

-një planifikim i dobët dhe i paargumentuar i buxhetit dhe një raportim jo të përshtatshëm, mungesa e një kostoimi dhe analize të mjaftueshme e të detajuar për kategoritë e shpenzimeve "Studime, kërkime dhe anketime", etj.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit

Strukturat drejtuese të AMA-s, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Titullari i Institucionit dhe Sekretari i Përgjithshëm (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH për auditimin financiar.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion për pasqyrat financiare vjetore në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me garantimin e sigursisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtimit, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

II. Opinioni për auditimin e përputhshmërisë³: i kualifikuar:

Ne audituam përputhshmërinë e institucionit të AMA-s për periudhën nga 01.01.2019 deri në 30.06.2022 me kriteret e vlerësimit, përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e burimeve të këtij institucioni publik. Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i institucionit të AMA-s, në përgjithësi, në të gjitha aspektet materiale, është kryer në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe të meta, parregullsi e shkelje, të konsideruara **materiale** dhe **jo të përhapura**, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar”⁴.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se veprimtaria e institucionit përmban gabime materiale, por jo të përhapura. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

-Mungesa e hartimit të planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave si dhe mangësi e parregullsi në zbatimin e procedurave të prokurimit me fondet publike;

-Mungesa e propozimeve për masa administrative, në rastet e shkeljes së detyrimeve të nenit 33, të ligjit të AMA-s nga ana e OSHMA dhe vendimmarrje në tejkalim të kompetencave ligjore të Këshillit të Ankesave;

-kanë rezultuar dobësi dhe një sistem i kontrollit të brendshëm pjesërisht efektiv për parandalimin dhe zbulimin e parregullsive dhe gabimeve. Për periudhën objekt auditimi 2019-2022 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet mbi hartimin e regjistrit të riskut për gjithë hallkat dhe drejtoritë e këtij institucioni publik dhe përgjegjësitë për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut; nuk janë marrë masat për përgatitjen dhe dërgimin në MFE të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratave të cilësisë dhe Raportet për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Plan Veprimi për MFK, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010;

*-Bordi i AMA-s, në 10 (dhjetë) raste gjithsej ka shfuqizuar sanksionet administrative të dënimit me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, në shumën prej **12,240 mijë lekë**, që përfaqëson rreth 20 % të numrit dhe vlerës së gjobave të vendosura gjatë asaj periudhe nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi.*

*-Vlera prej **1.360.000 lekë** si efekt negativ financiar për fondet publike, që rrjedh prej masave administrative të marra për 4 (katër) OMSHA, në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, etj.*

3 -Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

4-Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, vendimin nr. 24, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.2. “Në varësi të masës së mospërputhjes, kjo mund të rezultojë në: (i) Opinion të kualifikuar (nëse rastet e mospërputhjeve janë materiale, por jo të përhapura: “Bazuar në punën e kryer të auditimit, kemi zbuluar se, përveç [përkrahja përjashtimin....], Informacioni mbi çështjen e subjektit të audituar është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara [...]”; ose (ii) Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjeve janë materiale dhe të përhapura): “-Sipas mendimit tonë, [objekti / çështja/ lënda....] nuk është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara [.] , dhe mospërputhja është e përhapur”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

-Pagesat e vendimeve gjyqësore si shpenzim në mospërputhje me parimet e efijencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit, të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej 4,181 mijë lekë, etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të AMA-s janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.896/2, datë 03.11.2022 “Mbi auditimin e Përputhshmërisë në institucionin në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)Tiranë”, i ndryshuar, nga data 25.10.2022 – 20.02.2023, për periudhën nga 01.01.2019 deri në 30.06.2022, u krye Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Q. C, (përgjegjës grupi)
2. F.Xh, anëtar
3. A.Z, anëtar
4. E.Sh, anëtar.

a) Titulli:

Raporti i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në AMA.

b) Marrësi:

Ky raport përfundimtar i adresohet Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. A. K.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Autoriteti i Mediave Audiovizive kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu sistemin e kontrollit të brendshëm, procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se,

- “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

- “Auditimi i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”.

Në nenin 12 “Auditimi i përputhshmërisë” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislativë, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë institucioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit mbi rregullshmerine dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime⁵.

b) Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të shërbimeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në funksion të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, (ligji nr.97/2013).

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyravefinanciare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.896/2, datë 03.11.2022, i ndryshuar.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Bordi dhe niveli menaxherial i institucionit të AMA janë përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Titullarët e institucionit të AMA-s për periudhën objekt auditimi:

- I. Ish-Kryetari i Bordit Z. G. S. për periudhën objekt auditimi (nga data 1.1.2019 deri në 07.07.2021).
- II. Kryetari i Bordit Znj. A. K. për periudhën objekt auditimi (nga data 07.07.2021 deri në fund të periudhës së auditimit;

Nëpunësi autorizues i këtij institucioni për periudhën objekt auditimi:

- Ish-Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të AMA-s Znj. V.M. për periudhën objekt auditimi (me përjashtim të periudhave me leje lindjeje, Tetor 2019 - Qershor 2020 dhe Korrik 2021 - Gusht 2022).

Nëpunësi zbatues për periudhën objekt auditimi:

- Drejtori i Shërbimit të Brendshëm, Znj.M. P., për gjithë periudhën objekt auditimit deri në datën e mbajtjes së këtij raporti.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë, bazuar mbi rezultatet e auditimit. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

⁵ -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 107, datë 8.9.2017, me ndryshimet.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me kriteret dhe parimet e Buxhetimit; me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me rregullat për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i AMA-s, Ligji i kontabilitetit, ai i Prokurimit Publik, etj.
- b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, etj.
- d) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)
- e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohej material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjevesh mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në institucionin e AMA-st në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

e) Kriteret e vlerësimit:

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

Lloji i dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore
Standarde auditimi:	- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; - ISSAI 400 - Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë; - ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”; - ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik”; - ISSAI 200 “Parimet Themelore të Auditimit Financiar”; - ISSAI 2000 “Aplikimi i Standardeve të Auditimit Financiar”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të IFAC; - Manual i IDI-t “Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë”; - Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Manuali i Auditimit Financiar; - Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH, etj.
Ligje:	- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. - Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”; - Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në RSH” i ndryshuar; - Ligji nr. 34/2017, datë 30.03.2017 “Për lirin e frekuencave të dixhital - dividendit”, i ndryshuar. - Ligji nr.8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratesshtetore dhe enteve publike”. - Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; - Ligji nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar; - Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; - Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Për “Kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,. - Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, me ndryshime, shfuqizuar nga ligji nr. 162/2020, etj;
Vendime të Këshillit të Ministrave	- VKM nr.277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”, - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i shfuqizuar nga VKM nr. 823, dt 21.10. 2020, etj.
Akte të tjera ligjore:	- Udhëzimi i AMA nr.200, datë 12.1.2018 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për aplikim të projekt propozimeve në fushën e mediave audiovizive”, - Udhëzimi i AMA nr.713, datë 03.08.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Komsionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve”, - Udhëzimi i AMA nr.739, datë 12.02.2018 “Për parimet dhe rregullat e përgjithshme për menaxhimin e aktiveve në AMA”, etj
Rregullore, Udhëzues, Akte të tjera administrative:	- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015. - Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar të gabimeve materiale. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin e AMA-s, niveli i materialitetit për vitin 2021 rezultoi 2,238,258 lekë⁶.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

6 -Shiko Aneksin përkatës në fund të raportit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

$\text{Risku i Auditimit} = \text{Risku i qenësishëm} * \text{Risku i kontrollit} * \text{Risku i Zbulimit}$
--

Nisur sa më sipër, është aplikuar niveli i Riskut të Auditimit i pranuar prej 5%, i mbajtur parasysh për nivelin e procedurave analitike dhe testeve thelbësore të kryera.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Kontrolli aritmetik Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Kontrolli i vlerësimit. Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi. Intervistimi, Raporte dhe Informacione, Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, etj.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.

1. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- *Objekt i këtij auditimi* është auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së shërbimeve të AMA-s me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

- *Qëllimi i auditimit:* Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë institucioni i AMA-s.

- *Fushëveprimi i auditimit:* Vlerësimi i aktivitetit dhe shërbimeve të këtij institucioni me qëllim dhënien e opinionit financiar dhe atij të përputhshmërisë, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar me zgjedhje dhe në mënyrë të njëpasnjëshme dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2019-30.06.2022, ku janë mbuluar me auditim fondet publike të buxhetit të subjektit, si dhe janë audituar me përzgjedhje dosjet sipas drejtimeve të programit të angazhimit për periudhën objekt auditimi.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

Dokumenti i rezultateve të angazhimit deri në fazën e raportit përfundimtar:

☑ Janë dorëzuar zyrtarisht dhe protokolluar aktet e konstatimit me nr. 1-7, datë 20.02.2023, (protokolluar me nr.906-912, datë 20.02.2023 në institucionin e AMA-s),



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- ✎ Pas njohjes me akt-konstatimet e mbajtura, nga ana e ish-zyrtarëve dhe zyrtarëve të AMA-s, me shkresën nr. 1042 prot, datë 27.02.2023, janë dërguar observacionet përkatëse nga ana e subjektit të audituar në lidhje me akt-konstatimet e mbajtura nga audituesit e KLSH, (protokolluar në KLSH me nr. 896/4 prot., datë 27.02.2023).
- ✎ Me shkresën nr. 896/5, datë 21.3.2023 të KLSH është dërguar zyrtarisht Projekt Raporti i Auditimit në institucionin e AMA-s, me qëllim njohjen me konstatimet dhe rekomandimet dhe konfirmimin e tyre.
- ✎ Sipas shkresës me nr. 1604., datë 20.4.2023, (protokolluar në KLSH me nr.896 / 6 , datë 20.4.2023), institucioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive ka dërgua në KLSH objeksionet në lidhje me çështjet e trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit.

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Mediave audiovizive , për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën 305/12, datë 08.11.2017 dhe “Mbi zbatimin e rekomandimeve” të lëna nga grupi i mëparshëm i zbatimit të rekomandimeve bazuar në Vendimin nr.103, datë 31.07.2018 se:

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

janë rekomanduar gjithsej:

- a. Masa për shpërblim dëmi janë lënë 3 gjetje dhe 5 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 4 rekomandim dhe pa zbatuar 1 rekomandime.
- b. Masa Disiplinore është lenë 1 rekomanduar për 4(katër) persona, nga të cilat rekomandimi është zbatuar.

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Komisionit të vlerësimit të ofertave i përbërë nga zj. E. R. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, E. F. me detyrë jurist, z. R.P. me detyrë arkitekt (i jashtëm) të zhdëmtojnë vlerën 389,000 lekë, ose nga 129,667 lekë/secili, pasi në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues skualifikonte BOE “A.C.” sh.p.k & “D.C” shpk. Me skualifikimin e tij, fitues do të rezultonte OE “A & E” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “A .C” sh.p.k & “D & C” shpk.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Pika 1

1.1. & 1.2. Në vijim të rekomandimeve tuaja, sikurse ju kemi bërë me dije edhe në komunikimet tona shkresore, Kryetari i AMA-s, me urdhër nr.131, datë 24.11.2017 ka urdhëruar kontabilizimin dhe ndjekjen në rrugë ligjore për arkëtimin e vlerës së zhdëmtimit prej 389,000 (treqindetëdhjetëenëntëmijë) lekë për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave të procedurës me objekt “Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

përshtatje për zyrat e AMA-s“. Mbi këtë urdhër, është ngritur padi ndaj AMA-s, në Gjykatën Administrative të Tiranës, e cila në përfundim të procesit gjyqësor, me Vendimin nr.5055, datë 28.12.2017, vendosi pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimin e Urdhërit nr.131, datë 24.11.2017 të Kryetarit të AMA-s.

Ky vendim bazuar në ligjin e posaçëm për gjykatat administrative, është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim, referuar nenit 45 gërma “b” të ligjit nr. 49/2012 në të cilin përcaktohet se: “Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: b) kundërshtimin e aktit administrative që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;”

Kjo shumë përbën kufirin minimal të detyrimit në të holla që duhet të përmbajë akti administrativ (vendimi nr. 5055 datë 28.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) në mënyrë që të legjitimohej si objekt kundërshtimi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pasi vendimi i gjykatës mori formë të prerë, nga ana jonë u krye ç’kontabilizimi i vlerës së zhdëmtimit prej 389,000 (treqindetëdhjetëenëntëmijë) lekë.

Për sa më sipër, rekomandimi i KLSH-së është zbatuar plotësisht nga ana jonë.

Komenti i grupit të auditimit

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimet janë zbatuar.**

2.1 Rekomandimi: BOE “A.C.” sh.p.k & “D.C” sh.p.k, t’i kërkohet të zhdëmtojë vlerën 366,504 lekë, e cila përfaqëson vlerën e TVSH, fondit rezervë etj, të pajisjeve të përfshira padrejtësisht në zërat e punimeve të preventivit gjatë llogaritjes së fondit limit në tenderin me objekt “Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Pika 2

1.1. & 1.2. Sikursre jeni në dijeni, Kryetari i AMA-s, me urdhër nr.132, datë 24.11.2017 ka urdhëruar kontabilizimin dhe ndjekjen në rrugë ligjore për arkëtimin e vlerës së zhdëmtimit prej 366,504 (treqindegjashtëdhjetëegjashtëmijëepesëqindekatër) lekë për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “A. C.” sh.p.k. & “D.C” sh.p.k. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A. C.” sh.p.k. & “D.C” sh.p.k., të përfaqësuar nga “A.C.”, është njoftuar zyrtarisht për këtë urdhër.

Duke qenë se kjo shoqëri nuk shleu vullnetarisht detyrimin e mësipërm, AMA investoi organet gjyqësore për vlerën e këtij detyrimi. Gjatë gjyqimit të çështjes, AMA kërkoi pushimin e gjyqimit, pasi vlera e mësipërme duhej të zhdëmtohej prej bashkimit të shoqërive “M.” sh.p.k. & “C” sh.p.k. Në vijim, AMA kërkoi shkresërisht nga ky bashkim operatorësh, shlyerjen e detyrimit. Në përgjigje të shkresës sonë, shoqëria « M. » sh.p.k., shleu vlerën prej 366,504 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e katër) lekë, në datën 20 shtator 2018.

Më pas, nga ana jonë u krye ç’kontabilizimi i vlerës së zhdëmtimit prej 366,504 (treqindegjashtëdhjetëegjashtëmijëepesëqindekatër) lekë.

Për sa më sipër, rekomandimi i KLSH-së është zbatuar plotësisht nga ana jonë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Komenti i grupit të auditimit

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion vëren se **rekomandimet janë zbatuar**

3. Rekomandimi: Të mbahet vlera prej 248,858 lekë për 1,395 litra karburant, diferencë nga krahasimi i dokumentacionit të fletë udhëtimeve me daljet nga magazine, personave përgjegjës të cilët në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 të menaxhimit financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nuk kanë kryer akt rakordimet për monitorimin e harxhimit të karburantit duke çuar në mos përdorim korrekt të sasisë së karburantit nga drejtuesit automjeteve që dispononin.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me rekomandimin tuaj, AMA konstaton se nuk janë përcaktuar nga ana juaj personat përgjegjës dhe masat zhdëmtuese respektive për shumën prej 248,858 lekë. Personat e cituar në proces verbalin nr.3, datë 14.07.2017, kanë kryer detyra të ndryshme funksionale gjatë viteve 2014-2016, detyra që nuk lidhen me konsumin e karburantit. Në këto kushte, AMA e ka të pamundur zbatimin e këtij rekomandimi.

Sikurse e kemi parashtruar edhe në korrespondencat e mëparshme, AMA është në kushtet e pamundësisë të zbatimit të kësaj mase zhdëmtimi, pasi nuk janë përcaktuar personat përgjegjës dhe masat përkatëse për zhdëmtim financiar për secilin.

Komenti i grupit të auditimit

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni vëren se:

Rekomandimi nuk është zbatuar .

B. MASA DISIPLINORE

Bordi i AMA-së të analizojë Raportin e Auditimit dhe të marri masat bazuar në legjislacionin në fuqi. Për sa më poshtë: Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimet dhe procesverbalet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor për shërbimin civil” Bordi i Autoriteti të Mediave Audiovizive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”, në varësi të shkallës së përgjegjësisë për personat si më poshtë:

1. **Zj. A. K.** me detyrë Përgjegjëse Zyrës së Financës,
2. **Z. E. N.** me profesion inxhinier ndërtimi ekspert i jashtëm,
3. **Zj. E. R.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore,
4. **Zj. E. F.** me detyrë jurist, pasi në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “A.C.” sh.p.k & “D.C.”sh.p.k.

KVO me parregullsitë që kishte në dokumentacionin ligjor kualifikues duhet të kishte skualifikuar BOE “A.C.” sh.p.k & “D.C.”sh.p.k. de të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues OE “ A & E .” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “A.C.” sh.p.k & “D.C.”sh.p.k, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Sikurse e kemi parashtruar edhe në korrespondencat e mëparshme, AMA lidhur me rekomandimet për nëpunësit civilë: Znj. E.R. – me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Znj. A.K. – me detyrë (ish Përgjegjës i Financës) aktualisht Përgjegjës i Administratës dhe Znj. E. F. – me detyrë specialist në Drejtorinë Juridike dhe të Licencave, Kryetari i AMA-s, ka miratuar urdhrin nr. 129, datë 24.11.2017, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor” për nisjen e ecures së procedimit disiplinor ndaj tyre.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni Disiplinor, me Vendimet nr. 8 dhe 9 datë 07.12.2017, vendosi: “Ndërprerjen e shqyrtimit të masës disiplinore për nëpunësat znj. E. F. dhe znj. E. R.” me arsyetimin se: “Gjatë hetimit administrativ, rezultoi e provuar se procedura e prokurimit të ndjekur nga Autoriteti Kontraktor (AMA), me objekt “Hartimi i projekt-zbatimit për rikonstruksionin e godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit, të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, dhe përshtatje për zyrat e AMA-s”, është zhvilluar në përputhje me nenin 37, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, i cili parashikon se: “Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me fazë, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese”.

Edhe pas shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj znj. A.K., Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 10, datë 07.12.2017, vendosi ndërprerjen e procedimit disiplinor me arsyetimin se: “Gjatë seancës së shqyrtimit, rezultoi e provuar se: Në zbatim të nenit 74 pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” në të cilin parashikohet se në rastin kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Për sa më sipër, AMA ka vijuar procedurat për zbatimin e rekomandimeve, duke ngritur Komisionin Disiplinor i cili mbështetur në kompetencat e dhëna prej legjislacionit për nëpunësit civilë, ka arritur në përfundimin se nëpunësit e sipërpërmendur nuk kanë konsumuar elementë që përbëjnë shkak për masë disiplinore.

I njëjti qëndrim është mbajtur edhe prej gjykatës administrative të shkallës së parë gjatë shqyrtimit të kërkesë padisë së ngritur prej znj. R. dhe znj. E.F.

Për, z.E. N. me detyrë inxhinier i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, nuk mund të merren masa disiplinore nga AMA pasi nuk është punonjës i organikës së institucionit.

Komenti i grupit të auditimit Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

Përfundimisht, janë rekomanduar 5 masa për shpërblim dëmi nga të cilat janë realizuar 4 masa, ndërsa 1 masë në vlerën 248,858 lekë rezultoi e pazbatuara. KLSH rikërkon nga Autoriteti i Media Audiovizive zbatimin e 1 masa të pazbatuara në vlerën 248,858 lekë, si vijon:

A. Masa për shpërblim dëmi (të pazbatuara)

1. Nga auditimi i fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion dhe fletë daljeve të magazinës në disa muaj u konstatuan diferencë në karburant: Për vitin 2015 në sasi prej 935 litra karburant në vlerë 162,253 lekë, (dalje 6,458 dhe harxhuar sipas fletë udhëtimeve 5,523). Për vitin 2016 në sasi prej 460 litrash në vlerë 86,605 lekë (1,370 sipas fletë udhëtimeve dhe duke i krahasuar me daljet nga magazina për një sasi prej 1,830). Për dy vitet 2015, 2016 diferencat në karburant prej 1,395 litra nga të cilat 945 lira benzinë dhe 450 litra naftë me vlerë prej 248,858 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

1.1.Rekomandimi: Të mbahet vlera prej 248,858 lekë për 1,395 litra karburant, diferencë nga krahasimi i dokumentacionit të fletë udhëtimeve me daljet nga magazine, personave përgjegjës të cilët në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 të menaxhimit financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nuk kanë kryer akt rakordimet për monitorimin e harxhimit të karburantit duke çuar në mos përdorim korrekt të sasisë së karburantit nga drejtuesit automjeteve që dispononin.

Titulli gjetjes:	Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin e Auditimit të mëparshëm, prandaj rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.
Situata:	AMA ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon: Janë rekomanduar 5 masa për shpërbllim dëmi nga të cilat janë realizuar 4 masa, ndërsa 1 mase në vlerën 248,858 lekë rezulton e pazbatuara.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, gërma j;
Ndikimi/Efekti	Mos zbatimi i rekomandimeve ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të AMA-s.
Shkaku:	Mos ndjekja e gjitha procedurave nga ana e institucionit, për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna për arkëtimin të vlerës 248,858 lekë.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandimi:	Titullari i institucionit, në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 305/12 prot, datë 08.11.2017 si dhe relacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguar me shkresë nr.103, datë 31.07.2018, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

2. Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr.2 të programit të auditimit nr.896/2, datë 03.11.2022”, u shqyrtua dokumentacioni i subjektit dhe konstatohet që:

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës

Nga auditimi me zgjedhje për vitet objekt auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Sektorin e Financës, për veprimet e arkës në valutë rezultoi se, veprimet janë kryer komform kërkesave të Ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”, i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Me mandat pagesën nr. 75 datë 27.11.2019 janë paguar shpenzime për udhëtim e dieta në aktivitetin “që do të zhvillohet në Yokohama (Kanagaëa) Japoni Ekspozita e Mediave Audiovizive 2019” dhe vizitë në televizion shtetëror Japonez (NHK)”, në datat 02-06 dhjetor 2019 në shumën 420 usd për ish titullarin z.G.S., shpenzime dietash 7ditë * 60usd=420 usd.

Ndërsa me mandat pagesën nr. 76 datë 27.11.2019 është dhënë paradhënie znj. E. P. Këshilltare e kabinetit në AMA, me mandat arkëtimi nr.49 datë 17.12.2019 ka kthyer 572 usd ndërsa pjesa tjetër prej 577.45 janë shpenzime për dieta 7 ditë * 50= 350 usd , Shpenzime transporti 227.45 usd total shpenzime 577.45 usd.

Rezervimi i hotelit me 5 yje është kryer me datë 22.11.2019 dhe është kryer nga karta personale e ish titullarit në vlerën 4224 usd për 2 dhoma për 6 netë nga data 2.12.2019 deri me 8.12.2019, ndërsa me date 26.11.2016 është kryer pagesa me bankën credins në shumën 442.339,90 lekë ne llogari te ish titullarit për rezervimin e hotelit.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e vizitës zyrtare në Yokohama (Kanagaëa) Japoni, referuar pagesave për qëndrimin në hotel, rezulton të jenë paguar 6 netë, në vlerën totale prej 4224 USD. Aktiviteti “*Ekspozita e Mediave audiovizive 2019*” ka qenë për 2 netë, plus 3 netë udhëtimi prej distancës së largët, 5 netë në total, ndërsa dieta ditore është paguar për 7 netë në shumën 770 USD. Shpenzimi për njërën nga netët e qëndrimit nuk ka dokumentacion justifikues. Sa më sipër, shpenzimi për qëndrimin në hotel do të ishte 3520 USD (me një diferencë prej 704 USD) dhe shpenzimi për dietat ditore do të paguhej në vlerën 660 USD (me një diferencë prej 110 USD). Shpenzimi total i pajustificuar prej 814 USD (për hotelin dhe dietat për 1 natë) përbën dëm ekonomik për buxhetin e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 35 dhe 36.*

Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat pagesave tek të gjitha praktikant mungon ftesa e vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit. Këto veprime janë në kundërshtim me *VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe pikën 4 të Udhëzimit nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave.*

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 24.04.2023, me nr.896/6 prot.

Pretendimi i subjektit: Veprimtaria për vizitën në Japoni është kryer në bazë të një urdhri ku janë skeduar veprimtaritë që do të kryhen dhe afatet e qëndrimit dhe jo të një akti të paligjshëm sikurse është cituar nga ana juaj. Kërkesa juaj për të paraqitur dokumente justifikuese lidhur me vizitën studimore në Televizionin Shtetëror Japonez, duket se është e pazakontë dhe e pabazuar në ligj. Veprimtaria në fjalë ishte një vizitë studimore dhe në asnjë kërkesë të dispozitave ligjore nuk parashikohet që një veprimtari e tillë duhet të dokumentohet me ndonjë mënyrë të veçantë. As Projekt Raporti juaj, nuk e përcakton konkretisht me çfarë dokumenti duhet të vërtetohet kryerja e vizitës nga ana jonë në televizion. VKM nr. 870, datë 14.12.2011, në asnjë pikë të tij nuk përcakton dokumentimin e veprimtarive gjatë kryerjes së shërbimit jashtë vendit përveçse përcakton se si bëhet dokumentimi i shpenzimeve për akomodim si dhe për transport.

Sqarojmë se Autoriteti i Mediave Audiovizive është institucion rregullator në fushën e medias audio dhe audiovizive, dhe kryerja e vizitave në televizione të huaja shtetërore, është në praktikën e punës të tij, ndaj nuk kuptojmë pretendimet tuaja të paraqitura në Projekt Raport.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar observacioneve të ardhura me shkresën nr. 896/6 prot, datë 20.04.2023, në lidhje me realizimin e vizitës zyrtare në Yokohama (Kanagaëa) Japoni komentet e subjektit **merren parasysh** kurse në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur pagesës sipas percaktimeve ligjore në fuqi dhe akteve nënligjore në fuqi (UMF nr. 30/2011 dhe UMF nr. 22/2013), **observacioni nuk merret në konsideratë**.

Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit justifikues për vizitat zyrtare jashtë vendit
Situata:	1.Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime/ dieta me jashtë, grupi i auditimit ka konstatuar mungesë të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur mandat pagesave, pasi mungon ftesa e vendit organizator pritës dhe draft agjenda e aktivitetit. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.
Kriteri:	VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; Pika 4, e Udhëzimit nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e justifikimit të qëllimit dhe objektit të shërbimit të kryer jashtë vendit.
Shkaku:	Mangësi në plotësimin e dokumentacionit justifikues.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	1.Sektori i Financës të marrë masa që, në të gjitha praktikatat për udhëtime e dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t’i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës.

Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve të kryera me bankën dhe arkën për 3/ mujorin e dytë të vitit 2019 dhe 6 mujorin e vitit 2020, 3 mujorin e parë dhe të fundit të 2021 dhe tremujorin e dytë të 2022 rezultoi se, veprimet ekonomike ishin kryer në mënyrë kronologjike dhe të justifikuara, me dokumentacionin bazë dhe atë mbështetës. Çdo veprim i kryer me arkën ose me bankën ishte i regjistruar në ditarët përkatës.

Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve të kryera me bankën nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi veprimet e kryera me bankën kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimeve, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar.

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se për vitin **2019** janë paguar 2 punonjës. Me shkresë nr.1009/1 prot datë 26.02.2019 Drejtori i Mbikëqyrjes ka bërë kërkesa për pagesën e orëve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

jashtë orarit, ndërsa me shkresë nr. 1028 prot datë 27.02.2019 Sekretari i Përgjithshëm ka miratuar pagese e orëve shtesë për zyrtare për znj. N. D. për datën 16.02.2019 6.5 orë dhe E. Ç. për datën 16.02.2019 4 orë. (Tabela më poshtë)

Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar viti 2019			
Nr	Emri i punonjësve	orët jashtë orarit	paga e përfituar ne leke
1	N.D	6.5	5,639
2	E.Ç	4	2,662
Totali		10.5	8,301

Nga auditimi për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të kryera për vitin 2019 konstatohet nuk ka kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe miratimin e titullarit të institucionit për punonjës të qe kanë punuar orë shtesë, por kërkesa e drejtorit të mbikëqyrjes dhe miratimi i kërkesës nga Sekretari i Përgjithshëm për pagesën për orët jashtë orarit zyrtar është mbas faktit. *Veprime në kundërshtim me Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”, pika 5 citon se “Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenin 4/26 -pikën 17 “Kontrolle para faktit, në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga titullari me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: ish Sekretari i Përgjithshëm, znj. V. B.

Për vitin **2020** me shkresë nr. 590 prot., datë 11.02.2020 Drejtori i shërbimeve të brendshme ka bërë kërkesë drejtuar titullarit të Institucionit për pagesë jashtë orarit për nëpunësin znj. A. K. për datat 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 ore për datat e sipërcituara.

Me shkresë nr. 644 prot datë 12.02.2020 Titullari i Institucionit ka miratuar orët shtesë për 9 punonjës për data 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 ore pune për çdo datë. (Tabela më poshtë)

Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar viti 2020			
Nr	Emri i punonjësve	oret jasht orarit	paga e përfituar ne leke
1	U.B	24	24,235
2	E.C	24	23,547
3	S.Xh	24	24,120
4	E.D	24	26,112
5	A.M	24	28,325
6	M.P	24	24,235
7	A.K	24	18,086



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

8	O.S	24	19,849
9	M.M	24	20,651
Totali		216.0	209,160

Burimi:AMA

Për vitin **2021** me shkresë nr. 1442 prot date 25.03.2021 Sekretari i Përgjithshëm ka angazhuar 20 punonjës për monitorimin e subjekteve audiovizive gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që do të zhvillohen në datën 25.04.2021.

Punonjësit do të angazhohen nga date 26.03.2021 deri me datë 25.04.2021 duke përfshire ditët e shtuna/të diela dhe festat zyrtare duke i paguar për orët jashtë orarit zyrtar të punës. (Tabela më poshtë):

Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar viti 2021					
Nr	Emri i punonjësve	Orët jashtë orarit mars dhe prill	Paga e përfituar në mars	Paga e përfituar në prill	Paga e përfituar Total
1	N.D	88	13,882	62,468	76,350
2	B.K	88	10,609	47,741	58,350
3	G.SH	88	10,456	47,054	57,510
4	Sh.B	88	10,724	48,256	58,980
5	A.M	88	10,533	47,397	57,930
6	E. Ç	88	10,724	48,256	58,980
7	G.M	88	10,533	47,397	57,930
8	E.H	88	11,823	53,202	65,025
9	E.B	88	11,288	50,797	62,085
10	Z.K	88	13,882	62,468	76,350
11	V.B	88	13,309	59,891	73,200
12	E.SH	88	11,067	49,803	60,870
13	M.TH	88	11,144	50,146	61,290
14	G.D	88	10,685	48,085	58,770
15	I.K	88	10,609	47,741	58,350
16	D.J	88	10,418	46,882	57,300
17	B.Z	66	3,450	15,525	18,975
18	S.H	64		42,436	42,436
19	S.A	16		5,175	5,175
20	A..P	36	1,536	7,680	9,216
Totali		1590	186,671	888,401	1,075,073

Nga auditimi për pagesat e orëve jashtë orarit zyrtar të kryera për vitin 2020 dhe 2021 konstatohet se Institucioni nuk është përpjekur në asnjë rast që këto orë shtesë të kompensohen me ditë pushimi brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë, *veprime në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar*, pika 5 citon se “Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë. Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkesit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë. Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 24.04.2023 me nr.896/6 prot.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pagesat e orëve shtesë për vitin 2019, Z. E. L., ish Drejtori/epriori i Përgjegjëses të Sektorit të Monitorimeve zj. N. D. dhe Specialistit të Monitorimeve z. E. Ç., ka bërë kërkesë me shkrim nr. 1009 prot., datë 26.02.2019, me lëndë “**Informim mbi orët jashtë orari**”, drejtuar zj. V. M., Sekretar i Përgjithshëm dhe zj. E. R., Drejtor i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. (bashkëlidhur shkesa nr. 1009 prot., datë 26.02.2019);

Z. E. L. ka bërë kërkesë me nr. 1009/1 prot., datë 26.02.2019, me lëndë “Kërkesë për pagesën e orëve jashtë orari”, drejtuar zj. V. M., Sekretar të Përgjithshëm dhe zj. E. R., Drejtor i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. (bashkëlidhur shkesa nr. 1009/1 prot., datë 26.02.2019);

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Sekretar i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhër nr. 63, datë 27.02.2019, për pagesat e orëve jashtë orari për zj. N. D. dhe z. E. C. (bashkëlidhur urdhëri nr. 63, datë 27.02.2019).

Ju risjellim në vëmendje se **procedura e kërkesës dhe nxjerrja e urdhërit janë kryer pas kryerjes së orëve shtesë nga dy punonjësit, kjo pasi drejtori z. E. L. ka njoftuar në mënyrë të menjhërsme të protestës së zhvilluar nga partitë opozitare.** <https://www.dw.com/sq/vazhdon-me-trazira-protesta-e-opozit%C3%ABs-n%C3%AB-tiran%C3%AB/a-47545940>

Në lidhje me pagesat e orëve shtesë për **vitin 2020**, vijohet observacioni si më poshtë:

Në nenin 5 të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2022, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, citohet..... “Me kërkesë të epororit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë. Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale”.

Kryetar i AMA-s e ka **patur të pamundur vijimin normal të punës në institucion, duke kompensuar drejtuesit e drejtorive/njësive të AMA-s, secilin me nga 36 orë pushimi** (24 orë + 24 orë x 50%) apo 4 ditë pushimi, brenda 2 muajve.

Pra, për sa më sipër, Kryetar është përpjekur të vijojë punën në autoritet, dhe jo ta zvarrisë, duke iu dhënë drejtuesve të drejtorive/njësive të AMA-s, ditë pushimi, kjo në zbatim të nenit 5, të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2022, të ndryshuar.

Zj. V.B., Sekretar i Përgjithshëm ka qenë me leje lindje në muajin shkurt 2020.

Në lidhje me pagesat e orëve shtesë për **vitin 2021**, vijohet observacioni si më poshtë: Ju shpreheni në projekt raport, se nuk është bërë asnjë lloj përpjekje për të kompensuar me orë pushimi brenda



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

2 (dy) muajve, orët shtesë të punës të stafit. Risqarojmë se, AMA për herë të parë ka vendosur stafin e tij për monitorim të fushatës zgjedhore, në zbatim të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor përmes ligjit nr. 118/2020, datë 05.10.2020, i cili e ngarkoi Autoritetin e Medias Audiovizive për të monitoruar fushatat zgjedhore në mediat audio/audiovizive në Republikën e Shqipërisë, në të dhëna sasiore edhe cilësore, si dhe raportim të monitorimit të përcaktuara qartësisht në Vendimin nr. 2 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Sqarojmë se institucioni ose do të trajtonte me orë pushimi të 20 punonjësit, ose do t'i paguante të 20 punonjësit për orët shtesë të punës të kryer. Për 16 punonjës/monitorues, të cilët kanë punuar 88 orë shtesë gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore, AMA duhet t'i kompensonte me 132 orë pushimi (88 orë + 88 orë x 50%) ose me 17 ditë pushimi/punonjës. Duke qenë se të 16 punonjësit janë nga Drejtoria e Programeve dhe Drejtoria e Monitorimeve dhe Inspekte, kompensimi me ditë pushimi të stafit do të conte në pezullim të aktivitetit të përgjithshëm të institucionit. AMA duhet të zbatojë ligjin e tij nr. 97/2013, të ndryshuar, dhe të vijojë punën në institucion në përmbushje të tij. Eficenca dhe efektiviteti i punës në AMA, është konkretizuar në rezultatet e punës që stafi monitorues i tij pati gjatë fushatës zgjedhore, punë shtesë e ardhur në zbatim të ligjit nr. 118/2020, datë 05.10.2020, duke përmbushur edhe punën në zbatim të ligjit 97/2013, të ndryshuar. Për sa më sipër, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë vlerësuar shumë të rëndësishëm vijim e punës në institucion dhe jo dhënie ditë pushim të stafit. Kjo në përputhje me nenin 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar, që lejon institucionet shtetërore që në mënyrë përjashtimore sipas rrethanave të natyrës që u shpjeguan më lart, të bëjnë pagesën e orëve shtesë në punë për punonjësit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Referuar observacioneve të ardhura me nr. 896/6 prot datë 20.04.2023 në lldhje me përgjegjësinë e znj. M.P në likuidimin e orëve jashtë orarit për vitin 2019 dhe 2020 **observacioni nuk meret në konsideratë** sepse nuk janë sjellë arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues, ndërsa për sa i përket observacionit dhe shpjegimeve të dhëna për v.2021, audituesit e autorizuar të KLSH pranojnë arsyetimin e subjektit dhe e **marrin atë në konsideratë, nisur nga përgjegjësitë e AMA për monitorimin e fushatës zgjedhore.**

Titulli gjetjes:	Parregullsi në dokumentimin dhe ekzekutimin e pagesave për orët jashtë orarit zyrtar.
Situata:	Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se për vitin 2019 procedura e kërkesës dhe nxjerrja e urdhërit janë kryer pas kryerjes së orëve shtesë nga dy punonjës. Me shkresën nr.1009/1 prot, datë 26.02.2019 Drejtori i Mbikëqyrjes ka bërë kërkesa për pagesën e orëve jashtë orarit, ndërsa me shkrese nr. 1028 prot datë 27.02.2019 Sekretari i Përgjithshëm ka miratuar pagesë të orëve shtesë për zyrtare për znj. N. D. për datën 16.02.2019 për 6.5 orë dhe E. Ç. për datën 16.02.2019 për 4 orë. Për vitin 2020 me shkresë nr. 590 prot, datë 11.02.2020 Drejtori i Shërbimeve të Brendshme ka bërë kërkesë drejtuar titullarit të Institucionit për pagesë jashtë orarit për nëpunësin znj. A.K. për datat 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 orë për datat e sipërcituara. Me shkresën nr. 644 prot., datë 12.02.2020, titullari i institucionit ka miratuar orët shtesë për 9 punonjës për data 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 orë pune për çdo datë, për kryerjen e detyrave funksionale. Për pasojë vlera prej 217,461 lekë e paguar për orët shtesë përbën efekt financiar negativ për Autoritet e Mediare Audiovizive.
Kriteri:	VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”, pika 5,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenin 4/26 -pikën 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
Ndikimi/Efekti	Efekt financiar negative në vlerën 217,461 lekë .
Shkaku:	Mungesa e marrjes së masave paraprakisht për zëvendësimin e orëve shtesë, për të evituar efektet financiare për pagesën e tyre.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të marrë masa për analizimin e përgjegjësi dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, të buxhetit të AMA-s në vlerën 217,461 lekë mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar.

Shpërblimi i punonjësve të Autoritet të Mediave Audiovizive në prill të vitit 2021.

Me shkresë nr. 1738 prot., datë 22.04.2021 bordi i AMA-s ka miratuar vendin nr. 61 “*Një ndryshim në vendim e AMA-s nr. 153 datë 24.12.2020, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021, te ndryshuar.*”

Në relacion shpjegues të vendim të bordit është përcaktuar se 65 punonjësit e AMA-s do të shpërblehen për monitorimit e procesit zgjedhore, shpërblimet janë të ndara si më poshtë vijon:

1. Për komisionin ad hoc 2 paga mujore /person.
2. Për 15 monitorues të AMA-s në masën 60,000 lekë dhe për 2 administratorët në masës 75,000 lek/personi.
3. Pjesa tjetër e stafit të AMA-s në mase $\frac{1}{2}$ e pagës.

Me shkresë nr. 1785 prot datë 28.04.2021 është nxjerr urdhër për shpërblimin e Anëtarëve dhe punonjësve të AMA-s lista bashkangjitur shkrese.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se në shkresën nr. 1785 datë 28.04.2021 për shpërblimin i punonjësve dhe anëtarëve të AMA-s nuk janë të pasqyruar dhe nuk kanë përfituar shpërblim të gjithë punonjësit e AMA-s por vetëm 64 punonjës ndërsa z. I.H. i cili duhet të përfitonte 38,200 leke $\frac{1}{2}$ e pagës sipas relacionit të vendimit të bordit nr. 61 datë 22.04.2021 nuk ka përfituar. *Veprime në kundërshtim me shkresë nr.1738 prot datë 22.04.2021 vendin nr. 61 “Një ndryshim në vendim e AMA-s nr. 153 datë 24.12.2020, “ Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021, të ndryshuar, II. Argumentimi i projekt-vendimit lidhur me problematikat, përparësitë dhe efektet e pritshme.*

Titulli gjetjes:	Trajtim jo i barabartë i punonjësve
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, sa i përket shpërblimeve të punonjësve për vitin 2021, një nga punonjësit nuk ka përfituar shpërblimin, pavarësisht faktit se në relacionin përkatës pasqyrohej se duhej të përfitonte vlerën prej 38,200 lekë (ekuivalente me $\frac{1}{2}$ e pagës), pa asnjë argumentim.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me shkresën nr.1738 prot datë 22.04.2021 vendin nr. 61 “Një ndryshim në vendim e AMA-s nr. 153 datë 24.12.2020, “ Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021, te ndryshuar, II. Argumentimi i projekt-vendimit lidhur me problematikat, përparësitë dhe efektet e pritshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Ndikimi/Efekti	Trajtimi i pabarabartë midis punonjësve.
Shkaku:	Mospërfitimi i shpërblimit nga të gjithë punonjësit.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të marrë masa për trajtimin e barabartë midis punonjësve në rastin e shpërblimeve financiare, ose të argumentojë rastet kur trajtimi është i ndryshëm bazuar në performancë individuale të punonjësit apo shkaqe të tjera të argumentuara.

b) Saktësia dhe rregullueshmëria e veprimeve të kryera në magazinë.

Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina dhe kontabilizimi i saj është bërë në mënyrë manuale. Fletë daljet e fletë hyrjet e magazinës ishin me blloqe dhe numra të ndarë për hyrjet dhe daljet e “brendshme”.

Nga audituan me zgjedhje hyrjet dhe daljet e “brendshme” rezultoi: Fletë Hyrjet e mallrave dhe materialeve “në përdorim” ishin të plotësuar në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë, shoqëruar me urdhër dorëzimi. Fletë Daljet e brendshme janë të ndara për dalje të mallrave e materialeve, për dalje të inventarit të imët, mobilieri e pajisje dhe magazina e librit. Fletë Daljet ishin të plotësuar në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë të firmosura nga marrësi në dorëzim, shoqëruar me urdhër dorëzimi. Magazineri rakordon me specialisten e financës mbi kartelat respektive çdo 3 muaj dhe në fund të vitit firmosin për lëvizjet, gjendjet në librat dhe regjistrat respektiv.

c) Inventarizimi

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2019-2022. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2019-2022 çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të **paktën një herë në vit** ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo raste dokumentohet me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

Procesi i inventarizimit të aktiveve, **për vitin 2019-2022** është kryer nga disa komisione të ngritur sipas urdhrit të titullarit të Institucionit “Për krijimin e komisionit të inventarizimit”.

Për vitin 2019

Në zbatim të urdhrit të Titullarit nr.4596 prot., datë 30.12.2019 “Kryerja e inventarizimit fizik të aktiveve të Institucionit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se: *“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”*.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2019 me shkresë nr.332 prot datë 27.01.2020 në lidhje me rezultatet nga ku ka konstatuar se ambientet e institucionit që ju nënshtruan inventarit rezultuan në rregull me përmbajtjen e tyre dhe materialet ekonomike dhe pajisjeve kompjuterike por disa prej artikujve në ngarkim të punonjësve rezultuan jashtë përdorimit dhe janë mbajtur shënimet përkatëse.

Gjithashtu në zbatim të urdhërit të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi me nr. 2669 prot datë 23.09.2020.

Komisioni i vlerësimit të aktiveve ka hartuar një relacion mbi vlerësimin e aktive me nr.2915 datë 15.10.2020 dhe ka propozuar që disa aktive të dalin nga përdorimi.

Me shkresë nr. 3179 prot., datë 10.11.2020 Titullari i Institucionit ka ngritur komisionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara nga AMA si dhe artikujt të konfiskuar nga ama dhe të referuara nga drejtoria rajonale e rezervave të Shtetit.

Me proces verbal datë 26.11.2020 komisioni ka bërë nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi duke i asgjësuar bashkëngjijt relacionit fotot përkatëse.

Për vitin 2020

Në zbatim të urdhrit të Titullarit nr.3765 prot datë 31.12.2020 *“Kryerja e inventarizimit fizik të aktiveve të Institucionit”*.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2020 me shkresë nr.3765/1 prot datë 18.01.2021 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ambientet e institucionit dhe magazina që ju nënshtruan inventarit rezultuan në rregull me përmbajtjen e tyre dhe materialet ekonomike dhe pajisjeve kompjuterike por disa prej artikujve në ngarkim të punonjësve rezultuan jashtë përdorimit dhe janë mbajtur shënimet përkatëse.

Gjithashtu në zbatim të urdhërit të Titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi me nr. 3684 prot datë 18.11.2021.

Me shkresë nr. 3684/1 datë 13.12.2021 kryetarja e komisionit të vlerësimit të aktiveve i kërkon titullarit të institucionit pezullimin e procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, pas ardhjes së kërkueses për mbështetje ndihme nga Qendra e zhvillimit “Pëllumbat” për pajisje dhe materialë, shkresë e cila është miratuar nga kryetari i Institucionit.

Për vitin 2021

Në zbatim të urdhrit të Titullarit nr.98 prot datë 10.01.2022 *“Kryerja e inventarizimit fizik dhe vlerësimit të aktiveve si dhe materialeve të magazinës të Institucionit”*.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:

“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2021 me shkresë nr.98/1 datë 11.01.2021 në lidhje me rezultatet e inventarizimit të magazinës ku ka konstatuar se gjendja e magazinës rezultuan në rregull me përmbajtjen e tyre. Ndërkohë me relacion



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

nr.92/2 ka konstatuar se ambientet e institucionit që ju nënshtruan inventarit rezultuan në rregull me përmbajtjen e tyre dhe materialet ekonomike dhe pajisjeve kompjuterike, por disa prej artikujve në ngarkim të punonjësve rezultuan jashtë përdorimit dhe janë mbajtur shënimet përkatëse, ndërkohë rezulton se mungon një lap top avancet Hp pro book nga zyra e zv, Kryetarit.

Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të Titullarit nr.98 prot datë 10.01.2022 “Kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve si dhe materialeve të magazinës të Institucionit”, në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresë nr.1388 prot datë 17.03.2022 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar.

Ndërkohë nga **Institucioni nuk është ngritur një komision për procesin e dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit**, duke mos e çuar kështu procesin deri në fund në kundërshtim me Udhëzimin nr.30/2011 pika 96 ku citohet: **Procesi i vlerësimit të aktiveve te propozuara për dalje nga përdorimi ne njësi, pika 96:** Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi ne njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim te nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: Titullari i Institucionit: znj. A. K.

Titulli i gjetjes:	Për vitin 2021 procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara, duke kryer vetëm procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të Titullarit nr.98 prot datë 10.01.2022 “Kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve si dhe materialeve të magazinës të Institucionit”, në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresë nr.1388 prot datë 17.03.2022 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar. Ndërkohë nga Institucioni nuk është ngritur një komision për procesin e dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit duke mos e çuar kështu këtë proces deri në fund.
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Pika 95 dhe 96
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe pasqyrimin në kontabilitet të ngjarjeve ekonomike vijuese, referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Nga auditimi me zqjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve për karburant për automjetet e AMA-së, u konstatua se:

Nga Sektori i Financës për secilin automjete mbahet si dokument vërtetues për konsumin e karburantit kartela, në të cilat pasqyrohen të gjitha shpenzimet të shoqëruara me fletë udhëtimet e tyre përkatëse.

Nga drejtuesit e automjeteve në të gjitha rastet fletë-udhëtimet nuk ishin të plotësuar në mënyrë korrekte, pasi për inteneraret e përshkruara ato plotësoheshin nga shoferët e automjeteve pa u



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

vërtetuar me firmat e nëpunësve udhëtues të kryerjes së shërbimit. (Tabela me poshtë e detajuar)
Veprimet ne kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 739 prot 12.02.2018 “Për parimet dhe rregullat e përgjithshme për menaxhimin e aktiveve ne Autoritetin e Mediave Audiovizive” neni 5.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. A. K.

Viti 2019	
Targat e mjete	karburanti i harxhuar në litra
AA496BO	2080
AA089BO	3040
TR2901I	2610
AA019XO	1310
AA082XO	1790
Totali	10830

Viti 2020	
Targat e mjete	karburanti i harxhuar në litra
AA089BO	2330
TR2901I	2580
AA019XO	1940
AA082XO	2430
Totali	9280

Viti 2021	
Targat e mjete	karburanti i harxhuar në litra
AA089BO	3400
TR2901I	310
AA019XO	1910
AA082XO	2890
Totali	8510

30.06.2022	
Targat e mjete	karburanti i harxhuar në litra
AA089BO	1510
AB485GL	500
AA019XO	800
AA082XO	1500
Totali	4310



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Titulli gjetjes:	Parregullsi në plotësimin e fletë udhëtimeve të automjeteve.
Situata:	Nga drejtuesit e automjeteve në të gjitha rastet fletë-udhëtimet nuk ishin të plotësuara në mënyre korrekte, pasi për intineraret e përshkruara ato plotësoheshin nga shoferët e automjeteve pa u vërtetuar me firmat e nëpunësve udhëtues të kryerjes së shërbimit.
Kriteri:	Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 739 prot 12.02.2018 “Për parimet dhe rregullat e përgjithshme për menaxhimin e aktiveve në Autoritetin e Mediave Audiovizive” neni 5.
Ndikimi/Efekti	Mos justifikim i shpenzimeve të kryera.
Shkaku:	Parregullsi në plotësimin e dokumenteve justifikues.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandimi:	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa që për çdo fletë-udhëtim të dorëzuar nga shoferët, në fund të muajit të jenë të plotësuara në mënyre të saktë me të gjithë elementet e nevojshme sic janë <i>1. itinerari i udhëtimit të përshkruar, 2. kilometrat e udhëtimit të përshkruar si dhe litrat e karburantit të harxhuar për itinerarin e udhëtimit, 3. Punonjësi i Ama-s në me të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe firma e tij.</i> Në fund të fletë udhëtimeve të bëhet përmbledhja e kilometrave të përshkruara si dhe litrat e harxhuara.

Mbi shpenzimet për prokurimet me vlera të vogla.

Për vitin 2019 me urdhrin nr.51 prot datë 09.01.2019 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2019” miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm komisioni përbëhet nga F. D. Kryetare, K.K. dhe E.H. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2019 me urdhrin nr.53 prot datë 04.01.2019 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm komisioni përbëhet nga F. D. Kryetare, K. K. dhe E. H. anëtare.

Për vitin 2020 me urdhrin nr.4594 prot datë 31.12.2019 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2020” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbëhet nga A.B. Kryetar, A.B. dhe D.J. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2020 me urdhrin nr.4595 prot datë 30.12.2019 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbëhet nga A.B. Kryetar, A.B. dhe D.J. anëtare.

Për vitin 2021 me urdhrin nr.15 prot datë 05.01.2021 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2021” miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm komisioni përbëhet nga A. B. Kryetar, K.K. dhe D.J. anëtare.

Gjithashtu për vitin 2021 me urdhrin nr.16 prot datë 05.01.2021 “Krijimi i komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm komisioni përbëhet nga A.B. Kryetare, K. K. dhe D.J. anëtare.

Për vitin 2022 me urdhrin nr.210 prot datë 11.01.2022 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

vlerë të vogël për vitin 2021” miratuar nga Titullari i Institucionit komisioni përbehet nga A. K. Kryetar, K.K. dhe E.B. anëtare.

Për vitin 2019 janë realizuar në total 26 procedura prokurime me vlerë të vogël dhe 50 procedura prokurimi me vlerë më të vogël së 100,000 lekë.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 12,380,392 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 8,311,172 lekë pa TVSh, për Sistemin dinamik të Blerjeve të biletave janë parashikuar 2,300,000 si fond limit dhe vlera e kontratës së realizuar është 2,013,426 lekë.

Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 9 procedura prokurimi me blerje të vogël me fond limit të parashikuar në vlerën 5,205,170 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 3,917,649 lekë pa TVSh dhe nga sistemi Sistemin dinamik i Blerjeve të biletave janë përzgjedhur 6 procedura me vlerë të kontratës së realizuar 1,004,999 lekë.

Për vitin 2020 janë realizuar në total 30 procedura prokurime me vlerë të vogël dhe 39 procedura prokurimi me vlerë më të vogël së 100,000 lekë.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 11,011,923 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 7,690,692 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 8 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 5,684,137 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 3,289,160 lekë pa TVSh.

Për vitin 2021 janë realizuar në total 23 procedura prokurime me vlerë të vogël dhe 33 procedura prokurimi me vlerë më të vogël së 100,000 lekë.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 11,523,729 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 8,573,634 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 9 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 6,059,538 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 4,491,580 lekë pa TVSh.

Deri me 30.06.2022 janë realizuar 12 procedura prokurime me vlerë të vogël dhe 15 procedura prokurimi me vlerë më të vogël së 100,000 leke.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë parashikuar 5,838,324 lekë si fond limit nga ku vlera e kontratës së realizuar është 3,236,388 lekë pa TVSh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 6 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 3,840,655 lekë dhe me fond të realizuar në vlerë kontratë në shumën 2,707,090 lekë pa TVSh.

Gjithashtu nga grupi i auditimit u përzgjedhën 2 procedura të sistemit dinamik biletave të transportit ajror ndërkombëtar me vlerë 664,100 lekë.

Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua mangësi si më poshtë.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për prokurim me nr.315 prot me datë 16.01.2019 me lëndë “Kërkesë për mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit dhe aspirimit”. Me urdhër prokurimi nr.315/1 prot., datë 16.01.2019 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte AK ka kërkuar kriter si më poshtë:

2. Operatori ekonomik që do të mirëmbajë këtë sistem, duhet të ketë eksperiencë në këtë fushe (për VRF system) me të paktën 3 vjet.

3. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë certifikate trajnimi për sistemet e Kondicionimit VRF (Variable Refrigerant Flow).

4. Të ketë të paktën 2 punonjës të trajnuar në këtë fushe (për VRF system) të cilin duhet të jenë të certifikuar nga vetë prodhuesit.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 8, pasi OE-t e renditur në vendi e dytë dhe të shtatë janë skualifikuar për mos plotësim të kriterëve të përcaktuara nga AK, ndërsa OE e tjerë janë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

skualifikuar pasi kanë njoftuar AK për tërheqë nga procedura e prokurimit.

Me nr.315/2 datë 07.02.2019 është lidhur kontrata midis OE “N.E” dhe AK me vlerën **840,00** lekë me TVSh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se nuk janë argumentuar kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë. Gjithashtu komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka mbajtur procesverbale për arsyet e kalimit nga OE i renditur në vendin e parë dhe me radhë deri tek OE i shpallur fitues. Gjithashtu nuk ka një procesverbal për OE e shpallur fitues por është vetëm kontrata e lidhur midis tij dhe AK. Kpvv nuk ka bërë përlllogaritjen e fondin limit por është bazuar në fondin e parashikuar për këtë objekt prokurimi i cili është 800,000 lek pa TVSh.

Gjithashtu në dokumentat e OE të shpallur fitues “N.E.” certifikata e dorëzuar nuk është për sistemet VRF kriter i vendosur nga AK. Gjithashtu edhe 2 certifikatat e dorëzuar për punonjësit e trajnuar për sistemet VRF siç cituam dhe me sipër nuk janë për sistemet VRF, OE nuk ka dorëzuar liste pagesë ose kontrata pune ku të verifikohet se punonjësit e certifikuar janë në marrëdhënie pune me këtë OE.

Kpvv duhet të skualifikonte OE e shpallur fitues “N.E.” pasi nuk plotëson pikën 2, 3 dhe 4 të kriterëve të vendosura në ftesën për ofertë.

Referuar me sipër KPVV nuk ka siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera. *Në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,, neni 1 pika 2 . Neni 2 Parimet e përzgjedhjes , neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 5, 15 dhe 17. Referuar nenit 18 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme dhe duhet të protokollohen. Referuar nenit 19 të këtij akti, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: F. D., K. K. dhe E. H.

2. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.990 prot me datë 25.02.2019 me lëndë “Kërkesë për blerje boje për fotokopje dhe printerë”.

Me urdhër prokurimi nr.990/1 prot., datë 25.02.2019 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për ofertë AK ka kërkuar kriter si më poshtë:

Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me certifikatat ISO si vijon:

EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

ISO/EC 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 9, pasi OE-t e tjera kanë njoftuar AK për tërheqë nga procedura e prokurimit. Paga është kryer nga Banka R me datë 02.04.2019 me vlerë **815,280** me TVSh kundrejt Oe fituese “E. I.”

Nga auditimi i procedurës konstatohet se KPVV nuk ka bërë përlllogaritjen e fondin limit por është bazuar në fondin e parashikuar për këtë objekt prokurimi i cili është 696,800 lek pa TVSh, dhe nuk



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

ka argumentuar kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë.

Gjithashtu konstatohet se certifikata 9001:2015 gjen referim në llojin e objektit të prokurimit, ndërsa certifikatat e tjera si 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46, VKM 914 datë 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017" e ndryshuar neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 5.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: F. D., K. K.dhe E. H.

3. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.1666 prot., me datë 22.06.2020 me lëndë "Kërkesë për mirëmbajtje për automjetet e AMA-s". Vlëra e përlogaritur për fondin limit është **250,000** lekë pa TVSh dhe komisioni i është referuar kontratave të mëparshme.

Me urdhër prokurimi nr.2075 prot date 27.07.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me procesverbal nr.2075/1 datë 03.08.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 5, pasi OE-t e renditur nga vendi i parë deri në vendin e katër janë skualifikuar, pasi nuk kanë kontaktuar me AK brenda 2 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e App, kriter i përcaktuar nga Kpvv në Ftesa për Ofertë.

Me nr.1666/1 datë 07.08.2020 është lidhur kontrata midis Oe "A.D." dhe AK me vlerën **278,832** lekë me TVSh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se nuk janë argumentuar kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë. Gjithashtu komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 2 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s'kualifikojnë. KPVV ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pasi në pikën 15 të saj është e përcaktuar se afati do të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit publik. KPVV pas publikimit të fituesit duhet të priste minimalisht deri në ditën e nesërmen të punës dhe në rast se OE i shpallur fitues nuk paraqitej në afatin kohorë atëherë duhet ta s'kualifikonte dhe të kalonte tek OE e renditur në vendin e dytë dhe me radhë. Mos respektimi i afatit të pritjes së OE të renditur në vendin e parë ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të OE pjesëmarrës. KPVV nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera, në kundërshtim me Ligjin e nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,, neni 1 pika 2, Neni 2 Parimet e përzgjedhjes a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, VKM nr.914 datë 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017” e ndryshuar neni 40 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 15 dhe 17.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. B., A. B. dhe D.J.

4. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.2490 prot me datë 08.09.2020 me lëndë “Kërkesë për shërbimin e lyerjes së ambienteve të AMA-s”. Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka argumentuar e fondin limit i cili është **650,000** lekë pa TVSh, Kpvv i është referuar fondit të parashikuar për këtë objekt prokurimi.

Me urdhër prokurimi nr.2665 prot date 22.09.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me procesverbal nr.2665/1 datë 01.10.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 10. OE-t e renditur nga vendi i parë deri në vendin e nëntë janë skualifikuar, pasi nuk kanë kontaktuar me AK brenda 2 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, kriter i përcaktuar nga Kpvv në Ftesa për Ofertë.

Pagesa është kryer nga Banka Kombëtare Tregtare me datë 13.11.2020 me vlere **741,600** me TVSh. **Nga auditimi i procedurës konstatohet se** nuk janë argumentuar kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë. Gjithashtu komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 2 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s’kualifikojnë. KPVV ka vepruan në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pasi në piken 15 të saj është e përcaktuar se afati do të jete minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit publik. KPVV pas publikimit të fituesit duhet të priste minimalisht deri në ditën e nesërmen të punës dhe në rast se OE i shpallur fitues nuk paraqitej në afatin kohore atëherë duhet ta s’kualifikonte dhe të kalonte tek Oe e renditur në vendin e dyte dhe me radhë. Mos respektimi i afatit të pritjes së OE të renditur në vendin e parë ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të OE pjesëmarrës.

Ndërkohë certifikata En – ISO 9001:2015 e dorëzuar nga OE i shpallur fitues B. L. është e subjektit “D.” dhe jo e OE fitues B.L., në këtë rast KPVV duhet të skualifikonte OE B. L. dhe të rishpallte procedurën e prokurimit.

Kpvv nuk ka siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera.

Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,, neni 1 pika 2 citon: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 2 Parimet e përzgjedhjes a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, VKM nr.914 datë 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017” e ndryshuar neni 40, dhe neni



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

60 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15, 16 dhe 17.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: A.B., A.B. dhe D. J.

5. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.2957 prot., me datë 21.10.2020 me lëndë “Kërkesë për Prokurimin e një serveri backup”.

Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka bërë argumentimin e fontit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlogaritur e fondit limit është **795,000** lekë pa TVSh.

Me urdhër prokurimi nr.3538 prot date 14.12.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me procesverbal nr.3603/1 datë 17.12.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e tretë. OE-t e renditur në vendi i parë dhe në vendin e dytë janë skualifikuar, pasi nuk kanë kontaktuar me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, kriter i përcaktuar nga Kpvv në ftesën për ofertë.

Me nr.3538/1 datë 21.12.2020 është lidhur kontrata midis OE “B.E.” shpk dhe AK me vlerën **840,000** lekë me TVSh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s’kualifikojnë. Kpvv ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pasi në pikën 15 të saj është e përcaktuar se afati do të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit publik. Kpvv pas publikimit të fituesit duhet të priste minimalisht deri në ditën e nesërmen të punës dhe në rast se OE i shpallur fitues nuk paraqitej në afatin kohorë atëherë duhet ta s’kualifikonte dhe të kalonte tek OE e renditur në vendin e dytë dhe me radhë. Mos respektimi i afatit të pritjes së OE të renditur në vendin e parë ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të OE pjesëmarrës.

Gjithashtu konstatohet se OE i renditur në vendin e dytë ka dorëzuar dokumentacione për procedurën e prokurimit pranë AK, por oferta e tij nuk është hapur dhe OE është skualifikuar pasi OE nuk ka njoftuar AK brenda 3 orëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

Grupi i auditimit pasi hapi dhe shqyrtoj dokumentacionin e ofertuesit të renditur në vendin e dytë konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar nga OE “S. Co” është komfort specifikimeve teknike të vendosura në ftesën për ofertë, oferta e sjellë nga OE “S. Co” është në vlerën **665,880** lekë me TVSh.

Në këtë rast Kpvv nuk ka siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera, Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 pika 2 citon: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 2 Parimet e përzgjedhjes a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

40 dhe 66 pika 3 dhe Udhëzimi nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15, 16 dhe 17, pika 15 citon: Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t’i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë.

Afati i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në ftesën për ofertë për paraqitjen e dokumentacionit nga ofertuesi i renditur në vend të parë nuk duhet të përkohet në ditë pushimi (e shtunë, e dielë, festë zyrtare). Ky afat duhet të jetë **minimalisht dita e nesërme** e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

Referuar me sipër, OE i shpallur fituese “B. E.” shpk dhe skualifikimi i OE “S. Co” me ofertë me të ulët kemi të bëjmë me dëm ekonomik vlerën 174,120 lekë me Tvsh diferenca midis OE.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. B., A.B. dhe D. J.

6. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.2003 prot me datë 24.07.2020 me lëndë “Kërkesë për ndryshim sasie dhe fondi limit për blerje karburanti”.

Me urdhër prokurimi nr.2154 prot., datë 05.08.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me procesverbal nr.2412/1 datë 07.08.2020 ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e parë.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që sasie e lëvruar do të jetë me tollona 10L, në kundërshtim me VKM nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ndërsa për vitet 2019-2020 është përdorur sistemi me kartë elektronike në përputhje me VKM nr.561 datë 29.07.2016.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. B., A. B. dhe D. J.

7. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.96 prot., me datë 11.01.2021 me lëndë “Kërkesë për dezinfektimin të ambienteve të AMA-s”.

Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka bere argumentimin e fontit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlere e përlllogaritur e fondit limit është **734,000** lekë pa TVSh.

Me urdhër prokurimin nr.706 prot., datë 09.02.2021 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 5.

OE i renditur në vendi e parë është skualifikuar pasi nuk plotësonte disa nga kriteret e vendosua nga AK.

Oe të renditur në vendin e dytë dhe të tretë janë skualifikuar pasi nuk kanë kontaktuar me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, kriter i përcaktuar nga Kpvv në Ftesën për Ofertë, ndërsa OE i renditur në vendin e katërt është tërhequr nga procedura.

Me nr.706/1 datë 19.02.2021 është lidhur kontrata midis OE “E. M.” shpk dhe AK me vlerën **648,000** lekë pa TVSh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë te vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s’kualifikojnë. Kpvv ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pasi në pikën 15 të saj është e përcaktuar se afati do të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit publik. KPVV pas publikimit të fituesit duhet të priste minimalisht deri në ditën e nesërmen të punës dhe në rast se OE i shpallur fitues nuk paraqitej në afatin kohorë atëherë duhet ta s’kualifikonte dhe të kalonte tek OE e renditur në vendin e dytë dhe me radhë. Mos respektimi i afatit të pritjes së OE të renditur në vendin e parë ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të OE pjesëmarrës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

KPVV nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera, *Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,, neni 1 pika 2 , Neni 2, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 40 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 15 dhe 17.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. B., K. K. dhe D. J.

8. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.312 prot me datë 20.01.2021 me lëndë *"Kërkesë për blerje të pajisjeve elektronike"*.

Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka bërë argumentimin e fontit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlllogaritur e fondit limit është **795,000** lekë pa TVSh.

Me urdhër prokurimi nr.543 prot date 29.01.2021 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 3.

OE i renditur në vendi e parë është skualifikuar pasi nuk kanë kontaktuar me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, kriter i përcaktuar nga Kpvv në Ftesa për Ofertë, ndërsa OE i renditur në vendin e dytë është tërhequr nga procedura.

Me datë 08.02.2021 është mbajtur proces verbali i dorëzimit të mallit dhe pagesa është kryer nga Banka C me datë 10.02.2021 me vlerë 701,999 me TVSh kundrejt OE fitues "IT Gj. K." shpk.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s'kualifikojnë. KBVV ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 *"Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"* pasi në pikën 15 të saj është e përcaktuar se afati do të jete minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit publik. Kpvv pas publikimit të fituesit duhet të priste minimalisht deri në ditën e nesërmen të punës dhe në rast se OE i shpallur fitues nuk paraqitej në afatin kohorë atëherë duhet ta s'kualifikonte dhe të kalonte tek OE e renditur në vendin e dytë dhe me radhë. Mos respektimi i afatit të pritjes së OE të renditur në vendin e parë ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të OE pjesëmarrës.

KPVV nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe ka cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera, *Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,, neni 1 pika 2 , Neni 2, VKM nr. 914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 40 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 15 dhe 17.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A.B., K. K. dhe D. J.

9. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.1021 prot., me datë 01.03.2021 me lëndë *"Kërkesë për blerje boje për fotokopje dhe printerë"*.

Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka bere argumentimin e fontit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlllogaritur e fondit limit është 586,491 lekë pa TVSh.

Me urdhër prokurimi nr.1061 prot date 03.03.2021 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte AK ka kërkuar kriter si më poshtë:

Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me certifikatat ISO si me vijon:

EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

ISO/EC 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 3, pasi OE-ja e renditur në vendin e parë ka njoftuar AK për tërheqje nga procedura e prokurimit, ndërsa OE i renditur në vendin e dytë është skualifikuar pasi nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga AK.

Pagesa është kryer nga Banka R. me datë 16.03.2021 me vlerë 478,800 me TVSh kundrejt OE fituese "IT Gj. K."

Nga auditimi i procedurës konstatohet se certifikata 9001:2015 gjen referim në llojin e objektit të prokurimit, ndërsa certifikatat e tjera si 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me *përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46.*

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A.B., K. K. dhe D.J.

10. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.477 prot me datë 26.01.2022 me lëndë "Kërkesë për blerje Hard disk të jashtëm".

Kpvv me proces verbal pa nr. prot dhe datë ka bërë argumentimin e fondit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlogaritur e fondit limit është 372,267 lekë pa TVSh.

Kpvv me proces verbal pa nr. Prot, datë 14.02.2022 ka argumentuar specififikimet teknike.

Me urdhër prokurimi nr.683 prot date 14.02.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte AK ka kërkuar kriter si me poshtë:

ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë), e cila të përfshijë objektin e prokurimit.

ISO/EC 27001 : 2013 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurtë të informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Me procesverbal pa nr. prot datë 25.02.2022 KPVV ka shpallur fitues OE të renditur në vendin e parë. Pagesa është kryer nga Banka R. me datë 10.03.2022 me vlerë 320,880 me TVSh kundrejt OE fituese "I.S." shpk.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se certifikata 9001:2015 gjen referim në llojin e objektit të prokurimit, ndërsa certifikatat e tjera si ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemi i Menaxhimit të Sigurtë të Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemi i Menaxhimit të Sigurtë të Informacionit. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me *përcaktimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36* Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46, dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 44.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. K., K. K. dhe E. B.

11 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.935 prot me datë 25.02.2022 me lëndë "Kërkesë për furnizim vendosje drum".

Kpvv me proces verbal nr.1413/1 prot datë 05.04.2022 ka bere argumentimin e fondit limit duke marrë 3 oferta në treg dhe vlera e përlllogaritur e fondit limit është 20,333 lekë pa TVSh.

Kpvv me proces verbal nr.1413/2 Prot, datë 06.04.2022 ka argumentuar specifikimet teknike.

Me urdhër prokurimi nr.1413 prot date 05.04.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte AK ka kërkuar kriter si më poshtë:

ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë), e cila të përshijë objektin e prokurimit.

ISO/EC 27001 : 2013 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jete e vlefshme.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Me procesverbal nr.1413/3 prot datë 08.04.2022 Kpvv ka skualifikuar OE e renditur në vendin e parë pasi nuk ka dorëzuar certifikatën ISO/EC 27001 : 2013 ose ekuivalente.

Me procesverbal nr.1413/4 prot datë 11.04.2022 Kpvv ka shpallur fitues OE e renditur në vendin e dytë pasi dokumentacioni është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Me nr.1526/1 datë 15.04.2022 AK i ka kthyer përgjigje OE të renditur në vendin e parë dhe të skualifikuar se ankesa e ardhur prej tij nuk është shqyrtuar pasi ka ardhura jashtë afateve kohore të përcaktuara në ligjin e LPP.

Pagesa është kryer nga "B" me datë 22.04.2022 me vlere 22,080 me TVSh kundrejt OE fituese "E. H."

Nga auditimi i procedurës konstatohet se KPVV me proces verbal nr.1413/2 Prot, datë 06.04.2022 ka argumentuar specifikimet teknike sic është vendosjen e certifikata ISO 9001:2015 por nuk ka argumentuar se përse është kërkuar certifikata tjetër ISO/EC 27001 : 2013.

Gjithashtu konstatohet se certifikata ISO 9001:2015 gjen referim në llojin e objektit të prokurimit, ndërsa certifikatat e tjetër si ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me *përcaktimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36* Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre si dhe nenet 23 dhe 46, dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 44.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A. K., K. K. dhe E. B.

Titulli i gjetjes:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit.
Situata:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit në procedurat, si më poshtë: ✓ Procedura blerje boje për fotokopje dhe printerë 2019. Certifikatat ISO 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT. ✓ Procedura blerje boje për fotokopje dhe printerë 2021. Certifikatat ISO 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT. ✓ Procedura blerje hard disk te jashtëm 2022. Certifikatat ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. ✓ Procedura furnizim vendosje drum 2022. Certifikatat ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë i cili është blerje mallrash, por i shërben vetë subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.
Kriteri:	Neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; nenet 23 dhe 46, VKM 914 Date 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017" e ndryshuar neni 40, 59 dhe udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 5. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36 "Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre", si dhe nenet 23 dhe 46, dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 44.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Ndikimi/Efekti	Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e Operatoreve Ekonomik dhe nuk nxisin pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik.
Shkaku:	Devijimi nga kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit publik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të marrë masa për hartimin e kriterëve në mënyrë jo diskriminuese apo orientuese, në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të OE, si dhe të nxitë pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre .

Titulli gjetjes:	Përcaktim i pambështetur ligjërisht i afatit për njoftimin për të realizuar procedurën.
Situata:	Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, në ftesën për ofertë, ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 2 ose 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta skualifikojnë, e referuar kjo në procedurat, si më poshtë: ✓ <i>Mirëmbajtje për automjetet e AMA-s” 2020.</i> ✓ <i>Shërbimin e lyerjes së ambienteve të AMA-s”2020.</i> ✓ <i>Prokurimin e një serveri backup” 2020.</i> ✓ <i>Dezinfectimin të ambienteve të AMA-s” 2021.</i> ✓ <i>Blerje të pajisjeve elektronike” 2021.</i>
Kriteri:	<i>-Pika 15 dhe 17 e Udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</i>
Ndikimi/Efekti	Vendosja e afatit të pambështetur ligjërisht, ka sjellë skualifikimin e ofertave pavarësisht plotësimit ose jo të kriterëve teknike që do të garantonin zbatimin me sukses të kontratës, duke cënuar parimin e vlerësimit të ofertave bazuar në economicitet.
Shkaku:	Përcaktim i pambështetur ligjërisht i afatit për njoftimin e zhvillimit të kontratës.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Komisioni i prokurimit me vlere te vogël të marrë masa për shmangien e vendosjes së kriterëve të pambështetura ligjërisht, të cilat cënojnë parimin e vlerësimit të ofertave bazuar në economicitet.

Titulli gjetjes:	Parregullsia në vlerësimin e ofertave.
Situata:	✓ Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (KPVV) ka marrë kërkesë për prokurim me nr.315 prot, me datë 16.01.2019 me lëndë <i>”Kërkesë për mirëmbajtje e sistemit te kondicionimit dhe aspirimit”</i> . Nga auditimi në dokumentat e OE të shpallur fitues “N. E.” certifikata e dorëzuar nuk është për sistemet VRF kriter i vendosur nga AK. Gjithashtu edhe 2 certifikatat e dorëzuara për punonjësit e trajnuar për sistemet VRF siç cituam dhe më sipër, nuk janë për sistemet VRF, OE nuk ka dorëzuar listë pagese ose kontrata pune ku të verifikohet se punonjësit e certifikuar janë në marrëdhënie pune me këtë OE.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	✓ Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.2490 prot., me datë 08.09.2020 me lëndë <i>"Kërkesë për Shërbimin e lyerjes së ambienteve të AMA-s"</i>. Nga auditimi konstatohet se certifikata ISO 9001:2015 e dorëzuar nga OE i shpallur fitues B.L. është e subjektit "D." dhe jo e OE fitues B. L.
Kriteri:	<i>VKM nr. 914 datë 29.12.2014 Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017" e ndryshuar neni 66 pika 3. Udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike";</i>
Ndikimi/Efekti	Vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit publik.
Shkaku:	Mos vlerësimi i saktë i ofertave ekonomike.
Rëndësia:	I larte.
Rekomandimi:	Komisioni i prokurimi me vlere te vogël të marrë masa ku të kualifikojë dhe shpallë fitues Operatorët Ekonomik pasi të plotësojnë çdo kriter të veçantë të vendosur ne ftesën për ofertë.

Titulli gjetjes:	Skualifikimi i padrejtë i Operatorëve Ekonomikë me ofertë më të ulët.
Situata:	<i>Procedura për Prokurimin e një serveri backup 2020".</i> Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë te vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta s'kualifikojnë. KPVV ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.3, datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 15. Gjithashtu konstatohet se OE i renditur në vendin e dytë ka dorëzuar dokumentacione për procedurës e prokurimit pranë AK, por oferta e tij nuk është hapur dhe OE është skualifikuar pasi OE nuk ka njoftuar AK brenda 3 orëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP. Grupi i auditimit pasi hapi dhe shqyrtoj dokumentacion e ofertuesit të renditur në vendin e dytë konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar nga OE "S.Co." është komfort specifikimeve teknike të vendosura në ftesën për oferte, oferta e sjelle nga OE "S. Co." është në vlerën 665,880 lekë me TVSh. Referuar me sipër, OE i shpallur fituese "B. E." shpk dhe skualifikimi i OE "S.Co." me ofertë më të ulët kemi të bëjmë me dëm ekonomik në vlerën 174,120 lekë me TVSH, si diferencë midis OE.
Kriteri:	<i>VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar , neni 40 dhe 66 pika 3 dhe Udhëzimi nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 15, 16 dhe 17, pika 15 citon: "Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Afati i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në ftesën për ofertë</i>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	<i>për paraqitjen e dokumentacionit nga ofertuesi i renditur në vend të parë nuk duhet të përkojë në ditë pushimi (e shtunë, e dielë, festë zyrtare). Ky afat duhet të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.”</i>
Ndikimi/Efekti	Vlerësimi në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit publik.
Shkaku:	Dëm ekonomik në fondet e AMA në vlerën 174,120 lekë me tvsh.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga AMA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 174,120 lekë , nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulët në procedurën e vitin 2020 "Kërkesë për Prokurimin e një serveri backup".

- **Në zbatim të pikës nr.8 të programit të auditimit nr.896/2, datë 03.11.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

a) Emërimet dhe largimet.

Në zbatim të pikës nr.8 të programit të auditimit nr.896/2, datë 03.11.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

b) Emërimet dhe largimet.

c) Zbatimi i vendimeve të Gjykatave për punonjës e larguar nga puna.

Emërimet

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në AMA janë emëruar gjithsej 7 punonjës, nga të cilët 5 punonjës me status Nëpunësi Civil, dhe 2 punonjës me Kod Pune.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në AMA janë emëruar gjithsej 2 punonjës, nga të cilët 1 punonjës me status Nëpunësi Civil dhe 1 punonjës me Kod Pune.

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në AMA janë emëruar gjithsej 7 punonjës, nga të cilët 2 punonjës janë emëruar me status Nëpunësi Civil dhe 5 punonjës me Kod pune.

Për periudhën 01.01.2022-30.06.2022, në AMA janë emëruar gjithsej 7 punonjës, nga të cilët 1 punonjës është emëruar me status Nëpunësi Civil dhe 6 punonjës me Kod pune.

Largimet

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në AMA i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 12 punonjësve, për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Lirim nga shërbimi civil (Dorëheqje)	4	33%
Përfundim kontrate (Dorëheqje) kod pune	5	42%
Pezullim statusi	2	17%
Dalje në pension	1	8%
Totali	12	

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në AMA nuk ka pasur ndërprerje të marrëdhënieve të punës me punonjësve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në AMA i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 11 punonjësve për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Lirim nga shërbimi civil (Dorëheqje)	1	9%
Përfundim kontrate	3 anëtare Komisioni Ankesave (mbaruar mandati) + 3 dorëheqje + 4 mbyllje strukture.	91%
Totali	11	

Për periudhën 01.01.2022-30.06.2022 në AMA i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 7 punonjësve për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Lirim nga shërbimi civil (Dorëheqje)	3	43%
Vendimi I Kmshe	1	14%
Përfundim kontrate (Dorëheqje)	3	43%
Totali	7	

Proceset Gjyqësore

-Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë planifikuar për shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna, si më poshtë:

Zëri "Shpenzime për vendime gjyqësore për ish-punonjës"	Masa e parashikuar	Masa e realizuar
Vendimi nr. 202, datë 24.12.2018, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2019"	8,409,416	0
Vendimi nr. 183, datë 19.12.2019, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020"	8,642,616	4,181,090
Vendimi nr.153, datë 24.12.2020, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021"	5,079,120	0
Vendimi nr. 97, datë 21.12.2021, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2022"	6,233,760	0

Detyrimi i paguar, ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbartimore, për gjithë periudhën e auditimit, paraqitet në tabelë dhe në listat bashkëlidhur.

Viti	Përshkrimi	Pagesë për vendimin gjyqësor për largim nga puna	Pagesë përmbartimore	TOTALI
------	------------	--	----------------------	--------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

2019	Pagesë për Vendimet gjyqësore	0	0	0
2020	Pagesë për Vendimet gjyqësore	3,829,207	351,883	4,181,090
2021	Pagesë për Vendimet gjyqësore	0	0	0
30.06.2022	Pagesë për Vendimet gjyqësore	0		
TOTALI		3,829,207	351,883	4,181,090

Shpenzimet gjyqësore për periudhën objekt auditimi së bashku me shpenzimet përmbartimore më të detajuara në tabelën e më poshtë.

Vendimet gjyqësore të likuiduara					
Emri i gjyq fituesit	Vendimet gjyqësore të formës së prerë	Data e pagesës	Pagesë për vendimin gjyqësorë	Pagesë përmbartimore	Totali
E. B.	17.12.2019	18.06.2020	3,665,455	351,883	4,017,338
F. H.	23.01.2020	26.02.2020, 03.06.2020	163,752	0	163,752
			3,829,207	351,883	4,181,090

Nga auditimi u konstatua se janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 2 ish-punonjës në vlerën totale **4,181,090** lekë. Vendimi gjyqësor i znj. E. B. nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga AMA, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve me shkresë nr.1407 prot datë 05.06.2020 të lëshuara nga përmbartuesit privat duke paguar tarifa përmbartimore, në vlerë totale prej **351,883 lekë**.

Gjithashtu në rastin e znj. E. B. AMA nuk ka ushtruar të drejtën e saj në 2 raste si më poshtë vijon:

- 1) Të ankimojë në Gjykatë pezullimin e veprimeve përmbartimore.
- 2) Të kërkojë në Gjykatë interpretimin se sa është pjesa që do të paguaj AMA dhe sa Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3239 datë 17.12.2019 citon: Detyrimet e palëve të paditura, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive ti paguaj paditësit, E. B., pagën si kryetare e KKRT-së sot Ama.

Vendimet gjyqësore janë shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit, të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej **4,181,090 lekë**.

Veprimet e sipërme nuk janë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 “Rregullat e njoftimit shkresor të akteve” ku citon se “Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve”, neni 451/a ku citon se “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët” dhe neni 510/a “Titujt ekzekutivë”.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: ish titullari z. G. S., ish Sekretarja e Pergjithshme znj. V. M., Drejtore Juridike znj. S. X. dhe Nëpunësi zbatues znj. M. P.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 24.04.2023 me nr.896/6 prot.

Pretendimi i subjektit: Së pari saktësojmë se shpenzimet për zj. E. B. në masën 4,017,338 lekë (3,665,455 lekë + 351,883 lekë) nuk janë paguar nga AMA, por janë vënë në sekuestro nga shoqëria përmbarimore private “A” sh.p.k. në llogarinë e AMA-s në R. Bank. (bashkëlidhur nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 18.06.2020);

Zyra Përmbarimore Private “A” sh.p.k. me shkresën nr. 1318 prot., datë 28.05.2020, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, me lajmërimin për ekzekutim vullnetar. (bashkëlidhur shkresa nr. 1308 prot., datë 28.05.2020);

AMA, me shkresën nr. 1318/1 prot., datë 01.06.2020, i ka kthyer përgjigje Zyrës Përmbarimore Private “A” sh.p.k. (bashkëlidhur shkresa nr. 1308/1 prot., datë 01.06.2020);

Zyra Përmbarimore Private “A” sh.p.k. me shkresën nr. 1407 prot., datë 05.06.2020, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. (bashkëlidhur shkresa nr. 1407 prot., datë 05.06.2020);

Zyra Përmbarimore Private “A” sh.p.k. me shkresën nr. 1408 prot., datë 05.06.2020, i është drejtuar 12 bankave të nivelit të dytë, duke vënë në dijeni Kuvendin e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive, për vënie sekuestro Konservative mbi llogaritë e debitorit (bashkëlidhur shkresa nr. 1408 prot., datë 05.06.2020);

AMA, me shkresën nr. 1408/1 prot., datë 05.06.2020, iu është drejtuar për mosvënie sekuestro Konservative 3 (tre) bankave të nivelit të dytë (ku ka patur llogari të tij për zhvillimin e aktivitetit të institucionit) B, C Bank dhe R Bank, duke vënë në dijeni Zyrën Përmbarimore Private “A” sh.p.k. dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

AMA, me këtë shkresë i ka njoftuar institucionet/shoqëri të sipërcituara, që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, nuk ka përcaktuar pjesën e detyrimit që secila palë debitore (AMA dhe Kuvendi) i detyrohen palës kreditore. (bashkëlidhur shkresa nr. 1408/1 prot., datë 05.06.2020);

R Bank me shkresën nr. 11213/1 prot., datë 09.06.2020, protokolluar në AMA me nr. 1408/3 prot., datë 11.06.2020, ka njoftuar zyrën Përmbarimore Private “A” sh.p.k. dhe AMA-n, se:

Kuvendi i Shqipërisë është institucion buxhetor dhe nuk ka llogari në këtë bankë, ndërsa Autoriteti i Mediave Audiovizive ka llogari në këtë bankë. (bashkëlidhur shkresa nr. 1408/3 prot., datë 11.06.2020);

Zyra Përmbarimore Private “A” sh.p.k. me shkresën nr. 956/4 prot., datë 11.06.2020, protokolluar në AMA me nr. 1705 prot., datë 24.06.2020, i është drejtuar R Bank, palës Kreditore E.B. dhe palëve debitore Kuvendit të Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë:

Edhe pse ka dy palë debitore dhe detyrimi është solidar, mqs AMA ka llogari bankare në R Bank, sekustro të vendoset në llogarinë e këtij të fundit. (bashkëlidhur shkresa nr. 1705 prot., datë 24.06.2020);

Zyra Përmbarimore Private “A” sh.p.k. me shkresën nr. 956/5 prot. dhe nr. 956/6 prot. datë 18.06.2020, protokolluar në AMA me nr. 1705 prot., datë 22.06.2020, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, si dhe palës Kreditore E. B. ekzekutimin tërësisht të shumës (bashkëlidhur shkresa nr. 1665 prot., datë 22.06.2020);

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe Rekursin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 1208/1 prot., datë 11.05.2020, protokolluar në AMA me nr. 1431 prot., datë 08.06.2020.

Në përfundim, për gjithë sa më sipër, vlerësojmë se gjetjet dhe përfundimet në projekt raport për ekzekutimin për zj. E. B., nuk janë të bazuara ligjërisht, kjo pasi AMA ka ndërmarrë masat për të penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të pambështetura në ligjin material dhe procedural, kjo pasi AMA ka kërkuar pjesën e saj takuese.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Ndërkohë që sic e kemi theksuar edhe në observacionin mbi akt-konstatimin tuaj, një nga kërkimet kryesore të autoritetit në Gjykatën e Lartë, lidhet me caktimin e pjesëve takuese të secilës palë të paditur AMA-s dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe çështja është në gjykim pranë kësaj të fundit.

Shënim: Sekretar i Përgjithshëm, për periudhën tetor 2019-qershor 2020 ka qenë me leje barrë lindje. Në lidhje me ish punonjësën zj. F. H., për pagesë për shpenzime gjyqësore në masën 163,752 lekë, sqarojmë se Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme likuidon menjëherë detyrime për vendime gjyqësore për ish punonjës, vetëm pas urdhërimit të Kryetar/Sekretar të Përgjithshëm, të hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve. (bashkëlidhur udhëri nr. 659 prot., datë 14.02.2020 dhe pagesat e kryera për ish punonjësën F. H.).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Referuar observacioneve të ardhura me nr. 896/6 prot datë 20.04.2023, nuk u sollën arsye të apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Auditimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore të institucionit.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

3.a -Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Nga auditimi rezultoi se, mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2020 dhe 2021 është mbështetur në kriteret e vendosura në ligjin 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si institucion i pavarur, vepron në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të akteve të tjera normative në fushën e ekonomisë dhe të financave.

- ✓ Për vitin 2020, burimi i financimit të institucionit janë të ardhurat e veta, të përdorura sipas limiteve të miratuara me Vendimin e AMA-s nr. 183, datë 19.12.2019 "Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2020", të ndryshuar.
- ✓ Për vitin 2021, burimi i financimit të institucionit janë të ardhurat e veta, të përdorura sipas limiteve të miratuara me Vendimin e AMA-s nr. 153, datë 24.12.2021, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2021", të ndryshuar.

Institucioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive është njësi shpenzuese me kontabilitet më vete. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Mbajtja e dokumentacionit dhe veprimet kontabile janë konform dispozitave ligjore, rregjistrimet janë kryer sipas dokumentave justifikuese, bazuar në parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare. dhe llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Sistemi i kontabilitetit mbahet me programin "Financa 5", janë pasqyruar drejtë të gjitha veprimet kontabile, dhe janë rregjistruar në ditarët përkatës si: Ditari i hyrjeve dhe daljeve të magazinës për lëvizjen e mallrave, veprimeve me bankën, veprimeve me arkën, veprimeve për pagat, dhe veprimeve të ndryshme, duke regjistruar drejt artikujt kontabël (për pjesën e testeve të kryera), si në llogaritë e "Arkës në lekë", "Arkës në valutë", "Veprimeve me bankën", "Hyrjeve dhe Daljeve të magazinës" dhe të "Pagave" etj.. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të regjistruara, janë kryer referuar dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu bilancet janë të kuadruar dhe të shoqëruar me inventarin e llogarive dhe me situacionin mbi realizimin e buxhetit vjetor të firmosur nga drejtori i DSHB



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

dërguar kryetarit të AMA-s. Bilanci i institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme është i kuadruar dhe i dorëzuar në Ministrinë e Financave brenda afatit ligjor. Nga verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020, trajtuar më hollësisht në vijim.

Në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të Autoritetit të Mediave Audiovizive **për vitin 2020** janë hartuar dhe depozituar sipas shkresës zyrtare nr.1295, datë 16.03.2021 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Miratimi i bilancit vjetor është bërë me vendimin e Bordit të AMA nr.30, datë 23.02.2021, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, pika 13, e ligjit nr. 97/2013, që parashikon se “AMA miraton projektbuxhetin e saj vjetor, shqyrton dhe miraton bilancin vjetor, si dhe raportin vjetor mbi veprimtarinë e saj përpara se t’i paraqitet Kuvendit”. Pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore janë shoqëruar nga relacioni shpjegues mbi pozicionin e posteve, zërave dhe llogarive përkatëse.

- Pasqyrat Financiare **të vitit 2021** janë hartuar dhe depozituar me shkresën zyrtare nr.1245, datë 24.03.2022 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Miratimi i bilancit vjetor është bërë me vendimin e Bordit nr.15, datë 23.03.2022, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, pika 13, e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar. Pasqyrat financiare të llogaridhënies e llogaridhënieve vjetore, edhe për këtë vit janë shoqëruar me relacionin shpjegues mbi pozicionin e posteve, zërave dhe llogarive përkatëse.

Llogaridhënia Vjetore ka përfshirë pasqyrën e plotësuar të pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, atë të flukseve monetare (*cash flow*), investimet sipas burimeve të financimit, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet afatgjata, pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave së bashku me pyetësin dhe shënimet shpjeguese.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës të kontabilitetit dhe më tej të dhënat janë pasqyruar në bilancin vjetor të veprimtarisë. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme janë mbajtur Ditari i bankës, ditari i magazinës (si për aktivet afatgjata, ashtu dhe ditari për aktivet e magazinës); Regjistri i Shpenzimeve të vitit, Fletët e kontabilizimit, etj., Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar.

Nga ana e audituesve të KLSH u kyer verifikime mbi bazë testimesh në lidhje me llogaritë inventariale të magazinës dhe rezultoi se është kryer rakordimi periodik midis sektorit të financës dhe magazinës. (*librat e magazinës*) si dhe rakordimi financë –arkë e institucionit (*librat e arkës*). Sa më sipër, është vepruar në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr.80, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, që shpreh se:

Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.

- **Mbi auditimin e pasqyrave financiare të AMA-s, 2021.**

Në bilancin e vitit 2020 shumat e zërave të aktivitetit janë të barabarta me ato të pasivit në shumën prej 782,505,012 lekë dhe në bilancin e vitit 2021 zërat e aktivitetit përputhen me shumat e zërave të pasivit në shumën prej 792,454,406 lekë.

Nga auditimi i formatit nr. 1 dhe 7/b mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme me vlerën e tyre neto, u konstatua se vlera totale e Aktiveve Afatgjata (AAGJ) më datën 31.12.2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

është 164,700 mijë lekë, nga të cilat 32,768 mijë lekë (rreth 20 % e totalit të aktiveve) e zënë Aktivet Afatgjata Jomateriale dhe 131,931 mijë lekë (rreth 80 % e totalit të aktiveve) përbehet nga Aktivet Afatgjata Materiale (ose të trupëzuara).

Analizuar për vitin 2021, evidentohet se AAGJ gjithsej janë 158,450 mijë lekë, nga të cilat 38,290 mijë lekë (ose rreth 24 % e aktiveve) janë Aktivet të Patrupëzuara dhe 120,160 mijë lekë nga Aktivet Afatgjata Materiale.

Në tabelën më poshtë paraqiten me të detajuar zërat e Aktivit të Bilancit Kontabël (me vlerën e tyre neto):

Në lekë

AKTIVE	2020	2021	Ndryshimi në%	Ndryshimi në vlerë
1	2	3	$4=3/2*100$	$5=3-2$
II.Aktivët Afatgjatë	164,700,148	158,450,317	96.2 %	-6,249,831
1.Aktivët Afatgjatë jo materiale	32,768,791	38,290,211	116.8%	+5,521,420
Studime dhe kërkime	32,768,791	38,290,211		
2.Aktivët Afatgjatë materiale	131,931,357	120,160,106	91.7%	
Toka, Troje, Terene	0	0		
Ndërtesa e Konstruksione	87,411,432.00	82,417,346		
Rrugë, rrjete, vepra ujore	0	0		
Instalime teknike, makineri e paisje	30,784,179.20	28,634,023		
Mjete Transporti	6,858,255.00	6,172,429		
Inventar ekonomik	6,877,491.20	2,936,308		
Aktivët afatgjatë të dëmtuara	0	0		
3.Aktivët Afatgjatë Financiare	0	0	0%	0

Burimi: Autoriteti i Mediave Audiovizive, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga analiza e llogarive dhe posteve të bilancit evidentohet sa vijon:

“Aktivët Afatshkurtra”

Totali i aktiveve qarkulluese në fund të vitit 2021 është paraqitur në bilanc për vlerën prej **634,004 mijë lekë**, shume e cila përbëhet nga:

1. Arka dhe banka

Ky post në masën 181,773 mijë lekë është i përbërë nga nën zërat sipas analizës së mëposhtme;

- Llog.512, “Mjete monetare në bankë dhe arkë” me një shumë prej 181,773 mijë lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve financiare në llogari deri më datën 31.12.2021 pranë Bankave të nivelit të dytë dhe një diferencë e mbetur nga kurset e këmbimit në arkë.
- Llog.530, “Disponibilitete në Thesar” me një shumë prej 537 lekë përfaqëson gjendjen e të ardhurave si agjent tatimor, të cilat mbarten nga Thesari në vitin pasardhës.

2.Gjendja e inventarit qarkullues (Klasa 3)

Ky post në masën 4,126 mijë lekë, përfaqëson vlerën e inventarit në magazinë sipas kontabilitetit dhe fletëve të inventarit sipas gjendjes fizike. Teprica e kësaj llogarie paraqitet me një ndryshim



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

gjendje prej 1,040 mijë lekë , (që evidentohet si efekt në shpenzime), si pasojë e pakësimit të kësaj llogëri, e cila në fund të vitit 2020 paraqitet me saldo debitore prej 5,166 mijë lekë.

Llogaritë e klasës 3-të pasqyrojnë gjendjen dhe lëvizjet e inventarit qarkullues, që përfaqësojnë 2.2 % të grupit të aktiveve afatshkurtëra dhe 0.6 % të vlerës së aktiveve gjithsej. Ndryshimi i llogarive të aktiveve qarkulluese me vitin parardhës, jep ndryshimin e gjendjes së inventarit. Për vitin 2021, ky ndryshim rezulton në vlerë -1,039 mijë lekë. Kjo vlerë (gjendja në pakësim të inventarit) paraqitet me + në llogaria 63, në pasqyrën e performancës financiare).

3.Llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra (Klasa 4)

Ky post në shumën prej 445,522 mijë lekë.

Aktivet Afatgjata:

Totali i aktiveve afatgjata është në shumën 158,450, mijë lekë e cila përbëhet nga zërat e mëposhtëm të aktivitetit:

Llog.20, “Aktivet afatgjata jo materiale”:

Llogaritë afatgjata jomateriale përbëhen nëmasën 100 % nga **Llog 202, “Studime dhe kërkime”**, e cila është paraqitur në shumën prej 38,290 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën neto të “studimeve dhe projekteve”, të financuara nga AMA, në fushën mediatike, (pas amortizimit), dhe që ka ardhur në rritje kundrejt vitit 2022, me një shtesë prej +5,521 mijë lekë

Zerat e bilancit	2021	2020
1.Aktive Afatgjata jo materiale	38,290,211	32,768,791
Studime dhe kërkime	38,290,211	32,768,791

Burimi: AMA, DSHB, PF 2021

Në grupin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale, **Llogaria 202 “Studime e kërkime”** institucioni ka të regjistruar shtesat e kryera gjatë vitit 2021 me vlerën bruto prej 12.184.695 lekë (referuar formatit 7/a dhe e ardhur nga blerjet e krijuara me pagesë), shumë kjo e rakorduar me listën analitike inventariale të zërave të AQPT që e formojnë atë; si dhe me një vlerë neto më dt 31.12.2021 prej 38.290.211 lekë, (referuar formatit 7/b), e cila është e barabartë me tepicën e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar (rreshti nr. 45). Si elementë përbërës të kësaj llogarie janë vlerat e paguara për studime, anketime, etj. Shtesat në aktivet jomateriale, janë blerje me pagesë me fondet e vete institucionit.

Gjendja dhe lëvizjet e AAJM / llogaria 202, “Studime dhe anketime”, sipas periudhës së auditimit evidentohet si më poshtë:

Për vitin 2019:

a. Në bazë të vendimit të bordit të AMA-s, me nr. 202, datë 24.12.2018 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019”, janë parashikuar të ardhurat gjithsej prej 353,446 mijë lekë dhe shpenzimet prej 351,258 mijë lekë. Në kategorinë e shpenzimeve gjithsej janë përfshirë dhe shpenzimet për investime prej 58,685 mijë lekë, ku zëri “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar prej 31,891 mijë lekë, **ose kjo e barabartë me 54 % të investimeve vjetore**, e cila është detajuar në **2 (dy) elemente**: studime e kërkime prej 23,500 mijë lekë (nga Drejtoria e Programeve me shkresën nr. 4366 dt 20.10.2018) dhe nga Këshilli i Ankesave me shkresën nr 4442, dt 02.11.2018, anketime prej 1,500 mijë lekë.

Në funksion të këtyre zërave janë shkresat me nr. 3382/7, datë 11.11.2019 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes është zëri studim mbi mbulimin e territorit me sinjal televizv kabllor, si dhe shkresa me nr. 3392/1 prot., dt 23.10.2019 të Drejtorisë së Programeve, për projekte të ndryshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

b.Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, për vitin 2019 ajo përfshin **11 zëra studimesh dhe projektesh**, me vlerë totale prej 15,539 mijë lekë. Kjo shumë përputhet me shumën e pagesave të kryera për këtë zë gjatë vitit 2019.

Për vitin 2020:

a.Në bazë të vendimit të bordit të AMA-s, me nr. 183, datë 19.12.2019 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2020”, janë parashkuar të ardhurat gjithsej prej 255,489 mijë lekë dhe shpenzimet prej 255,051 mijë lekë. Në kategorinë e shpenzimeve janë përfshirë dhe ato për investime prej 39,245 mijë lekë, ku zëri “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar prej **7,500 mijë lekë, ose kjo e barabartë me afro 20 % të investimeve vjetore**, dhe është e detajuar në **2 (dy) elemente**:

- studime e kërkime: studim mbi mbulimin e territorit me sinjal televiziv (kabllor, tokësor, IPTV, satelitor) prej 6,500 mijë lekë dhe
- sondazh/anketim në lidhje me treguesit mediatik në zonat ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, prej 1,000 mijë lekë.

Sipas vendimit të Bordit të AMA me nr. 83, datë 08.10.2020, shpenzimet për investime në zërin “Studime e anketime”, nga 7,500 mijë bëhen në **12,300 mijë lekë**, i cili nuk është shoqëruar me një detajim të këtyre zërave.

b.Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, për vitin 2020 ajo përfshin **4 (katër) zëra studimesh dhe projektesh**, me vlerë totale prej **8,009 mijë lekë**. Kjo shumë përputhet me shumën e pagesave të kryera për këtë zë gjatë vitit 2020, ku për dy projekte ka vijuar pagesa e projekteve të vitit 2019.

c. Bazuar në situacionin vjetor të realizimit të zërave të projekt buxhetit të vitit 2020, përgatitur nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, plani vjetor për këtë llogari rezulton prej **12,300 mijë lekë** (vendimi AMA me nr. 83, dt 08.10.2020) dhe realizimi prej **8,009 mijë lekë**.

Për vitin 2021:

a.Në bazë të vendimit të bordit të AMA-s, me nr.153 , datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021”, janë parashkuar të ardhurat gjithsej prej 283,158 mijë lekë dhe shpenzimet prej 249,196 mijë lekë. Në kategorinë e shpenzimeve janë përfshirë dhe ato për investime prej **38,328 mijë lekë**, ku zëri “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar **prej 15,000 mijë lekë, ose kjo e barabartë me afro 40 % të investimeve vjetore gjithsej**, e detajuar në **7 (shtatë) zëra**:

- Studime në tregun audioviziv (mbi dinamikën e tv online) prej 2,000 mijë lekë;
- **Përkthime të literaturës së huaj mbi mediat në shqip, prej 1,500 mijë lekë;**
- Përmirësimi i raportimit dhe monitorimit të medias audio dhe audio-vizive –mbrojtje e të miturve, prej 1,500 mijë lekë;
- **Ekspertizë e kërkimit shkencor mbi sfidat e tregut audioviziv, prej 1,500 mijë lekë;**
- Ndjekja e grupeve të studimit të ITU-së lidhur me çështjet audio/audiovizive, prej 1,500 mijë lekë;
- Transmetimet audio FM/DB, standardet teknike dhe optimizimi i cilësisë, spektri i frekuencave, prej 1,200 mijë lekë;
- Rregullimi i teknikave për stabilizimin dhe mirëmbajtjen e nivelit maksimal të volumit dhe zhurmave në televizione;
- **Projekte të propozuara nga anëtarët e AMA-s, prej 4,600 mijë lekë.**

Sipas shënimit të vendosur nga ana e DSHB, anëtarët e AMA në mbledhjen e datës 24.12.2020 kanë propozuar shtimin e zërit “Studime dhe anketime” me 4,600 mijë lekë. Rezulton se ky zë është vendosur pa një analizë të hollësishme paraprake nga ana e strukturave të AMA-s.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Nga shqyrtimi i praktikave të vëna në dispozicion nga subjekti nën auditim, rezulton se me shkresën nr. 2785/3 dt 16.11.2020, nga ana e Drejtorisë së Programeve shuma e planifikuar për studime është 6,500 mijë lekë; drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK për 2,700 mijë lekë; dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes, me shkresën nr. 2785/7 dt 10.11.2020 për 1,200 mijë lekë.

b.Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, për vitin 2021 ajo përfshin **12 (dymbëdhjetë)** zëra studimesh dhe projektsh, me vlerë totale prej **12,184 mijë lekë**. Kjo shumë përpunet me shumën e pagesave të kryera për këtë zë gjatë vitit 2021.

c. Bazuar në situacionin vjetor të realizimit të zërave të projekt buxhetit të vitit 2021, përgatitur nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, plani vjetor për këtë llogari rezulton (15,000 mijë + 8,300 mijë), prej **23,300 mijë lekë** dhe realizimi (16,600 mijë – 4,476 mijë) prej **12,124 mijë lekë**.

Partitari i llogarisë studime dhe anketime për periudhën 2016-2020 paraqet shtesat dhe pakësimet nga amortizimi i kësaj llogarie, si vijon:

Të dhënat në lekë

Viti	Emertimi	Vlera studimit	Amortizimi 2016	V.Mbetur 2016	Amortizimi 2017	V.Mbetur 2017	Amortizimi 2018	V.Mbetur 2018	Amortizimi 2019	V.Mbetur 2019	Amortizimi 2020	V.Mbetur 2020	Amortizimi 2021	V.Mbetur 2021
2015	Studime dhe kerkime	3,798,277	949,569	2,848,708	949,569	1,899,139	569,742	1,329,397	569,742	759,655	569,742	189,914	189,914	0
2016	Studime dhe kerkime	3,460,000		3,460,000	865,000	2,595,000	519,000	2,076,000	519,000	1,557,000	519,000	1,038,000	519,000	519,000
2017	Studime dhe kerkime	6,211,550				6,211,550	931,733	5,279,818	931,733	4,348,085	931,733	3,416,353	931,733	2,484,620
2018	Studime dhe kerkime	9,936,150				-		9,936,150	1,490,423	8,445,728	1,490,423	6,955,305	1,490,423	5,464,883
2019	Studime dhe kerkime	15,538,796								15,538,796	2,330,819	13,207,977	2,330,819	10,877,157
2019 (MBYL LUR NE 2020)	Studime dhe kerkime	320,000									48,000	272,000	48,000	224,000
2020	Studime dhe kerkime	7,689,243										7,689,243	1,153,386	6,535,857
2021	Studime dhe kerkime	12,184,695												12,184,695
TOTAL		59,138,711	949,569	6,308,708	1,814,569	10,705,689	2,020,474	18,621,364	3,510,897	30,649,264	5,889,716	32,768,991	6,663,275	38,290,211

Situata:

Planifikimi i buxhetit për shpenzimet e investimeve në kategorinë “Studime dhe anketime”, që për periudhën objekt auditimi arrijnë deri në 50 % të investimeve vjetore gjithsej, nuk është bërë duke u mbështetur në analiza të mirëfillta, pasi nuk janë hartuar preventivat e vlerave të projekteve, nuk janë hartuar fishat e projekteve përpara lancimit të thirrjeve, përcaktimi i vlerave totale të këtyre projekteve është bërë apriori, sipas përvojave të viteve të mëparshme. Mungesa e një kostoimi dhe analize të mjaftueshme e të detajuar për aprovimin e buxhetit për këto kategori të shpenzimeve për investime nga ana e AMA-s, ka bërë që të kemi një planifikim të dobët të buxhetit dhe një raportim jo të përshtatshëm.

Konstatim:

1.Nga auditimi i kryer mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së si dhe intervistat e strukturuar të realizuara me zyrtarët përgjegjës të stafit të AMA-s, rezulton se nuk ka një analizë dhe preventivim të vlerave të projekteve, nuk janë hartuar fishat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

e projekteve përpara lancimit dhe thirrjeve, por përcaktimi i vlerave totale të këtyre projekteve është bërë apriori, mbështetur në përvojat e viteve të mëparshme.

Rezulton se, anëtarët e AMA në mbledhjen e dt 24.12.2020 kanë propozuar shtimin e zërit “Studime dhe anketime” me 4,600 mijë lekë në buxhet, si pakësim nga një zë tjetër i buxhetit të institucionit, dhe shtim tek investimet për “Studime, kërkime e anketime”, po kjo vendimmarrje është kryer pa u thelluar në shpjegimin e arsyeve të këtij transferimi. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e mjaftueshme mbi analizat që bordi ka bërë përpara aprovimit të buxhetit dhe mosaprovimit të kërkesave fillestare të paraqitura nga ana e Titullarit dhe Nëpunësit Zbatues; nuk ka asnjë detajim dhe konstatohet mungesë e një analize të hollësishme paraprake nga ana e strukturave të AMA-s. Sa më sipër, planifikimi për këtë kategori shpenzimesh nuk është i argumentuar dhe tregon për një planifikim të dobët të këtyre shpenzimeve për investime.

2. Nuk përcaktohet numri dhe vlera e projekteve të realizuara kundrejt atyre të miratuar në planin vjetor të miratuar nga ana e Bordit të AMA-s, dhe për sa sipër, kjo nuk justifikohet me dokumente të mjaftueshme rreth këtyre mospërputhjeve, e më konkretisht sipas viteve të analizuara konstatohet sa ka nivele të ulëta të realizimit të fondeve të detajuara për këto kategori të AAJM, si vijon:

- **Në v.2019** në zërin “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar prej 25,000 mijë lekë, e detajuar në **2 (dy) elemente**: studime e kërkime prej 23,500 mijë lekë dhe anketime prej 1,500 mijë lekë. Në funksion të këtyre zërave janë shkresat me nr. 3382/7, datë 11.11.2019 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes është zëri studim mbi mbulimin e territorit me sinjal televiziv kabllor, si dhe shkresa me nr. 3392/1 prot., dt 23.10.2019 të Drejtorisë së Programeve, për projekte të ndryshme. Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, për vitin 2019 ajo përfshin **11 zëra studimesh** dhe **projektesh**, me vlerë totale prej 15,539 mijë lekë.
- **Në v.2020**, në kategorinë e shpenzimeve janë përfshirë dhe ato për investime prej 39,245 mijë lekë, ku zëri “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar prej **7,500 mijë lekë**, e detajuar në **2 (dy) elemente**: studime e kërkime: studim mbi mbulimin e territorit me sinjal televiziv (kabllor, tokësor, IPTV, satelitor) prej 6,500 mijë lekë dhe sondazh/anketim në lidhje me treguesit mediatik në zonat ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, prej 1,000 mijë lekë. Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, si dhe ndryshimeve të zërave të shpenzimeve për investime, me Vendimin e Bordit të AMA nr. 83, dt 08.10.2020, zëri “studime dhe kërkime”, nga 7,5 milion lekë, bëhet për 12,3 milion lekë, **me një mosrealizim prej 4,291 mijë lekë të planit të miratuar për këtë zë nga ana e AMA.**
- **Në v.2021** në kategorinë e shpenzimeve janë përfshirë dhe ato për investime prej **38,328 mijë lekë**, ku zëri “Studime dhe kërkime” (Llog.202) është parashikuar **prej 15,000 mijë lekë, ose 40 % e investimeve gjithsej**, e detajuar në **7 (shtatë) zëra**. Referuar partitarit analitike të kësaj llogarie, për vitin 2021 ajo përfshin **12 (dymbëdhjetë) zëra studimesh** dhe projektesh, me vlerë totale prej **12,184 mijë lekë**, e rakorduar me shumën e situacionit të shpenzimeve dhe të ardhurave vjetore. Duke shtuar dhe pjesën e “shpenzimeve për investime të parashikiara për vitin 2020 dhe të realizuar në vitin 2021”, prej **8.399 mijë lekë**-(referuar sipas faqes nr. 7 të tabelave që shoqërojnë vendimin e Bordit të AMA me nr. 153, dt 24.12.2020), shuma e këtij zëri për studime në v.2021 arrin në **23,300 mijë lekë.**

Në formë tabelare realizimi i shpenzimeve të investimeve për studime e kërkime për periudhën 2019-2021 paraqitet si më poshtë: (të dhënat në mijë lekë)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Viti	Plan	fakt	%
2019	25,000	15,529	62
2020	12,300	8,009	65
2021	23,300	12,184	52

Burimi: Situacionet vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të AMA-s

Nga sa më sipër, evidentohen devijime si në numrin e projekteve që iniciohen dhe atyre që realizohen efektivisht, ashtu edhe në respektimin e shumave të vëna në dispozicion për kategorinë e projekteve për studime dhe anketime, miratuar në vendimin e AMA për miratimin e buxhetit vjetor.

Si përfundim:

Planifikimi i buxhetit për shpenzimet e investimeve në kategorinë “Studime dhe anketime”, që për periudhën objekt auditimi arrijnë deri në 43 % të investimeve vjetore gjithsej, nuk është bërë duke u mbështetur në analiza të mirëfillta, pasi nuk janë hartuar preventivat e vlerave të projekteve, nuk janë hartuar fishat e projekteve përpara lancimit të thirrjeve, përcaktimi i vlerave totale të këtyre projekteve është bërë apriori, sipas përvojave të viteve të mëparshme. Mungesa e një kostoimi dhe analize të mjaftueshme e të detajuar për aprovimin e buxhetit për këto kategori të shpenzimeve për investime nga ana e AMA-s, ka bërë që të kemi një planifikim të dobët të buxhetit dhe një raportim jo të përshtatshëm. Nga sa më sipër, evidentohen devijime si në numrin e projekteve që iniciohen dhe atyre që realizohen efektivisht, ashtu edhe në respektimin e shumave të vëna në dispozicion për kategorinë e projekteve për studime dhe anketime, miratuar në vendimin e AMA për miratimin e buxhetit vjetor.

Situata:	Konstatohet se: 1.Nga auditimi i kryer mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së si dhe intervistat e strukturuar të realizuara me zyrtarët përgjegjës të stafit të AMA-s, rezulton se nuk ka një analizë dhe preventivim të vlerave të projekteve, nuk janë hartuar fishat e projekteve përpara lancimit dhe thirrjeve, por përcaktimi i vlerave totale të këtyre projekteve është bërë apriori, mbështetur në përvojat e viteve të mëparshme. Rezulton se, anëtarët e AMA-s në mbledhjen e datës 24.12.2020 kanë propozuar shtimin e zërit “Studime dhe anketime” me 4,600 mijë lekë në buxhet, si pakësim nga një zë tjetër i buxhetit të institucionit, dhe shtim tek investimet për “studime, kërkime e anketime”, po kjo vendimmarrje është kryer pa u thelluar në shpjegimin e arsyeve të këtij transferimi. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e mjaftueshme mbi analizat që bordi ka bërë përpara aprovimit të buxhetit dhe mosaprovimin e kërkesave fillestare të paraqitura nga ana e Titullarit dhe Nëpunësit Zbatues; nuk ka asnjë detajim dhe konstatohet mungesë e një analize të hollësishme paraprake nga ana e strukturave të AMA-s. Sa më sipër, planifikimi për këtë kategori shpenzimesh nuk është i argumentuar dhe tregon për një planifikim të dobët të këtyre shpenzimeve për investime. 2.Nuk pëpëthet numri dhe vlera e projekteve të realizuara kundrejt atyre të miratuar në planin vjetor të miratuar nga ana e Bordit të AMA-s, dhe për sa sipër, kjo nuk justifikohet me dokumente të mjaftueshme rreth këtyre mospërputhjeve, e më konkretisht sipas viteve të analizuara.
Kriteri:	✓ Ligji për Mediat Audiovizive; ✓ SKK për AAJM;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	✓ Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin; ✓ Aktet nënligjore dalë në zbatim të tyre.
Ndikimi/Efekti:	Mbi shpenzimin e fondeve publike
Rëndësia:	i mesëm - i lartë
Rekomandim	1.Bazuar në faktin se, në llogarinë 202 “<i>Studime dhe projekte</i>” janë përfshirë dhe përkthime, anketime, etj., që në analizën e audituesve të pavarur të KLSH, kërkohet një vlerësim më i kujdesshëm i domosdshmërisë dhe i përfshirjes së tyre në kategorinë e investimeve për “<i>studime dhe anketime</i>”, institucioni duhet të adresojë prioritetet e planifikuara sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor mbi menaxhimin e financave publike, në harmoni me afatet kohore të përcaktuara me qëllim që të sigurojnë shpenzim efikas dhe efektiv të buxhetit të planifikuar duke gjykuar rast pas rasti, mbi vlerat, dobinë dhe domosdoshmërinë e projekteve të përzgjedhura; duke arsyetuar nëse një zë apo projekt duhet të përfshihet në grupin e aktiveve afatgjata jomateriale, apo duhet kategorizuar si “shpenzime të ushtrimit”; si dhe vendimarrja e AMA të mbështetet në analiza të mjaftueshme dhe në një dokumentim të studiuar të kostos së këtyre projekteve. 2.Gjatë hartimit të buxhetit të AMA-s, drejtoritë përgjegjëse, të identifikojnë nivelin e zbatimit të këtyre projekteve/objektivave në mënyrë që këto projekte të aprovohen në bordin e AMA-s, dhe në vijimësi të merren në analizë për vonesat apo mosrealizimet e tyre. Projekt propozimet për investime kapitale të përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara sipas Programit për Investime Publike dhe ky proces planifikimi i aktiviteteve të diskutohet dhe kalojë në filtrat e brendshëm të drejtorive deri në analizimin nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik të AMA-s, me qëllim realizimin e projekteve më të domosdoshme, më të dobishme dhe me impakt, si dhe të ndihmojnë në zvogëlimin e devijimeve mes planifikimit fillestar dhe realizimit të buxhetit të AMA-s për këto zëra.
Afati	Në vijimësi

2.Aktivet afatgjata materiale (AAGJM):

Në fund të vitit 2021, grupi AAGJM është evidetuar në pasqyrën e pozicionit financiar prej 120,160 mijë lekë duke ekspozuar njëpakësim prej 11,771 mijë lekë nga ajo e një viti më parë, dhe përbëhet nga llog.212 “Ndërtesa e rikonstruksione”, llog. 214 “Instalime teknike”, llog.215 “Mjete transporti” dhe llog.218 “Inventar ekonomik”,që në mënyrë më të detajuar paraqiten më poshtë:

- ✓ A. Llogaria 212,*Ndërtesa e rikonstruksione*”: Në këtë zë pasqyrohet vlere neto e punimeve të rikonstruksionit të godinës së AMA-s në masën prej 82,417 mijë lekë, e cila është pakësuar në shumën prej 4,994 mijë lekë ndaj vitit 2020. Dinamika e regjistrimit të vlerës së rikonstruksioneve dhe amortizimit të tyre jepet nga tabela e mëposhtme:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Të dhënat në lekë.

Nr.	Emërtimi	Akti i marrjes në dorezim të godinës	Garancia nga sipërm Arrësi	V.Mbetur 2019	Shtesa gjatë 2020 (II)	Pake sime gjatë 2020 (III)	Vlera e mbetur 2020 ((I+II)-(III))	Amortizimi 2020	V.Mbetur 2020	Amortizimi 2021	V.Mbetur 2021
1	Rikonstruksioni i godinës	23.08.2017	qershor 2018	92,321,518			92,321,518	4,990,352	87,331,165	4,990,352	82,340,813
2	F.V dere në zyrën e TIK	26.12.2019		28,000			28,000	1,400	26,600	1,400	25,200
3	F.V pompe uji	24.02.2020			56,000		56,000	2,333	53,667	2,333	51,333
TOTAL				92,349,518	56,000	-	92,405,518	4,994,086	87,411,432	4,994,086	82,417,346

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, PF 2021

- ✓ B. Llog.214, “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla, inventar ekonomik”. Në këtë zë është paraqitur vlera neto e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara ku përfshihen pajisjet specifike të instaluar, me një vlerë prej 28,634 mijë lekë, ose me një pakësim prej 2,150 mijë lekë, nga 30,784 mijë lekë të kontabilizuara në mbyllje të vitit 2020.
- ✓ C. Llog.215 “Mjete Transporti”. Në këtë zë pasqyrohet vlera neto e mjeteve të transportit që janë në inventar të institucionit me një vlerë prej 6,173 mijë lekë, ose me një pakësim prej 685 mijë lekë, nga 6,858 mijë lekë të kontabilizuara në mbyllje të vitit 2020, si vijon ”

Nr.	Kodi	Automjetet	Cmimi	Vite rjes	Vlera mbetur kontabile	viti 2017		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
						Shtesa gjatë vitit	Amortizimi vitit	Vlera mbetur	Amortizimi (2018)	Shtesa	Vlera mbetur	Shtesa/Pakesime	Vlera mbetur	Amortizimi (2021)	Shtesa/Pakesime
1	0570	Land cruise TR2910I	5,325,714	2003	383,640		38,364	345,276	34,528	117,600	428,348		42,835	385,514	38,551
4	0168	Makina Hyundai i35 AA089NO	3,612,000	2016	3,341,100		334,110	3,006,990	300,699		2,706,291		270,629	2,435,662	219,210
5	0006/10	Skoda Karoq AA082XO	2,548,200	2019						2,548,200			148,645	2,399,555	215,960
6	0006/10	Skoda Karoq AA019XO	2,548,200	2019						2,548,200			148,645	2,399,555	215,960
TOTALI			14,034,114		3,724,740	0	372,474	3,352,266	335,227	117,600	3,134,639	5,096,400	610,754	7,620,285	685,826

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, PF 2021

- ✓ D. Llog.218, “Inventar Ekonomik”. Në këtë zë përfshihen pajisjet e zyrave dhe inventari ekonomik me një vlerë neto prej 2,936 mijë lekë. Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar sipas llogarive në partitarët e mbajtur dhe i rakorduar me tepriçen neto të inventarit me datë 31.12.2021, në pasqyrën anekse statistikore 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i AAGJM me vlerën e tyre neto”, (rreshti 14).

Nga analizimi i të dhënave të bilancit kontabël konstatohet se Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara/ AAGJM, gjatë vitit 2021 rezultojnë në vlerën e tyre neto prej 120 milionë lekë, nga 132 milionë lekë të regjistruara në fund të v.2020, dhe ku gjatë vitit u konstatua një pakësim i vlerës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

së Aktiveve të Qëndrueshme prej -12 milionë lekë, në krahasim me vitin paraardhës. Nga ana tjetër, Aktivët Afatgjatë Jomateriale nga 32,8 milionë lekë janë shtuar dhe kanë arritur në 38.3 milionë në vitin 2021 duke rezultuar kështu me një rritje totale prej + 5.5 milionë lekë, e cila përbëhet kryesisht nga vlera e llogarisë “studime dhe kërkime”, të kontabilizuara në llogarinë 202.

Në përfundim të procedurave të **kontrolleve kryqëzuese e verifikuese, si dhe kryerjes së testeve thelbësore** u konstatua se:

- a) *Totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit*, përkatësisht në shumën 792,454 mijë lekë për vitin kontabël të mbyllur më 31.12.2021 dhe në shumën 782,505 mijë lekë për vitin 2020;
- b) *Totali i Aktiveve Neto (F4, rreshti 20), janë të barabarta me shumën e Fondin e Konsoliduar* (rreshti 96 dhe 97 i pasqyrës së Pozicionit Financiar), përkatësisht prej 425,403 mijë lekë në vitin 2021 dhe 366,679 mijë lekë në vitin 2020;
- c) *Llogaria 63 “Ndryshimi gjendjes”, evidentuar në postin përkatës të pasqyrës së performancës financiare, (rreshti nr.130 në Pasqyrën F2 “Pasqyra e performancës financiare”), për institucionin e AMA-s, është e barabartë me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës së 3-të (midis vitit ushtrimor dhe ushtrimit të vitit të mëparshëm), në rreshtin nr.11, të Pasqyrës F1 “Pozicioni financiar”, përkatësisht për shumën +1,039 mijë lekë në vitin 2021 (si diferencë e llogarive vjetore të klasës së tretë mbi gjendjen e inventarit, 5,165 mijë dhe 4,126 mijë lekë); dhe në vlerën prej - 61,277 lekë në vitin 2020, konform parashikimeve të paragrafit nr.24, aneksi nr.2 i Udhëzimit nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;*
- d) Nga kryerja e testeve substantivë, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim periudhe (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjatë, u konstatua se, nuk ekzistojnë mospërputhje midis:
 - ✓ të dhënave të gjendjes në fillim të vitit 2021 (në formatin 7/b, kolona nr.3, e tepricës neto të llogarive në fillim të periudhës), të cilat janë të rakorduara me ato të regjistruara në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, në lidhje me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2020.
 - ✓ të dhënave të gjendjes në fillim të vitit 2020 (në formatin 7/b, kolona e tepricës neto të llogarive në fillim të periudhës), të cilat janë të rakorduara me ato të regjistruara në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, në lidhje me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2019;
- e) Sipas parashikimeve të Paragrafit nr.15, Aneksi nr.2, i Udhëzimit nr.5, datë 21.2.2022, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, evidentohet që totali i aktiveve neto/ fondeve neto, i evidentuar në pasqyrën e pozicionit financiar, (formati F1, rreshti 96, grupi C), është i barabartë me totalin e fondeve të veta të evidentuar në pasqyrën financiare të Ndryshimeve në Aktivët Neto/Fondet Neto (formati F4, rreshti 20), përkatësisht për 425,403 mijë lekë për vitin 2021 dhe 366,680 mijë për vitin 2020;
- f) Evidentohet se, teprica e Llogarisë së Likuiditeteve, në fund të vitit ushtrimor (rreshti nr.34, i formatit F3, cash flow), janë pasqyruar përkatësisht për 181,773 mijë lekë në fund të vitit 2021 dhe për 159,634 mijë lekë më 31.12.2020, shifra këto që rakordojnë me Tepricën e Llogarive të Likuiditeteve (Llogaria 520, “Disponibilitete në Thesar”, në rreshtin nr. 6 të Pasqyrës F1), të Pozicionit Financiar për institucionin e AMA;
- g) Në auditimin e të dhënave të *pasqyrës së performancës financiare rezulton që totali i të ardhurave gjithsej është i barabartë me shpenzimet plus pjesën e rezultatit*, sa sipër kjo, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.201, i ndryshuar. Kështu për vitin 2021, të ardhurat janë **229,227 mijë** lekë, kurse



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

shpenzimet **141,686 mijë** lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej **87,541 mijë** lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore. Kurse, për vitin 2020, të ardhurat janë **216,208 mijë** lekë, kurse shpenzimet **152,782 mijë** lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej **63,426 mijë** lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore. Nga ana tjetër u verifikua pasqyrimi për të njëjtën shumë i llogarisë 85 “Teprica ose deficit i periudhës” në pasqyrën nr.1 të pozicionit financiar (rreshti nr.100) dhe në rreshtin nr. 132, të pasqyrës së performancës financiare dhe nuk u konstatuan mospërputhje.

Në mënyrë të përmbledhur zërat e Bilancit Kontabël për dy vitet ushtrimore të njëpasnjëshëm 2020 dhe 2021, paraqesin këtë situatë si vijon:

Nga ana e strukturave përgjegjëse për financat dhe kontabilitetin, është evidentuar në bilanc fakti, se gjatë vitit 2020 dhe 2021 **nuk ka patur shtesa të aktiveve pa pagesë si dhe nuk janë kryer dalje jashtë përdorimi dhe referimi në kolonë është për 0 lekë**. Referuar pasqyrës nr. 7/a të bilancit të vitit 2021, (aktivet me koston e tyre historike), konstatohen këto teprica të gjendjes së llogarive të aktiveve të transferuara dhe nxjerra nga përdorimi:

EMERTIMI	Fillim vit te vitit	Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve	Gjith sej	Shitje	Nx.jasht përdor.	Pakësime Të Tjera	Gjith sej	mbyllje të ushtrimit
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit							
C	1	2	3	4	5	6.00	7	8	9	10	11
I. AAGJ/JO MATERIALE	46,954,016	12,184,695	-	-	-	12,184,695	-	-	-	-	59,138,711
Studime dhe kërkime	46,954,016	12,184,695				12,184,695				-	59,138,711
II. TAAGJ/ MATERIALE	208,456,024	10,383,028	-	-	-	10,383,028	-	-	-	-	218,839,052
Ndërtime e Konstruksione	99,891,046					-				-	99,891,046
Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	68,906,508	9,487,248				9,487,248				-	78,393,756
Mjete transporti	14,151,714	-				-				-	14,151,714
Inventar ekonomik	25,506,756	895,780				895,780				-	26,402,536
TOTALI (I+II)	255,410,040	22,567,723	-	-	-	22,567,723	-	-	-	-	277,977,763

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, PF viti 2021, përpunuar nga grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e AAGJM:

Nga auditimi rezulton se nuk është marrë në dorëzim vlera e godinës të kaluar në përgjegjësi administrimi sipas VKM-së nr. 468, datë 03.06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, ngga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive,të katit përdhes, katit të parë dhe katit të dytë të godinës me emertimin “Atelier për dekorin e Radio-Televizionit”. Sa më sipër, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion shkresa që është dërguar nga ana e AMA-s në RTSH me nr. 2808, datë 06.09.2017, për të cilën nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme.

Llogaria 212, “Ndërtime dhe rikonstruksione” është e kontabilizuar për vitin 2020 për vlerën **neto** prej 87 milionë lekë dhe në fund të vitit 2021 për 82 milionë lekë. Përkatësisht,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Të dhënat në lekë

	Viti 2021	Viti 2020
Aktive Afatgjata materiale	120,160,106	131,931,357
Toka, Troje, Terene	0	0
Ndërtesa e Konstruksione	82,417,346	87,411,432

Burimi: AMA, Drejtoria e Financës dhe Sherbimeve, PF v.2021, formati F1

Per vitin 2020, vlera e llogaritjeve te AQT, sipas vlerës së saj neto është:

Nr. Rrje	Nr. Llog	EMERTIMI	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjatë vitit		Teprica në Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	B	C	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	38,944,773.00	8,295,509.00	30,649,264	8,009,243.00	5,889,716	-	0	46,954,016	14,185,225	32,768,791.00
2	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kërkime	38,944,773.00	8,295,509.00	30,649,264	8,009,243.00	5,889,716			46,954,016	14,185,225	32,768,791
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	200,956,389.40	58,972,506.00	141,983,883	12,557,140.00	21,625,666	5,057,505.00	4,073,505	208,456,024	76,524,667	131,931,357.40
6	210	Toka, troje, Terene			0					0	0	0
7	211	Pyje, Kullota Plantacione			-					0	0	0
8	212	Ndërtim e Konstruksione	99,835,046.00	7,485,528.00	92,349,518.00	56,000.00	4,994,086	-		99,891,046	12,479,614	87,411,432.00
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	-		-					0	0	0
10	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	57,344,255.20	27,748,054.00	29,596,201.20	12,307,900.00	11,119,922	745,647.00	745,647	68,906,508	38,122,329	30,784,179.20
11	215	Mjete transporti	18,438,982.00	9,834,698.00	8,604,284.00		762,029	4,287,268.00	3,303,268	14,151,714	7,293,459	6,858,255.00
12	216	Rezerva shtetore	-		-					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	-		-					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	25,338,106.20	13,904,226.00	11,433,880.20	193,240.00	4,749,629	24,590.00	24,590	25,506,756	18,629,265	6,877,491.20
15	24	Aktive të Qend. të trupëzuara të dëmtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		TOTAL I (I+II)	239,901,162.40	67,268,015.00	172,633,147	20,566,383.00	27,515,382	5,057,505.00	4,073,505	255,410,040.40	90,709,892	164,700,148

Burimi: AMA, DSH, PF v.2020. Pasqyra e AQT me vlerë neto

Kurse për vitin 2021, janë regjistruar këto vlera të AAGJM:

Nr.	EMERTIMI	Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Reference		Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto
Llogarije											
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	46,954,016.00	14,185,225.00	32,768,791	12,184,695.00	6,663,275	-	0	59,138,711	20,848,500	38,290,211.00
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave										
202	Studime dhe kërkime	46,954,016.00	14,185,225.00	32,768,791	12,184,695.00	6,663,275			59,138,711	20,848,500	38,290,211
203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme										
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	208,456,024.40	76,524,667.00	131,931,357	10,383,028.00	22,154,279	-	0	218,839,052	98,678,946	120,160,106.40
210	Toka, troje, Terene										



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

211	Pyje, Kullota Plantacione			-							
212	Ndertime e Konstruksione	99,891,046.00	12,479,614.00	87,411,432.00		4,994,086			99,891,046	17,473,700	82,417,346.00
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	-	-	-							
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	68,906,508.20	38,122,329.00	30,784,179.20	9,487,248.00	11,637,404			78,393,756	49,759,733	28,634,023.20
215	Mjete transporti	14,151,714.00	7,293,459.00	6,858,255.00		685,826			14,151,714	7,979,285	6,172,429.00
216	Rezerva shtetërore	-	-	-							
217	Kafshe pune e prodhimi	-	-	-							
218	Inventar ekonomik	25,506,756.20	18,629,265.00	6,877,491.20	895,780.00	4,836,963			26,402,536	23,466,228	2,936,308.20
24	Aktive të Qend. të trupezuara të demtuara										
28	Caktime										
	TOTALI (I + II)	255,410,040.40	90,709,892.00	164,700,148	22,567,723.00	28,817,554	-	0	277,977,763.40	119,527,446	158,450,317

Burimi: AMA, DSHB, PF v.2021 Pasqyra e AQT me vlere neto

Sa më sipër, nuk konstatohen mos përputhje të vlerave neto të aktivitetit të qëndrueshëm “Ndërtesa” në pasqyrën e pozicionit financiar, me ato të pasqyrës së gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve, dhe pasqyrës së përlogaritjes së amortizimit, sipas parashikimeve të paragrafit nr. 94, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar:

“Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto), sipas rreshtave, përfaqëson:

- ✓ Rubrika I “aktive afatgjata jomateriale”, e cila përfshin prime të emisionit, studime dhe kërkime, koncensione, patenta, licenca e të ngjashme.
- ✓ Rubrika II “aktive afatgjata materiale”, e cila përfshin zëra si: toka, troje, pyje, ndertime e konstruksione, mjete transporti, rezerva shtetërore, kafshë pune e prodhimi, inventar ekonomik, etj.
- ✓ Totali i aktiveve afatgjata, për çdo zë të evidentuar në kolonat e pasqyrës, paraqitet në rreshtin e fundit të kësaj pasqyre.
- ✓ Gjendja e aktiveve afatgjata (të evidentuara në këtë pasqyrë), në çelje dhe në mbyllje të vitit ushtrimor, duhet të kuadrojë përkatësisht me totalin e zërave të aktiveve afatgjata jomateriale dhe aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar”.

Titulli i gjetjes:

Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave me përcaktimet VKM-së që ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivët Afatgjata Materiale pasqyrojnë vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këtë objekt ndërtimor. Procedurat e kalimit në përgjegjësi administrimi dhe transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitetit afatgjatë material “Ndërtesa” nuk janë dokumentar rregullisht sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, pasi mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies për zërin “Ndertime e konstruksione”, kanë regjistruar në fund të v.2021 vlerën neto prej 82.4 mln lekë, që i përket vetëm rikonstruksioneve të kësaj godine, të kryer ndër vite.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Konstatim:

Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivët Afatgjatë Materiale pasqyrojnë **vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këtë objekt ndërtimor**. Procedurat e kalimit në përgjegjësi administrimi dhe transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material “Ndërtesa” nuk janë dokumentuar rregullisht sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, pasi mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për zërin “Ndërtime e rikonstruksione”, kanë **regjistruar në fund të v.2021 vlerën neto prej 82.4 mln lekë që i përket vetëm vlerës së rikonstruksioneve të kryera ndër vite**.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.468, datë 03.06.2015 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) objektin me emërtimin “Atelier për Dekorin e Radio Televizionit”, në zonën kadastrale nr. 8160 me numër pasurie 2/94, me sipërfaqe totale 10,177 m² dhe sipërfaqe ndërtese 6,202 m². Në këtë vendim nuk është përcaktuar vlera e aseteve të transferuara. Nga ana e AMA-s janë kryer rikonstruksione dhe riparime që kanë përfshirë në Aktivët e Qëndrueshme të Trupëzuara të periudhës 2016-2022, vetëm vlerën e situacioneve të likuiduara dhe nuk është përfshirë vlera tjetër e objektit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Veprimi i mësipërm shtrembëron vlerën e aktiveve të Institucionit si edhe të shpenzimeve të amortizimit, që duhen llogaritur për këtë aktiv.

AMORTIZIMI I VLERES SE RIKONSTRUKSIONIT TE GODINES viti 2020 (NORMA 5%)

N r.	Emërtimi	Akti i marrjes në dorëzim të godinës	Garancia nga sipërmasia rrësi	V.Mbetur 2019	Shtesa gjatë 2020 (II)	Pa kështim e gjatë 2020 (III)	Vlera e mbetur 2020 ((I+II)-(III))	Amortizimi 2020	V.Mbetur 2020
1	Rikonstruksioni i godinës	23.08.2017	qershor 2018	92,321,518			92,321,518	4,990,352	87,331,165
2	F.V derene zyren e TIK	26.12.2019		28,000			28,000	1,400	26,600
3	F.V pompe uji	24.02.2020			56,000		56,000	2,333	53,667
TOTAL				92,349,518	56,000	-	92,405,518	4,994,086	87,411,432

Situata:

1. Në regjistrin kontabël të pasurive të institucionit të AMA-s, nuk ishte regjistruar objekti në të cilin operon institucioni. Nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të mbyllura me datën 31.12.2020 dhe datë 31.12.2021, vlera e plotë dhe të saktë kontabile e llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa” tek AQT e institucionit. Procedurat e transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material “Godinë” nuk janë kryer sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, dhe mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të AMA-s. Rezulton se në kontabilitet dhe në pasqyrat e llogaridhënies vjetore dhe regjistrin e Aktiveve Afatgjatë Materiale janë pasqyruar vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këto objekte ndërtimore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të mbyllura me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2022 nuk kanë të pasqyruara në kontabilitet vlerën e drejtë e të saktë në pasqyrën e pozicionit financiar për zërin “Ndërtime e konstruksione”, pasi kjo llogari (llog. 212 “Ndërtesa dhe rikonstruksione”) është pasqyruar për vlerën 246,403 mijë lekë që ka regjistruar vetëm vlerën e rikonstruksioneve të kryera. Sa sipër është në mospërputhje të paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuatr i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, që ka përcaktuar se, <i>“vetëm ato aktive, kostoja e të cilëve mund të përcaktohet me besueshmëri, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar”</i>. SKK nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”. ✓ Paragrafi 20 “Një klasë AAM, vlera e drejtë e së cilave mund të matet me besueshmëri, paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e rivlerësuar, e cila është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit, pakësuar në periudhat në vijim me amortizimin e akumuluar të mëpasshëm dhe humbjet e akumuluar të mëpasshme nga zhvlerësimi. Rivlerësimet duhet të kryhen rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-së, në datën e raportimit do të bëhej me vlerën e drejtë. ✓ Paragrafi 21, “Vlera e drejtë e truallit dhe ndërtesave zakonisht përcaktohet mbi bazën e treguesve të tregut nëpërmjet vlerësimeve të kryera nga vlerësues profesionistë të kualifikuar. Vlera e drejtë e elementeve të AAM-së është zakonisht vlera e tyre e tregut e përcaktuar nga vlerësuesit.
Kriteri	-Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, paragrafi 20 dhe 21, dhe paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuatr i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”. -Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. -Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar. -Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.468, datë 03.06.2015. -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. -Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.
Ndikimi/ Efekti:	• Nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të mbyllura për vitin 2020 dhe 2021 vlera e plotë dhe e saktë kontabile e llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa” tek AQT e institucionit. • Mos regjistrimi i godinës së AMA, në regjistrat e aktiveve ndikon në nënvlerësimin domethënës të pasurive kapitale që ky institucion zotëron dhe në pasqyrimin me pasaktësi të shkallës së amortizimit të këtyre aktiveve. • Bazuar në shkaqet dhe impaktin, kjo gjetje ndikon në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara (ose AAGJM).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Shkaku:	Është ndikuar nga faktorë të jashtëm, si mos pasqyrimi në kontabilitet i vlerës kontabile të godinës nga institucionet që ka qenë administrues të kësaj pasurie më parë, por edhe nga mosveprimi i Titullarit , NA dhe NZ se AMA-s.
rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Duke patur parasysh rëndësinë e këtij procesi për të pasqyruar vlerën e drejtë të këtij aktivi në pasqyrat financiare të institucionit, pasaktësitë e informacionit të mbartur dhe trashëguar AMA për vlerën e kësaj godine, Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që objekti ndërtimor në administrim të institucionit, të pasqyrohet me vlerën e drejtë në kontabilitetin e tij. Për sa sipër, SP të marrë masat për kryerjen e një procesi të transferimit dhe vlerësimi të pavarur për të përcaktuar vlerën aktuale të këtyre aktiveve, për ta pasqyruar dhe për ta sjellë vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet në llogarinë 212 “Ndërtesa” në përputhje me përcaktimet e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 ”Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)” dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues të kryhen regjistrimet e drejta të vlerës së aktiveve të institucionit.
Afati	Në vijimësi

Konstatimi:

Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2021, llogaria 212 “Ndërtesa” si dhe llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” (për vitin 2020 dhe 2021) janë në vlerën zero lekë. Ekzistojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet që mbulon godina që ka në dispozicion dhe përgjegjësi administrimi për periudhën objekt auditimi. Si rrjedhojë, nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në kontabilitetin e AMA-s, ndonëse sipas VKM nr.468, dt 3.6.2015, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objektit dhe truallit, për llogari të institucionit të AMA-së.

Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet se **për zonën kadastrale ZK 8160, çmimi është 33,755 lekë/m² x sipërfaqja 10,177 m² = 343,524,635 leke, vlerë kjo që rezulton mbi pragun e mterialitetit sasior në auditim.**





KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

(Burimi: Harta e tokës dhe vlera e pasurive të paluajtshme për tokën truall, sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973)

Në referim të çmimit për m² për zonën kadastrale nr. 8160 sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësish shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.

Titulli i Gjetjes: Nuk është regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare për periudhën 2019 2021 vlera e trojeve në administrim të institucionit. ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël për institucionin e AMA-s

Situata:	Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” është në vlerën zero lekë. Ekzistojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet takuese qëi perkasin godinës prej 6,202 m² dhe sip. se truallit prej 10,177 m² që ka në dispozicion dhe përgjegjësi administrimi institucioni për periudhën objekt auditimi, por nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në kontabilitetin e tij ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objektit dhe truallit, për llogari të këtij institucioni. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet me 66,969 lekë/m² në zonën kadastrale ku shtrihen këto pasuri publike.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se: “62. Aktivët paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: ☐ Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	☐ Nën rubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin <u>toka</u>, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj; ☐ Nën rubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet; dhe ☐ Nën rubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale. 91. Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me kosto historike), sipas rreshtave, përfaqëson: ☐ Rubrika I “aktive afatgjata jomateriale”, e cila përfshin prime të emisionit dhe rimbursimit të huarve, studime dhe kërkime, koncensione, patenta, licenca e të ngjashme. ☐ Rubrika II “aktive afatgjata materiale”, e cila përfshin zëra si: <u>toka, troje</u>, pyje, ndërtime e konstruksione, mjete transporti, rezerva shtetërore, kafshë pune e prodhimi, inventar ekonomik, etj. ☐ Totali i aktiveve afatgjata, për çdo zë të evidentuar në kolonat e pasqyrës, paraqitet në rreshtin e fundit të kësaj pasqyre.
Ndikimi/Efekti:	Nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 1.1.2020-31.12.2020 dhe për periudhën 1.1.2021-31.12.2021 vlera kontabile e llogarisë ekonomike 210 “Toka, troje e terrene”, tek grupi i AQAM të AMA-s, që shtë në vlerën e përlllogaritur prej 343,524,635 leke .
Shkaku:	Është ndikuar nga faktorë të jashtëm, si mos pasqyrimi në kontabilitet i vlerës kontabile të tokës mbi të cilën ngrihet ndërtesa si dhe oborrit në dispozicion nga ana e institucionit.
Vlerësimi i nivelit të riskut	i mesëm
Konkluzioni	Këto parregullsi, bazuar shkaqet dhe ndikimin që ka pasur kjo gjetje, ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël.
Rekomandimi	1. Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të ngrejë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. 2. Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të AMA-s bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimit dhe pasqyrimi në kontabilitetin e institucionit i vlerave të këtyre pasurive bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesi i pavarur.
Afati	Në vijimësi

Konstatim:




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA, debitorëve dhe klientëve dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht në shumën prej 442 milionë lekë në vitin 2019, 450 milionë lekë në vitin 2020, 446 milionë lekë në vitin 2021 dhe 487 milionë lekë në fund të 6-mujorit të parë 2022.

Më hollësisht,

Bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga ana e zyrtarëve të AMA-s rezulton se niveli i detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA paraqitet me një trend rritës. Grafikisht, tendenca e debitorëve, klientëve dhe të drejtave të arkëtueshme për periudhën objekt auditimi paraqitet si në grafik:



I. Detyrimet e subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/ autorizuara si dhe të drejtata e tjera të arkëtueshme nga AMA, në fund të vitit 2020 janë për 450,418 mijë lekë, me një rritje nga viti 2019 për 8 milionë lekë:

zerat	Emërtimi	v.2020	v.2019
	Llogari të Arkëtushme	450.418.574	442.054.418
411	Kliente e llogari të ngjashme	326.540.457	325.770.726
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	6.283	6.283
44	Institucione të tjera publike	7.200.000	0
468	Debitorë të ndryshëm	116.671.834	116.277.409

Ky post në shumën prej **450,418,574 lekë** është i përbërë nga nën zërat sipas analizës së mëposhtme:

✓ "Klientë e llogari të ngjashme" me një shumë prej **326,540,457 lekë** përbëhet nga klientë si më poshtë:

- "Klientë për **pagesë vjetore për licencë/ autorizim**" në masën 13,912,683 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që kanë OSHMA-të e licencuara/autorizuara ndaj AMA-s për pagesat vjetore për licencë/ autorizim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- “Klientë për **tarifën për shërbimet RTV**” në masën 2,222,272 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që kanë OSHMA-të e licencuara ndaj AMA-s për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive.
- “Klientë për **sanksione me gjobë**” në masën 284,466,822 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për sanksionet gjobë të vëna nga AMA, për subjektet e rezultuara në shkelje, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- “Klientë për **kamatëvonesa**” në masën 3,502,305 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përllogaritura gjatë vitit 2020, ndaj OSHMA-ve që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave të detyrimeve financiare vjetore.
- “Klientë për **kamatëvonesa për sanksionet me gjobë**” në masën 22,436,375 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përllogaritura nga përfaqësuesit e përmbarimit privat gjyqësor, për OSHMA-të që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave të sanksioneve me gjobë në kohë.
- ✓ “Organizma të tjerë shtetërore” me një shumë prej **6,283 lekë**, përfaqëson diferencën kreditore të detyrimeve të AMA-s për pensionin suplementar.
- ✓ “Institucione të tjera publike” me shumën prej **7,200,000 lekë**, përfaqëson shumën e kaluar në llogari të Ministrisë së Kulturës në vijim të kontratës të firmosur mes dy institucioneve tona, për mbështetjes financiare nga AMA për dy projekte të Ministrisë së Kulturës.
- ✓ “Debitorë të ndryshëm” me një shumë prej **116,671,834 lekë**, përfaqëson shumën e detyrimeve për pagesë vjetore për licencë/autorizim në masën 107,795,685 lekë dhe detyrimet për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive në masën 5,758,993 lekë, të mbetura nga subjektet radiotelevizive, pasi iu është hequr licenca/autorizimi ose është bërë konstatim i pavlefshmërisë së licencës/autorizimit me vendim të AMA-s; si dhe detyrimin për kthim shumash/ pagash nga ish punonjësi A. B. në masën 1,995,656 lekë (sipas vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 560, datë 27.02.2019) dhe ish punonjëses A. H. mbetur në masën 1,121,500 lekë (sipas vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 111, datë 05.02.2019). (Znj. A.H. ka shlyer gjatë vitit 2020 shumën prej 408,000 lekë, në vijim të kontratës me nr. 3934 prot., date 31.10.2019, lidhur për pagesë me kështu të detyrimit).
- ✓ “Parapagime” me një shumë prej **2,586,013 lekë**, përfaqëson pagesat e kryera si parapagim për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm të titujve ekzekutiv për vjeljen e detyrimeve financiare nga debitorët për të cilët AMA ka vendosur heqjen e licencës/autorizimit, si dhe nga tarifat gjyqësore në masën 1% të vlerës së detyrimit, për çeljen e akt padive ndaj subjekteve të mbetur debitor në AMA.

II. Detyrimet e subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA, në fund të **vitet 2021**:

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra (Klasa 4), dt.31.12.2021:

Ky post është evidentuar në fund të vitit në kontabilitet në shumën prej **445,521,863 lekë** dhe është i përbërë nga nën zërat sipas analizës së mëposhtme:

Nr.llog	Emertesa	2021	2020
	Llogari të Arkëtueshme	445,521,863	450,418,574



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

411	Klientë e llogari të ngjashme	342,683,700	326,540,457
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	5,483	6,283
44	Institucione të tjera publike	5,096,500	7,200,000
468	Debitorë të ndryshëm	97,736,180	116,671,834

Më hollësisht llogaritë e arkëtueshme,

⊕ **"Klientë e llogari të ngjashme"** me një shumë prej **342,683,700 lekë** përbëhet nga klientë si më poshtë:

- **"Klientë për pagesë vjetore për licencë/ autorizim"** në masën 15,678,871 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që kanë subjektet e licencuara/autorizuara ndaj AMA-s për pagesat vjetore për licencë/autorizim.
- **"Klientë për tarifën për shërbimet RTV"** në masën 1,908,145 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që kanë subjektet e licencuara ndaj AMA-s për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive.
- **"Klientë për sanksione me gjobë"** në masën 296,793,722 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për sanksionet gjobë të vëna nga AMA, për subjektet e rezultuara në shkelje, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- **"Klientë për kamatëvonesa"** në masën 5,866,587 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përlllogaritura gjatë vitit 2021, ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave vjetore për licencë/autorizim.
- **"Klientë për kamatëvonesa për sanksionet me gjobë"** në masën 22,436,375 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përlllogaritura përmbauesit privat gjyqësor, për OSHMA-të që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave të sanksioneve me gjobë në kohë.

⊕ **"Organizma të tjerë shtetërore"** me një shumë prej **5,483 lekë**, përfaqëson diferencën kreditore të detyrimeve të AMA-s për pensionin suplementar.

⊕ **"Institucione të tjera publike"** në masën **5,096,500 lekë**, përfaqëson totalin e vlerës të financimeve të kryera nga AMA, ndaj institucioneve të tjera publike, konkretisht:

1. Financimi në masën **3,600,000 lekë** përfaqëson shumën e kaluar në llogari të **Ministrit të Kulturës** në vitin 2020 në vijim të një prej kontratave mes dy institucioneve tona, për të cilën nuk pati finalizim gjatë vitit 2021, ndaj u shoqërua me shtyrje afati në vitin 2022.
2. Financimi në masën **1,496,500 lekë** përfaqëson shumën e kaluar në llogari të **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, për mbështetje financiare nga AMA për një projekt të propozuar nga ky i fundit, i cili është finalizuar në fund të vitit 2021 dhe pritet të bëhet kthimi i shumës të papërdorur nga fondi i financimit, në fillim të vitit 2022.

⊕ **"Debitorë të ndryshëm"** me një shumë prej **97,736,180 lekë**, përfaqëson shumën e detyrimeve për **pagesë vjetore për licencë/autorizim** në masën 89,384,729 lekë dhe detyrimet për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive në masën 5,642,295 lekë, të mbetura nga subjektet radiotelevizive, pasi iu është hequr licenca/autorizimi ose është bërë konstatim i pavlefshmërisë së licencës/autorizimit me vendime të AMA-s; si dhe detyrimin për kthim shumash/pagash nga ish punonjësi A. B. në masën 1,995,656 lekë (sipas vendimit të Gjykatës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Apelit nr. 560, datë 27.02.2019) dhe ish punonjëses A. H. mbetur në masën 713,500 lekë (sipas vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 111, datë 05.02.2019). (Konstatohet se znj.A.H. ka shlyer gjatë vitit 2021 shumën prej 408,000 lekë, në vijim të kontratës me nr. 3934 prot., datë 31.10.2019, lidhur për pagesë me këste të detyrimit).

⊕ **“Parapagime”** me një shumë prej **2,583,013 lekë**, përfaqëson detyrimin e mbetur për pagesat e kryera si parapagim për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm të titujve ekzekutiv për vjeljen e detyrimeve financiare nga debitorët për të cilët AMA ka vendosur heqjen e licencës/autorizimit në masën 2,335,736 lekë dhe nga tarifat gjyqësore në masën 1% të vlerës së detyrimit, për çeljen e akt padive ndaj subjekteve të mbetur debitor në AMA.

Pra, në strukturën e klientëve dhe të drejtave për arkëtim (paraqitur në tabelën e mëposhtme), rezulton shuma **28,302 mijë lekë e ardhur nga aplikimi i kamatëvonesave**, kjo, si ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave vjetore për licencë/autorizim, ashtu dhe mbi vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përllogaritura përmbaresit privat gjyqësor, për OSHMA-të që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave të sanksioneve me gjobë në kohë:

Vlera në lekë

“Klientë për pagesë vjetore për licencë/autorizim”	15,678,871
“Klientë për tarifën për shërbimet RTV”	1,908,145
“Klientë për sanksione me gjobë”	296,793,722
“Klientë për kamatëvonesa”	5,866,587
“Klientë për kamatëvonesa për sanksionet me gjobë”	22,436,375
“Institucione të tjera publike”	5,096,500
“Debitorë të ndryshëm”	97,736,180
Gjithsej	445,516,380

Burimi: AMA, Relacioni shpjegues i PF v.2021, përpunuar nga grupi i auditimit

III. Mbi detyrimet e subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA, në fund të 6–muajorit të I-të, 2022.

- Detyrimet e subjekteve të licencuara/autorizuara nga AMA në fund të muajit qershor 2022 janë në masën **70,177,574 lekë**, ndarë si më poshtë:
 - 68,172,633 lekë për pagesë vjetore për licencë/autorizim;
 - 96,796 lekë për kamatëvonesa deri në fund të muajit qershor 2022;
 - 1,908,145 lekë tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive, RTV.
- Shuma prej **321,049,430 lekë**, përfaqëson masën e sanksioneve me gjobë të fund të vitit 2021, ku masa 298,613,055 lekë është vlera e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për sanksionet gjobë të vëna nga AMA, për subjektet e rezultuara në shkelje, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe masa 22,436,375 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara që rezultojnë për kamatëvonesat e përllogaritura nga përfaqësuesit e përmbaresit privat gjyqësor, për OSHMA-të që nuk kanë respektuar afatet ligjore për kryerjen e pagesave të sanksioneve me gjobë në kohë.
- Shuma prej **95,716,474 lekë**, përfaqëson shumën e detyrimeve për pagesë vjetore për licencë/autorizim në masën 90,126,679 lekë dhe detyrimet për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive në masën 5,589,795 lekë, të mbetura nga subjektet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

radiotelevizive, pasi iu është hequr licenca/autorizimi ose është bërë konstatim i pavlefshmërisë së licencës/autorizimit me vendim të AMA-s.

Nga ana tjetër, duhet të theksohet se shuma e shpenzimeve për ngritje akt-padi dhe përmbartime, në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2022 janë në shumën prej 2,143,492 lekë, ose vlerë kjo e barabartë me 2.24 % të totalit të detyrimit të mbetur, për licenca të hequra nga viti 2015 e në vijim nga ana e AMA-s.

Konstatim:

Gjatë periudhës 2015-2022 nga ana e AMA-s, disa subjekteve për arsye të shkeljeve të ndryshme ligjore të konstatuara, u janë hequr licencat dhe autorizimet, mirëpo deri në momentin e heqjes së licencave këto subjekte kanë rezultuar me detyrime financiare të papaguara, detyrime të lindura gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencave /autorizimeve, deri në datën e mbajtjes së raportit, të paarkëtuara, duke shtuar mundësinë e parashkrimit të këtyre të drejtave për arkëtim. Rezulton se në 69 raste, nga lista prej 96 subjektsh të regjistruar, që kanë qenë pajisuar me licenca dhe autorizimi, të cilat u janë hequr gjatë periudhës 2015-2022, figurojnë me detyrime të konsiderueshme financiare kundrejt Autoritetit të Mediave Audiovizive për shumën prej 95.716.474 lekë. Në pjesën më të madhe të rasteve, nga ana e AMA janë ngritur dhe depozituar në gjykatë kërkesë paditë ose shpenzime përmbartime për arkëtimin e detyrimeve, për të cilat janë kryer pagesat përkatëse nga ana e institucionit, ku janë testuar:

A. K	2016	2,150,000	Lidhur kontratë me shoqërinë përmbartime "S." me nr. 1493/1 prot., datë 04.2022.
Ko.	2016	3,554,170	Gjykata Administrative e Shkallës së I-rë, Tiranë me vendim datë 27.10.2022, vendosi pranimin e kërkesë-padisë (pritet vendimi të marrë formë të prerë).
Tv K. H.	2019	2,118,040	Çështja vijon në Gjykatën e Apelit Administrative
Tv. N.	2018	1,825,600	Pezulluar procesi gjyqësor deri në gjykimin në apel të çështjes së rinovimit të licencës.
Mi.	2016	733,630	Çështja vijon në Gjykatën e Apelit Administrative
Tv. V. C.	2018	419,027	Lidhur kontratë me përmbartues S. sh.p.k. për ekzekutimin e titullit ekzekutiv urdhër nr. 3580 & 3582 prot., datë 09.11.2021, dhe nr. 3931, datë 26.10.2022, për vendosjen e sekuestros konservative bankave dhe QKB.
Tv. K. A. V.	2022	828,650	Gjykata Administrative e Shkallës së I-rë, Tiranë me vendimin nr. 1429, datë 04.05.2022, vendosi kthimin e kërkesë-padisë dhe akteve palës paditëse. Për t'u rihedhur Kërkesë Padia.
OSHMA C. O.	2021	415,095	Kontratë shërbimi nr. 1368/1 prot, datë 04.04.2022. Njoftim nr. 1835 dhe 1836 për sekuestro konservative nga shoqëria përmbartime S. sh.p.k.

Burimi: Autoriteti i Mediave Audiovizive, DSHB.

Titulli i gjetjes:

Domosdoshmëria e marrjes së masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve, veprime në pajtueshmëri me gerrat "g" dhe "gj", neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Situata:	Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuar dhe subjekteve të palicencuara/autorizuara nga AMA, debitorëve dhe klientëve dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht në shumën prej 442 milionë lekë në vitin 2019, 450 milionë lekë në vitin 2020, 446 milionë lekë në vitin 2021 dhe 487 milionë lekë në fund të 6-mujorit të parë 2022. Konstatohet se vlera e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në AMA në fund të vitit 2020 ishte 117 milionë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet për 98 milionë lekë, vlera këto të konsiderueshme që përfaqësojnë mbi 20 % të llogarive të arkëtueshme vjetore të institucionit.
Kriteri:	✓ Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 12, pika 3, germa “g” dhe “gj”; ✓ Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 19 dhe 20; ✓ Udhëzimi nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit” i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48.
Ndikimi/Efekti:	Mundësi për mos arkëtimin e debitorëve duke kaluar afatet administrative, në saktësimin e vlerës së të drejtave dhe detyrimeve të sektorit publik si dhe rritje të detyrimeve si rezultat i mos likuidimit në kohë të furnitorëve.
Shkaku:	Mosrespektim dhe mos zbatim i kuadrit ligjor për debitorët dhe kreditorët.
Rëndësia:	i mesëm – lartë
Rekomandimi	1. Institucioni i AMA-s të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të të drejtave për arkëtim, me qëllim vënien e tyre në kushtet e arkëtimit; analizën e gjendjes së debitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete për ndjekjen dhe të vendosin në kushtet e arkëtimit vlerat e debive të regjistruara në kontabilitet sidomos në kushtet që një pjesë e madhe e tyre kërcënohen nga risku i parashkrimit. Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar. Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 2, germa “g”, është përgjegjës për: <i>“garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa arkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij...”</i>, të marrë masat që të dërgohen shkresa zyrtare dhe nga strukturat përgjegjëse të AMA-s të kërkohej në rrugë gjyqësore arkëtimi i debive nëpërmjet ngritjes së padisë për këtë qëllim për arkëtimin e detyrimeve, për debitorët që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, t’i propozohet Ministrisë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	së Financave që t'i mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre. 2. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Afati	Menjëherë e në vijimësi

Konstatim:

AMA, për rastet e shfuqizimit të sanksioneve me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, ka marrë në shqyrtim pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimues duke rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit, nga revokimi pa shkaqe të arsyeshme të sanksioneve administrative, që është vlera totale e gjobave të shfuqizuara, pasi 80% e vlerës së gjobës shkon në buxhetin e shtetit dhe 20% e saj shkon në buxhetin e AMA-s).

Këto veprime tregojnë ose parregullsi në caktimin e gjobës (që duhej shoqëruar me mosnxjerrje të përgjegjësisë), ose parregullsi për shfuqizimin e tyre, sipas kompetencave të dhëna nga neni 132, pika 4 e ligjit nr. 97/2013, që ka përcaktuar: “Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka selinë organi administrativ”.

Më hollësisht,

Për vitin 2019:

Gjatë vitit 2019 nga AMA janë vendosur 26 sanksione me gjobë, ku:

- Me propozim të Drejtorisë së Mbikqyrjes, janë vendosur 19 sanksione gjobë;
- Me propozim të Këshilli i Ankesave, u vendosën janë vendosur 5 sanksione me gjobë;
- Me propozim të Drejtorisë Juridike dhe Licencave, është vendosur 1 sanksion me gjobë;
- Me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, është vendosur 1 sanksion me gjobë, në zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, në vitin 2019, pasi vetëm 1 (një) subjekt i autorizuar, nuk depozitoi bilancin për vitin 2018, subjekt për të cilin AMA ka marrë vendimin e sanksionimit me gjobë, të propozuar nga Drejtoria e Shërbime të Brendshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

a.Ecuria e financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2019 (në lekë)

Celja në fillim të vitit 2019	310,779,178
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2019	35,030,000
+ Kamatë vonesa të lindura në vitin 2019	275,097
- Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë (vitet 2010 - 2019) dhe kamatëvonesat e lindura	8,832,887
- Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	29,500,000
Detyrimi në fund të vitit 2019	307,751,388

Burimi: AMA, Raporti vjetor dërguar Kuvendit, v.2019.

-Masa e detyrimeve të lindura prej 26 sanksioneve me gjobë në vitin 2019 është në vlerën 35.030.000 lekë.

-Masa e uljes në vlerën **29,500,000 lekë** për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ ulurmasa/ shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të AMA-s është ulur masa e detyrimit për 1 vendim të sanksionit me gjobë të vitit 2019;
- Me vendime të AMA-s të vitit 2019, janë shfuqizuar 8 vendime të sanksione me gjobë të vitit 2018 dhe 6 vendime të sanksione me gjobë të vitit 2019.

6 raste të shfuqizimit janë:

1. T. M., nr. 1, datë 10.04.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 93, datë 07.06.2019, (1,000,000) lekë
2. Y. Xh., nr. 5, datë 15.04.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 82, datë. 16.05.2019, (5,000,000) lekë;
3. T.B., nr. 12, datë 02.05.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 92, datë 07.06.2019 (1,000,000) lekë;
4. T.R.B., nr. 13, datë 07.05.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 108, datë 11.07.2019, (1,000,000) lekë;
5. T.D., nr. 18, datë 15.10.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 177, datë 18.11.2019, (1,000,000) lekë;
6. T S., nr. 20, datë 02.12.2019, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 201, dt. 26.12.2019 (1,000,000) lekë.
 - 1 vendim të sansionit me gjobë i vitit 2015 është shfuqizuar me vendim gjykate.

Për vitin 2020, në vijim të kontrolleve të ushtruara kryesisht, mbi të dhënat e subjekteve të pasqyruara në ekstraktin për të dhënat e subjekteve në faqen zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit, gjatë vitit 2020, Drejtoria Juridike dhe e Licencave e AMA-s, ka ndëshkuar 1 subjekt, me vendim për dënimin me gjobë nr. 6¹, datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA, me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021.

b.Ecuria financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2020 (në lekë):

Çelja në fillim të vitit 2020	307,751,388
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2020	5,160,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

+ Kamatëvonesa të lindura në vitin 2020	0
- Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë dhe kamatëvonesat e lindura	2,008,191
- Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	4,000,000
Detyrimi në fund të vitit 2020	306,903,197

Burimi: AMA, Raporti vjetor dërguar Kuvendit, v.2020.

-Masa e detyrimeve të lindura prej 6 sanksioneve me gjobë në vitin 2020 është në vlerën 5.160.000 lekë.

-Masa e uljes në vlerën 4,000,000 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të **AMA-s janë shfuqizuar 2 vendime të sanksioneve me gjobë** të vitit 2020: gjoba nr. 2, datë 21.07.2020, shfuqizuar me vendimin nr. 81, datë 03.09.2020 dhe gjoba nr. 4 datë 21.07.2020 shfuqizuar me vendimin nr. 71, datë 21.08.2020.

Viti 2020, shfuqizime dënimi me gjobë

1. T.K., nr. 2, datë 21.07.2020, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 81, datë 03.09.2020 (1,000,000) lekë;
2. T.E., nr. 4, date 21.07.2020, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr.71, datë 21.08.2020, (1,000,000) lekë;
3. T.Ch. 7, nr. 6, datë 23.12.2020, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 8, datë 18.01.2021, (120,000) lekë.
 - **2 vendime të sanksioneve me gjobë janë shfuqizuar me vendim gjykate:** gjoba nr. 49 datë 24.11.2015 shfuqizuar me VGJA me nr. 682, datë 29.06.2020 dhe gjoba nr. 55 datë 07.12.2015 shfuqizuar me VGJA me nr. 130, datë 29.01.2020.

Gjatë vitit 2021 janë iniciuar 5 hetime administrative dhe janë dënuar për kundërvajtjen administrative, “Mosnjofim i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e licencës / autorizimit”, me sanksion gjobë:

- ✓ Nr. 1, datë 02.03.2021, vendosur ndaj shoqërisë “R.-O.” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP, në masën 120,000 leke, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 50, datë 26.03.2021;
- ✓ Nr. 2, datë 02.03.2021 vendosur ndaj shoqërisë “S. K.” sh.p.k., për subjektin “S.K.”, në masën 120, 000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 41, datë 11.03.2021.

c. Ecuria financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2021 (në lekë):

Çelja në fillim të vitit 2021	306,903,197
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2021	17,240,000
+ Kamatëvonesa të lindura në vitin 2021	0



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë dhe kamatëvonesat e lindura	2,553,100
- Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	2,360,000
Detyrimi në fund të vitit 2021	319,230,097

Burimi: AMA, Raporti vjetor dërguar Kuvendit, v.2021.

-Masa e detyrimeve të lindura prej 15 sanksioneve me gjobë, në vitin 2021, është 17,240,000 lekë.

-Masa e uljes në vlerën **2,360,000 lekë** për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- **Me vendim të AMA-s** nr. 8, datë 18.01.2021, është shfuqizuar sanksioni me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, në masën 120,000 lekë.
- **Me vendime të AMA-s janë shfuqizuar 2 (dy)** vendime të sanksioneve me gjobë, të vitit 2021, në masën 240,000 lekë, konkretisht: sanksioni me gjobë nr. 1, datë 02.03.2021 (shfuqizuar me vendimin nr. 50, datë 26.03.2021) dhe sanksioni me gjobë nr. 2 datë 02.03.2021 (shfuqizuar me vendimin nr. 41, datë 11.03.2021).
- **Me 2 (dy) vendime të AMA-s** janë ulur masat e dënimit të sanksioneve me 2,000,000 lekë, konkretisht: me vendimin nr. 95, datë 26.11.2021 është ulur masa e sanksionit me gjobë nr. 12, datë 11.10.2021 dhe me vendimin nr. 103, datë 21.12.2021 është ulur masa e sanksionit me gjobë nr. 13, datë 01.11.2021.

Viti 2021, total 15 vendime dënimi me gjobë

1. R.O, nr. 1, datë 02.03.2021, shfuqizuar me vendimin e AMA-s. nr. 50, datë 26.03.2021, (120,000) lekë;
2. K. S. nr. 2, datë 02.03.2021, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 41, datë 11.03.2021, (120,000) lekë.

Sipas evidencave të vënë në dispozicion nga ana e AMA-S, rezulton se për periudhën objekt auditimi paraqitet kjo situatë:

		Të aplikuara	Të shfuqizuara	Të shfuqizuaraat në %
Viti 2019	Numri i gjobave	26	6	23
	Vlera në lekë	35.030.000	10.000.000	29
Viti 2020	Numri i gjobave	6	2	33
	Vlera në lekë	5.160.000	2.000.000	39
Viti 2021	Numri i gjobave	15	2	13
	Vlera në lekë	17.240.000	240.000	1,4
Viti 2022 (6 muajori i I-rë)	Numri i gjobave	6	0	0
	Vlera në lekë	6.120.000	-	-
Totali	Numri i gjobave	53	10	19
	Vlera në lekë	63.550.000	12.240.000	19

Burimi: AMA, Drejtorja e Shërbimeve të brendshme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Konstatim:

Për periudhën objekt auditimi, 1.1.2019- 30.6.2022, bordi i AMA-s, në 10 raste gjithsej ka shfuqizuar sanksionet administrative të dënimit me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, në shumën prej 12,240 mijë lekë, që përfaqëson rreth 20 % të numrit dhe vlerës së gjobave të vendosura gjatë asaj periudhe, duke marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimues duke rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit / institucionit në vlerën prej 12,240,000 lekë, që është vlera totale e gjobave të shfuqizuara.

Analiza e vendimeve të shfuqizuara për periudhën objekt auditimi:

Nga auditimi është konstatuar se, në zbatim të pikës 3, neni 19, i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" si dhe Rregullores së Inspektimeve , miratuar nga Bordi i AMA-s nga ana e strukturave të AMA-s janë kryer kontrole/inspektime për zbatimin e ligjit nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të ligjit dhe janë vendosur sanksione për rastet e shkeljeve. Subjektet të cilat janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga ana e grupeve të inspektimit kanë ushtruar të drejtën e ankimimit të sanksionit të vendosur. Në përfundim të procesit të ankimimit, AMA është shprehur për shfuqizimin e sanksionit me gjobë të vendosura.

Më konkretisht:

Ankimimi (me zgjedhje), i masave administrative / gjobë, për të cilat subjektet që janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga ana e grupeve të inspektimit, kanë ushtruar të drejtën e ankimimit të sanksionit të vendosur dhe bordi i AMA-s është shprehur pas shqyrtimit të ankimit

Tabela nr.

Nr	OMSHA	Gjoha të vendosura nga strukturat e AMA për parregullsi e shkelje Nr datë	Masa administrative gjobë në shumën	Ankimi administrativ i Subjektit kundër gjobës/sanksionit	Vendimi i AMA për ankesën e subjektit	Subjekti ka rikërkuar heqjen e sanksionit	Vendimi i AMA-s për rikërkesën
	Viti 2019						
1.	Shoqëria "J" shpk	Nr.26, dt 17.9.2018	5 milionë Lekë	Nr.3211/1 dt 01.10.2018	Nr.14, dt 16.02.2019 Shfuqizim i gjobës	X	x
2.	Shoqëria "U" shpk	Nr.25,dt 10.07.2018	5 milionë Lekë	Nr.3010/1 dt 26/7/2018 Ankim k/vendimit nr.25	Nr.188, dt 05.11.2018 refuzim ankimi administrativ	Nr. 4512, dt 12.11.2018 Ankim k/vendimit me nr. 188	Nr.16, dt 06.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.25
3.	Subjekti person fizik, A. Sh., T. H.	Nt. 28, dt 14.11.2018	1,2 milione lekë	Nr. 4540/1, dt 06.12.2018	Vendimi nr. 17, dt 06.02.2019, Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.28	x	X
4.	Shoqëria "T. J"	Nr.29, dt 14.11..2018	1,3 milion lekë	Nr. 4608, dt 21.11.2018	Nr.18, dt 06.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.29	x	X
5.	T.F.	Nr.18, dt 11.06.2018	1 milion lekë	Nr.2614/1 dt 27.6.2018	Nr. 191, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ	Nr. 5013/1 dt 11.01.2019 Kërkesë për rishikim	Nr.34, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.18



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

6.	T.H.	Nr.19, dt 11.06.2018	2 milion lekë	Nr.2561/1 dt 17.07.2018	Nr. 185, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi adminis trativ	Nr.383, 18.01.2019	Nr.35, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.19
7.	T.Z.	Nr.27, dt 14.11.2018	1 milion lekë	Nr.4539/1 dt 12.12.2018	Nr.36, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.27	x	x
8.	T.H.	Nr.30, dt 14/11/2018	2 milion lekë	Nr.4542/1 dt 14.11.2018	Nr.37, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.30	x	x
9.	T.Y. XH.	Nr.5, dt 15.04.2019	5 milion lekë	Nr. 1611/1 dt 30.04.2019	Nr.82, dt 16.05.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.05	x	x
10.	T. M.	Nr.01, dt.10.04. 2019	1 milion lekë	Nr.1524 /1 dt 18.4.2019	Nr.93, dt 7.6.2019 Shfuqizim i gjorbës sipas vendimit 01	x	x
11.	Shoqëria "B"	Nr.12, dt.02.05. 2019	1 milion lekë	Nr. 1874/1 dt 30.05. 2019	Nr. 92, dt 07.06.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.12	x	x
12.	Shoqëria "O.N."	Nr. 65, dt 17.4.2019	400 mijë lekë	Nr.2003, dt 21.05.2019 (protokolluar në AMA me nr. 1844/1, dt 23.05.2019	Nr.110, dt.11.07. 2019 Pranimin e pjeseshëm të ankimit prej 200 mijë lekë vendimit nr.65	x	x
13.	Shoqëria "3D.&A. "	Nr.13, dt.6/5/2019	1 milion lekë	Nr.1904 /1 dt 23.5.2019	Nr.108 , dt 11.07.2019 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.13	x	x
	Viti 2020						
14.	T.K., shoqëria "M"	Nr.2, dt.21.07. 2020	1 milion lekë	Nr. 2005/2 dt 19.08.2020	Nr. 81, dt 3.9.2020 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.02	x	x
15.	T."E"	Nr.4, dt.21.07. 2020	1 milion lekë	Nr. 2012/1 dt 3.8.2020	Nr. 71, dt 21.08. 2020 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.4	x	x
	Viti 2021						
16.	Shoqëria "Ch." shpk	Nr.6, dt.23.12. 2020	120 mijë lekë	Nr. 51 dt 31.12.2020, prot AMAm nr.8, dt 5.1.2021	Nr.8 , dt 18.1.2021 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.6	x	x
17.	Shoqëria "R.O" shpk	Nr.1, dt.2.3.2021	120 mijë lekë	Nr. ska, dt 9.3.2021, adminstruar ne AMA Nr.1047/2 dt 09/03/2021	Nr. 50, dt 26.3.2021 Shfuqizim gjorbës sipas vendimit nr.1	x	x



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

18.	Shoqëria "S." shpk	Nr.2, dt.2/3/3021	120 mijë lekë	Nr. ska, dt 3.3.2021, Nr.1048 /2 dt 3.3.2021	Nr.41 , dt 11/3/2021 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.2	x	x
19.	O. "T." shpk	Nr.12, dt.11.10. 2021	2 milion lekë	Nr. 3296/2 dt 09.11. 2021	Nr.95 , dt 26.11.2021 Pranimi pjesor, mbetet gjoba prej 1 mln lekë sipas vendimit nr.12	x	x
20.	O."T." shpk	Nr.13, dt.01.11. 2021	2 milion lekë	Nr.3774, dt 1.12.2021	Nr.103 , dt 21.12..2021 Shfuqizim pjesor prej 1 mln lekë të gjobës sipas vendimit nr.13	x	x
	Viti 2022						
21.	O. "T." shpk	Nr.14, dt.10.11. 2021	2 milion lekë	Nr. 3895/1 dt 10.12.2021	Nr.04 , dt 07.01.2022 Shfuqizim pjesor prej 1 mln lekë të gjobës sipas vendimit nr.14	x	x

Burimi: AMA, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Rezulton se,

I. Në 2 (dy) raste gjithsej (1 në vitin 2018, 1 në vitin 2019), ankesat e subjekteve janë pranuar dhe marrë në shqyrtim nga ana e AMA-S përtej afatit 30 ditor nga ana e subjekteve ankuese:

- T. H. vendosur gjoba Nr.19, dt 11.06.2018 dhe ankimi ishte me Nr.2561/1 dt 17.07.2018;
- Shoqëria "O.N." vendosur gjoba Nr. 65, dt 17.4.2019 dhe ankimi është me Nr.2003, dt 21.05.2019, (protokolluar në AMA me nr. 1844/1, dt 23.05.2019

Sa vepruar në shkelje të afatit të caktuar nga neni 132 "masat për shkeljet", pika 4, e ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013 "Për mediat audiovizive" i ndryshuar, që ka përcaktuar se, "Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit".

II. Në 9 (nëntë) raste vendimarrjet e AMA janë në tejkalim të parashikimeve të nenit 132/4 të ligjit 97/2013, pasi kapërcejnë afatin 30 ditor, përkatësisht për subjektet:

- ⊕ Subjekti "Shoqëria "J." shpk: shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.3211/1, dt 01.10.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.14, dt 16.02.2019, ose pas 4,5 muajsh;
- ⊕ Subjekti "Shoqëria "U." shpk": shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.3010/1, dt 26/7/2018, Ankim k/vendimit nr.25 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.188, dt 05.11.2018 refuzim ankimi administrativ, ose pas 3 muajsh;
- ⊕ Subjekti person fizik, A. Sh., T. H. shkresa e ankimit të gjobës është me Nr. 4540/1 dt 06.12.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 17, dt 06.02.2019, Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.28, ose pas 2 (dy) muajsh;
- ⊕ Subjekti "T.F." shpk shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.2614/1, dt 27.6.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 191, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ, ose pas 4 muajsh;
- ⊕ Subjekti "T.H": shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.2561/1 dt 17.07.2018, dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 185, dt 05.11.2018, Refuzim ankimi administrativ, ose pas 3.5 muajsh;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- ✦ Subjekti “T.Z.” shpk shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.4539/1 dt 12.12.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.36, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.27, ose pas 2 muajsh;
- ✦ Subjekti “T.H.” shpk shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.4542/1 dt 14.11.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.37, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.30, ose pas 3 muajsh;
- ✦ Subjekti “T.M.” shpk shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.1524 /1, dt 18.4.2019 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.93, dt 7.6.2019, Shfuqizim i gjobës sipas vendimit 01, ose pas 1.5 muajsh; etj

Sa më sipër, nuk ka gjetur zbatim neni 132 “Masat për shkeljet”, pika 4, e ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive” i ndryshuar, që ka përcaktuar se, “AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve”.

III. Në shumë raste të analizuara, si arsye për heqjen e sanksioneve administrative me gjobë nga ana e bordit të AMA janë konsideruar shkaqe të tilla si, “pamundësia financiare”, “mosnjohja e ligjit”, etj, që nuk përbëjnë një argumentim ligjor për heqjen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e masës së kundërvajtjes administrative që ka ardhur si pasojë e shkeljes me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji ka parashikuar dënim administrativ.

IV. Rezulton se, në tre raste, kundër vendimit të AMA-s është vijuar sërish me ankim në AMA, dhe jo në gjykatë:

Nr	OMSHA	Gjoba të vendosura nga strukturat e AMA për parregullsi e shkelje Nr datë	Masa administrative gjobë në shumën	Ankimi administrativ i Subjektit kundër gjobës/sanksionit	Vendimi i AMA për ankesën e subjektit	Subjekti ka rikërkuar heqjen e sanksionit	Vendimi i AMA-s për rikërkesën
1.	Shoqëria “U.” shpk	Nr.25, dt 10.07.2018	5 milion Lekë	Nr.3010/1 dt 26/7/2018 Ankim k/vendimit nr.25	Nr.188, dt 05.11.2018 refuzim ankimi administrativ	Nr. 4512, dt 12.11.2018 Ankim k/vendimit me nr. 188	Nr.16, dt 06.02. 2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.25
2.	T.F.	Nr.18, dt 11.06.2018	1 milion lekë	Nr.2614/1 dt 27.6.2018	Nr. 191, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ	Nr. 5013/1 dt 11.01.2019 Kërkesë për rishikim	Nr.34, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.18
3.	T.H.	Nr.19, dt 11.06.2018	2 milion lekë	Nr.2561/1 dt 17.07.2018	Nr. 185, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ	Nr.383, 18.01.2019	Nr.35, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.19

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 97/2013, datë 4.3.2013, Kreu XIV, “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, Neni 132, “Masat për shkeljet”, pikat nr.1-5, që përcaktojnë shprehimisht se:

1. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, AMA vendos:
a) gjobë;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

b) pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;

c) reduktim të kohës së licencës dhe/ose autorizimit;

ç) heqje të licencës dhe/ose autorizimit.

AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer.

2. AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

3. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.

4. Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve.

Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka selinë organi administrativ.

5. Vendimet e AMA-s, ekzekutohen nga shërbimi përmbartimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

Si dhe pikat nr 10-13 , të Nenit 133, “Gjobat”, të po këtij ligji, që shpreh se:

10. Gjopa vendoset nga inspektorët ose AMA, me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara. Ndëshkimi me gjobat e mësipërme është i vlefshëm edhe për RTSH-në.

11. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në AMA brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni. AMA merr vendim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

12. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ka selinë organi administrativ.

13. Gjopa është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbartimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s.

Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative”, Neni 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik:

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij. 2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban: a) pjesën hyrëse, që përmban: i) emrin e organit publik që nxjerr aktin; ii) palët të cilave u drejtohet akti; iii) datën e miratimit; iv) bazën ligjore; b) pjesën arsyetuese; c) dispozitivin që tregon: i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur; ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit; **iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.** 3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjal. 4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pjesa e gjashtë “mjetet ligjore administrative”, kreu I “dispozita të përgjithshme”, Seksioni 2 Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ ndaj aktit, Neni 136 Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

1. Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. 2. Organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar. Nëse është e nevojshme, organi publik kompetent mund të kryejë hetime administrative shitesë. 3. Nëse anulimi, shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ të ankimuar apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t'i shkaktonte dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t'i japë asaj mundësinë për t'u dëgjuar, sipas neneve 87 dhe 88, të këtij Kodi, përpara marrjes së vendimit për ankimin e paraqitur. **4. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, ai me një akt të ri administrativ anulon, shfuqizon ose ndryshon aktin e ankimuar, ose përkatësisht nxjerr aktin e refuzuar, sic është kërkuar nga pala.** 5. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

Mbi depozitimin e pasqyrave financiare nga subjektet e licencuar/autorizuara nga AMA:

Në zbatim të përcaktimeve të nenit nr. 48, “Bilancet vjetore dhe përmbajtja e tyre”, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Operatorët radiotelevizivë publikë e privatë janë të detyruar të hartojnë bilancet e tyre vjetore në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin, të cilat i depozitojnë pranë KKRT-së. Në mënyrë të veçantë në to pasqyrohen të dhëna për programet e transmetuara, çmimet e tyre kur ato janë blerë ose shuma e harxhuar kur ato janë programe origjinale, të dhëna për reklamën e transmetuar ose veprimtari të tjera dhe të ardhurat përkatëse, sponsorizimet, si dhe lista e financuesve apo dhuruesve me shumën përkatëse dhe çdo shpërblim tjetër në favor të subjektit radioteleviziv publik ose privat”; të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; të nenit 33, “Detyrimet e OSHMA-ve”, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku thuhet se:...” **g) të paraqesë bilancin vjetor pranë AMA-s jo më vonë se data 30 prill e çdo viti**”, operatorët radiotelevizivë janë të detyruar të hartojnë dhe depozitojnë pranë AMA-s pasqyrat e llogaridhënies vjetore (bilancet e tyre kontabël). Me shkresat përkatëse AMA ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë të cilët kanë patur aktivitet për periudhën objekt auditimi, të depozitojnë një kopje të pasqyrave financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare. Kështu, AMA ka njoftuar në vitet 2020, 2021 dhe 2022 përmes postës zyrtare dhe asaj elektronike (info@ama.gov.al), subjektet audio/audiovizive të licencuar/autorizuar prej saj, mbi respektimin e afateve ligjore për depozitimin e pasqyrave financiare (ose formular deklarimi fitimi vjetor) të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Nga auditimi i kryer nga ana e audituesve të KLSH-së, në lidhje me dorëzimin e këtyre pasqyrave financiare dhe masat e propozuara nga ana e strukturave përgjegjëse në AMA, rezultoi se:

Mbi bilancet e vitit 2018

Më datë 05.04.2019, referuar shkresës me nr. 14453 prot., AMA ka njoftuar shkresërisht 148 shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar prej tij, për depozitimin e bilancit për vitin 2018. Ky njoftim është dërguar edhe përmes postës elektronike info@ama.gov.al. Në vitin 2019, janë depozituar në total 177 bilance për vitin 2018 (nga shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nga 178 bilance të pritshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Për sa më sipër, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme i ka drejtuar Kryetarit të Autoritetit dhe Sekretarit të Përgjithshëm relacionin me nr. 2936 prot., datë 01.08.2019, mbi depozitimin e pasqyrave financiare për vitin 2018, listën e subjekteve të licencuara/autorizuara nga AMA që nuk kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.

Në vijim është marrë nga ana e DSHB vendimi nr. 15, datë 05.08.2019, “Për dënimin me gjobë të personit fizik “E. L.”, autorizuar për televizionin privat “E.”, në masën prej 40,000 lekë. Ky vendim i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 2965 prot., datë 05.08.2019, të nënshkrur nga ana e SP së AMA-s.

Mbi bilancet e vitit 2019

Në vitin 2020, në kuadër të masave të marra ndaj pandemisë të Covid -19, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) shtyu afatin e depozitimit të pasqyrave financiare për vitin 2019, deri në datën 31 Korrik 2020.

AMA me shkresën me nr. 2275 prot., datë 18.08.2020, me lëndë “Mbi depozitimin e pasqyrave financiare për vitin 2019”, ka njoftuar 163 shoqëri apo person fizik të licencuara/autorizuara nga AMA për depozitimin e bilancit për vitin 2019.

Gjithashtu, AMA me shkresën me nr. 2882 prot., datë 13.10.2020, me lëndë “Rikujtesë mbi depozitimin e bilancit për vitin 2019”, ka njoftuar 41 shoqëri apo person fizik të licencuar/autorizuar nga AMA, për depozitimin e bilancit për vitin 2019.

Më tej, AMA ka njoftuar shkresërisht më datë 25.11.2020, subjektet të cilët nuk kishin depozituar ende bilancet për vitin 2019.

Në vitin 2020, janë depozituar në total 137 bilance për vitin 2019 (nga shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nga 163 bilance të pritshme. Si rrjedhojë, rezultojnë 26 subjekte që nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2019. Nga ana e e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për OMSHA si vijon:

Nr.	Subjektet që nuk kanë dorëzuar bilancin e vitit 2019
1	T. "A."
2	T. "D."
3	T. "L."
4	T. "M.G."
5	T. "S."
6	T. "T."
7	T. "T. C."
8	T. "T."
9	T. "BS"
10	T. "Ch."
11	T. "K."
12	T. "M."
13	T. "Sh."
14	R. "+2"
15	R. "F."
16	R. "H.A."
17	R. "S."
18	R. "V. K."
19	O. "E."
20	O. "M.T.A."



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

21	Shoqëria "D."
22	Shoqëria "T.T"
23	Shoqëria "A. N." shpk
24	Shoqëria "R.A.M."
25	Shoqëria "M.M." sh.p.k.
26	Personi fizik R.R.

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.

Mbi bilancet e vitit 2020

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme e AMA-s përmes postës elektronike info@ama.gov.al, në datën 06.04.2021 u ka përcjellë njoftimin për 155 shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA, për depozitimin e bilancit për vitin 2020.

Më tej, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme e këtij institucioni, përmes postës elektronike ka rikërkuar në datë 08.06.2021 dërgimin të njoftimit për 86 shoqëri apo person fizik të licencuar/autorizuar nga AMA për depozitimin e bilancit për vitin 2020.

Duke qenë se numri i subjekteve audio/audioviziv, (që rezultojnë se ende nuk kishin depozituar pasqyrat financiare/FDP tatim fitimi), ishte i lartë, AMA me shkresën me nr. 2635 prot., datë 03.08.2021 me lëndë “Rikërkesë mbi depozitimin e bilancit për vitin 2020”, rinjoftoi 61 shoqëri apo person fizik të licencuara/autorizuar nga AMA për depozitimin e bilancit për vitin 2020.

Në vitin 2021, janë depozituar në total 156 bilance për vitin 2020 (nga shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nga 162 bilance të pritshme. **Si rrjedhojë, rezultojnë 6 subjekte që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2020. Nga ana e e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për OMSHA si vijon:**

Nr.	Subjektet që nuk kanë dorëzuar bilancin e vitit 2020
1	T.“A.V. P.”
2	T.“L.”
3	T. “R..A.”
4	R.“C. F.”
5	R.“A.”
6	Shoqëria "D." .

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.

Mbi bilancet e vitit 2021

Më datë 14.04.2022, AMA ka njoftuar shkresërisht 148 shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar prej saj, për depozitimin e bilancit për vitin 2021.

Më tej, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme përmes postës elektronike është kërkuar në datë 04.07.2022, dërgimi i njoftimit për 9 shoqëri apo person fizik të licencuar/autorizuar nga AMA, për depozitimin e bilancit për vitin 2021.

Në vitin 2022, janë depozituar në total 161 bilance për vitin 2021 (nga shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nga 164 bilance të pritshme. **Si rrjedhojë, rezultojnë 3 subjekte që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2021. Nga ana e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për OMSHA si vijon:**

Nr.	Subjektet që nuk kanë dorëzuar bilancin e vitit 2021
-----	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

1	T."R.M."
2	R."D."
3	R.P.V"S.I."

Burimi: AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.

Titulli i gjetjes:

Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), nuk janë përmbushur detyrimet ligjore mbi depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore për vitet 2018-2021 në 36 raste gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, , “Për dënimin me gjobë”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar për OMSHA, (përkatësisht, 1 OMSHA për PF të vitit 2018, 26 të vitit 2019, 6 të vitit 2020 dhe 3 të viti 2021), dhe nga ana e AMA për gjithë periudhën e audituar është mbajtur qëndrim nëpërmjet aplikimit të sanksioneve administrative (gjobë), vetëm në një rast në vitin 2019, për shumën prej 40 mijë lekë.

Situata:	Konstatohet se ✓ Gjatë vitit 2019, janë depozituar në total 177 bilance për vitin 2018 (nga shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), nga 178 bilance të pritshme. Nga ana e DSHB vendimi nr. 15, datë 05.08.2019, “Për dënimin me gjobë të 1 subjekti, personit fizik “E.L.”, autorizuar për televizionin privat “E”. Ky vendim i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 2965 prot., datë 05.08.2019, të nënshkrur nga ana e SP së AMA. ✓ Gjatë vitit 2020 rezultojnë 26 subjekte që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2019. Nga ana e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. ✓ Gjatë viti 2021 rezultojnë 6 subjekte që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2020. Nga ana e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. ✓ Në vitin 2022, rezultojnë 3 subjekte që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore më depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të v.2021. Nga ana e e DSHB nuk është marrë ndonjë vendim, “Për dënimin me gjobë” nga mospërmbushja e detyrimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për OMSHA.
Kriteri:	✓ neni 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	✓ neni nr. 48, “<i>Bilancet vjetore dhe përmbajtja e tyre</i>”, e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ✓ Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ✓ Rregullore e AMA-s, “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”. (miratuar me Vendimin nr. 101, datë 07.06.2017);
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e disiplinimit të ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore në kohë dhe mos aplikimi dhe mos arkëtimin e këtyre detyrimeve.
Shkaku:	Mosrespektim dhe mos zbatim i kuadrit ligjor për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA).
Rëndësia:	i mesëm - i lartë
Rekomandime:	Masat organizative 1. Institucioni i AMA-s të marrë masat e duhura për administrimin e pasqyrave financiare të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), në përmbushur detyrimet ligjore referuar përcaktimeve të nenit 33,” Detyrimet e OSHMA-ve “, pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. 2. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, të mosveprimet nga ana e ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA), për depozitimin e PF të llogaridhënies vjetore të fillojë procedurat administrative “Për dënimin me gjobë”, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Masa administrative 1. Të merren masat nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive për vendosjen e sanksioneve ligjore, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e Kreut XIV “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, Neni 132 “Masat për shkeljet”, pika 2 është sanksionuar se “AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes”, të fillojë procesi i dhënies së këtyre masave administrative për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/autorizuar nga AMA që janë brenda këtij afati.
Afati	Menjëherë e në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Konstatim:

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i evidencës së vënë në dispozicion të audituesve të pavarur të KLSH-së nga ana e strukturave të AMA-s, evidentohen detyrime në vlerë të konsiderueshme ndaj shoqërisë “M.” sh.a., e cila ka vijuar korrespondenca shkresore me Përmbartuesin Privat Gjyqësor.

Konkretisht, ky detyrim ka patur këtë dinamikë:

- Midis shoqërisë “M.” sh.a., dhe ish-KKRT-së (sot AMA), janë zhvilluara disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Apelit dhe Gjykatës së Lartë, në përfundim të të cilave AMA, (ish KKRT), në bazë të vendimit nr. 10709, datë 21.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është detyruar t’i paguajë shoqërisë “M.” sh.a., shumën prej **112.861.320 lekë**.
- Gjykata e Lartë me vendimin nr. 58, datë 23.02.2012, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Kundër vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit dhe KKRT (sot AMA). Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2012-2659, datë 21.12.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe me vendim nr. 00-2018-150, datë 20.02.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga ish-KKRT.
- Ndaj titullit ekzekutiv (vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011), është lëshuar urdhëri i ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. akti 1191, datë 07.02.2012 dhe nga ana e AMA-s, është kërkuar ndarja në këste e detyrimit që buronte prej vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës të Apelit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6037, datë 30.05.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së ngritur nga pala kërkuuese, vendim i cili pasi është kundërshtuar nga të dyja palët pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, kjo e fundit me vendimin e datës 16.01.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Për shkak të pamundësisë financiare për ekzekutimin e titullit të mësipërm ekzekutiv, AMA dhe shoqëria “M.” sh.a., në datën 09.12.2015, kanë lidhur marrëveshjen e parë për pagesë me këste të detyrimit. Afati i vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje ka përfunduar në datën 01.01.2018. Referuar dispozitave të këtij akti, është ekzekutuar **30% e vlerës së detyrimit** ndaj palës kreditore, detyrim në të cilin janë përfshirë edhe shpenzimet përmbartimore.
- Pas përfundimit të afatit të marrëveshjes, përmbartuesi privat gjyqësor ka kërkuar vijimin e procedurave të ekzekutimit. Në vijim midis palëve janë lidhur sërish marrëveshje për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, konkretisht:
 - marrëveshja me nr. 1831/2, datë 24.04.2018, me afat deri në datën 01.01.2019,
 - marrëveshja me nr. 416/2 prot., datë 25.01.2019, me afat deri në datën 01.01.2020,
 - marrëveshja me nr. 23 prot, datë 06.01.2020, me afat deri në datën 01.01.2021.
- Në vijim të akt-marrëveshjeve të lidhura, të pagesave të kryera nga AMA dhe kompensimeve financiare të bëra ndaj shoqërisë “M.” sh.a., përmbartuesi privat gjyqësor me shkresën nr. 6/3 prot., datë 27.07.2021, drejtuar AMA-s, ka njoftuar vendimin e pushimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, (vendimit nr. 10709, datë 21.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë). **Pas ekzekutimit të plotë të detyrimit sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, shoqëria “M.” sh.a., ka paraqitur kërkesë padinë objekt gjykimi**, ku pala paditëse kërkon që AMA, të paguajë dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në vendimin nr. 2819, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

22.12.2011, të Gjykatës së Apelit. e cila në vlerësimin e AMA është në kundërshtim të plotë me ligjin material dhe si e tillë është kërkuar rrëzimi i saj.

Pra, nga sa referuar më sipër, konstatohet se sipas vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 58, datë 23.02.2012, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë (2819, datë 21.12.2011), deri sa Gjykata e Lartë të shprehet për rekursin ndaj këtij vendimi.

Audituesit e autorizuar sjellin në vëmendje se, Gjykata e Lartë, në lidhje me rekursin e ushtruar nga palët ndërgjyqjese, është shprehur me 2 vendime, përkatësisht me vendimin nr. 00-2012-2659, datë 21.12.2012, si dhe me vendimin nr. 00-2018-150, datë 20.02.2018.

Si pasojë, duke qenë se Gjykata e Lartë për të njëjtën kërkesë/çështje është shprehur me dy vendime në kohë të ndryshme, AMA, si palë e paditur është shprehur se nuk mund të konsiderohet në vonesë në shlyerjen e detyrimit.

Në kërkesë-padi, pala paditëse shoqëria “M.” sh.a., ka pretendime për vonesë në ekzekutimin e detyrimit prej datës 21.12.2011, pa marrë parasysh vendimin e Gjykatës së Lartë për pezullim ekzekutimi deri në datën 20.02.2018, periudhë gjatë së cilës ka vijuar shlyerja me këste e këtij detyrimi.

Për shkak të pamundësisë financiare për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, AMA me shkresat nr. 1525/1 prot., datë 31.07.2015, nr. 2644, datë 16.12.2016 dhe nr. 385 prot., datë 02.02.2016, i është drejtuar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Financave për akordim fondesh nga buxheti i shtetit.

Nisur nga kushtet e paaftësisë paguese të plotë të detyrimit të sipërcituar, AMA dhe shoqëria “M.” sh.a., me dakordësi, kanë lidhur marrëveshje për pagesë me këste të detyrimit.

Gjithashtu, bazuar në pikën 8, të akt - marrëveshjes midis AMA-s dhe shoqërisë “M.” sh.a., të datës 09.12.2015, për pagesë me këste të detyrimit, parashikohet se: “.....nëse detyrimi nuk është përmbushur dhe nuk është arritur një marrëveshje e re, shoqëria “M.” sh.a., ka të drejtë të përdorë të gjitha mjetet ligjore për të realizuar përmbushjen e detyrimit”.

Bëjmë me dije se, marrëveshja midis AMA-s dhe shoqërisë “M.” sh.a., e pagesës me këste të detyrimit, është pasuar nga marrëveshje të tjera, konkretisht nga marrëveshja me nr. 1831/2 prot., datë 24.04.2018; marrëveshja me nr. 416/2 prot., datë 25.01.2019, marrëveshja me nr. 23 prot, datë 06.01.2020.

Kreu V, titulluar “Detyrimet monetare”, në nenin 447 të tij, parashikon se: “.....Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari”.

Nga komunikimi shkresor i AMA-s me përmblyesin privat gjyqësor me shkresën nr. 291/1 prot., datë 08.01.2021, AMA, ka bërë me dije se, në vijim të akt-marrëveshjeve të lidhura midis AMA-s dhe shoqërisë “M.” sh.a., pagesave të kryera nga AMA dhe kompensimeve financiare të bëra ndaj shoqërisë “M.” sh.a., vlera e detyrimit të mbetur prej 11,191,369 lekë, është shlyer në llogarinë bankare të përmblyesit privat gjyqësor, në datën 11.01.2021.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse se AMA, është ***në vonesë në shlyerjen e detyrimit*** dhe për këtë arsye pretendohet shpërblimi i dëmit, nga ana e Drejtorisë Juridike të AMA-s është bërë sqarimi se, ***në çdo komunikim shkresor me palën kreditore për ekzekutim të detyrimit nga ana e AMA-s, nuk është përcaktuar asnjëherë qenia në vonesë e debitorit në shlyerjen e tij, pasi AMA ka respektuar çdo kusht të marrëveshjes, përfshirë këtu edhe afatet e shlyerjes.*** Nga ana tjetër, pala kreditore nuk ka kërkuar llogaritjen e kamatëvonesave të arrira për shkak vonesë.

Bazuar në nenin 616, të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, “Ekzekutimi pushon: a)kur ***debitori i paraqet përmblyesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, të vërtetuar rregullisht, se ka paguar shumën që shënohet në urdhrin e ekzekutimit, ose kuitancë të zyrës postare ose shkresë***



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

të bankës me të cilat vërtetohet se shuma që shënohet në urdhrin e ekzekutimit është derdhur në dobi të kreditorit”.

Në vijim të pagesës së kryer nga AMA, me shkresën nr. 6/3 prot., datë 27.07.2021, përmbartuesi privat B. Sh., ka vendosur pushimin e dosjes përmbartimore nr. 6 që i përket ekzekutimit të titullit ekzekutiv vendimit nr. 10709, datë 21.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2819, datë 22.12.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Procedurat e ndjekura gjatë vitit 2020:

Bazuar në projektbuxhetin për vitin 2020, të miratuar me vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, AMA ka lidhur aktmarrëveshjen nr. 23, datë 06.01.2020 me shoqërinë “M” sh.a., për të parandaluar bllokimin e llogarive bankare të institucionit nga shoqëria përmbartimore dhe ekzekutimin e menjëhershëm të detyrimit. Me këtë aktmarrëveshje, me afat deri më 01.01.2021, AMA ka reduktuar masën e detyrimit me 25,305,036 lekë, (nga e cila, 25,000.000 lekë të likuiduara nga të ardhurat e AMA-s dhe kompensimin reciprok prej 305,036 lekë për detyrimin vjetor për licencë dhe tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të vitit 2020). Në fund të vitit 2020, detyrimi i AMA-s ndaj shoqërisë “M.” sh.a. është në masën 11,191,369 lekë.

Procedurat e ndjekura gjatë vitit 2021:

Nga ana e AMA-s është kryer pagesë për llogari të shoqërisë “M.sh.a. në masën 7,824,471 lekë; ulur detyrimet financiare të shoqërisë “M.” sh.a. ndaj AMA-s në masën 766,898 lekë; Si dhe në zbatim të Urdhër Sekuestros me nr. 6/10 prot., datë 24.06.2021 janë sekuestruar nga llogaria shumat prej 2,600,000 lekë në një nga llogaritë bankare të AMA-s.

Referuar shkresës, nr. 6/12 prot., datë 14.07.2021, me lëndë “Kërkesë”, të lëshuar nga ana e përmbartuesit dhe të administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 2526 prot., datë 16.07.2021, nga ana e institucionit i janë venë në dispozicion kërkesit dokumentacioni si më poshtë:

- Kopje të akt marrëveshjes datë 09.12.2015 dhe të 3 (tre) urdhër xhirimeve të kryera në zbatim të saj;
- Kopje të akt marrëveshjes nr. 1831/2 prot., datë 24.04.2018 dhe të 2 (dy) urdhër transfertave të kryera në zbatim të saj;
- Kopje të akt marrëveshjes nr. 416/2 prot., datë 24.01.2019 dhe të 3 (tre) urdhër transfertave të kryera në zbatim të saj;
- Kopje të akt marrëveshjes nr. 23 prot., datë 06.01.2020 dhe të 3 (tre) urdhër transfertave të kryera në zbatim të saj;
- Kopje të korespondencave shkresore me nr. 29 prot., datë 06.01.2021; nr. 29/1 prot., datë 08.01.2021; nr. 29/2 prot., datë 11.01.2021 dhe të urdhër transfertës në zbatim të saj.

Dokumentacioni i kërkuar nga ana subjektit dhe pagesat e kryera referohen më hollësisht në vijim:

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
TIRANË***(të dhënat në lekë)*

Pagesat e kryera kreditorit			Bankat	
Numri i pagesave të kryera	Akt-Marrëveshje/ Shkresa	Pagesat e kryera	C.	R.
1	Datë 09.12.2015	11.12.2015	5.463.419	
2		14.01.2016	10.000.000	
3		24.02.2016	11.853.678	
4	Nr. 1831/2 prot., datë 24.04.2018	26.04.2018		7.500.000
5		22.05.2018		7.500.000
6	Nr. 416,/2 prot., datë 25.01.2019	28.01.2019		16.000.000
7		18.03.2019		4.000.000
8		18.04.2019		5.000.000
9	Nr. 23 prot., datë 06.01.2020	07.01.2020		16.000.000
10		10.02.2020		4.000.000
11		02.03.2020		5.000.000
12	Nr. 29 prot., datë 06.01.2021; nr. 29/1 prot., datë 08.01.2021; nr. 29/2 prot., datë 11.01.2021	11.01.2021		7.824.471
Totali			27.317.097	72.824.471
Totali (1+2)			100.141.568	

Burimi: (AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria Juridike)

Pra, nga masa e detyrimit 116,181,989 lekë, AMA ka kryer pagesa në masën 100,141,568 lekë, ka zbritur detyrimet financiare që shoqëria “M.” sh.a. ka patur ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për periudhën 2007 - Janar 2021 në masën totale 13,440,421 lekë *(të përcaktuara në akt marrëveshjet/ korespondencat shkresore)*, ka zbritur masën e detyrimeve për gjoba që AMA ka palikujduar ndaj kësaj shoqërie prej 2,600,000 lekë *(të mbajtuar në llogarinë e AMA-s në C Bank në zbatim të Urdhër Sekuestros me nr. 6/10 prot., datë 24.06.2021).*

Për sa më sipër, sipas sistemit të dokumentacionit të AMA-s, në zbatim të vendimin nr. 2819, datë 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë me të cilin është ndryshuar vendimi nr. 10709, datë 21.12.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimi i Autoritetit të Mediave Audiovizive, (ish Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit), paraqitet i zeruar. *(116,181,989 lekë – 100,141,567 lekë - 13,440,421 lekë – 2,600,000 lekë = 0 lekë)*

Konstatimi:

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i evidencës së vënë në dispozicion të audituesve të pavarur të KLSH-së nga ana e strukturave të AMA-s, evidentohen detyrime në vlerë të konsiderueshme ndaj shoqërisë “M.” sh.a, e cila ka vijuar korespondenca shkresore me Përmbaruesin Privat Gjyqësor, por edhe pas shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimeve në vendimin gjyqësor, pretendimet e palës paditëse janë se AMA, është në vonesë si palë debitore në shlyerjen e detyrimit dhe për këtë arsye pretendohet shpërblimi i dëmit, në tejkalim të përcaktimeve të kushteve të marrëveshjeve të dakordësuar midis palëve, përfshirë këtu edhe afatet e shlyerjes.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Situata:	Nga auditimi në AMA rezultoi se, për subjektin shoqëria “M.” sh.a. janë ekzekutuar pagesat për vendime gjyqësore në vlerën 100,141,568 lekë. 1. Referuar praktikave shkresore të vënë në dispozicion, nga auditimi i kryer rezultoi se AMA kërcënohet nga risku i pagesave të penaliteteve / kamatvonesave të pretenduara nga ana e kreditorit, të lidhur me pagesat e kryera për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe marreveshjeve të dakordësuara. 2. Për periudhën objekt auditimi, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për praktikat e sipërpërmendura, <u>nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga AMA</u> me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbartuesit privat, duke paguar tarifa përmbartimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e këtij institucioni.
Kriteri:	✓ Kodi Civil, ✓ Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ✓ Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor ✓ Ligji për detyrimet e prapambetura dhe VKM përkatëse
Ndikimi/Efekti:	Mbi aftësinë paguese dhe gjendjen financiare të autoritetit.
Rëndësia:	i lartë
Rekomandimi	1. Nga ana e strukturave përgjegjëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat që, të ndiqet me prioritet në gjykatë çështja e padisë së fundit të shoqëria “M.” sh.a me nr.2981 akti, ku pretendohet dëmi i shkaktuar nga mospërmblotja e detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 2819, dt 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit. Strukturat përgjegjëse të AMA-s të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes, duke shmangur kështu kostot e përmbartimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit. 2. Nga ana e DSHB te AMA të përlllogariten provizionet për rreziqe e dëmtime, në kuadër të procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2023, sipas përcaktimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr 6” provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara.
Afati	Në vijimësi



AMA ka financuar organizata dhe institucione të ndryshme që angazhohen në fushën e medias, si dhe subjekte buxhetore për financime projektesh, të cilat janë njësi shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, fakultete ose universitete, ose Organizata jofitimprurëse. Më konkretisht,

Per vitin 2019:

Prej vitit 2015 Autoriteti bashkëpunon me organizata dhe institucione të ndryshme që angazhohen në fushën e medias, duke mbështetur projekte që kanë në fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, studime dhe analiza të fenomeneve dhe trendeve të zhvillimit, përmirësimi i raportimit dhe trajtimit të temave në programet e transmetuara, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median etj.

✚ **Q. “N. P.G.”** realizoi projektin “Shqip dhe Qartë: Hulumtim mbi Gjuhën informative të televizioneve”, që iu dedikua respektimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar nga redaksitë audiovizive. Qendra kreu një monitorim profesional të përmbajtjeve që transmetojnë dy televizione kombëtare dhe dy informative dhe mbi problematikat dhe gjetjet e rezultuara i përmbloodhi në një publikim, duke vënë atë në qendër të diskutimit me redaksitë audiovizive, jo vetëm në Tiranë, por dhe në Shkodër, Durrës, Korçë dhe Vlorë. Ky ishte një kontribut konkret për të vlerësuar situatën, por dhe pasuroi vlerësimet dhe ekspertizat që ka realizuar edhe vetë AMA në tri vitet e fundit, të cilat dhe i ka ndarë me OSHMA-të në shërbim të përmirësimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në transmetimet audiovizive.

✚ **Qendra “A.Gj.Zh.”** u angazhua në kryerjen e projektit “Studim dhe analizë performance në tregun audioviziv shqiptar, bazuar në vlerësimet e ndjekësve të përmbajtjeve të transmetuara, për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore dhe dhunën e çdo forme ndaj grave e vajzave.” Qëllimi ishte që jo vetëm të kryhej një vlerësim mbi nivelin e mbulimit të tematikës gjinore në programacionin audioviziv, por dhe rreth problematikave dhe gjetjeve të analizohen aspekte të shkeljes së barazisë gjinore në transmetime. Referuar këtyre, projekti ofroi dhe një paketë me rekomandime, se si mund të përshtatet/amendohet ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, me ligjin mbi barazinë ligjore.

✚ Gjatë vitit 2019, Këshilli i Ankesave ka organizuar tryeza tematike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga OSHMA-të dhe kontributin e partnerëve tanë që veprojnë në fushën e medias. Gjithashtu, Këshilli i Ankesave mbështeti dhe ndoqi disa projekte të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, për tema të ndjeshme si mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore dhe imazhi gjinor në ekran etj. Qëllimi i këtyre projekteve, të përmbyllura tashmë, ishte studimi i detajuar i situatës dhe rekomandimet për përmirësimin e saj. Këshilli i Ankesave i ka projektuar këto aktivitete si një platformë efektive për komunikim dhe shkëmbim informacioni mes institucioneve e organizatave të ndryshme, që fokus kryesor kanë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, e në veçanti interesin më të lartë të fëmijëve. Këto aktivitete dhe tryeza diskutimi, kryesisht me tema për fëmijët dhe mbrojtjen e tyre nga transmetimet e dëmshme audiovizive, për respektimin e normave ligjore dhe etike, kanë ndikuar në sensibilizimin jo vetëm të operatorëve audiovizivë, por edhe të publikut, institucioneve dhe organizatave të ndryshme për të shtuar vëmendjen ndaj problematikave në përmbajtjet audiovizive.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- Gjatë vitit të kaluar, Këshilli i Ankesave monitoroi disa projekte të përbashkëta me organizata të shoqërisë civile, një prej të cilëve kishte si temë: “*Popkultura në median televizive dhendikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve*”. Projekti është përmbyllur me sukses dhe në fund të tij pati disa rekomandime, thelbi i të cilave është ngritja e një instrumenti monitorues për të analizuar mesazhet që përcillen nëpërmjet artit muzikor (nëpërmjet teksteve apo klipeve të këngëve) të transmetuar në mediat audiovizive shqiptare, me qëllim identifikimin e problematikave që lidhen me çështjet e etikës dhe ndikimin në edukimin dhe botëkuptimin psikologjik/social/kulturor të adoleshentëve.
- Projektet e tjera, të përmbyllura gjithashtu, trajtuan tema mbi barazinë gjinore dhe rolet gjinore në median audiovizive. Projektet, në përfundim të tyre, sollën studime për temat përkatëse, rekomandime dhe botime të ndryshme, të cilat janë publikuar në faqet zyrtare në internet të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa botimet si broshura do t’u shpërndahen operatorëve audiovizivë dhe grupeve të interesit.

Bazuar në të dhënat e vena në dispozicion nga ana e subjektit, audituesit e autorizuar të KLSH vërejnë se:

- ✓ Gjatë vitit 2019, Buxheti i Shtetit nuk ka akorduar fonde për AMA-n për vijimin e fushatës së informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve analoge.
- ✓ Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) bazuar në ligjin nr. 34/2017, “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividentit” të ndryshuar, është ***caktuar në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, të fondit prej 5,000,000 euro për tre kategoritë e subjekteve të parashikuara në ligj***. Konkretisht: kategoria e parë përfituese janë operatorët historikë privatë kombëtarë, kategoria e dytë janë operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike, ndërsa kategoria e tretë janë subjektet televizivë analogë ekzistues. Ligji nr. 34/2017, “Për Lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, i ndryshuar parashikon se subjektet audiovizive që afektohen prej kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike do të kompensohen pjesërisht.
- ✓ **Me fondin e akorduar me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.17297/1 prot., datë 24.10.2018 dhe shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.12202/3 prot., datë 25.10.2018, u akordua fondi 40,000,000 lekë për vazhdimin e fushatës së informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës dhe vijimin e tij në qarqet e tjera. Me fondin e akorduar u zhvillua fushatë e informimit të publikut për periudhën 17 dhjetor - 17 mars 2019 (3 muaj)⁷.**

Në zbatim të vendimit nr. 89, datë 23.04.2019 të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, për **autorizimin e ndihmës shtetërore**, AMA ka hapur një llogari në “C Bank” për kalimin e fondit nga Ministria e Financave dhe kryerjen e procesit të kompensimit financiar. ***Në datën 02.05.2019 është bërë kalimi i fondit 5,000,000 euro nga Ministria e Financave në llogarinë e dedikuar nga AMA.***

a. Kategoria e I-rë

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor, nga ana e institucionit janë përcaktuar operatorët privatë historikë kombëtarë “T.C.” sh.a. dhe “T.K.” sh.a. si dhe operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike shoqëritë “D.-A.” sh.a. dhe “T.T.” sh.a.

⁷ -Raporti vjetor i AMA-s për vitin 2019, Tiranë 2020, faqe 92



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në zbatim të akteve të sipërcituara, operatorët privatë historikë kombëtarë janë kompensuar në masën **2,000,000 euro** për mbulimin e pjesshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analoge në numerike, vlerë e cila, sipas referimeve në shkresat zyrtare, është shpërndarë në mënyrë të barabartë, përkatësisht **1,000,000 euro për çdo operator**. Ekzekutimi i vlerës së kompensimit të subjekteve historikë kombëtare është kryer në datat e mëposhtme:

- ✓ Për shoqërinë “T. C.” sh.a. në datë 03 maj 2019;
- ✓ Për shoqërinë “T.K.” sh.a. në datë 03 maj 2019.

b. Kategoria e II-të

Vlera kompensimit në masën **2,000,000 euro** për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike, u llogarit sipas përqindjes që vlera financiare për përgjegjësitë tatimore të paguara prej secilit prej tyre, zuri në totalin e vlerës financiare për përgjegjësitë tatimore të të dy operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike. Referuar dokumentacionit financiar të depozituar nga operatorët e përfshirë në skemën e kompensimit financiar, nga ana e AMA-s janë kompensuar:

- ✓ shoqëria “D.-A.” sh.a. në masën **1,837,351 euro**, dhe
- ✓ shoqëria “T.T.” sh.a. në masën **162,649 euro**.

Procesi i kompensimit financiar për kategorinë e dytë (operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike) ka vijuar të kryhet në disa faza, pasi një prej operatorëve nuk përmbushte kërkesat e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 34/2017 të ndryshuar, (rezultoi debitor ndaj AMA-s për pagesat vjetore për licencë, si dhe kishte sanksione gjobë të kthyer në titull ekzekutiv).

Ekzekutimi i vlerës së kompensimit të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike, është kryer në datat e mëposhtme:

- Për shoqërinë “D.-A.” sh.a. në datat 9 dhe 16 maj 2019;
- Për shoqërinë “T.T.” sh.a. në datën 13 qershor 2019.

c. Kategoria e tretë

Kategoria e tretë e subjekteve e përfshirë në skemën e kompensimit financiar janë subjektet ekzistues lokalë/rajonale. Ligji nr. 34/2017, i ndryshuar, ka përcaktuar masën e kompensimit (1,000,000 euro) si dhe mënyrën e llogaritjes së tij. Kostoja për tarifën e mbështetjes llogaritet, për çdo rast, mbi bazën e zonës së mbulimit, sipas licencës, për një vit, nga momenti i lidhjes së kontratës së mbështetjes në rrjetet numerike. AMA, mbi bazën e tarifës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së, bën llogaritjen e vlerave të mbështetjes për secilin nga subjektet përfitues.

Duke qenë se fondi i përcaktuar në masën 1,000,000 euro për subjektet ekzistues analogë (të përcaktuar në vendimin nr. 38, datë 07.03.2019) ishte më i ulët se totali në bazë vjetore i tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese në rrjet numerik, vlera e mbulimit të tarifës së mbështetjes për subjektet përfitues, nga ana e AMA-s është llogaritur me përqindjen që fondi i shpërndarë zë në totalin në bazë vjetore të tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese. Nga përllogaritjet e kryera, rezultoi masën **53,87% të pagesës së kryer ose për 6.46 muaj**.

Më tej, AMA, me vendimin nr. 69, datë 07.03.2019, rishikoi listën e subjekteve përfituese, reduktimi i të cilëve rriti masën përfituese deri në **65.55% të totalit vjetor ose deri në 7.888 muaj**.

Gjatë periudhës korrik 2019 – qershor 2022, janë kompensuar financiarisht **30 subjekte, në 9 allotmente** (sipas qarqeve të licencuara nga AMA) në masën totale **594,664 euro**. Gjithashtu gjatë periudhës maj 2019 (kur kaloi fondi nga Ministria e Financave në llogarinë bankare të euro të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

dedikuar për këtë fond) deri në 30 qershor 2022, janë mbajtur 119 euro komisione bankare. Fondi i mbetur për tu shpërndarë është në masën **405,218 euro**. (vijon tabela e detajuar).

Për sa më sipër, nga ana e AMA është informuar MFE mbi zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore, me anë të shkresave nr. 969, dt 25.3.2020, nr.699/1 datë 16.2.2022, dhe nr. 1028/1 datë 25.3.2022.

Masat e kompensimeve financiare për allotment (euro) për periudhën korrik 2019 - qershor 2022

Nr.	Shoqëria/person fizik	Emri tregtar/televizionar vendor	Berat	Korcë	Fier	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Gjirokastrë	Dibër	Totali/subjekt
1	Shoqëria "S." sh.a.	"T. S."			12,916.00	16,647.00			5,302.80			34,865.80
2	Shoqëria "M." sh.p.k.	"R.T."	7,315.53	10,987.46	15,716.60	20,256.95						54,276.54
3	Shoqëria "M.R." sh.p.k.	"T.L."		3,784.80								3,784.80
4	Personi fizik A. Sh.	"T.B."	7,315.38									7,315.38
5	Shoqëria "U."	"T. U. E"		10,987.46		20,256.95			13,904.40			45,148.81
6	Shoqëria "E.T." sh.a.	"C.T"		10,987.46		20,256.95			8,838.00			40,082.41
7	Shoqëria "F.K.T." sh.p.k.	"T.A."			12,915.00			11,969.16				24,884.16
8	Shoqëria "G.M." sh.p.k.	"T.A"	-			20,256.95						20,256.95
9	Shoqëria "S." sh.p.k.	"T.S."		10,987.46								10,987.46
10	Shoqëria "F.M.N" sh.p.k.	"N.T."			12,915.79	16,647.00		6,086.40				35,649.19
11	Shoqëria "F.M.N" sh.a.	"F. N."				15,451.20						15,451.20
12	Shoqëria "O" sh.a.	"T.O."			12,915.79	16,647.00		9,129.60				38,692.39
13	Shoqëria "C.O." sh.p.k.	"T.O.N."			12,915.79	16,647.00			8,838.00			38,400.79
14	Shoqëria "B.B"	"T.B"				16,647.00						16,647.00
15	Shoqëria "M.P."	"T.Sh."				12,778.60						12,778.60
16	Shoqëria "D& E."	"T.S."				20,256.95						20,256.95
17	Shoqëria "P.M.G."	T. "4"			2,464.20							2,464.20
18	Personi fizik Z.H.	T. "K"					10,506.05					10,506.05
19	Personi fizik G. B.	T. "BS"					10,506.05					10,506.05
20	Shoqëria "Ch." sh.p.k	T. "Ch."								1,741.00		1,741.00
21	Shoqëria "M. N." sha	T. "Ch 1."					10,506.05					10,506.05
22	Shoqëria "A.N" sha	T. "A.N."			15,716.60	20,256.95			13,904.22			49,877.77
23	Shoqëria "E. B. N." shpk	T. "E.B.N"				12,876.00						12,876.00
24	Shoqëria "R.A-M."	T. "P.C."				20,256.95		11,969.16				32,226.11
25	Shoqëria "A 2"	T. "Al."								3,686.00		3,686.00



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

26	Shoqëria "T.A. N."	T. "A. N."					6,160.90					6,160.90
27	Shoqëria "S. N shpk"	TV "S.P"					8,013.60					8,013.60
28	Shoqëria "O.T.V." shpk	"O.T.V."						9,129.40				9,129.40
29	Personi fizik A. V.	"T.K."							13,904.23			13,904.23
30	Shoqëria "V." sh.p.k.	"T.M."									3,588.00	3,588.00
Totali euro/allotment			14,630.91	47,734.64	98,475.77	266,139.45	45,692.65	48,283.72	64,691.65	5,427.00	3,588.00	594,663.79
Totali euro periudha korrik 2019 - 30.06.2022			594,664									
Komisione bankare			119									
Vlera e mbetur për tu kompensuar (nga fondi 1,000,000 euro)			405,218									

Burimi: (AMA, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme)

Per vitin 2020-2021:

- AMA, ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me institucionin e **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)**, dhe pas miratimit nga bordi i AMA-s të projektbuxhetit për vitin 2021, ka realizuar mbështetjen financiare të KMD për projektin: *Sfido urrejtjen - "Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit"*, në masën **1,496,500 lekë**.

- AMA ka financuar **Ministrinë e Kulturës**, e cila, në vijim të mbështetjes financiare të dhënë nga AMA, në tetor 2020, për dy projekte, në masën totale **7,200,000 lekë** (3,600,000 lekë/projekt), përfundoi, në vitin 2021, projektin *"Edukimi përmes Kulturës"* në masën 3,550,000 lekë, duke kthyer në llogari të AMA-s shumën e pashpenzuar prej 50,000 lekë. Në lidhje me projektin *"Digjitalizimi i filmit"* është bërë amendim kontrate midis Ministrisë së Kulturës dhe AMA-s për realizimin e tij në vitin 2022.

- AMA, edhe në vitin 2021, vijoi me mbështetjen financiare për veprimtari sociale e publike (ekologjike), duke dhuruar pemë për **Bashkinë Tiranë** në masën **620,400 lekë**.

Pasivi i bilancit kontabël.

Siç edhe konstatohet nga tabela e pozicionit financiar, **pasivii bilancit kontabël** për vitin 2021 përbëhet nga llogaritë e pagueshme në shumën prej 68,175 mijë lekë (që përfaqësojnë 8.5 % ndaj totalit të pasivit) dhe 100% ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra. Pjesa tjetër janë vlera e fondeve neto. Gjatë vitit 2021 konstatohet se pasivi është rritur në total me 2,736 mijë lekë, krahasuar me vitin 2020, dhe përfaqësohet në masën 91.5% nga fondet e veta neto (ose 733,007 mijë lekë) dhe 8.5% nga detyrimet afatshkurtra (ose 68,175 mijë lekë). Nga auditimi u konstatua se është paraqitur drejtë lëvizja e fondeve, në formatin nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto", ku përfshihen shtesat dhe pakësimet e fondeve gjatë periudhës në fjalë, e rakorduar dhe e pasqyruar për të njëjtën shumë prej 73,007 mijë në totalin e fondeve të veta (zëri nr.96, i Pasqyrës nr.1 të pozicionit financiar) të kësaj njësie shpenzuese.

Nga auditimi u konstatua se shumatat e llogarive të paraqitura në postet e Bilancit Kontabël kuadrojnë me informacionin e gjeneruar në formatet respektive për aktivet e qëndrueshme, për shpenzimet e burimet për investime si dhe për lëvizjet e disponibiliteteve dhe fondeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në pasiv të bilancit, janë paraqitur detyrimet e institucionit për shpenzimet e muajit dhjetor 2021 dhe detyrimet e mbartura, të cilat janë konstatuar, por nuk janë paguar. Furnitorët (llogaria 401); detyrimi për pagat e personelit (421); detyrimet ndaj organeve tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, suplementare, tatimin mbi pagën dhe tatim në burim (llogaritë 435,436,431). Kundërvlera e këtyre llogarive është paraqitur në aktiv në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” përkatësisht për vitin 2021 dhe 2020 në shumat 47,593 mijë dhe 43,694 mijë lekë, që pasqyrojnë detyrimet e institucionit të Kuvendit (buxheti i shtetit), likuiduar rregullisht në fillim të vitit pasardhës.

Ky post është pasqyruar në kontabilitet në shumën prej 367,051,234 lekë, i cili ka ardhur në pakësim, nga shuma prej 415,825,053 lekë, e kontabilizuar në fund të vitit të mëparshëm dhe është i përbërë nga zërat e mëposhtëm:

- ✓ **“Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”** me shumën 1,059,893 lekë përfaqëson detyrimet e AMA-s ndaj furnitorëve.
- ✓ **“Detyrime ndaj personelit”** me shumën 23,007 lekë, përfaqëson të drejtën e lindur për pagën e muajit dhjetor 2021, për një punonjës të AMA-s të emëruar rishtaz në detyrë. Duke qenë se paga për muajin dhjetor 2021, për punonjësin në fjalë, i përket periudhës tatimore dhjetor 2021, kjo shumë edhe pse u likuidua në janar 2022, është detyrim që institucion e njeh në mbyllje të vitit 2021.
- ✓ **“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”** me shumën 930,798 lekë përfshihen detyrimet që ka AMA ndaj shtetit për tatim mbi të ardhura.
- ✓ **“Sigurime shoqërore”** me shumën prej 315,788 lekë përfaqëson vlerën debitoare të mbetur ndaj organeve tatimore për kontributet për sigurimet shoqërore. **“Sigurime shëndetësore”** me shumën prej 44,582 lekë përfaqëson vlerën debitoare të mbetur ndaj organeve tatimore për kontributet për sigurimet shëndetësore.
- ✓ **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** me shumën e konvertuar në 55,029,627 lekë (ose 419,919 euro) përfaqëson fondin e mbetur në llogari të AMA-s për kryerjen e kompensimit financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit. Në zbatimin të ligjit nr. 34/2017 “Për Lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara në vitin 2019, AMA-s i kaloi fondi prej 5,000,000 euro (622,000,000 lekë).
- ✓ **“Të tjera operacione me shtetin”** në shumën 309,647,539 lekë, përfshihen detyrimet e subjekteve për tarifa për shërbime të transmetimeve radiotelevizive në masën 10,074,312 lekë (95% e detyrimit si klient) dhe sanksioneve gjobë (gjobë + kamatëvonesë) në masën 299,573,227 lekë (80% e detyrimeve për gjoba si klient), të cilat priten të transferohen në Buxhet të Shtetit pas arkëtimit të tyre.

Mbi auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet ushtrimore 2020 dhe 2021.

Të ardhurat

Të ardhurat e vitit 2021 janë në vlerën e përgjithshme prej **229,227,329 lekë**. Këtu përfshihen të ardhurat e konstatuara gjatë vitit 2021 nga burimet e veta të financimit. Këto të ardhura janë të detajuara si më poshtë:

- I. **“Të ardhura nga taksat e tatimit”**, në shumën **7,640,106 lekë**. Në këtë zë janë paraqitur të ardhurat që AMA ka realizuar gjatë vitit 2021, nga tarifat për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive në masën 663,970 lekë dhe nga kamatëvonesat për vonesat në shlyerjen pagesave vjetore ndaj AMA-s në masën 6,976,136 lekë.
- II. **“Të ardhura jo tatimore”**, në shumën prej **221,555,542 lekë**. Në këtë zë janë paraqitur të ardhurat që AMA ka realizuar gjatë vitit 2021, nga pagesat për licenca/autorizime në masën 215,452,298



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

lekë, nga pagesa për përpunim dokumentacioni në masën 3,103,244 lekë dhe pagesa nga sanksionet me gjobë, nga kamatëvonesat për moskryerjen në kohë të pagesave për sanksionet me gjobë dhe nga të ardhura të tjera në masën 3,000,000 lekë.

- III. “Të ardhura financiare”, në shumën **31,681 lekë**, paraqet shumën e interesave bankare të përfuara nga bankat e nivelit të dytë dhe nga diferencat pozitive nga veprimet me valutë (kursat e këmbimit) gjatë vitit 2021.

Shpenzimet

Gjatë vitit 2021, nga auditimi i shpenzimeve të kryera, në bazë të situacionit dhe pasqyrës së performancës financiare (pasqyra e PASH), u konstatua se janë shpenzuar në total **141,686,562 lekë** të shpërndara sipas kategorive të shpenzimeve. Këtu përfshihen shpenzimet e kryera nga fondet e veta. Këto shpenzime janë të detajuara si më poshtë:

1. “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”, në shumën **76,378,563 lekë**. Këtu përfshihen shpenzimet për paga dhe shpërblime për punonjësit e AMA-s dhe për punonjësit me kontratë jashtë organikës të AMA-s, të strukturës *Call Center*.

2. “Kontribute të sigurimeve”, në shumën **10,602,039 lekë**, përfshijnë shpenzimet e kryera nga institucioni për detyrime ndaj Drejtorisë Tatimore Rajonale Tiranë, për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

3. “Mallra dhe shërbime”, në shumën **27,816,510 lekë**, përbëhen nga:

a) “Materiale zyre të përgjithshme”, në masën 2,248,315 lekë që përfshijnë shpenzimet e kryera për kancelari, bojë për printer/fotokopje etj.

b) “Shërbime nga të tretët”, në masën 9,198,694 lekë, përfaqëson shpenzime për furnizim me shërbime utilitare si energji elektrike, ujë, për telefoni fikse dhe celulare, shpenzime interneti, shpenzime postare, shërbime bankare, njoftime në shtyp për çelje garash, printim kartonash për licenca/autorizime, shërbim programit Financa 5, abonime vjetore (botimet e shtypit), abonime vjetore TV, shërbim përkthimi, mirëmbajtje faqes zyrtare të AMA-s, shërbim parkimi, shërbim faqosje/design, shërbim pastrimi i ambienteve të AMA-s, shpenzime për qeramarrje ambiente akomodimi për sistemin FM, shpenzime fotografie, shërbim lavazhi, shërbim dezinfektimi, etj.

c) “Shpenzime transporti”, në masën 1,645,135 lekë pasqyron shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, shpenzimet për blerje karburanti dhe siguracion automjetesh.

d) “Shpenzime udhëtimi”, në masën 5,210,362 lekë përfaqëson shpenzimet për udhëtime brenda dhe jashtë vendit të kryera në bazë të urdhër shërbimeve të nxjerra nga Kryetari/ Sekretar i Përgjithshëm.

e) “Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme”, në masën 2,346,408 lekë përfaqëson shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit, elektrik, ambienteve të institucionit, pajisje kompjuterike, kolaudim të fikseve të zjarrit, mirëmbajtjen e softeve të cilat përdoren nga Drejtoria e Mbikqyrjes.

f) “Shpenzime të tjera operative”, në masën 7,167,596 lekë, përfaqëson shpenzimet e kryera për përfaqësim, si pritje përcjellje, organizim takimesh me OSHMA-të, shpenzime për honorare, taksa për bashkinë Tiranë, shpenzime për taksa gjyqësore, shërbim me SHRFS.

4. “Transferime korente” në masën **4,349,281 lekë**, përfaqëson totalin e shpenzime të kryera për:

a) Vijimin e akordimit të ndihmës me vendim të AMA-s, për mbulimin e shpenzimeve mjekësore për nëpunësen e AMA-s Xh. N. në masën 199,281 lekë;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- b) Finalizimin e kontratës të mbështetjes financiare me objekt “Edukimi përmes Kulturës”, të lidhur midis Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Ministrisë së Kulturës, në masën 3,550,000 lekë;
- c) Subjeket audio të komunitetit të licencuara nga AMA (Radio Maria, Radio Spectrum dhe Radio Ngjallja) të cilat në vijim të Vendimit të AMA-s nr. 70, datë 19.05.2021, kanë përfituar ndihmë financiare në masën 600,000 lekë (200,000 lekë/subjekt).
- ✓ **“Shpenzime financiare”** në masën **1,480,185 lekë**, përfaqëson diferencat negative nga veprimet me valutë (kurset e këmbimit).
- Në zbatimin të ligjit nr. 34/2017 “Për Lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara në vitin AMA çeli llogari të dedikuar në euro për fondin e vënë në dispozicion nga Ministria e Financave në masën 5,000,000 euro (622,000,000 lekë). Në fund të vitit 2020, gjendja në këtë llogari ishte 713,243 euro (91,832,606 lekë). Në fund të vitit 2021 gjendja është në masën 55,029,627 lekë (419,919 euro). Gjatë vitit 2021 pati ulje të kursit të këmbit euro/lekë, duke çuar në diferencën negative prej 1,480,185 lekë.
- I. **“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** në masën prej **1,039,821 lekë**, përfaqëson diferencën negative midis gjendjes së inventarit të imët në fund të vitit 2020 dhe atij në fund të vitit 2021.
- II. **“Shpenzime të tjera”**, në masën **20,020,163 lekë**, janë përfshirë humbjet e vitit në ngarkim të rezultatit financiar për shkak të shfuqizimit të gjobave të vendosura nga institucioni, si dhe ndryshime në detyrimet e subjekteve si pasojë e reduktimit të zonës së licencës ose fshirje të detyrimeve financiare të ndodhura me vendime të AMA-s.

4-5. Organizimi dhe funksionimi i AMA-s. Veprimtaria e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe e Këshillit të Ankesave. Auditimi i procesit të Licencimit të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv dhe inspektimi i tyre.

Përputhshmëria ligjore në lidhje me procedurat e dhënies së licencave/autorizimeve dhe veprimtaria administrative e Këshillit të Ankesave.

I. Auditimi i procesit të licencimit të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv dhe inspektimi i tyre.

LICENCAT

Autotiteti i mediave Audiovizive (AMA) në zbatim të kompetencave të ligjit organik lëshon licencat e mëposhtme:

1. Llojet e licencave që jep AMA-ja janë:
 - a) licencë shërbimi programi audio, për ofrimin e një shërbimi programi audio;
 - b) licencë shërbimi programi audioviziv, për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv;
 - c) licencë transmetimi audio, e cila përbëhet nga:
 - i) licencë shërbimi programi audio, sipas shkronjës “a” të kësaj pike;
 - ii) licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit, i cili mund të jetë analog ose numerik;
 - ç) licencë transmetimi audioviziv, e cila përbëhet nga:
 - i) licencë shërbimi programi audioviziv, sipas shkronjës “b” të kësaj pike;
 - ii) licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit

Licencat e mësipërme jepen me konkurrim publik. AMA, duke pasur parasysh planin e përdorimit të frekuencave, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- a) përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit, për të cilën mund të aplikohet;
b) çel garën për dhënien e licencës përkatëse.

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet që:

“Ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, që kërkojnë përdorimin e frekuencave radiotelevizive, licencohet nga AMA, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, AMA mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare, me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore dhe duhet të garantojë shmangien e interferencave dhe shfrytëzimin efektiv të spektrit. Caktimi i frekuencave bëhet nga AMA mbi bazën e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t’u administruar nga AMA.”

Po kështu referuar nenit 59 të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet që:

“Për të siguruar zhvillimin e rregullt të shërbimeve audio dhe sigurimin e një larmie shërbimesh në hapësirën e mbulimit dhe respektimin e interesave të pakicave, AMA harton planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.”

Konstatime:

Nga auditimi është konstatuar se Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave nuk ka ndërmarr hapat ligjore në lidhje me hartimin e planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave. Minimalisht ky plan, i cili mund të kishte afate të caktuara, duhet të kishte përcaktuar planin e përdorimit, referuar parametrave teknik në të gjitha rastet dhe përcaktimin e saktë të frekuencave të lira kur është objektivisht e mundur. Ekzistenca e një plani vjetor ose në periudha më të gjata, i cili duhet të publikohej, në faqen zyrtare të AMA do të krijonte kushtet për respektimin e parimit të transparencës dhe garantimin e një konkurrence efektive në lidhje me procedurat e licencimit.

Referuar nenit 54 të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet që:

“Caktimi i frekuencave bëhet nga AMA mbi bazën e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t’u administruar nga AMA.”

AMA, në zbatim të dispozitave ligjore të mësipërme, ka miratuar rregullore të posaçme për dhënien e licencave të transmetimit audio dhe të licencave të shërbimit të programit audioviziv. Konkretisht:

- Vendimi nr. 153, datë 18.07.2016, *Për miratimin e Rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave të transmetimit audio”,* e ndryshuar, me Vendimin nr. 232, datë 03.11.2016 dhe Vendimin nr. 192, datë 06.10.2017 të AMA-s;
- Vendimi nr. 2, datë 16.01.2020, *Për miratimin e Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”;*
- Vendimi nr. 55, datë 04.04.2016 *Për miratimin e Rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave të transmetimit audio të komunitetit”.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Referuar nenit 60 pika 2 e Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet që:

“AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, çel garën për dhënien e licencës së shërbimit të programit audio ose audioviziv”.

Nga shqyrtimi i procedurave për dhënien e licencave të transmetimeve audio për periudhën objekt auditimi rezulton se në asnjë rast nuk është ushtruar e drejta ligjore e AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira. Pikërisht, fakti i mungesës së planit të përdorimit të frekuencave, ka shërbyer si justifikim për të mos çelur asnjë garë kryesisht nga ana e AMA. Jo pa qëllim ligjvënësi ka përcaktuar si formë të konkurimit shpalljen e garave edhe kryesisht nga AMA, duke garantuar në këtë mënyrë objektivitet, transparencë dhe mosdiskriminim. Në kushtet e një zbatimi rigoroz të dispozitave ligjore, duke hartuar planin e përdorimit të frekuencave, në zbatim me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, AMA do të kishte mundësinë e përcaktimit të saktë të frekuencave të lira dhe do të ushtronte të drejtën e celjes së garave kryesisht, kjo nëpërmjet afishimit në fillim të çdo viti kalendarik të planit të përdorimit të frekuencave, duke i dhënë mundësi të gjithë palëve të interesuara për tu njohur me të. Çelja e garave vetëm pas kërkesave të subjekteve të interesuara nuk mund të jetë e vetmja formë e ushtrimit të kompetencave nga ana e AMA-s.

Nëpërmjet shkresës nr. prot. 1604, datë 20.04.2023, protokolluar në KLSH me nr. 896/6 dt. 20/4/2023, AMA ka paraqitur observacion në lidhje me projekt raportin, si më poshtë:

Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK ka përcaktuar frekuencat për subjektet që aplikojnë për licencë pranë AMA-s bazuar në Planin e Përdorimit të Frekuencave Audio dhe Audiovizive. Planet e përdorimit të frekuencave janë hartuar në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) dhe standardet ndërkombëtare të përcaktuara në PKF.

Nëse nuk do të ekzistonte Plani i Përdorimit të Frekuencave do të ishte i pamundur caktimi i frekuencave për përdorim nga subjekte të ndryshme, të cilët aktualisht janë në treg.

Plani i Përdorimit të Frekuencave nuk përmban afate kohore, pasi afatet e përdorimit të frekuencave përcaktohen në kushtet e licencës. Në rastin kur përfundon afati i licencës dhe subjekti nuk dëshiron të rilicencohet atëherë frekuencat që atij i janë dhënë në përdorim, konsiderohen të lira. Në planin e përdorimit identifikohen lehtësisht frekuencat e lira të cilat mbahen parasysh për çeljen e garave të reja.

Plani i përdorimit të frekuencave nuk mund të jetë plan vjetor apo me periudha të caktuara. Ekziston një plan përdorimi i cili përditësohet sa herë që licencohen subjekte të reja, sa herë që ndryshojnë kushtet teknike të licencës apo sa herë që hiqen licencat apo vetë subjektet tërhiqen nga aktiviteti audio/audioviziv.

Referuar përcaktimeve ligjore, AMA nuk ka detyrimin që të publikojë Planin e Përdorimit të Frekuencave, ndërkohë që për respektimin e parimit të transparencës dhe garantimin e një konkurrence efektive në lidhje me procedurat e licencimit gjejmë përcaktime në disa nene të ligjit nr. 97/2013, ku edhe drejtoritë e AMA-s përfshirë Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave janë bazuar në procedurën e dhënies së licencave.

Sqarojmë se gjetja e mësipërme, se në asnjë rast nuk është ushtruar e drejta ligjore e AMA-s për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira, për periudhën objekt auditimi janar 2019-qershor 2022 qëndron. Por nuk qëndron argumenti se fakti i mungesës së planit të përdorimit të frekuencave, ka shërbyer si justifikim për të mos çelur asnjë garë kryesisht nga ana e AMA.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Sikurse është thënë edhe më lart, Plani i Përdorimit të Frekuencave ka ekzistuar dhe ekziston dhe në këtë plan identifikohen lehtësisht frekuencat e lira.

Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA bëhet pikërisht në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit. Për dhënien në përdorim të frekuencave si pasuri kombëtare e fundme përdoret procedura e hapur, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ndërkohë, arsyeja pse nuk janë çelur gara me nismën e AMA-s në këtë periudhë është se brezat frekuencor audio dhe audiovizive janë shumë të kufizuar dhe aktualisht këto breza shfrytëzohen maksimalisht nga operatorët audio/audiovizivë në treg. Ato pak frekuenca të lira që ndodhen në Planin e Përdorimit të Frekuencave i përkasin kryesisht zonave malore të vendit, zona për të cilat nuk është shprehur interes për ofrimin e shërbimeve audio.

*Për më tepër informacion, ju bëjmë me dije se AMA në shkurt të vitit 2018 **ka çelur me nismën e vet** garën për dhënien në përdorim të 16 frekuencave për shërbimin audio analoge duke përfshirë ndër të tjera si zonë shërbimi edhe zonat malore të vendit (bashkitë Dibër, Mat, Bulqizë, Klos, Kukës, Has dhe Tropojë) me qëllim për të nxitur të interesuarit që të mbulonin me shërbim audio edhe këto zona, por në përfundim të afateve nuk është depozituar asnjë aplikim për këto frekuenca. **Në lidhje me vijimin e qëndrimit të grupit të auditimit edhe në Projekt Raport, se:** Hartimi i planit të përdorimit të frekuencave është një kërkesë ligjore dhe në këto kushte nuk mund të ketë asnjë justifikim për mungesën e tij. Po kështu, ushtrimi i të drejtës për çeljen e garave kryesisht nga AMA është një e drejtë ligjore dhe si e tillë duhet të ushtrohet në rakordim me planin e përdorimit të frekuencave, konkludojmë se:*

Duke konsideruar, karakterin teknik, rregullator të Planit të Përdorimit të Frekuencave, detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të koordinimit frekuencor sa i takon shërbimit radioteleviziv, do të duhej që në ekipin auditues të kishte edhe ekspertë të fushës të planifikimit, administrimit dhe koordinimit të frekuencave audio/audiovizive, siç parashikohet në kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullojnë veprimtarinë e KLSH-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Hartimi i planit të përdorimit të frekuencave është një kërkesë ligjore dhe në këto kushte nuk mund të ketë asnjë justifikim për mungesën e tij. Po kështu, ushtrimi i të drejtës për çeljen e garave kryesisht është një e drejtë ligjore dhe si e tillë duhet të ushtrohet në rakordim me planin e përdorimit të frekuencave. Pretendimet që lidhen me aftësitë profesionale dhe kompetencën e audituesve nuk mund të jenë objekt i vlerësimit të subjekteve të auditimit dhe nuk mund të vlerësohen si observacion.

Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arritë në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e hartimit të planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave. Mosushtrimi i të drejtës ligjore të AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira.
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave nuk ka ndërmarr hapat ligjore në lidhje me hartimin e planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Minimalisht ky plan, i cili mund të kishte afate të caktuara, duhet të kishte përcaktuar planin e përdorimit, referuar parametrave teknik në të gjitha rastet dhe përcaktimin e saktë të frekuencave të lira kur është objektivisht e mundur. Ekzistenca e një plani vjetor ose në periudha më të gjata, i cili duhet të publikohej, në faqen zyrtare të AMA do të krijonte kushtet për respektimin e parimit të transparencës dhe garantimin e një konkurrence efektive në lidhje me procedurat e licencimit. Nga shqyrtimi i procedurave për dhënien e licencave të transmetimeve audio për periudhën objekt auditimi rezulton se në asnjë rast nuk është ushtruar e drejta ligjore e AMA-s për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira. Pikërisht, fakti i mungesës së planit të përdorimit të frekuencave, ka shërbyer si justifikim për të mos çelur asnjë garë kryesisht nga ana e AMA-s. Jo pa qëllim ligjvënësi ka përcaktuar si formë të konkurimit shpalljen e garave edhe kryesisht nga AMA, duke garantuar në këtë mënyrë objektivitet, transparencë dhe mosdiskriminim. Në kushtet e një zbatimi rigoroz të dispozitave ligjore, duke hartuar planin e përdorimit të frekuencave, në zbatim me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, AMA do të kishte mundësinë e përcaktimit të saktë të frekuencave të lira dhe do të ushtronte të drejtën e celjes së garave kryesisht, kjo nëpërmjet afishimit në fillim të çdo viti kalendarik të planit të përdorimit të frekuencave, duke i dhënë mundësi të gjithë palëve të interesuara për tu njohur me të. Çelja e garave vetëm pas kërkesave të subjekteve të interesuara nuk mund të jetë e vetmja formë e ushtrimit të kompetencave nga ana e AMA.
Kriteri:	Ligji 97/2013 “Për mediat audovizive ne Republikën e Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Ekzistenca e një plani vjetor ose në periudha më të gjata, i cili duhet të publikohej, në faqen zyrtare të AMA do të krijonte kushtet për respektimin e parimit të transparencës dhe garantimin e një konkurrence efektive në lidhje me procedurat e licencimit.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi;
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AMA të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave sipas përcaktimeve ligjore.

Gjatë periudhës janar 2019 - qershor 2022, AMA ka proceduar me çeljet e garave dhe vendimmarrjet përkatëse lidhur me aplikimet e subjekteve për marrje licence/zgjerim zone licencimi. Janë audituar 5 procedura licensimi dhe konkretisht:

1.Aplikimi i subjektit person fizik I. D. (Z.T.)

Në nenin 60 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, çel garën për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Ndërsa, referuar nenit 67 pika 1e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

AMA jep licenca shërbimi për programet audiovizive, në bazë të së cilës i licencuari ka të drejtat dhe detyrimet për të ngritur dhe realizuar një shërbim programi audioviziv. Në bazë të licencës, i licencuari ka të drejtë për të ngritur, realizuar dhe vënë në funksion pajisje transmetuese, me qëllim transmetimin e shërbimit të programit audioviziv.

Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes rezultoi se ka kapacitete të lira transmetimi në rrjetin numerik të RTSH-së.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe Vendimit nr. 5, datë 29.01.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv” shpalli garën e kandidaturave për:

- Lëshimin e 2 (dy) licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë. (Qarqet Tiranë dhe Durrës).
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Fier.
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Korçë.

Referuar dosjes së administruar nuk disponohet asnjë akt, për të evidentuar se cila ka qenë arsyeja e çeljes së garave, në përputhje me përcaktimet e nenit 60 të të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti aplikues nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e rregullores së sipërcituar.

Për sa më sipër, AMA në zbatim të nenit 14, pika 5 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, në të cilën parashikohet se: “Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues”, arrin në përfundimin se aplikimi i subjektit person fizik I.D., për marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në allotmentin Tiranë, duhet të rrëzohet.

Për këto arsye, AMA me Vendimin nr. 27, datë 22.04.2020, ka vendosur rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “Z.T.” në allotmentin Tiranë.

Kundër këtij vendimi subjekti person fizik I. D. ngriti kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Në përfundim të gjyimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi mori në shqyrtim çështjen administrative me palë dhe objekt sa më sipër, me vendimin nr. 2091 (80-2020-2106), datë 28.09.2020, ka vendosur:

“- Pranimin e pjesës së kërkesës padisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- Shfuqizimin e vendimit nr. 27, datë 22.04.2020 të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe detyrimin e palës së paditur, Autoriteti i Mediave Audiovizive të rimarrë në shqyrtim kërkesën e subjektit person fizik I.D., me përbërje të plotë të anëtarësisë së saj.

- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.”

Konstatime:

Në kushtet kur jemi përpara një vendimi gjyqësor, KLSH në zbatim të përcaktimeve të nenit 36 të K.Pr.Civile ku parashikohet se “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, grupi i auditimit nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e procedurës, por duke ju referuar përmbajtjes së vendimit ka evidentuar faktin se mungesa e plotë e anëtarëve të AMA-s ka sjell risk në ligjshmërinë e procedurave të vendimmarrjes. Kjo pasi, në periudha të caktuara konkretisht periudha Mars 2021 – Shkurt 2022 AMA ka ushtruar aktivitetin e tij administrativ me 4 anëtar, pasi 3 prej tyre u ka përfunduar mandati. Rezulton se për një periudhë 11 muajore nuk janë ndërmarr procedura ligjore nga ana e Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante të anëtarëve të AMA-s. Pikërisht mosfunksionimi i plotë i AMA, duke patur të gjithë anëtarët efektivisht në detyrë (7) ka passjell kontradita në raport me mënyrën e vendimmarrjes së AMA. Institucioni i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë duhet të kishte ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për plotësimin e kuorumit të plotë të anëtarëve të AMA, në një kohë sa më të shpejt, me qëllim funksionimin sa më efektiv të tij.

2.Aplikimi i shoqërisë “D.&A.E.” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në qarqet Fier dhe Korçë, “S.T.”.

Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes rezultoi se kishte kapacitete të lira transmetimi në rrjetin numerik të RTSH-së për Qarqet Fier dhe Korçë.

Në vijim, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, me vendimit nr. 5, datë 29.01.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”, miratoi çeljen e garës për:

- Lëshimin e 2 (dy) licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë. (Qarqet Tiranë dhe Durrës);
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Fier;
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Korçë.

Më tej u vijua me publikimin e njoftimit për çeljen e garës në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetat “Panorama”, “Tema” dhe “Dita” me shpërndarje kombëtare.

Në vijim të njoftimit “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv” të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetat “Panorama”, “Tema” dhe “Dita” me shpërndarje kombëtare, shoqëria “DA.E” sh.p.k., ka depozituar aplikimin nr. 894 prot., datë 10.03.2020, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.” në qarqet Fier dhe Korçë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe në zbatim të urdhrit nr. 51, datë 04.03.2020, të Kryetarit të AMA-s, (nr. 837 prot., datë 04.03.2020) në datën 10 mars 2020, ora 10:00 u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “D&A.E” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.” në qarkun Fier dhe Korçë:

- Aplikimi nr. 894 prot., datë 10.03.2020, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.” në qarkun Fier dhe Korçë.

KSHD, vlerësoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.” në qarkun Fier dhe Korçë, i plotëson kriteret ligjore, financiare, teknike, programore, të së drejtës së transmetimit dhe të burimeve njerëzore.

- Aplikimi i subjektit, në zbatim të nenit 17 të rregullores së sipërcituar vlerësohet në total me 100 pikë, nga të cilat: 75 pikë programet; 5 pikë burimet njerëzore, 10 pikë dokumentacioni financiar; 10 pikë dokumentacioni teknik.

KSHD, bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, i propozoi AMA-s:

Pranimin e aplikimit të shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k. dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.”, në qarkun Fier dhe Korçë.

AMA me vendimin nr. 28, datë 22.04.2020, vendosi:

Pranimin e aplikimit të shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k., duke vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv “S.T.” në qarqet Fier dhe Korçë.

3. Aplikimi i shoqërisë “A” Sh.p.k për “A.T.”

Pranë AMA-s, kanë shfaqur interes subjekte për t’u pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv për qarqet Tiranë- Durrës. Konkretisht, bëjmë më dije se janë depozituar kërkesat e mëposhtme:

- Z. B. M., ka depozituar kërkesën, administruar në AMA me nr. 2762 prot., datë 02.10.2020, për pajisje me licencë shërbimi programi audioviziv me karakter gjeneralist, për të ofruar shërbim në qarkun Tiranë.

- Shoqëria “I.T.A” sh.p.k., me shkresën, administruar në AMA me nr. 2546 prot., datë 10.09.2020, ka paraqitur kërkesë për pajisje me licencë shërbimi programi audioviziv, për të ofruar shërbim në qarkun Tiranë.

Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes rezultoi se ka kapacitete të lira transmetimi në rrjetin numerik të RTSH-së.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 87, datë 08.10.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”, shpalli garën e kandidaturave për:

- Lëshimin e 2 (dy) licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë. (Qarqet Tiranë dhe Durrës).

Në vijim të njoftimit “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv” të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetën “Panorama”, “Tema” dhe “Dita”, me shpërndarje kombëtare, rezulton se shoqëria “A.” sh.p.k, ka depozituar aplikim për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në allotmetnin e Tiranës (qarqet Tiranë-Durrës).

KSHD vëren se në vijim të shpalljes publike për lëshimin e 2 licencave të shërbimit të programit audiovizive, është depozituar vetëm 1 aplikim.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, rregulloren “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 218, datë 12.10.2016, të ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrit nr. 207, datë 16.11.2020, të Kryetarit të AMA-s, (nr. 3239 prot., datë 16.11.2020) në datën 23 nëntor 2020, ora 10:00, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e subjektit, shoqërisë “A” sh.p.k.:

- Nr. 3330 prot., datë 23.11.2020, për marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm për licencë “A.T.”, në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë dhe Durrës). KSHD, vlerësoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “A.” sh.p.k., për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “A.T.” në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë dhe Durrës), i plotëson kriteret ligjore, financiare, teknike, programore, të së drejtës së transmetimit dhe të burimeve njerëzore.

- Aplikimi i subjektit, në zbatim të nenit 17 të rregullores së sipërcituar vlerësohet në total me 100 pikë, nga të cilat: 75 pikë programet; 5 pikë burimet njerëzore, 10 pikë dokumentacioni financiar; 10 pikë dokumentacioni teknik.

KSHD, bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, i propozoi AMA-s:

- Pranimin e aplikimit dhe lëshimin e licencës për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “A.T.”, në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë- Durrës);

- Caktimin e Numrit Logjik të Programit NLP- 90, shoqërisë “A.” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “A.T.”.

Referuar dosjes së aplikimit rezulton se subjekti ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 16.01.2020 të AMA, e ndryshuar përkatësisht neni 14.

AMA me Vendimin nr. 132, date 04.12.2020, vendosi:

- Dhënien e licencës, shoqërisë “A.” sh.p.k., me NIPT: dhe administrator: z. B. M., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “A.T.”, në allotmentin Tiranë (Qarqet Tiranë-Durrës), për një periudhë prej 8 vjetësh.

- Caktimin e numrit logjik të programit NLP 90, shoqërisë “A.” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “A.T.”.

4.Aplikimi i shoqërisë “I.B.-T.” sh.p.k. (R.I.B.)

Në nenin 59 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se AMA, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit audio, për të cilën mund të aplikohet dhe çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio.

Po ashtu, AMA me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016, ka miratuar rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, e ndryshuar. Objekti i kësaj rregulloreje është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave për dhënien e licencës së transmetimit audio. Në nenin 8 të këtij akti parashikohet kompetenca e AMA-s për çeljen e konkurrimit për dhënien e licencave të transmetimit audio.

Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA, bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, përkundrejt aplikimit të të interesuarit duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit.

Pranë AMA-s, kanë shfaqur interes për t'u pajisur me licencë transmetimi audio analoge ose zgjerim zone ofrimi shërbimi në rastin e subjekteve audio, tashmë të licencuara.

Konkretisht, bëjmë më dije se pranë AMA-s janë depozituar kërkesat e mëposhtme:

- Shoqëria "I.C." sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për pajisjen me licence shërbimi audio në Bashkinë Shkodër.
- Shoqëria "6.V." sh.p.k., ka paraqitur kërkesa të përsëritura për tu pajisur me licence transmetimi audio në Qarkun Vlorë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio" miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016, e AMA-s, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 103, datë 05.11.2020 të AMA-s "Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge", ka çelur procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e 2 (dy) licencave të transmetimit audio analoge, për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Vlorë	Audio Analoge Lokale	Zvërnec	93.7
			Llogara	99.1
			Treblvë	93.4
			Himarë	96.2
			Sopot	98
			Mile	97.1
2.	Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës	Audio Analoge Lokale	Tarabosh	104.4

Bazuar në parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, njoftimi për çeljen e garës për licencat e transmetimit audio analoge do të publikohet në faqen e internetit të AMA-s dhe në një organ shtypi, që shpërndahet në zonën e mbulimit të licencës së transmetimit. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio analoge, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.

Në vijim të njoftimit "Për çeljen e garës për dhënien e 4 (katër) licencave private transmetimi audio", të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetën "Panorama", "Dita", "Tema" me shpërndarje kombëtare, rezulton se shoqëria "I.B.T." sh.p.k., ka depozituar aplikim për marrje licence transmetimi audio analoge lokale në Bashkinë Shkodër dhe Vau i Dejës.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregulloren "Mbi procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrit nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

235, datë 21.12.2020, të Kryetarit të AMA-s, i ndryshuar, në datën 28.12.2020, ora 10:00, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “I.B.T.” sh.p.k.,

- Nr. 3442 prot., datë 22.12.2020, për marrje licence transmetimi audio analoge “R. I.B.”, në Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës, për frekuencën 104.4 Mhz.

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, pasi administroi dosjen e aplikimit të shoqërisë “I.B.T.” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio analoge “R.I.B.”, për të bërë vlerësimin sipas akteve nënligjore në fuqi, vlerëson se:

- Aplikimi i shoqërisë “I.B.T.” sh.p.k., për marrje licence audio private lokale për subjektin audio “Radio I.B.C”, në “Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës”, i plotëson kriteret ligjore, financiare, teknike, programore, të së drejtës së transmetimit dhe organizative.

- Aplikimi i subjektit, në zbatim të nenit 17 të rregullores së sipërcituar vlerësohet në total me 94,5 pikë, nga të cilat: 14,5 pikë programet; 20 pikë burimet njerëzore, 20 pikë dokumentacioni financiar; 40 pikë dokumentacioni teknik.

- KSHD, i propozon AMA-s, pranimin e aplikimit të shoqërisë “I.B.-T.” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio analoge “Radio I.B.C”, në Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës, për frekuencën 104.4 Mhz.

Sa më sipër, AMA, pas shqyrtimit të aplikimit të subjektit, me vendimin nr. 3, datë 18.01.2021, vendosi:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge lokale, shoqërisë “I.B.T.” sh.p.k., për subjektin audio “Radio I.B.C”, për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës”, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.

5.Aplikimi i shoqërisë “R. S.” SH.P.K.(R. S.)

Në nenin 59 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se AMA, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit audio, për të cilën mund të aplikohet dhe çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio.

Po ashtu, AMA me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016, ka miratuar rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, e ndryshuar. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave për dhënien e licencës së transmetimit audio. Në nenin 8 të këtij akti parashikohet kompetenca e AMA-s për çeljen e konkurrimit për dhënien e licencave të transmetimit audio.

Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA, bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, përkundrejt aplikimit të të interesuarit duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit.

Pas studimit të planit të frekuencave që shfrytëzohen për transmetime audio, kryer prej Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe TIK-ut, rezulton se frekuencat e mëposhtme janë të lira dhe mund të jepen për shfrytëzim për ofrimin e transmetimeve audio analoge:

Nr.	Zona e ofritit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.			Fushë Dajt	89



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Qarqet Tiranë dhe Durrës	Audio Analoge Rajonale	Krujë	93.8
--	--------------------------	------------------------	-------	------

Bazuar në parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, njoftimi për çeljen e garës për licencat e transmetimit audio analoge do të publikohet në faqen e internetit të AMA-s dhe në një organ shtypi, që shpërndahet në zonën e mbulimit të licencës së transmetimit. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio analoge, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 84, datë 07.06.2019 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge private dhe miratimin e dokumentacionit të licencimit” shpalli garën e kandidaturave për dhënien e 1 licencë private të transmetimit audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Në vijim të njoftimit “Për çeljen e garës për dhënien e 1 licencë private transmetimi audio analoge” të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetën “Panorama” me shpërndarje kombëtare, rezulton se vetëm subjekti, shoqëria “R.S.” sh.p.k., ka depozituar aplikim për marrje licence në qarqet Tiranë dhe Durrës.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Mbi procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrin nr. 224, datë 26.08.2019, të Kryetarit të AMA-s, (nr. 3075 prot., dt 26.08.2019) i ndryshuar në datën 28 gusht 2019, ora 10:00 u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e subjektit shoqërisë “R.S.” sh.p.k.:

- Nr. 3090 prot., datë 28.08.2019, për marrje licence audio private rajonale “R.S.” në frekuencat 89 MHZ në Fushë Dajt dhe 93.8 Mhz në Krujë.

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, pasi administroi dosjen e aplikimit të subjektit, shoqërisë “R.S” sh.p.k, për marrje licence private audio rajonale “R.S.”, për të bërë vlerësimin sipas akteve nënligjore në fuqi, vlerëson se:

- *Aplikimi i shoqërisë “R.S.” sh.p.k., i plotëson juridike, financiare, organizative, teknike, të mbikëqyrjes dhe programore për marrjen e licencës së transmetimit audio analoge rajonale “R. S.*
- *KSHD, i propozon AMA-s, dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale, shoqërisë “R.S.” sh.p.k. për subjektin “R.S.”.*

Referuar dosjes së aplikimit rezulton se subjekti ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas Rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me Vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, e ndryshuar përkatësisht neni 19.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Sa më sipër, AMA, pas shqyrtimit të aplikimit të subjektit, me Vendimin nr. 121, datë 30.09.2019, vendosi:

- *Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “R. S.” sh.p.k., për subjektin audio “R.S.”, për të mbuluar me sinjal audio “Qarqet Tiranë dhe Durrës”, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.*

Konstatime:

Referuar Vendimit nr. 248, datë 21.12.2016 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik” në nenin 5 janë përcaktuar detyrat e Sekretariatit Teknik dhe konkretisht:

- mban procesverbalin e mbledhjeve të AMA, në përputhje me nenin 28 të Rregullores së AMA;
- regjistron, publikon dhe arkivon vendimet dhe dosjen me dokumentacionin e shqyrtuar në mbledhjen e AMA, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” në nenin 16 përcakton që:

- *Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.*
- Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.
- *Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.*
- Vendimet jonormative të organeve kolegjiale hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.

Referuar nenit 28 të Vendimit nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së AMA” përcaktohet që:

- Sekretariati Teknik i AMA është përgjegjës dhe merr masat e nevojshme për regjistrimin në menyre të plotë audio dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjes së Autoritetit.
- Procesverbali mbahet nga anëtarët e Sekretariati Teknik i ngarkuar me këtë detyrë dhe duhet tu paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit të procesverbalit nënshkruhet së bashku, nga Kryetari i AAMA dhe anëtarë i Sekretariatit Teknik, i ngarkuar për mbajtjen e tij.
- *Vendimet e AMA, së bashku me regjistrimet e plota audio dhe procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve depozitohen pranë këtij autoriteti.*
- *Sekretariati Teknik i AMA merr masat e duhura për katalogimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhjeve që depozitohen pranë autoritetit.*

Nga shqyrtimi i të gjithë praktikave të mësipërme, evidentohet se procesverbalet e mbledhjes nuk janë të firmosur sipas përcaktimeve të dispozitave të mësipërme dhe nuk janë ruajtur dhe arkivuar pranë sektorit të arkiv-protokollit, sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Pavarësisht faktit se organi vendimmarrës e ka shprehur vullnetin nëpërmjet Vendimit nr. 28, datë 22.04.2020, Sekretariati Teknik ka vepruar në mospërputhje me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, nëse do të qëndrojmë strikt përcaktimeve të nenit 16 të Ligjit 8480, datë 27.05.199



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, do të konsiderohet si i pavlefshëm vendimi i organit kolegjial, në kushtet kur ai hyn në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.

Për veprimet e evidentuara më sipër, mbajnë përgjësi Kryetari i AMA, z. G.S. dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik, znj. V.M., Sekretare e Përgjithshme, znj. S.Xh., Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licencave dhe znj. Xh. H., Sekretare e Kryetarit

Titulli i Gjetjes:	Procesverbalet e mbledhjeve të bordit të AMA të pafirmosura sipas përcaktimeve ligjore.
Situata:	Nga shqyrtimi i të gjithë praktikave të mësipërme, evidentohet se procesverbalet e mbledhjes nuk janë të firmosur sipas përcaktimeve të dispozitave të mësipërme dhe nuk janë ruajtur dhe arkivuar pranë sektorit të arkiv-protokollit, sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Pavarësisht faktit se organi vendimmarrës e ka shprehur vullnetin nëpërmjet Vendimit nr. 28, datë 22.04.2020, Sekretariati Teknik ka vepruar në mospërputhje me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, nëse do të qëndrojmë strikt përcaktimeve të nenit 16 të Ligjit 8480, datë 27.05.199 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, do të konsiderohet si i pavlefshëm vendimi i organit kolegjial, në kushtet kur ai hyn në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.
Kriteri:	<i>Ligji nr. 8480, datë 27.05.199 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.</i> <i>Vendimi nr. 248, datë 21.12.2016 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik”.</i> <i>Vendimi nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së AMA”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Risk në ligjshërinë e procedurës së vendimmarrjeve të bordit të AMA.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi;
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AMA në cdo rast të mbledhjeve të bordit të ndërmarr masat për të administruar procesverbale sipas përcaktimeve ligjore.

A. NDRYSHIMET NË STRUKTURËN E PRONËSISË NË LIDHJE ME LICENCAT DHE AUTORIZIMET PËR VITET 2019-2022 DHE MASAT ADMINISTRATIVE.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet e licencuar/autorizuar kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtit subjekt tregtar.

Një ndër kushtet e licencës/autorizimit të subjekteve OSHMA është detyrimi për të njoftuar AMA-n për ndryshime në të dhënat e licencës dhe autorizimit. Bazuar në nenin 133, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mosnjoftimi i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e subjektit të licencuar/autorizuar përbën kundërvajtje administrative që ndëshkohet me gjobë nga 120 000 lekë deri në 2 000 000 lekë. Ky detyrim ligjor ka si qëllim vënien



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

në dijeni dhe njohjen e autoritetit rregullator me çdo ndryshim të të dhënave që i licencuari/autorizuari ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës/autorizimit, të tilla si: ndryshimet në pronësi, që është nga më të rëndësishmit, emrin e subjektit, ndryshime në strukturën programore etj. Nga ana tjetër, AMA, kryesisht, në mënyrë periodike, verifikon në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), statusin, objektin e veprimtarisë si dhe të dhëna të tjera për subjektet e licencuar/autorizuar nga autoriteti. Në vijim të verifikimeve të kryera, AMA ka iniciuar, rast pas rasti, procedimet administrative ndaj OSHMA-ve duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim si dhe rast pas rast duke vendosur sanksionet përkatëse.

Në vijim të kontroleve të kryera, AMA, rast pas rasti, ka ndërmarrë procedimet administrative ndaj OSHMA-ve, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim si dhe, rast pas rasti, duke vendosur sanksionet përkatëse.

2019

Për vitin 2019, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 7 subjekte, ndryshime të cilat janë miratuar nga AMA. Ndërkohë, 8 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, ndryshime të cilat janë miratuar nga AMA.

Subjekti (Shoqëria “D.&A.E.” sh.p.k.) është sanksionuar për mosdhënie informacioni për ndryshimet në pronësi me vendimin nr. 13, datë 06.05.2019, në masën 1.000.000 (një milion) lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA me Vendimin nr. 108, datë 11.07.2019 e AMA-s.

- Shqyrtimi i ankimit administrativ të shoqërisë “D.&A.E.” sh.p.k., kundër sanksionit me gjobë nr. 13, datë 06.05.2019, për subjektin audioviziv “T.T.” dhe për subjektin audio “B. R”.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me vendimin nr. 183, datë 11.09.2017, ka miratuar ndryshimet e ndodhura në pronësinë e shoqërisë “T.T” sh.p.k., duke kaluar të drejtat e licencës së shoqërisë “T.T” sh.p.k., tek shoqëria “D.&A.E.” sh.p.k.

AMA me vendimin nr. 208, datë 25.10.2017, miratoi ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv nga “T.T.” në “T.N.”. Më tej, me vendimin nr. 82, datë 20.04.2018 AMA ka kaluar të drejtat e licencës së subjektit audio privat “R.B.” nga shoqëria “E.M.” sh.p.k., tek shoqëria “D&A. E” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “T.N” dhe për subjektin audio “B.R.

AMA me shkresat nr. 109 prot., datë 10.01.2019 dhe nr. 444 prot., datë 22.01.2019, ka filluar procedimin administrativ për heqjen e licencës së shoqërisë “D.&A.E” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “T.N” dhe për subjektin audio privat “B.R.” për shkak se subjekti ishte debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit.

Në vijim, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k., “Studio Ligjore H & H.” me shkresën nr. 109/1 prot., datë 17.01.2019, ka depozituar pranë AMA-s, njoftimin se në kushtet kur z. D. Sh., ortak i vetëm i subjektit është ndarë nga jeta, trashëgimia nuk është çelur pasi është e ndërvarur nga një mosmarrëveshje gjyqësore ndërmjet personave që e trashëgojnë atë. Në këtë shkresë, subjekti ka bërë me dije se menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe ecurisë së tij, do të njoftonte autoritetin.

Më tej, AMA me shkresën nr. 109/2 prot., datë 20.02.2019, kërkoi nga shoqëria “D&A. E” sh.p.k., informacion mbi ecurinë e procesit gjyqësor civil me nr. 11089 dhe datë regjistrimi 05.07.2018, me paditës A.Sh. dhe të paditur: D.Sh., E.Sh., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së aktit noterial,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

testamentit me testator D.Sh., me nr. 32, datë 24.05.2018, të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Pas kalimit të një periudhe më shumë se 60 ditë, rezultoi se subjekti nuk ka dhënë informacion dhe nuk ka depozituar asnjë dokumentacion edhe pas kërkesës së AMA-s, për të plotësuar njoftimin e datës 17.01.2019.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si dhe të japin të dhënat e kërkuara nga autoriteti, si organi që monitoron respektimin e kërkesave të ligjit dhe kushteve të licencës së subjektit.

Neni 133, pika 2 gërma “dh” i ligjit nr. 97/2013, parashikon se mosdhënia e informacioneve dhe të dhënave të kërkuara përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet si më poshtë:

“2. Me gjobë nga 120 000 deri në 2 000 000 lekë për rastet kur:

.. ndalon hyrjen e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre;”

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar dhe nenit 26 të rregullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 101, datë 07.06.2017, si dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, subjekti është ndëshkuar me sanksionin me gjobën nr. 13, datë 06.05.2019, në masën 1.000.000 (njëmilion) lekë.

Subjekti për sanksionin e mësipërm është njoftuar me shkresën nr. 1914 prot., datë 06.05.2019. Në vijim, shoqëria “D&A.E.” sh.p.k., me shkresën nr. 1904/1 prot., datë 23.05.2019, administruar në AMA, ka paraqitur ankim administrativ ndaj sanksionit me gjobë nr. 13, datë 06.05.2019, ku ndër të tjera ka parashtruar se:

“...Siç dhe keni dijeni, i ndjeri D. SH., është ndarë nga jeta në datën 25.05.2018. Gjatë kohës që i ndjeri po kurohej në Shqipëri janë konstatuar se janë kryer disa veprime të paligjshme me qëllim përvetësimin e pasurisë trashëgimore, pjesë e të cilës është dhe shoqëria “D&A.E” sh.p.k., për këto arsye trashëgimtarët e të ndjerit janë përballur për 8 (tetë) muaj në procese gjyqësore në lidhje me trashëgiminë, me finalizimin e të cilave është mundësuar çelja e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore.”

Duke qenë se kemi qenë në konflikt gjyqësor me trashëgimtarët e tjerë, ne nuk kemi patur dijeni dhe nuk na kanë njoftuar në lidhje me kërkesën e AMA-s për informacionin e datës 20.02.2019. Gjithashtu nga ana jonë ka filluar procedura për shitjen e Kuotave të Shoqërisë, për këtë arsye kemi nënshkruar një kontratë shitje me kusht duke qenë se ortak të shoqërisë janë dhe tre fëmijë të mitur dhe sipas kushtit kjo kontratë do të konsiderohej përfundimtare në momentin që do të merren autorizimet e Gjykatës për fëmijët e mitur.

Duam t’ju informojmë se Kontrata e Shitjes me Kusht ende nuk është përmbushur, pasi vazhdojmë të jemi në proces gjyqësor për marrjen e autorizimeve për fëmijët e mitur, në rrethanat kur kushti nuk është plotësuar mund të themi se gjendja e shoqërisë vazhdon të mbetet e njëjtë dhe nuk ka asnjë ndryshim i cili do të përbënte detyrim ligjor për të informuar AMA-n, dhe aq më pak shkelje për të legjitimuar masën e gjobës së vendosur.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Informacionin AMA e ka kërkuar nga Studio Ligjore “H & H” dhe jo nga shoqëria. Procesi gjyqësor i filluar është një proces publik ku çdo subjekt i interesuar mund të merrte informacion, ekstrakti i shoqërisë është publik dhe mund të shkarkohet nga çdo subjekt i interesuar on-line, mendojmë se është i pa bazuar në ligj, pasi AMA kishte mundësi të konstatonte dhe vetë për ndryshimet e ndodhura në shoqëri.

Sa më sipër, bazuar në Nenin 133/11 të Ligjit me nr. 97.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, kundërshtojmë vendimin me Nr.13, datë 06.05.2019 të lëshuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, “Për dënimin me gjobë të shoqërisë “D&A.E” sh.p.k., Licencuar për subjektin Audioviziv “T.T.N” dhe për subjektin audio “B.R”.

Në njohje të pretendimeve të parashtruara në ankimin administrativ, rezulton se subjekti i ndëshkuar e vlerëson të pambështetur në ligj dënimin e tij me gjobë.

Pretendimet e parashtruara në ankimin administrativ sipas Drejtorisë Juridike kanë qenë të pabazuara pasi:

- Pretendimi se Kontrata e Shitjes me Kusht ende nuk është përmbushur, pasi vazhdon procesi gjyqësor për marrjen e autorizimeve për fëmijët e mitur, gjendja e shoqërisë vazhdon të mbetet e njëjtë dhe nuk ka asnjë ndryshim i cili do të përbënte detyrim ligjor për të informuar AMA-n, nuk qëndron pasi subjekti është ndëshkuar për shkak të mosdhënies së informacionit mbi ecurinë e procesit gjyqësor civil të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në të cilin subjekti ishte palë dhe jo në lidhje me mosnjohimin e ndryshimeve të ndodhura në pronësinë e subjektit.
- Kryerja e një veprimi të mëtejshëm juridik siç është shitja me kusht e kuotave nga trashëgimtarët ligjor D.Sh. (20%), D.Sh. (20%), D.Sh. (20%), A.Sh. (20%) dhe E.Sh. (20%), tek organizata jofitimprurëse “Qendra për informim të hapur” me NUIS L71..... (100%), nuk është objekti i sanksionimit nga AMA.
- Pretendimi se AMA e ka kërkuar informacionin nga Studio Ligjore “H & H” dhe jo nga shoqëria “D&A.E.” sh.p.k., është po ashtu i pambështetur pasi AMA ka kërkuar informacion nga kjo studio, në kushtet që kjo e fundit ishte përfaqësues ligjor i shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k.
- Pretendimi se AMA kishte mundësi t’i konstatonte dhe vetë kryesisht ndryshimet e ndodhura në shoqëri në faqen Web të QKB-së, si dhe se procesi gjyqësor i filluar nga ata është një proces publik, nuk merret në konsideratë, pasi sikurse u sqarua më sipër, subjekti është dënuar pasi nuk ka dhënë informacionin e kërkuar.

Për sa u trajtua më lart, Drejtoria Juridike dhe e Licencave i propozoi AMA-s:

Refuzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 13, datë 06.05.2019, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “D&A.E” sh.p.k., për subjektin audioviziv “T.T.N” dhe për subjektin audio “B.R.”

Pas shqyrtimit të ankimit administrativ, AMA me Vendimin nr. 108, datë 11.07.2019 vendosi:

Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 13, datë 06.05.2019, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “D&A.E.” sh.p.k., për subjektin audioviziv “T.T.N” dhe për subjektin audio “B.R.”, me argumentet si më poshtë:

Duke qenë se procedimi administrativ i iniciuar ndaj subjektit për heqjen e licencës së subjektit audioviziv dhe audio, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare prej këtij të fundit është ndërprerë dhe subjekti nuk ka më statusin e debitorit si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që ndëshkimi me sanksionin gjobë, objekt i këtij ankimi administrativ lidhet me procedimin e sipërcituar, kërkesa e palës ankuese duhet të mbahet parasysh. AMA po ashtu konsideron edhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

situatën në të cilën ndodhej shoqëria “D&A.E.” sh.p.k., faktin që ortaku i vetëm i shoqërisë ka ndërruar jetë në vitin 2018, zhvillimin e proceseve gjyqësore prej trashëgimtarëve të tij, prej të cilave ndërvarej edhe marrëdhënia e subjektit me autoritetin.

Konstatime:

Referuar procedurës së mësipërme evidentohet qartë se masa administrative e propozuar nga Drejtoria Juridike dhe e Licencave dhe e miratur me Vendimin nr. 13, datë 06.05.2019 të AMA, lidhet me faktin se ky sanksion është vendosur për shkak të mungesës së dhënies së informacionit për ndryshimet në pronësi, sipas përcaktimeve të nenit 133, pika 2 gërma “dh” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Referuar procedurës së shqyrtimit administrativ të konkluduar me vendimin nr. 108, datë 11.07.2019 të AMA, rezulton se arsyetimi për pranimin e ankimit administrativ bazohet të fakti procedimi i iniciuar lidhet me detyrimet financiare të subjektit, për të cilat nuk rezulton më debitor.

Ky arsyetim për pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e gjobës nuk qëndron në kushtet kur objekti i saj është i qartë dhe lidhet me mungesën e dhënies së informacionit. **Në këto kushte shfuqizimi i gjobës në vlerën 1.000.000 lekë është i pabazuar ne aktet ligjore dhe përbën efekt negativ financiar.**

Për vitin 2020, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 4 subjekte, ndryshime të cilat janë miratuar nga autoriteti. Ndërkohë, 6 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, të cilat janë miratuar. Ndërsa 1 subjekti i është rrëzuar kërkesa për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë. (Shoqëria “F.M.N.” Sh.a., për subjektin T. “F.N”),

Gjatë vitit 2020, AMA, ka ndëshkuar 1 subjekt (**Shoqërinë “Ch.” sh.p.k.**) me vendimin për dënimin me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA, me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021.

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe funksioneve ligjore, me qëllim verifikimin e respektimit të parashikimeve ligjore në fushën e mediave audiovizive, ka kryer kontrollin në faqen zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), të të dhënave të shoqërisë “C.” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “T.C.”.

Nga verifikimi i kryer është konstatuar se subjekti, ka bërë ndryshime në strukturën e pronësisë së saj. Konkretisht, struktura e pronësisë së shoqërisë “C.” sh.p.k., e miratuar nga AMA është zj. O.Ç., (100%) të kuotave;

Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të QKB- së, rezulton se në datën 04.11.2020, zj. O.Ç., ortak me 100% të kuotave, ka kaluar kuotat që zotëronte në këtë shoqëri tek zj. N.M., duke ndryshuar kështu plotësisht strukturën e pronësisë së shoqërisë.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesat për marrjen e autorizimit, brenda afatit 30 ditor nga data e kryerjes së tyre si dhe të kërkojë miratimin nga AMA.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 133, pikat 2 dhe 10 të ligjit nr. 97/2013 të sipërcituar, si dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Drejtoria Juridike dhe e Licencave, ka proceduar me marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nr. 6 datë 23.12.2020, në masën 120.000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë.

Në vijim, shoqëria "C." sh.p.k., me shkresën nr. 51 prot., datë 31.12.2020, administruar në AMA me nr. 8 prot., datë 05.01.2021, ka paraqitur ankim administrativ ndaj vendimit për dënimin me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, ku ndër të tjera ka parashtruar se:

"...Pasi u njohëm me vendimin e AMA-s, nr. 6, datë 23.12.2020 për "Dënimin me gjobë të shoqërisë "C." sh.p.k., për subjektin ofrues të shërbimit mediatik audioviziv "C.", bëjmë me dije se: Në datë 09.11.2020, ju kemi nisur me anë të postës (kopje mandatit të postës bashkëngjitur) kopje të kontratës së shitblerjes dhe ekstraktin e marrë në Q.K.B., me ndryshimet e bëra. Në dijeninë tonë ky ishte edhe njoftimi që duhet të bënim, pra mundet që të nevojitej që të bënim edhe hapa të tjerë apo të zgjidhnim mënyrë tjetër dhe kjo ju jep të drejtë të gjykoni se ne kemi bërë një shkelje administrative, por duke qenë se jemi të rinj në këtë fushë nuk e kemi informacionin e mjaftueshëm dhe në fillim të punës janë lapsuse që mund të ndodhin.

Duke patur parasysh të gjitha sa ju vumë në dijeni më lart por edhe kushtet tona si subjekt që ende jemi në fazën e investimeve dhe një gjobë e tillë do të na dëmtonte mjaft, kërkojmë nga ju që edhe në kuadrin e partneritetit të anuloni vendimin nr. 6, datë 23.12.2020 për dënimin me gjobë të subjektit tonë".

Në lidhje me sa parashtrohet në ankimin administrativ, bëjmë me dije se pranë AMA me shkresën administruar me nr. 3182 protokoli, datë 10 nëntor 2020, subjekti ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me licencë transmetimi audio lokale në qarkun Gjirokastrë, pa identifikuar në kërkesë ndryshimet e ndodhura në të dhënat e subjektit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur kësaj kërkesë, AMA konstaton se subjekti bashkëlidhur ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, të datës 06 nëntor 2020 si dhe kopje të kontratës noteriale të kalimit të kuotave.

AMA vëren se subjekti në shkresën e sipërcituar formalisht nuk ka kërkuar miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë, por duke qenë se bashkëlidhur kërkesës për marrje licence ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, dokument ku janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura, ankimi administrativ i subjektit është i pranueshëm.

Sa më sipër, AMA e gjeti të bazuar ankimin e shoqërisë "C." sh.p.k

dhe me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021 vendosi:

- Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, të vendosur ndaj shoqërisë "C." sh.p.k., licencuar për subjektin "T.C.".

Konstatime:

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar pretendimet e tij në ankim lidhen me mungesën e informacionit në lidhje me këtë detyrim. Nëse për çdo masë administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e mosdhënies së informacionit. **Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në ligj dhe në prova vlera 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë do të konsiderohet si efekt negativ financiar.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Gjatë vitit 2021, AMA ka ndëshkuar 2 subjekte për kundërvajtjen administrative, “Mosnjofitim i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e licencës/autorizimit”, me sanksion gjobë:

- Nr. 1, datë 02.03.2021, vendosur ndaj **shoqërisë “R.-O.” sh.p.k.**, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP, O., në masën 120,000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 50, datë 26.03.2021.
- Nr. 2, datë 02.03.2021 vendosur ndaj **shoqërisë “S.K.” sh.p.k.**, për subjektin “S.K.”, në masën 120, 000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 41, datë 11.03.2021.
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe funksioneve ligjore, me qëllim verifikimin e respektimit të parashikimeve ligjore në fushën e mediave audiovizive, ka kryer kontrollin në faqen zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), nga i cili është konstatuar se subjekti “R.-O.” sh.p.k. ka bërë ndryshime në strukturën e pronësisë së shoqërisë.

Konkretisht, struktura e pronësisë së shoqërisë “R.-O.” sh.p.k., e miratuar nga AMA është: L.V. (admin), me 17% të kuotave; R.Ç., me 16,6% të kuotave; A.B., me 16,6 % të kuotave; E.I., me 16,6 % të kuotave; A.U., me 16,6 % të kuotave; K.K., me 16,6 % të kuotave.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesat për marrjen e autorizimit, brenda afatit 30 ditor nga data e kryerjes së tyre si dhe të kërkojë miratimin nga AMA.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 133, pikat 2 dhe 10 të ligjit nr. 97/2013 të sipërcituar, si dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria Juridike dhe e Licencave ka proceduar me marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nr. 1 datë 02.03.2021, në masën 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë.

Në vijim, shoqëria “R.-O.” sh.p.k., me shkresën e datës 09.03.2021, administruar pranë AMA-s me nr. 1047/2 prot., datë 09.03.2021, ka paraqitur ankim administrativ ndaj vendimit për dënimin me gjobë nr. 1, datë 02.03.2021, ku ndër të tjera ka parashtruar se:

“...Në shkresën nr. 1047/1 prot., datë 02.03.2021, na komunikoni një masë administrative prej 120,000 lekësh, për shkak se nuk ju kemi dërguar informacionin e plotë për ndryshimet në Q.K.B., të ortakëve të shoqërisë “R.-O.” sh.p.k., duke argumentuar shkeljet ligjore që paskemi bërë. Ju informojmë se shoqëria që nga krijimi i saj deri në këto momente nuk ka funksionuar normalisht, për shumë arsye, midis tyre dhe tërheqja e disa ortakëve, me dëshirën e tyre, për mospërmblidhje të detyrimeve, ndaj shoqërisë. Kjo ka çuar në dhurimin e kuotave, tek ortakët ekzistues. Shkaku i mosinformimit të AMA-s për ndryshimet, nuk është as papërgjegjshmëria, as dëshira për të shkelur ligjin, por një gabim njerëzor, pasi duke patur papasys një person që ndjek veprimtarinë ligjore të shoqërisë, nuk e ka bërë këtë duke qenë i sëmurë, dhe ka më se 2 muaj që ndodhet për kurim jashtë shtetit.

Drejtoria Juridike propozoi lënien në fuqi të sanksionit me gjobë.

Organi kolegjal, AMA me vendimin nr. 50, datë 26.03.2021, vendosi:

Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 1, datë 02.03.2021, në masën 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë, vendosur ndaj shoqërisë “R.-O.” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Me arsyetimin si më poshtë:

AMA vëren se subjekti është autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në OTT, me vendimin e AMA-s nr. 189, datë 19.12.2019.

AMA konstaton se subjekti, ashtu sikurse dhe dallohet qartë në kërkesë, subjekti ankues nuk shprehet për kundërligjshmërinë e sanksionit me gjobë, por mungesën e njoftimit për ndryshimet e ndodhura në pronësi e lidh me faktin e pamundësisë për shkak të sëmundjes prej 2 muaj të personit që ndjek veprimtarinë ligjore të shoqërisë. Megjithatë, AMA mban në konsideratë arsyet e parashtruara në ankim mbi vështirësitë me të cilat është hasur subjekti gjatë aktivitetit të tij.

Për gjithë sa më sipër, AMA vendosi pranimin e ankimit të shoqërisë “R.-O.” sh.p.k.

Konstatime:

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti, mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar disa pretendime të cilat nuk rezultojnë të provuara në dokumente. Gjithashtu e ka konsideruar një gabim njerëzor dhe si të tillë ka kërkuar pranimin. Nëse për çdo masë

administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e mosdhënies së informacionit. **Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në liqj dhe në prova vlera 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë do të konsiderohet si efekt negativ financiar.**

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe funksioneve ligjore, me qëllim verifikimin e respektimit të parashikimeve ligjore në fushën e mediave audiovizive, ka kryer kontrollin në faqen zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), nga i cili është konstatuar se subjekti “S.K.” sh.p.k. ka bërë ndryshime në strukturën e pronësisë së shoqërisë.

Konkretisht, struktura e pronësisë së shoqërisë “S.K.” sh.p.k., e miratuar nga AMA është: z. V. B., me 100% të kuotave. Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të QKB - së, rezulton se në datën 04.12.2020, është ndryshuar plotësisht struktura e pronësisë së shoqërisë dhe ortak i vetëm me 100% të kuotave është z. G.B.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesat për marrjen e autorizimit, brenda afatit 30 ditë nga data e kryerjes së tyre si dhe të kërkojë miratimin nga AMA.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 133, pikat 2 dhe 10 të ligjit nr. 97/2013 të sipërcituar, si dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria Juridike dhe e Licencave ka proceduar me marrjen e vendimit për dënimin me gjobë nr. 2 datë 02.03.2021, në masën 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë.

Në vijim, shoqëria “S.K.” sh.p.k., me shkresën e datës 03 mars 2021, administruar në AMA, me nr. 1048/2 prot., datë 03.03.2021, ka paraqitur ankim administrativ ndaj vendimit për dënimin me gjobë nr. 2, datë 02.03.2021, ku ndër të tjera ka parashtruar se:

“.. në bazë të shkresës që më ka ardhur kërkoj ndjesë se nga padituria që nuk kemi njohje me ligjin kërkoj që nga AMA të merret në konsideratë heqja e gjobës.”

Drejtoria Juridike propozoi lënien në fuqi të sanksionit me gjobë.

Organi kolegjal, AMA me vendimin nr. 41, datë 11.03.2021, vendosi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 2 datë 02.03.2021 në masën 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë, vendosur ndaj shoqërisë “S.K” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “T.K.S.”.

Me arsyetimin si më poshtë:

AMA vëren se, ashtu sikurse dhe dallohet qartë në kërkesë, subjekti ankues nuk shprehet për kundërligjshmërinë e sanksionit me gjobë, por mungesën e njoftimit për ndryshimet e ndodhura në pronësi e lidh me faktin se nuk ka dijeni për parashikimin ligjor që ngarkon subjektet me detyrimin për të njoftuar autoritetin rregullator.

AMA duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që subjekti pasi është njohur me sanksionin gjobë, ka depozituar kërkesë mbi dokumentacionin që nevojitet, në kuadër të procedimit administrativ për miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë, merr në konsideratë pretendimet e subjektit për shfuqizimin e sanksionit gjobë.

Konstatime:

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti, mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar pretendimet e tij në ankim lidhen me mosnjohjen e ligjit. Nëse për çdo masa administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e mosdhënies së informacionit. Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në ligj dhe në prova vlera 120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë do të konsiderohet si efekt negativ financiar.

Për vitin 2021, vlera e sanksioneve që duhet të ishte vjelur ka qenë në masën 240,000 lekë.

Gjatë vitit 2022, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 3 subjekte, nga të cilat 2 ndryshime janë miratuar nga AMA ndërsa 1 ndryshim është në proces (*pasi shoqëria “C.” sh.p.k., nuk kishte marrë dijeni dhe shkresa është kthyer pas nga shërbime postar. Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për hetimin administrativ të AMA-s në muajin tetor 2022*). Ndërkohë, 9 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, të cilat janë miratuar nga Autoriteti. Nuk është sanksionuar asnjë subjekt për vitin 2022, deri në muajin korrik 2022.

Konstatime:

Vlera prej 1.360.000 lekë që rrjedh prej masave administrative të marra, në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, do të konsiderohen efekt negativ financiar. Mosdijeni në raport me detyrim për të dhënë informacion, që rrjedh prej dispozitave ligjore, si dhe fakti se subjektet e justifikojnë me pretendimin se janë të ri në treg, nuk mund të jetë shkak për mosaplikimin e gjobës. Këto pretendime AMA mund ti konsideronte, në raport me vlerën që do të aplikohet për gjobën, sipas shkronjës (d) të pikës 2 të nenit 133 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke qenë se kjo dispozitë parashikon masën e gjobës nga 120.000 deri në 2.000.000 lekë, AMA ashtu siç ka vepruar Drejtoria Juridike dhe e Licencave mund të aplikonte masën minimale. Duke qenë se ligji parashikon qartë masën që duhet të aplikohet nëse provohet fakti i mungesës së njoftimit për ndryshimet në pronësi, arsyetimi i përdorur nga AMA gjatë vendimarrjes për shqyrtimin e ankimit administrativ është i pabazuar në ligj.

Nga auditimi ka rezultuar se AMA, në lidhje me aktet që u kërkon subjekteve, gjatë shqyrtimit të kërkesave për ndryshimet në pronësi, i referohet dispozitave të nenit 56 dhe 61



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat kanë të bëjnë me kërkesat e aplikimit për licencë nga subjektet.

Procedurat e ndryshimeve në pronësi, konsistojnë në dy forma:

- ndryshime në pronësi brenda të njëjtës shoqëri,
- kalim të drejtash pronësie nga një shoqëri në një shoqëri tjetër.

Ndryshimet në pronësi brenda të njëjtës shoqëri nuk konsiderohet si procedurë për dhënie licence sipas përcaktimeve të nenit 56 dhe 61 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar të cilat kanë të bëjnë me aplikime fillestare për dhënie licence. Kjo pasi subjekti i licencuar (shoqëria) vazhdon të mbetet e njëjtë me atë që ka bërë aplikimin fillestar. Në këto kushte AMA nuk mund ti referohet me analogji neneve 56 dhe 61 të ligjit, në kushtet kur nuk jemi përpara dhënies së licencave, pasi licenca mbetet e të njëjtës shoqëri.

Kalimi i të drejtave të pronësisë nga një shoqëri në një shoqëri tjetër, rregullohet, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet që:

“Licencat dhe/ose autorizimet dhe çdo e drejtë apo detyrim i lidhur me to nuk mund të transferohet. Në rast se mbajtësi i licencës dhe/ose autorizimit, hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e licencuar/autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca dhe/ose autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence dhe/ose autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje. Kur AMA nuk e miraton kalimin, për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, licenca dhe/ose autorizimi bëhet e/i pavlefshëm.”

Pra, ky rast është rregulluar qartë nga përcaktimet e dispozitave ligjore, në kushtet kur licenca është transferuar.

Rregulloret e miratuara nga AMA, konkretisht:

- Vendimi nr. 153, datë 18.07.2016, *Për miratimin e Rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave të transmetimit audio”*, e ndryshuar, me Vendimin nr. 232, datë 03.11.2016 dhe Vendimin nr. 192, datë 06.10.2017 të AMA-s;
- Vendimi nr. 2, datë 16.01.2020, *Për miratimin e Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”*;
- Vendimi nr. 55, datë 04.04.2016 *Për miratimin e Rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave të transmetimit audio të komunitetit”*.

Nuk rregullojnë në përmbajtje të tyre procedurën dhe kërkesat që duhet të ndiqen nga AMA, në raport me rastet e kërkesave për miratim të ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri. Mungesa e rregullimeve nëpërmjet akteve nënligjore, ka sjell referime subjektive në zhvillimin e këtyre procedurave duke passjell edhe risk në ligjshmërinë e procedurave për miratimin e kërkesave për ndryshim në pronësi.

Republika e Maqedonisë së Veriut në lidhje me ndryshimet në pronësi, në zbatim të përcaktimeve të ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, ka miratuar “Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronarëve”. Nëpërmjet kësaj rregullore është përcaktuar qartë procedurat që duhen ndjekur nga radiodifuzerët (OSHMA) në rastet e njoftimeve të ndryshimeve të strukturës së pronarëve dhe dokumentet që duhen bashkëlidhur me aktin e njoftimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes:	Shfuqizim i pabazuar në ligj i masave administrative “gjoba”. Mungesa e një akti nënligjor në lidhje me kërkesat për ndryshimet në pronësi.
Situata:	Vlera prej 1.360.000 lekë që rjedh prej masave administrative të marra, në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, do të konsiderohen efekt negativ financiar. Mosdijeni në raport me detyrim për të dhënë informacion, që rjedh prej dispozitave ligjore, si dhe fakti se subjektet e justifikojnë me pretendimin se janë të ri në treg, nuk mund të jetë shkak për mosaplikimin e gjobës. Këto pretendime AMA mund t’i konsideronte, në raport me vlerën që do të aplikohet për gjobën, sipas shkronjës (d) të pikës 2 të nenit 133 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke qenë se kjo dispozitë parashikon masën e gjobës nga 120.000 deri në 2.000.000 lekë, AMA ashtu siç ka vepruar Drejtoria Juridike dhe e Licencave mund të aplikonte masën minimale. Duke qenë se ligji parashikon qartë masën që duhet të aplikohet nëse provohet fakti i mungesës së njoftimit për ndryshimet në pronësi, arsyetimi i perdorur nga AMA gjatë vendimarrjes për shqyrtimin e ankimit administrativ është i pabazuar në ligj. Aktet nënligjore nuk rregullojnë në përmbajtje të tyre procedurën dhe kërkesat që duhet të ndiqen nga AMA, në raport me rastet e kërkesave për miratim të ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri. Mungesa e rregullimeve nëpërmjet akteve nënligjore, ka sjell referime subjektive në zhvillimin e këtyre procedurave duke passjell edhe risk në ligjshmërinë e procedurave për miratimin e kërkesave për ndryshim në pronësi.
Kriteri:	<i>Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”</i>
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e arkëtimit të vlerës 1.360.000 lekë si pasojë e pranimi të ankimeve në lidhje me sanksionet e vendosura për shkelje të përcaktimeve ligjore nga OSHMA, e cila konsiderohet dëm ekonomik. Risk në ligjshmërinë e proceseve administrative në rastet e ndryshimeve në pronësi në kushtet kur kërkohen informacione të pabazuar në aktet ligjore.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi;
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AMA në shqyrtimet e ankimeve administrative mbi masat administrative ndaj OSHMA të mbështetet në dispozitat ligjore dhe të tregoj objektivitet në shqyrtimin e tyre. AMA të ndërmarrë nismën për miratimin e një akti nënligjor për rastet e ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri.



II. APLIKIMET PËR MARRJE/ RINOVIM AUTORIZIMI PËR VITET 2019-2022

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon që ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe audiovizive që mbështeten në rrjete kablllore, satelitore dhe shërbim online bëhet me autorizim të AMA-s, pa konkurrim, mbi bazën e kërkesës.

Duke qenë se subjektet që pajisen me autorizim, nuk shfrytëzojnë pasuri natyrore të fundme, edhe pajisja e tyre me këtë autorizim nuk i nënshtrohet procesit të konkurrimit, pra garës publike, por merret thjesht me kërkesë duke plotësuar aplikimin në përputhje me kriteret e miratuara nga autoriteti rregullator, AMA.

Procedura e pajisjes me autorizim rregullohet në nenin 64 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar:

“Autorizimi u jepet mbi bazën e kërkesës, subjekteve që plotësojnë kërkesat e këtij ligji lidhur me programet audio dhe audiovizive. Autorizimi jepet pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga AMA me rregullore të veçantë. Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së plotësuar. Refuzimi i aplikimit bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Nëse AMA nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, nga data e marrjes së aplikimit të plotë, autorizimi konsiderohet i miratuar. Autorizimi jepet për një afat 5-vjeçar me të drejtë rinovimi.”

Në zbatim të ligjit, AMA me Vendimin nr. 99, datë 07.06.2017, ka miratuar rregulloren “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”.

Po ashtu, AMA ka miratuar me Vendimin nr. 152, datë 11.10.2019, ka miratuar rregulloren “Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit dhe me Vendimin nr. 184, datë 08.10.2022 rregulloren “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve për përdorimin e brezit të frekuencave HF për ofrimin e shërbimit audio”.

• Aplikimi i shoqërisë “O.S.” SH.P.K., për marrje autorizimi

Në nenin 55 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen llojet e licencave dhe autorizimeve që jep AMA dhe afatet e tyre.

Po ashtu, AMA me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017, ka miratuar rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave për dhënien e autorizimeve dhe afatet e tyre.

Në nenin 3 të këtij akti nënligjor përcaktohet se:

“Aplikuesi për autorizim për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të depozitojë pranë AMA aplikimin në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore. Aplikimi përbëhet nga formulari i aplikimit dhe dokumentacioni shoqërues.”

Shoqëria “O.S.” sh.p.k., ka depozituar pranë AMA-s, aplikimin me nr. 3229 prot., datë 01.10.2021, dhe dokumentacionin plotësues nr. 3229/3 prot., datë 08.11.2021 dhe **nr. 3702/1 prot., datë 06.12.2021**, për marrjen e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet IP, “O.S.”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhreve nr. 227, datë 05.10.2021, nr. 260, datë 11.11.2021 dhe nr. 278, datë 10.12.2021, të Kryetarit të AMA-s, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “O.S.” sh.p.k.

KSHD, vlerësoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “O.S.” sh.p.k., i plotëson kriteret juridike, financiare, të së drejtës së transmetimit, programore, teknike dhe organizative, për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet IP .
2. KSHD, vlerëson se, aplikimi i shoqërisë “O. S.” sh.p.k., për marrje autorizimi, për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet IP (OTT), në kushtet kur AMA nuk mund të vendosë me akt administrativ për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm, konsiderohet i miratuar.

Në nenin 19, pika 1, germa “b” të ligjit të sipërcituar, parashikohet se AMA lëshon autorizimet me shumicë të cilësuar, shumicë e cila nuk mund të arrihej në kushtet kur AMA ushtronte aktivitetin me 4 anëtarë.

Nga ana tjetër, ligji i posaçëm, në nenin 64 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon: “5. Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së plotësuar. Refuzimi i aplikimit bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Nëse AMA nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, nga data e marrjes së aplikimit të plotë, autorizimi konsiderohet i miratuar”.

AMA, me shkresën nr. 16, datë 05.01.2022, njoftoi subjektin se:

Aplikimi i shoqërisë “O.S.” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet IP (OTT), në kushtet kur AMA nuk mund të vendoste me akt administrativ për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm, është konsideruar i miratuar, prej datës 05.01.2022.

Mungesa e kuorumit ka ardhur si pasojë e mungesës së numrit të plotë të anëtarëve të AMA, pasi 2 vende të anëtarëve të AMA kanë qenë vakante. Në këto kushte në zbatim të përcaktimeve të nenit 64 të ligjit nr. 97/2013, autorizimi është konsideruar i miratuar, në kushtet kur ka kaluar afati 30 ditësh nga momenti i marrjes së kërkesës së plotësuar.

- **Aplikimi i shoqërisë “T.O.” SH.P.K., për marrje autorizimi**

Shoqëria “T.O.” sh.p.k., ka depozituar pranë AMA-s, aplikimin me nr. 3073 prot., datë 17.09.2021, dhe dokumentacionin plotësues nr. 3073/2 prot., datë 12.10.2021, për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “T.O.”, në Bashkinë Patos, Njësitë administrative Kashar dhe Kamëz.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhreve nr. 217, datë 21.09.2021 dhe nr. 233, datë 14.10.2021, të Kryetarit të AMA-s, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “T.O.” sh.p.k.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

KSHD, vlerësoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “T.O.” sh.p.k., i plotëson kriteret juridike, financiare, teknike, programore, të së drejtës së transmetimit dhe organizative, për marrjen e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “T.O.”, në “Bashkinë Patos, Njësitë administrative Kashar dhe Kamëz”.
2. KSHD, vlerëson se, aplikimi i shoqërisë “T.O.” sh.p.k., për marrje autorizimi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor kabllor “T.O.”, në kushtet kur AMA nuk mund të vendosë me akt administrativ për shkak të mungesës së kuorimit të nevojshëm, konsiderohet i miratuar.

Në nenin 19, pika 1, germa “b” të ligjit të sipërcituar, parashikohet se AMA lëshon autorizimet me shumicë të cilësuar, shumicë e cila nuk mund të arrihej në kushtet kur AMA ushtronte aktivitetin me 4 anëtarë.

AMA, me shkresën **nr. 3073/4, datë 10.11.2021**, njoftoi subjektin se:

Aplikimi i shoqërisë “T.O.” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “T.O.”, në Bashkinë Patos, Njësitë administrative Kashar dhe Kamëz, në kushtet kur AMA nuk mund të vendosë me akt administrativ për shkak të mungesës së kuorimit të nevojshëm, konsiderohet i miratuar, prej datës 10.11.2021.

Mungesa e kuorimit ka ardhur si pasojë e mungesës së numrit të plotë të anëtarëve të AMA, pasi 2 vende të anëtarëve të AMA kanë qenë vakante. Në këto kushte në zbatim të përcaktimeve të nenit 64 të ligjit nr. 97/2013, autorizimi është konsideruar i miratuar, në kushtet kur ka kaluar afati 30 ditë nga momenti i marrjes së kërkesës së plotësuar.

- **Aplikimi i shoqërisë “M.” SH.P.K., për marrje autorizimi**

Shoqëria “M.” sh.p.k., ka depozituar pranë AMA-s, aplikimin me nr. 2373/1 prot., datë 01.07.2021, dhe dokumentacionin plotësues me nr. 3772 prot., datë 01.12.2021 dhe **nr. 3772/3 prot., datë 29.12.2021**, për zëvendësimin e licencës për transmetime analoge “T.B.”, me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrave nr. 278, datë 10.12.2021 dhe nr. 11, datë 13.01.2022, të Kryetarit të AMA-s, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “M.” sh.p.k.

KSHD, vlerësoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “M.” sh.p.k., i plotëson kriteret juridike, financiare, të së drejtës së transmetimit, programore, teknike dhe organizative, për zëvendësimin e licencës për transmetime analoge “T.B.”, me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor.
2. KSHD, i propozon AMA-s, dhënien e autorizimit, shoqërisë “M.” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, me karakter të përgjithshëm, mbështetur në rrjet kabllor “T. B.” për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

AMA, me vendimin nr. 31, datë 08.04.2022, vendosi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

1. Pranimin e aplikimit të shoqërisë “M.” sh.p.k., me NIPT: K76..... dhe administrator z. E.I., duke vendosur dhënien e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, me karakter të përgjithshëm, mbështetur në rrjet kabllor “T.B.” për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Konstatime:

Nga auditimi konstatohet se AMA ka aplikuar një standard të dyfishtë në shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e autorizimeve. Në rastin e aplikimit të Shoqërisë “O.S” sh.p.k, AMA, me shpresë e ka konsideruar të miratuar aplikimin pa vendimmarrje, në kushtet e mungesës së kuomit. Në rastin e aplikimit të Shoqërisë “M.” sh.p.k, AMA ka marr vendim edhe pse kanë kaluar 100 ditë nga dorëzimi i aplikimit të plotësuar, në shkelje të përcaktimeve të nenit 64 të ligjit nr. 97/2013, i cili parashikon afatin maksimal 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jasht afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.

- **Aplikimi i shoqërisë “R.T.S.S.” SH.P.K., për rinovimin e autorizimeve**

Shoqëria “R.T.S.S.” sh.p.k., ka depozituar pranë AMA-s, aplikimin me nr. 1970 prot., datë 17.05.2021 dhe dokumentacionin plotësues me nr. 1970/3 prot., datë 01.07.2021, për rinovimin e autorizimeve për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet “ST.” dhe “ST.F.”.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrave nr. 138, datë 20.05.2021 dhe nr. 163, datë 02.07.2021, të Kryetarit të AMA-s, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “R.T.S.S.” sh.p.k.

KSHD, vlerësoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “R.T.S.S.” sh.p.k., i plotëson kriteret juridike, financiare, të së drejtës së transmetimit, programore, teknike dhe organizative, për rinovimin e autorizimeve për ofrimin e shërbimeve të programit audioviziv mbështetur në internet “ST.” dhe “ST.F.”.
2. KSHD, bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore i propozon Kryetarit të AMA-s, njoftimin e subjektit, shoqërisë “R.T.S.S.” sh.p.k., për mungesën e kuoromit të nevojshëm ligjor për vendimmarrjen - rinovim autorizimi.

Ne vijim subjekti është njoftuar nga AMA për mungesën e kuoromit dhe se vendimi për rinovimin e autorizimeve do të merret në një kohë të dytë, me plotësimin e trupës kolegjiale.

AMA, me plotësimin e kuoromit të nevojshëm ligjor me Vendimin nr. 35, datë 19.04.2022, vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “R.T.S.S.” sh.p.k., me NIPT: dhe administrator zj. D.H.C., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, tematik muzikor, online mbështetur në internet “ST.”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Konstatime:

Edhe në këtë rast, duke aplikuar një standard të dyfishtë, AMA ka marr vendim edhe pse kanë kaluar 323 ditë nga dorëzimi i aplikimit të plotësuar, në shkelje të përcaktimeve të nenit 64 të ligjit nr. 97/2013, i cili parashikon afatin maksimal 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jashtë afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.

- **Aplikimi i shoqërisë “NE.” SH.P.K., për zgjerim zone**

Shoqëria “N” sh.p.k., ka depozituar pranë AMA-s, aplikimin me nr. 4110 prot., datë 29.12.2021 dhe shtojcë dokumentacioni me nr. 490, datë 27.01.2022, për zgjerim zone në “Qarkun Lezhë (Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin), Bashkitë Pukë dhe Fushë-Arrëz”.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrave nr. 11, datë 13.01.2022 dhe **nr. 27, datë 28.01.2022**, të Kryetarit të AMA-s, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “N” sh.p.k.

KSHD, vlerësoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “N” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “T.K.N.”, i plotëson kriteret juridike, të së drejtës së transmetimit, programore, teknike dhe organizative për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.
2. KSHD, i propozon AMA-s, zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, të shoqërisë “N.” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “T.K.N.”.

AMA, me **vendimin nr. 49, datë 09.05.2022**, vendosi:

1. Pranimin e aplikimit të shoqërisë “N” sh.p.k., me NIPT: dhe administrator D. B., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “N.T.” duke vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të këtij subjekti, në “Qarkun Lezhë, Bashkitë Pukë dhe Fushë-Arrëz”.
2. Zona e ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Ne.” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “N.T.”, ndryshon nga “Njësitë administrative Lezhë, Pukë dhe Fushë Arrëz” në “Qarku Lezhë, Bashkitë Pukë dhe Fushë-Arrëz”.

Nëpërmjet shkresës nr. prot. 1604, datë 20.04.2023, AMA ka paraqitur observacion në lidhje me projekt raportin, si më poshtë:

Ashtu sikurse kemi sqaruar edhe në observimin tonë në akt-konstatim, gjejkojmë se AMA ka zbatuar plotësisht kërkesat që parashikon kuadri ligjor në fuqi.

Kuadri rregullator për lëshimin e autorizimeve është i ndryshëm nga ai i rinovimit të autorizimeve. Autorizimi për ushtrimin e veprimtarisë audiovizive u jepet subjekteve mbi bazën e kërkesës së tyre kur këto plotësojnë kërkesat e ligjit të posaçëm lidhur me programet audio dhe audiovizive.

Në paragrafin vijues, në pikën 7 të nenit 64 të ligjit parashikohet e drejta e Autoritetit të Mediave Audiovizive për të ripërsëritur autorizimin. Në këtë paragraf përcaktohet se AMA mund të rinovojë këtë autorizim në bazë të plotësimit të kushteve të mësipërme dhe sipas procedurave të vendosura paraprakisht prej saj.

AMA me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 ka miratuar rregulloren “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”. Në këtë akt përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien dhe rinovimin e autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive si dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audiovizive të të tretëve, në rrjete të komunikimeve elektronike të ndryshme nga ato tokësore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në nenin 10 të rregullores së sipërcituar përcaktohet se gjatë shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e autorizimit, **AMA verifikon paraprakisht respektimin e kushteve teknike, financiare, programore etj të subjektit aplikues për periudhën gjatë të cilës ka ushtruar aktivitet.** Pikërisht këto kërkesa e ndryshojnë statusin ligjor të një subjekti i cili ka ushtruar aktivitet audio/audioviziv nga një subjekt i cili kërkon që për herë të parë të hyjë në tregun audioviziv. Në rastin kur një subjekt është kundërvajtës recidivist për një ose më shumë kundërvajtje administrative, atëherë AMA ka të drejtë të vendosë mosrinovimin e autorizimit, duke i hequr të drejtën për ushtrim aktiviteti audioviziv, një subjekti që ka ushtruar aktivitet në shkelje të ligjit të posaçëm.

AMA është organ i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe e ushtron veprimtarinë vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale, që nënkupton se në rastet e shqyrtimit të çështjeve të përfshira në rendin e ditës, secili anëtar voton sipas bindjes së tij dhe vendimet miratohen me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës me përjashtim të vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar.

Deri në datën 17 shkurt 2022, kur është plotësuar trupa kolegjiale vendimmarrëse e AMA-s, autoriteti e ka ushtruar aktivitetin me 4 anëtarë, duke qenë në kushtet e mungesës së kuorumit të nevojshëm për vendimmarrjet që kërkojnë shumicë të cilësuar, sikurse është rasti i aplikimeve për marrje autorizimi.

Me plotësimin e trupës kolegjiale, aplikimet për marrjen e autorizimeve u janë përcjellë për vendimmarrje anëtarëve të organit kolegjial, si organi i cili ushtron aktivitetin e tij administrativ përmes vendimmarrjeve administrative në bazë të ligjit. Në rast se nga ana jonë do të aplikohet miratimi në heshtje për të gjithë aplikimet, edhe kur AMA është me anëtarësi të plotë, do të ishim para devijimit dhe shmangies të kompetencave dhe tagrave të AMA-s, si organ kolegjial vendimmarrës.

Në këtë rast, Kryetari i AMA-s, (i cili konfirmon me shkresë marrjen e autorizimit) në mënyrë të padrejtë do të ishte në pozitë të privilegjuar dhe në kushtet e ushtrimit të pushtetit në tejkallim të kompetencave, për sa ligji njeh si organ vendimmarrës, bordin e AMA-s, pra organin kolegjial.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi se kuadri rregullator për lëshimin e autorizimeve është i ndryshëm nga ai i rinovimit të autorizimeve, është i pabazuar në ligj në kushtet kur nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore dhe në këto kushte çdo rinovimi për autorizim është në fakt dhënie autorizimi. Rregullorja e përmendur në observacion lidhet me kushtet që duhet të përmbush subjekti për rinovimin, por procedura e vlerësimit duhet të jetë duke respektuar afate ligjore. Procedura e ndjekur në lidhje me vendimmarrjen në tejkallim të afatit 30 ditor nuk mbështet në asnjë dispozitë ligjore. Mungesa e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje, pavarësisht se nuk është përgjegjësi e AMA, nuk mund të shërbejë si justifikim për vendimmarrjet në tejkallim të afateve ligjore.

Për sa trajtuar më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë.**

Konstatime:

Edhe në këtë rast, duke aplikuar një standard të dyfishtë, AMA ka marrë vendim edhe pse kanë kaluar 101 ditë nga dorëzimi i aplikimit të plotësuar, në shkelje të përcaktimeve të nenit 64, të ligjit nr. 97/2013, i cili parashikon afatin maksimal 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jashtë afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Titulli i Gjetjes:	Mbledhje dhe vendimmarrje të panevojshme të AMA në rastet e autorizimeve dhe rinovimeve të autorizimeve.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se AMA ka aplikuar një standard të dyfishtë në shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e autorizimeve dhe kërkesave për rinovim të autorizimeve. Në rastin e kërkesave për marrje autorizimi në mungesë të kuroumit AMA i ka konsideruar të miratuara pas kalimit të afatit 30 ditor, sipas përcaktimeve ligjore. Në rastin e aplikimeve për rinovim autorizimi ka marr vendim pas kalimit të afatit 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jashtë afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.
Kriteri:	<i>Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”</i>
Ndikimi/Efekti:	Risk në ligjshmërinë e procedurave administrative në rastet e aplikimeve për rinovim autorizimi në kushtet e mungesës së kuorumit për vendimmarrje nga ana e AMA. Kërkesa të pabazuara ligjore në lidhje me ndryshimet në pronësi brenda të njëjtës shoqëri.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi;
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	AMA të marr masat për shqyrtimet e aplikimeve brenda afateve ligjore dhe të mos ketë vendimmarrje në tejkalim të afateve ligjore.

III. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ANKESAVE DHE VEPRIIMTARIA E TIJ.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet:

1. Këshilli i Ankesave caktohet nga AMA me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3- vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.
2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.
3. Funksionet kryesore të Këshillit të Ankesave, në përmbushje të objektivit të punës së tij, janë:
 - a) të mbikëqyrë zbatimin e kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të dhe RTSH-ja, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - b) të shqyrtojnë ankesat, sipas neneve 51, 52 dhe 53 të këtij ligji.

Këshilli i Ankesave për periudhën objekt auditimi ka qenë i përbërë:

Janar 2019- Dhjetor 2021

- U.B. (Kryetar); 12.11.2018-12.11.2021
- I.F. (anëtar); 31.12.2018-31.12.2021
- E.K. (anëtar) 31.12.2018-31.12.2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

2022- dhe në vazhdim

- M.O.; 01.04.2022- dhe në vazhdim
- I.F.; 10.05.2022- dhe në vazhdim
- B. M.; 11.05.2022- dhe në vazhdim

Nga auditimi ka rezultuar se për një periudhë 4- mujore struktura e Këshillit të Ankesave ka qenë jo funksionale në kushtet kur anëtarëve ju ka mbaruar mandati. Duke qenë se procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave për periudhën 2019- 2022 është bërë në vitin 2018, periudhë e cila nuk ka qenë objekt i auditimit të KLSH, nuk është shqyrtuar, por është audituar veprimtaria e këtij organi. Në lidhje me procedurën e zhvilluar në vitin 2022 për përzgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ankesave, grupi i auditimit ka administruar të gjithë dokumentacionin në lidhje me këtë procedurë. Në lidhje me pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Ankesave, ka rezultuar se kanë paraqitur aplikimin zj. M.O., me shkresën nr. 1028, datë 07.03.2022 dhe z. U. B., me shkresën nr. 1086, datë 10.03.2022. Me Urdhrin nr. 76, datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e aplikimeve për pozicionin vakant të kryetarit të Këshillit të Ankesave në AMA. Me procesverbalin nr. 1150, datë 17.03.2022, grupi i punës ka vlerësuar se të dy aplikantët kualifikohen si kandidatë për vendin e Kryetarit të Këshillit të Ankesave, duke e paraqitur pranë bordit të AMA, me relacionin nr. 1150/1, datë 29.03.2022.

Me Vendimin nr. 18, datë 31.03.2022 AMA ka vendosur zgjedhjen e znj. M. O., si Kryetare të Këshillit të Ankesave.

Konstatime:

Referuar procesverbalit të bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pa numër dhe datë, rezulton se mungon nënshkrimi i Kryetarit dhe Sekretarit Teknik, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.199 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” ne nenin 16.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së procesverbalit nuk janë reflektuar qëndrimet e bordit në lidhje me arsyen e përzgjedhjes së kandidatit fituese, në raport me kandidatin tjetër.

Nga auditimi ka rezultuar se mungon një akt nënligjor në lidhje me aplikimin e kriterëve për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Ankesave. Në lidhje me kriteret e kërkuara AMA bazohet në një vendim të Bordit, përkatësisht Vendimi nr. 30, datë 16.04.2015, ku miratohet një relacion i Drejtorisë së Programeve në lidhje me kriteret e nevojshme.

Po kështu, ka rezultuar se nuk ka një sistem të qartë pikëzimi të vlerësimit të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Ankesave, gjatë zhvillimit të intervistave me gojë, kur ka 2 ose më shumë kandidatë të cilët kanë plotësuar kushtet e nevojshme për të kaluar në fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me veprimtarinë administrative të ushtruar nga Këshilli i Ankesave për periudhën objekt auditimi ka rezultuar që:

Në vitin 2019 KA ka administruar 93 ankesa

- ✓ 45% objekt/ fëmijët dhe të drejtat e tyre
- ✓ 42% objekt/ cënimin e dinjitetit dhe privatësisë
- ✓ 7% objekt/ komunikimet me natyrë tregtare
- ✓ 6% objekt të ndryshëm

Në 21 raste të shkeljes së detyrimeve të nenit 33 Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen operatorëve dhe në 6 raste i ka propozuar Bordit vendosjen e masës administrative “gjobë”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Në vitin 2020 KA ka administruar 123 ankesa

- ✓ 39 (32%) objekt/ shkeljen e të drejtave të fëmijëve
- ✓ 41 (33%) objekt/ shkeljen e të drejtave të njeriut, të etikës dhe moralit publik
- ✓ 19 (15%) jashtë objektit të AMA-s
- ✓ 2 (2%) objekt/ të drejtën e përgjigjes
- ✓ 2 (2%) objekt/ verifikim informacioni
- ✓ 20 (16%) objekt të ndryshëm

Në 36 raste të shkeljes së detyrimeve të nenit 33 Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen operatorëve dhe nuk ka propozuar në asnjë rast vendosjen e masës administrative “gjobë”.

Në vitin 2021 KA ka administruar 300 ankesa

- ✓ 35% objekt/ shkeljen e të drejtave të fëmijëve dhe privatësisë së tyre
- ✓ 31% objekt/ shkeljen e të drejtave të njeriut, etikës dhe moralit publik
- ✓ 11% jashtë objektit të punës së AMA-s
- ✓ 6% objekt/ të drejtën e përgjigjes
- ✓ 5% objekt/ verifikim informacioni
- ✓ 12% objekt të ndryshëm

Në 22 raste të shkeljes së detyrimeve të nenit 33 Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen operatorëve dhe nuk ka propozuar në asnjë rast vendosjen e masës administrative “gjobë”.

Në vitin 2022 KA ka administruar 310 ankesa

- ✓ 32 % me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- ✓ 38 % me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, etikës dhe moralit publik;
- ✓ 15 % rezultuan jashtë objektit të punës së AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ 2 % për të drejtën e përgjigjes;
- ✓ 13 % kishin objekt të ndryshëm.
- ✓ Në 14 raste të shkeljes së detyrimeve të nenit 33 Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen operatorëve dhe ka propozuar në 2 raste vendosjen e masës administrative “gjobë”.

Referuar akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Këshillit të Ankesave parashikohet që: Neni 20, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton që:

“2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

3. Funksionet kryesore të Këshillit të Ankesave, në përmbushje të objektit të punës së tij, janë: a) të mbikëqyrë zbatimin e kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të dhe RTSH-ja, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) të shqyrtojë ankesat, sipas neneve 51, 52 dhe 53 të këtij ligji.”

Neni 52 pika 4 e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton që:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

“Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s masat përkatëse. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.”

Sa më sipër, në përmbushje të objektit të punës dhe funksioneve të tij Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i ka përcaktuar detyrimin që në rast të evidentimit të shkeljeve, propozon AMA masat përkatëse.

Po kështu, referuar dispozitave ligjore konkretisht neni 132, pika 1e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet që:

Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, AMA vendos:

- a) gjobë;*
- b) pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;*
- c) reduktim të kohës së licencës dhe/ose autorizimit;*
- ç) heqje të licencës dhe/ose autorizimit.*

AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer.

Referuar dispozitave ligjore konkretisht neni 133, pika 1e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet që:

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

Me gjobë nga 40 000 deri në 400 000 lekë për rastet kur:

- a) nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga neni 33 i këtij ligji;*
- b) nuk zbaton afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve, sipas përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji.*

Në mbështetje të kësaj dispozite janë edhe parashikimet e Rregullores mbi procedurat e shqyrtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes, miratuar me Vendimin nr. 181, datë 11.09.2017 të AMA, neni 10 ku përcaktohet që:

“AMA pas shqyrtimit të propozimit të Këshillit të Ankesave, në rast se konstaton shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative dënon OSHMA-në me gjobë, në përputhje me parashikimet e nenit 133 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”

Sa më sipër, të gjitha aktet e sipërcituara, përcaktojnë qartë detyrimin e Këshillit të Ankesave të propozojë gjopa në lidhje me shkeljet e evidentuara. Referuar periudhës objekt auditimi ka rezultuar se në 93 raste të ankesave të trajtuara, në të cilat janë konstatuar shkelje të detyrimeve nga ana e OSHMA-ve, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me cënimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit, cënimin e të drejtave të fëmijëve, komunikime tregtare të ndaluara. Këshilli i Ankesave ka aplikuar si masë administrative “tërheqje vëmendje”, masë e cila nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Masa administrative “gjobë” është propozuar vetëm në 6 raste gjatë vitit 2019.

Vendimmarrje e Këshillit të Ankesave nëpërmjet “tërheqjes së vëmendjes” është në tejkalim të kompetencave ligjore të këtij organi, pasi çdo vendimmarrje e AMA, në raport me shkeljet e evidentuara nga Këshilli i Ankesave, i përket Bordit të AMA-s.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Po kështu, aplikimi i “apelit sensibilizues”, për subjektet cilët nga hetimi administrativ kanë rezultuar në shkelje të dispozitave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është i pabazuar në dispozita ligjore dhe në shkelje të përcaktimeve në lidhje me masat që duhet të aplikohen. Masat për përmirësim “apel sensibilizues”, janë sugjerime të cilat Këshilli i Ankesave ia paraqet AMA-s, pas anketimieve të publikut për problemet etike të programeve, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 20. Sa më sipër, nuk mund të aplikohet kurrësesi, ky standard i Këshilit të Ankesave në rast e trajtimit të ankesave.

Gjithashtu, evidentohet se subjektet që kanë qenë në shkelje të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të cilët është vendosur nga Këshilli i Ankesave “tërheqja e vëmendjes”, kanë qenë përsëritës në vazhdimësi gjatë periudhës objekt auditimi. Kështu dy prej OSHMA, i janë evidentuar shkelje përkatëse në 20 raste dhe 14 raste gjatë periudhës objekt auditimi. Ky fakt, do të ishte arsye për Këshillin e Ankesave për të propozuar jo vetëm aplikimin e gjobës si masë, por edhe përshkallëzimin e saj në raporte me rastet e përsëritura.

Në lidhje me veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshilit të Ankesave, sipas periudhave përkatëse përkatësisht z. U. B., znj M.O., znj. I. F., E. K. dhe B. M..

Nëpërmjet shkresës nr. prot. 1604, datë 20.04.2023 AMA ka paraqitur observacion në lidhje me projekt raportin, si më poshtë:

1. Mënyra e citimit të Observacionit tonë nr. 909/1 prot., datë 27.02.2023 ndaj Akt-Konstatimit tuaj nr. 4, datë 20.02.2023, si më poshtë:

“Aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes” është një praktikë prej vitit 2016 me synimin e edukimit ligjor të OSHMA dhe njëkohësisht pa vështirësuar zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive. KA nuk ka sanksionin qëllimin primar dhe as final të veprimtarisë së tyre. Aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes” ka rezultuar me impakt pozitiv, pasi ka ndikuar në rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjësisë ligjore të redaksive të OSHMA. Po kështu është standard i praktikës ndërkombëtare. Aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes”, nuk paraqet në vetvete, por përdoret si formë ndërgjegjësimi.” mosmarrja dhe e tij në konsideratë, në qëndrimin e poshtëcituar të grupit të auditimit: “Fakti se aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes” është praktikë prej vitit 2016 nuk mund të shërbejë si justifikim për faktin se është i pabazuar në ligj. Referuar përcaktimeve ligjore të cituara më sipër, KA ka rol propozues kur konstaton shkelje nga ana e OSHMA dhe nuk mund të ketë forma të tjera të ushtrimit të funksionit në rastet e shqyrtimit të ankesave. Po kështu është absurd pretendimi, se kjo formë joligjore ka pasur impakt pozitiv, në kushtet kur OSHMA, pas “tërheqjes së vazhdueshme të vëmendjes” kanë qenë përsëritës në shkeljet e detyrimeve na bën të mendojmë, se observacioni nuk është kuptuar.

Duket, se ekipi auditues e ka konsideruar dhe vlerësuar veprimtarinë mediatike audiovizive vetëm si aktivitet biznesi, pa marrë parasysh karakteristikat e saj dhe si e mirë publike (informim, edukim dhe argëtim për ndjekësit). Në kontaktet që kemi pasur me pjesëtarët e ekipit auditues gjatë periudhës së pranisë së tij në institucion, jemi përpjekur vazhdimisht t’u shpjegojmë këtë dimension të veçantë të medias në tërësi (përfshirë median audiovizive, e cila ishte në fokus të auditimit), por kjo për fat të keq nuk është konsideruar, ç’ka gjen reflektim edhe në gjetjet dhe rekomandimet e këtij projektraporti të paraqitur nga KLSH. Ndaj jemi të mendimit, se për karakteristikat specifike të veprimtarisë së AMA-s, fushës ku autoriteti operon sipas kërkesave ligjore, do të ishte dashur, që ekipi auditues të kishte në përbërje të tij dhe një ekspert të fushës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

medias, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, ashtu siç e parashikon edhe kuadri ligjor dhe nënligjor, që rregullojnë veprimtarinë e KLSH-së. Këtu kemi parasysh jo vetëm kërkesat e ligjit 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, (nenet 40 dhe 41), por dhe dy akte shumë të rëndësishme të miratuara nga KLSH, si “Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë”, (vendimi nr. 245, datë 29.12.2022 dhe “Manuali për auditimin financiar”, miratuar me vendim të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022, ku specifikisht theksohet, se: “Për auditimin duhet të planifikohen burime për fushat specifike të auditimit, përfshirja e anëtarëve të ekipit me përvojë të duhur për fushat me risk të lartë dhe përfshirja e ekspertëve në çështjet komplekse.” (“Manuali për auditimin financiar”, faqe 24).

2. “Tërheqja e vëmendjes” si paralajmërim, bazohet në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Kreu II “Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), neni 6 “Statusi i AMA-s”, pika 3), (Kreu II “Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), neni 18 “Objektivat e veprimtarisë së AMA-s”, pika 1/d), ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (Kreu II “Parime të Përgjithshme”, neni 10 “Parimi i dhënies së ndihmës aktive”, pika 1), (Kreu II “Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), neni 18 “Objektivat e veprimtarisë së AMA-s”, pika 1/d, 3/a).

3. “Tërheqja e vëmendjes”, siç aplikohet nga ana e Këshillit të Ankesave, nuk paraqet në vetvete “vendimmarrje” dhe as aplikim të masës administrative “tërheqje vëmendjeje”.

Togfjalëshi “tërheq vëmendjen” në shkresat e Këshillit të Ankesave përdoret si një hap “edukues/paralajmërues” - përputhur si me praktikën ndërkombëtare për edukimin ligjor të mediave, ashtu edhe me përgjegjësinë, që “Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.” (ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Kreu II “Parime të Përgjithshme”, neni 15 “Parimi i përgjegjësisë”).

4. AMA, si “autoritet rregullator” (Kreu II “Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), neni 6 “Statusi i AMA-s”, pika 1) dhe Këshilli i Ankesave, si pjesë integrale e tij, nuk e kanë sanksionin qëllim primar dhe as final të veprimtarisë së tyre.

5. Aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes” si paralajmërim ka gjegjëset e veta në praktikën ndërkombëtare. Shkëmbimet me kolegë nga autoritetet rregullatore të vendeve anëtare të BE-së, si p.sh. nga Sllovenia, Italia apo Holanda, kanë konfirmuar se mekanizmi i “tërheqjes së vëmendjes” aplikohet edhe atje si instrument paralajmërues për kujdesin që duhet treguar nga profesionistët. (bashkëlidhur gjeni referencat përkatëse)

6. Aplikimi i “tërheqjes së vëmendjes” si paralajmërim nuk është identifikuar si i pambështetur në ligj as nga Raporti i Auditimit të ushtruar në AMA në vitin 2017, me objekt kontrolli periudhën 01.01.2014 -31.12.2016, duke u konsideruar rrjedhimisht si pjesë e Fondit të Praktikave të Mira Administrative.

7. Anëtarët e Këshillit të Ankesave janë ekspertë në fushën e komunikimit dhe mediave audiovizive, por jo në fushën e jurisprudencës (ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Kreu II “Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), neni 20 “Këshilli i Ankesave”, pika 1, 4), ndaj veprimtaria e tyre mbështetet nga strukturat e tjera të AMA-s.

8. Koncepti i “përsëritjes” së shkeljes në rastin e produkteve audiovizive nuk mund të vlerësohet matematikisht, por duhet marrë parasysh specifika e produktit audioviziv në prodhim, shpërndarje dhe perceptim.

9. Çdo shkresë e Këshillit të Ankesave, përfshirë edhe ato me “tërheqje vëmendjeje” ka qenë rezultat konsultimi jo thjesht dhe vetëm brenda Këshillit të Ankesave, por dhe rezultat konsultimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

dhe koordinimi (me gojë ose/edhe me shkrim) dhe me strukturat e tjera të Autoritetit, që monitorojnë tregun, përmbajtjet audiovizive dhe ligjshmërinë e funksionimit të OSHMA-ve dhe ka dalë nga Autoriteti vetëm me shkresën përcjellëse (që presupozon miratim) të titullarit të institucionit, njëkohësisht kryetar i Bordit të AMA-s.

10. Apelet sensibilizuese – PA U EMËRTUAR SI TË TILLA – janë përdorur nga Këshilli i Ankesave VETËM në ato raste kur nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, por qasja editoriale mund të kishte qenë më e kujdesshme kundrejt temës apo targetit përkatës ose kur administrimi ka qenë i pamundur për shkak tejkalimi afatesh ligjore dhe pamundësi verifikimi të përmbajtjes audiovizive, megjithëse shqetësimi i ankesës ka qenë i justifikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në mënyrë të përsëritur përdoret si justifikim praktika ndërkombëtare. Nëse ligjvënësi do ta konsideroj si të nevojshme praktikën ndërkombëtare, do ta integronte në ligj. Përsa kohë ligji është i qartë me detyrat funksionale të Këshillit të Ankesave dhe me mënyrën e ushtrimit të tyre janë të pabazuara pretendimet e ngritura. Po kështu janë edhe pretendimet në lidhje me nevojën për specialist të fushës në procesin e auditimit. Auditimi i përputhshmërisë referuar standardeve ndërkombëtare dhe nenit 3 të ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në nenin 3 përcakton që: “*Auditim i përputhshmërisë*” nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, **mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord**. Pra kriteri që audituesi duhet të referohet në auditim është ligji dhe aktet nënligjore. Përsa kohë veprimtaria e KA është në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pretendimet janë të pabazuara në ligj. Për sa trajtuar më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**.

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e propozimeve për masa administrative në rastet e shkeljes së detyrimeve të nenit 33 të ligjit të AMA nga ana e OSHMA. Vendimmarrje në tejkalim të kompetencave ligjore të Këshillit të Ankesave.
Situata:	Referuar periudhës objekt auditimi ka rezultuar se në 93 raste të ankesave të trajtuara, në të cilat janë konstatuar shkelje të detyrimeve nga ana e OSHMA-ve, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me cënimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit, cënimin e të drejtave të fëmijëve, komunikime tregtare të ndaluara. Këshilli i Ankesave ka aplikuar si masë administrative “tërheqje vëmendje”, masë e cila nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Masa administrative “gjobë” është propozuar vetëm në 6 raste gjatë vitit 2019. Vendimmarrje e Këshillit të Ankesave nëpërmjet “tërheqjes së vëmendjes” është në tejkalim të kompetencave ligjore të këtij organi, pasi çdo vendimmarrje e AMA, në raport me shkeljet e evidentuara nga Këshilli i Ankesave, i përket Bordit të AMA-s.
Kriteri:	Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Rregullorja mbi procedurat e shqyrtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes, miratuar me Vendimin nr. 181, datë 11.09.2017 të AMA.
Ndikimi/Efekti:	Sanksione të munguara në rastet e shkeljeve të përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të AMA, nga ana e OSHMA. Mospërmbushje e detyrave kryesore të Këshillit të Ankesave si organ që shqyrton ankesa dhe monitoron respektimin e detyrimeve të nenit 33.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	Shkelje të vazhdueshme të OSHMA në respektimin e të drejtave të përcaktuara në nenin 33 dhe mungesë reflektimi.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi;
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	AMA të marr masat ligjore në rastet e evidentimit të shkeljeve në rastet e shqyrtimit të ankesave nga ana e Këshillit të Ankesave.

6.Auditimi mbi zbatimin e ligjmërisë për prokurimet me fondet publike për periudhën objekt auditimi.

Në zbatim të pikës nr.6 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

Për vitin 2019 në Autoritetin e Mediave Audiovizive janë realizuar procedurat e prokurimit, si më poshtë:

- A. Procedurë e Hapur – është kryer 1 procedurë prokurimi
Fondi limit i parashikuar - 8,122,333 lekë pa TVSH,
Vlera e Kontratës së lidhur - 7,960,000 pa TVSH
- B. Kërkesë për propozim- janë kryer 10 procedura prokurimi
Fondi limit i parashikuar - 29,547,778 lekë pa TVSH,
Vlera e Kontratave të lidhura - 26,754,411 lekë pa TVSH,

Për vitin 2020 në Autoritetin e Mediave Audiovizive janë realizuar procedurat e prokurimit, si më poshtë:

- A. Kërkesë për propozim- janë kryer 2 procedura prokurimi
Fondi limit i parashikuar – 4,884,742 lekë pa TVSH,
Vlera e Kontratave të lidhura – 4,737,282 lekë pa TVSH

Për vitin 2021 në Autoritetin e Mediave Audiovizive janë realizuar procedurat e prokurimit, si më poshtë:

- A. Kërkesë për propozim- janë kryer 3 procedura prokurimi
Fondi limit i parashikuar – 7,666,667 pa TVSH
Vlera e Kontratave të lidhura – 7,232,700 lekë pa TVSH

Për periudhën janar – qershor 2022 në Autoritetin e Mediave Audiovizive janë realizuar procedurat e prokurimit, si më poshtë:

- A. Procedurë e hapur e thjeshtuar- janë kryer 2 procedura prokurimi
Fondi limit i parashikuar – 6,224,798 pa TVSH,
Vlera e Kontratave të lidhura – 5,290,000 lekë pa TVSH

Në vijim janë procedurat e vlerësuara nga ana e audituesve të pavarur të KLSH-së dhe konstatohet sa vijon:

1.) Procedura e Prokurimit : “Sistem i qendëruar i monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit A. FM” me nr.REF 04368-01-21-2019

“Sistem i qendëruar i monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM”			
1. Urdhër Prokurimi nr.18, datë 10.01.2019 nr.164 prot Njësia e prokurimit	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.252, datë	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave,	Urdhri nr.18/1, datë 10.01.2019 nr.164/1 prot



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

: E.F. - juriste e sektorit të çështjeve juridike T.P. – përgjegjës në sektorin e inspektimeve G.N. – teknik në sektorin e monitorimit	03.10.2019 nr.3982 prot me përbërje: T.P. – përgjegjës në sektorin e inspektimeve G.N. – teknik në sektorin e monitorimit	me përbërje: E. L. - kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes Xh. N. – anëtare, specialiste në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave I. H. – anëtar, specialist në sektorin e inspektimeve
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8.320.000 (tetë milion e treqind e njëzet mijë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) TB shpk me NUIS K714..... me ofertë ekonomike 7.960.000 (shtatë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 360.000(treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 14.02.2019, ora 10.00 në www.app.gov.al	9.Burimi Financimit nga Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike B. El shpk me NUIS J61 (skualifikuar) TB shpk me NUIS K71
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.164/12 prot, datë 20.03.2019	Zbatimi i kontratës: Është ngritur komisioni me urdhrin nr.18/2 datë 04.04.2019, nr.164/16 për marjen në dorëzim me përbërje : A. K., I.H., SH.M. i cili ka marrë në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.164/18, datë 14.05.2019. Likujduar me urdhër transfertën e datës 14.05.2019	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.3513 prot, datë 22.08.2018, është hartuar kërkesa nga Drejtori i Mbikqyerjes për objektin e prokurimit të miratuar me vendimin nr.202 datë 24.12.2018 të Bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2019”.

Me urdhrin nr.252, datë 03.10.2018 nr.3982 prot është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Sistem i qendëruar i monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit A. FM” i përbërë:

T.P. – Përgjegjës në Sektorin e Inspektimeve

G.N. – Teknik në Sektorin e Monitorimit

Nga grupi i punës është hartuar përllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike. Përllogaritja e fondit limit sipas shkresës nr.3982/1 prot datë 19.10.2018 është bazuar në ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.18, datë 10.01.2019 nr.164 prot, me fond limit 8.320.000 (tetë milion e treqind e njëzet mijë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : procedurë e hapur, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E.F. - Juriste e Sektorit të Çështjeve Juridike

T.P. – Përgjegjës në Sektorin e Inspektimeve

G.N. – Teknik në Sektorin e Monitorimit

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.18/1, datë 10.01.2019 nr.164/1 prot me përbërje:

E.L. - Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

Xh.N. – anëtare, specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave

I. H. – anëtar, specialist në Sektorin e Inspektimeve

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.164/2 prot, datë 17.01.2019.

✓ Njoftimi i kontratës nr.164/3 prot datë 18.01.2019 nuk është miratuar nga zyrtari i publikimit për pasaktësi në përllogaritjen e datës së zhvillimit të procedurës nga ana e njësisë së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

prokurimit bazuar në udhëzimet teknike e APP-së referuar afateve të VKM nr.914 datë 29.12.2014 (i ndryshuar). Njësia e prokurimit me njoftimin e anulimit nr.164/5 datë 21.01.2019 ka anuluar procedurën në sistem duke e ringarkuar sërish nga fillimi. Njoftimi i kontratës nr.164/6 prot datë 21.01.2019 është publikuar në botimin e njoftimeve publike nr.4 datë 28.1.2019.

✓ Me shkresën nr.164/7 prot, datë 14.02.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 2 (dy) operatorë ekonomik: 1.B.E. me NUIS J61.... me ofertë ekonomike 43.815.084 lekë pa tvsh dhe 2. TB. shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 7.960.000 lekë pa tvsh.

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.164/8 datë 19.02.2019 duke kualifikuar vetëm TB. shpk me NUIS K71.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.164/9 prot, datë 27.02.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit.

✓ Njoftimi i fituesit nr.164/10 prot datë 27.02.2019 i hartuar nga juristi i njësisë së prokurimit përmban pasaktësi në nr.referencës së procedurës dhe nuk është miratuar nga zyrtari i publikimit të APP-së. Sërish është ngarkuar njoftimi i fituesit dhe është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.10 datë 11.03.2019.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.164/11 prot, datë 11.03.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues. Është nënshkruar kontrata me nr.164/12 prot, datë 20.03.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik TB...shpk me NUIS K71..... me vlerë 7.960.000 (shtatë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh e 9.552.000 (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë me tvsh dhe afat realizimi 2 (dy) muaj nga lidhja e kontratës. Me shkresën nr.164/14 prot, njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është botuar në faqen 465-466 në buletin e njoftimeve publike nr.13 datë 01.04.2019.

Me urdhrin nr.18/2 datë 04.04.2019, nr.164/16 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., I. H., Sh. M. i cili ka marrë në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.164/18 prot, datë 14.05.2019 sipas faturës nr.71 datë 13.05.2019.

2) Procedura e Prokurimit : “Shërbim për mirëmbajtjen e automjeteve” i ndarë në lote me nr.REF 23310-05-22-2019

Loti I “Shërbim për mirëmbajtjen e automjetit tip Hyundai Ix35” REF: 23316-05-22-2019

Loti II “Shërbim për mirëmbajtjen e automjetit tip Toyota Land Cruiser” REF:23322-05-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Shërbim për mirëmbajtjen e automjeteve		
1. Urdhër Prokurimi nr. 147/1, datë 22.05.2019 nr.2094/2 prot Njësia e prokurimit : T. P. – specialist në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave A.K. – përgjegjës në sektorin e administratës E. H. – specialist në sektorin TIK	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.147, datë 20.05.2019 nr.2094 prot me përbërje: T. P. – specialist në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave A. K. – përgjegjës në sektorin e administratës	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.147/2, datë 22.05.2019, nr.2094/3 prot me përbërje: E. Ç. – kryetar, përgjegjës në sektorin e inspektimeve A. B. – anëtar, përgjegjës në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave O. S. - anëtar, përgjegjës në sektorin e burimeve njerëzore
2. Lloji i procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim i ndarë në lote		
5.Fondi limit total (pa tvsh) 1,550,343(një milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e dyzet e tre) lekë Lot 1 709,794 (shtatëqind e nëntëmijë e	6. Oferta fituese (pa tvsh) “A.D.” NUIS K81..... (për të dy lotet) Loti 1 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Hyundai IX35 në masën 688.500 lekë pa	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 45,753



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë Lot II 840,549 (tetëqind e dyzet mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë	tvsh Loti 2 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Toyota Land Cruiser në masën 816.090 lekë pa tvsh	
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 10.06.2019	9. Burimi Financimit nga Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomikë a. "A.M." shpk NUIS L62..... (skualifikuar) b "A. D." NUIS K81.....
11. Ankimime Është paraqitur ankesa me nr.2244 prot, datë 28.05.2019 nga subjekti A.M.S.shpk mbi kriteret kualifikuese në dokumentet standarte të prokurimit	12. Përgjigje Ankesës nga AK AK me urdhrin nr.147/3, datë 28.05.2019 nr.2094/6 prot pezulloi procedurën, shqyrtoi ankesën e cila është pranuar pjesërisht dhe u realizuan nga NJP ndryshimet përkatëse sipas procesverbalit nr.2094/10 datë 30.05.2019.	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës: Janë nënshkruar kontratat respektive me nr.2094/21 prot, datë 30.07.2019 për lotin 1 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Hyundai IX35 në vlerën 826.199 (tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh si dhe nr.2094/22 datë 30.07.2019 Loti 2 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Toyota Land Cruiser në vlerën 979.308 (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetë) lekë me tvsh midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues "A. D." NUIS K81..... (për të dy lotet) me afat realizimi 12 muaj nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: Likujdimi është kryer me urdhër transfertën e datës 17.12.2019 në vlerën totale prej 200.054 lekë për faturimet nga kontraktuesi "A.D." NUIS K81..... (për të dy lotet) konkretisht fatura nr.414 datë 21.11.2019 në masën 111.004 lekë, fatura nr.416 datë 22.11.2019 në masën 89.050 lekë si dhe likujdimi me urdhër transfertën e datës 11.03.2020 në vlerën totale prej 599.032 lekë për faturimet nga kontraktuesi "A.D." NUIS K81..... (për të dy lotet), konkretisht fatura nr.95, datë 06.03.2020 në masën 274.900 lekë, si dhe fatura nr.96 datë 06.03.2020 në masën 324.132 lekë.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me urdhrin nr.147, datë 20.05.2019, nr.2094 prot është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: T. P.– specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave, A. K. – përgjegjës në Sektorin e Administratës.

Nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë specialist për një detajim të shërbimeve që ju nevojiten makinave.

Nga grupi i punës është hartuar përllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike sipas shkresës nr.2094/1 prot datë 21.05.2019.

Llogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. urdhri i prokurimit me nr.147/1, datë 22.05.2019, nr.2094/2 prot me fond limit total 1,550,343 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim me njësi prokurimi : T. P. – specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave, A. K. – përgjegjës në Sektorin e Administratës, E. H. – specialist në Sektorin TIK.

Me urdhrin nr.147/2, datë 22.05.2019, nr.2094/3 prot janë caktuar e anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave me me përbërje:

E. Ç. – kryetar, Përgjegjës në Sektorin e Inspektimeve

A. B. – anëtar, Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave

O. S. - anëtar, Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.2094/4, datë 22.05.2019 i cili përmban pasaktësi përsa i përket kriterit 2.3.1 në DST pasi i referohet bazës ligjore të gabuar konkretisht nenit 27 pika 4, e VKM nr.914, që flet për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

kontratat e mallrave ndërkohë objekti i prokurimit është shërbim dhe neni argumentues është neni 28 pika 3. Nuk argumentohen ligjërisht kriteret teknike të vendosura konform nenit 28, pika 2 e po këtij vendimi *”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

Është paraqitur ankesa me nr.2244 prot, datë 28.05.2019 nga subjekti “A.M.S.” shpk mbi kriteret kualifikuese në dokumentet standarte. Titullari i autoritetit kontraktor Sekretari i Përgjithshëm, me urdhrin nr.147/3, datë 28.05.2019, (nr.2094/6 prot) ka pezulluar procedurën dhe ka krijuar komisionin e shqyrtimit të ankesës. Komisioni shqyrtoi ankesën me procesverbalin nr.2094/7 prot, datë 30.05.2019 i cili vendosi pranimin e pjesshëm të ankesës dhe njësia e prokurimit realizoi ndryshimet përkatëse sipas procesverbalit nr.2094/10 datë 30.05.2019.

Me shkresën nr.2094/12, datë 10.06.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës ku janë paraqitur dy operatorë ekonomik: 1. “A. M.” shpk me NUIS L62..... dhe 2. “A. D.” NUIS K81.....

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave me procesverbalin nr.2094/17 datë 14.06.2019 është skualifikuar operatori ekonomik “A. M.” për mungesë dokumentacioni dhe është shpallur fitues operatori “A. D.”.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave, i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.2094/18 prot, datë ____06.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit.

✓ Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit me shkresën e titullarit të AK nr.2094/19 prot datë 24.06.2019 i cili është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.26 datë 01.07.2019 faqe 117-119 nuk u gjet në dosje dhe i paadministruar sipas fletës së inventarit në dosjen e prokurimit.

- Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.2094/20 prot, datë 02.07.2019, KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues për të dy lotet. Janë nënshkruar kontratat respektive me nr.2094/21 prot, datë 30.07.2019 për lotin 1 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Hyundai IX35 në vlerën 826.199 (tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh si dhe nr.2094/22 datë 30.07.2019 Loti 2 Shërbime për mirëmbajtjen e automjetit tip Toyota Land Cruiser në vlerën 979.308 (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetë) lekë me tvsh midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues “A. D.” NUIS K81..... (për të dy lotet) me afat realizimi 12 muaj nga lidhja e kontratës.

Me shkresat nr.2094/23 prot, nr.2094/24 datë 30.07.2019 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar për të dy lotet. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga Agjencia e Prokurimit Publik është bërë me datë 31.07.2019 në sistem dhe është botuar në faqen 465-466 në Buletin e Njoftimeve Publike nr.31 datë 05.08.2019.

✓ Në dosje mungon formulari i raportimit të kontratës mbi ecurinë e zbatimit të kontratës në zbatim të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,(i ndryshuar), neni 57 ku citohet: *“Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.”

Likujdimi është kryer me urdhër transfertën e datës 17.12.2019 në vlerën totale prej 200.054 lekë për faturimet nga kontraktuesi “A. D.” NUIS K81..... (për të dy lotet) konkretisht fatura nr.414 datë 21.11.2019 në masën 111.004 lekë, fatura nr.416 datë 22.11.2019 në masën 89.050 lekë si dhe likujdimi me urdhër transfertën e datës 11.03.2020 në vlerën totale prej 599.032 lekë për faturimet nga kontraktuesi “A.D.” NUIS K81..... (për të dy lotet), konkretisht fatura nr.95, datë 06.03.2020 në masën 274.900 lekë, si dhe fatura nr.96 datë 06.03.2020 në masën 324.132 lekë.

Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në zbatimin e kontratës së shërbimit për mirëmbajtjen e automjeteve.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se nuk është hartuar urdhri për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit, veprime në mospërputhje me udhëzimit e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 42, 43. Procedurat e pagesave janë ekzekutuar në kundërshtimet me parashikimet e kontratave të nënshkruara, përkatësisht nenin 5.6 ku është përcaktuar se: “Kontraktuesi do të dorëzojë automjetin e riparuar duke e shoqëruar me këtë dokumentacion a) faturë tatimore që do të plotësohet për riparimet e kryera për automjetin;b)situacion i automjetit të riparuar i firmosur nga kontraktuesi dhe AK (komisioni i ndjekjes së realizimit të shërbimit); c) procesverbali i marrjes në dorëzim i firmosur nga kontraktuesi dhe AK (komisioni i ndjekjes së realizimit të shërbimit); si dhe aneksit 1, pika 6, ku citohet: “Personat përgjegjës për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe për marrjen në dorëzimin të automjeteve të riparuar do të jenë drejtuesit e automjeteve ose persona të autorizuar prej Autoritetit të Mediave Audiovizive”.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” Udhëzimi e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42, 43.
Ndikimi/Efekti:	Risku i realizimit të shërbimit jo në përputhje me DT dhe kontratën e lidhur mes OE dhe AK.
Shkaku:	Mosngritja e komisionit të marrjes në dorëzim nga Titullari i Institucionit
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim nga ana e AMA-s të hartohen urdhrat përkatës të marrjes në dorëzim të mallrave, punimeve dhe shërbimeve për çdo procedurë prokurimi me fondet publike.

3.) Procedura e Prokurimit: “Sistem për monitorimin e subjekteve numerike” me nr.REF 10324-02-25-2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Sistem për monitorimin e subjekteve numerike		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.32/1, datë 19.02.2019 nr.482/2 prot Njësia e prokurimit : N. M. – përgjegjës në sektorin teknik E. F. – juriste në sektorin e çështjeve juridike N. D. – përgjegjës në sektorin e monitorimit	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.32, datë 25.01.2019, nr.482 prot me përbërje: N. M. – përgjegjës në sektorin teknik N. D. – përgjegjës në sektorin e monitorimit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me nr.32/2, datë 19.02.2019, nr.482/3 prot me përbërje: E. L. - kryetar drejtor i drejtorisë së mbikqyrjes Xh. N. – anëtar, specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave B. K. – anëtare, specialiste e sektorit të monitorimit.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi limit (pa tvsh) 2.241.598 (dy milion e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 2.203.500 (dy milion e dyqind e tre mijë e pesëqind) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 38,098 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 11.03.2019	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike “P.S.” me NUIS L01.....
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.482/16 prot, datë 10.04.2019 midis AMA dhe subjektit P. S. me NUIS L01.... me vlerë 2,644,200 (dy milion e gjashtëqind e dyzet e katër mijë e dyqind) lekë me tvsh me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.		
Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.35/5, datë 12.04.2019 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit, me përbërje : J.S., SH. M. dhe SH. B., i cili është marrë në dorëzim me shkresën nr.482/20, datë 08.05.2019. Likujduar me urdhrë transfertën e datës 10.06.2019		

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.394, datë 21.01.2019, nga Drejtoria e Mbikqyrjes është bërë kërkesa për riorganizimin të zërave të kërkesave të drejtorisë ku përfshihet edhe zëri buxhetor “sistemi për monitorimin e subjekteve numerike”.

Me urdhrin nr.32, datë 25.01.2019 e Sekretarit të Përgjithshëm znj.V. M., është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: N. M., Përgjegjës në Sektorin Teknik dhe N. D. Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit.

Me relacionin nr.482/1 prot datë 19.02.2019 nga grupi i punës ka hartuar përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Llogaritja e fondit limit sipas shkresës nr.482/1 prot datë 19.02.2019 është bërë bazuar në ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik.

- Nga auditimi konstatohet se ofertat bashkëlidhur relacionit nr.482/1 prot datë 19.02.2019 nga operatorët ekonomik janë pa datë duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e llogaritjes së fondit limit.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.32/1, datë 19.02.2019 nr.482 prot, me fond limit 2.241.598 (dy milion e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

N. M. – Përgjegjës në Sektorin Teknik

E. F. – juriste në Sektorin e Çështjeve Juridike

N. D. – përgjegjës në Sektorin e Monitorimit

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.32/2,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

datë 19.02.2019, nr.482/3 prot me përbërje:

E. L. – Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

Xh. N. – anëtare, specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave

B. K. – anëtare, specialiste e Sektorit të Monitorimit

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.482/4, datë 22.02.2019.

Njoftimi i kontratës nr.482/5 datë 25.02.2019 është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik, nr.9, datë 04.03.2019, faqe 86-87.

Me datë 04.03.2019 është dorëzuar nga operatori ekonomik “R.” shpk me NUIS L11..... ankesa e protokolluar në institucionin e AMA-s me nr.1079 prot datë 04.03.2019.

Me urdhrin nr.32/3 datë 04.03.2019 me nr.482/6 prot datë 04.03.2019 është pezulluar procedura dhe është caktuar komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë:

E. Y. – kryetar

L. L. – anëtare

E. H. – anëtar

Operatori ekonomik me shkresën e protokolluar me nr.1079/1 prot datë 04.03.2019 është tërhequr nga ankesa. Komisioni i shqyrtimit të ankesës me procesverbalin nr.482/7 prot datë 05.03.2019 ka vendosur pushimin e shqyrtimit dhe ia ka komunikuar titullarit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.482/8 prot datë 05.03.2019.

Me shkresën nr.482/11 prot, datë 11.03.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku është paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: “P. S.” shpk me NUIS L01.... me ofertë ekonomike 2.203.500 (dy milion e dyqind e tre mijë e pesëqind) lekë pa tvsh. KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.482/12 datë 15.03.2019.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.482/13 prot, datë 16.04.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.482/15 prot, datë 03.04.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr.482/16 prot, datë 10.04.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik “P. S.” shpk me NUIS L01..... me vlerë 2,644,200 (dy milion e gjashtëqind e dyzet e katër mijë e dyqind) lekë me tvsh dhe afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Me shkresën nr.1175/15 datë 23.04.2019 anëtari i njësies së prokurimit i ka përcjell Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.32/5, datë 12.04.2019, nr.482/19 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: J.S., Sh. M. dhe Sh. B. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.482/20 prot, datë 08.05.2019.

Likujdimi është realizuar me urdhër transfertën e datës 10.06.2019 në vlerën 2.644.200 lekë.

4.) Procedura e Prokurimit me objekt : “Eventi për 20-vjetorin e AMA-s”, me nr.REF 14896-03-25-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Eventit për 20-vjetorin e AMA-s		
1. Urdhër Prokurimi nr. 76/1, datë 20.03.2019 nr.1175/2 prot NjësiA e prokurimit : E. R. -drejtore e burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me jashtë	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.76, datë 12.03.2019 me përbërje: E R. - drejtore e burimeve njerëzore	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Me nr.76/2, datë 20.03.2019 me përbërje: D. Xh. - kryetar, drejtor kabineti F. M. – anëtar, përgjegjëse e sektorit të çështjeve juridike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

A. M. - drejtor i programeve M. P. - drejtore e shërbimeve të brendshme I. H. - specialist i sektorit të inspektimeve E. F. - juriste e sektorit të çështjeve juridike	dhe marrëdhënieve me jashtë A. M. - drejtor i programeve M. P. - drejtore e shërbimeve të brendshme I. H. - specialist i sektorit të inspektimeve	E. N. – specialiste e sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,987,833 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) D. P-A. shpk me vlerë 1,968,900 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 18,933 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 05.04.2019, ora 11.00 në www.app.gov.al	9.Burimi Financimit nga Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike D. P-A shpk NUIS K72.....
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.1175/13 prot. datë 19.04.2019	Zbatimi i kontratës: Është krijuar komisioni me urdhrin nr.76/3, datë 19.04.2019, nr.1175/14 prot për marjen në dorëzim me përbërje : A. K., E. K., Sh. M., M. Th. dhe B. K..	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.3896/3, datë 02.11.2018, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë është bërë parashikimi i nevojave për vitin 2019, shpenzimet e të cilave janë miratuar me vendimin nr.202 datë 24.12.2018 të Bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2019”, ku është parashikuar edhe fondi për këtë objekt prokurimi.

Me urdhrin nr. 76, datë 12.03.2019 është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Eventi për 20-vjetorin e AMA-s” i përbërë:

E. R. - Drejtore e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

A. M. - Drejtor i Programeve

M. P. - Drejtore e Shërbimeve të Brendshme

I. H. - specialist i Sektorit të Inspektimeve

Nga grupi i punës është hartuar përllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përllogaritja e fondit limit sipas shkresës nr.1175/1 datë 19.03.2019 është bazuar në ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.76/1, datë 20.03.2019 nr.1175/2 prot, me fond limit 1,987,833 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E. R. -Drejtore e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

A. M. - Drejtor i Programeve

M. P. - Drejtore e Shërbimeve të Brendshme

I. H. - specialist i Sektorit të Inspektimeve

E. F. - juriste e Sektorit të Çështjeve Juridike

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.76/2, datë 20.03.2019, nr.1175/3 prot me përbërje:

D. Xh.-kryetar, Drejtor Kabineti

F. M. – anëtar, Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve Juridike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

E. N. – specialiste e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun.

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1175/4, datë 25.03.2019.

Njoftimi i kontratës nr.1175/5 datë 25.03.2019 është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.13, datë 01.04.2019 faqe 112.

Me shkresën nr.1175/6 prot, datë 05.04.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku është paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: “D. P-A“ shpk me NUIS K72..... me ofertë ekonomike 1,968,900 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë. KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1175/9, datë 09.04.2019.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1175/10 prot, datë 16.04.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit.

- Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1175/12 prot, datë 19.04.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues. Në këtë proceverbale citohet sigurimi i kontratës me nr.serie 070300540026791 datë 19.04.2019 në masën 10% të vlerës së kontratës.

Është nënshkruar kontrata me nr.1175/13 prot, datë 19.04.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik “D. P-A” shpk NUIS K72..... me vlerë 2.362.680 (dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me tvsh dhe afat 20 ditë nga lidhja e kontratës. Me shkresën nr.1175/15 datë 23.04.2019 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, kontratën e nënshkruar. Me urdhrin nr.76/3, datë 19.04.2019, nr.1175/14 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., E. K., Sh. M., M. Th. dhe B. K. Me shkresën 1175/15 prot datë 23.04.2019 komisioni ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim dizejnim dhe printim ftesash 150 copë.

Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në zbatimin e kërkesave ligjore mbi sigurimin e kontratës
Situata:	<i>Nga auditimi i nënshkrimit të kontratës rezultoi se:</i> Sigurimi i kontratës me nr.serie 070300540026791, datë 19.04.2019 në masën 10% të vlerës së kontratës është lëshuar nga kompania “E” sha. në masën 236.268 lekë, katër ditë pas nënshkrimit të kontratës, në kundërshtim me afatin e vendosur nga VKM-ja nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 24, ku shprehimisht citohet “ <i>Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj</i> ”.
Kriteri:	VKM-ja nr.914, datë 29.12.2014 “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ” i ndryshuar neni 24.
Ndikimi/Efekti:	Risku i mospërmbushjes së kontratës.
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim të merren masa nga njësia e prokurimit të verifikohet sigurimi i kontratës së përcjellë nga OE fitues, në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

5.) Procedura e Prokurimit : “Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit sipas strategjisë së komunikimit” me nr.REF 18597-04-17-2019

“Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit sipas strategjisë së komunikimit”		
1. Urdhër Prokurimi nr.83/1, datë 04.04.2019 nr.1238/2 prot Njësia e prokurimit : E. F. - juriste e sektorit të çështjeve juridike D. V. – përgjegjës në sektorin e marrëdhënieve me jashtë F. D. – specialist në drejtorinë e shërbimeve të brendshme 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.83, datë 19.03.2019 me përbërje: D. V. – përgjegjës në sektorin e marrëdhënieve me jashtë F. D. – specialist në drejtorinë e shërbimeve të brendshme	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Me nr.83/2, datë 04.04.2019 me përbërje: D. Xh.-kryetar, drejtor kabineti M. P. – anëtare, drejtoreshë shërbimeve të brendshme S. Xh. – anëtare, drejtoreshë juridike dhe e licencave
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6.772.010 (gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dhjetë) lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) AL. me NUIS J61.....6.695.080 (gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 76.930 (shtatëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 07.05.2019, ora 10.00 në www.app.gov.al	9. Burimi Financimit nga Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomikë AL. me NUIS J61.....
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.1238/19 prot. datë 23.05.2019	Zbatimi i kontratës: Është ngrit komisioni me urdhrin nr.83/5, datë 29.05.2019, nr.1238/20 prot për marjen në dorëzim me përbërje : A. K., I. H., E. C.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.659 prot, datë 05.02.2019, është bërë kërkesa për objektin e prokurimit të miratuar me vendimin nr.202 datë 24.12.2018 të Bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2019”.

Me urdhrin nr.83, datë 19.03.2019 nr.1238 prot është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit sipas strategjisë së komunikimit” i përbërë:

D. V. – Përgjegjës në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë

F. D. – specialist në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme

Nga grupi i punës është hartuar përllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përllogaritja e fondit limit sipas shkresës nr.1238/1 prot datë 03.04.2019 është bazuar në ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.83/1, datë 04.04.2019 nr.1238/2 prot, me fond limit 6.772.010 (gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dhjetë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

D. V. – Përgjegjës në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë

E. F. - juriste e Sektorit të Çështjeve Juridike

F. D. – specialist në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.83/2, datë 04.04.2019, nr.1238/3 prot me përbërje:

D. Xh. - Kryetar, Drejtor Kabineti



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

M. P. – anëtare, Drejtore e Shërbimeve të Brendshme

S. Xh. – anëtare, Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe e Liçencave

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1238/4, datë 17.04.2019.

Njoftimi i kontratës nr.1238/5 datë 17.04.2019 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.16, datë 23.04.2019, faqe 106. Me datë 19.04.2019 agjencia e prokurimit publik përmes monitorimit i solli në vëmendje njësisë së prokurimit nevojën për saktësim të kriterëve. Njësia e prokurimit me procesverbalin nr.2, datë 26.04.2019 ka hartuar shtojcën nr.1 ku janë ndryshuar kriteret dhe zgjati afatin e dorëzimit të ofertave. Me shkresën nr.1238/9 prot, datë 07.05.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku është paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: “AL.” me NUIS J61..... me ofertë ekonomike 6.695.080 (gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë) lekë. KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1238/15 prot, datë 10.05.2019.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1238/16 prot, datë 17.05.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1238/18 prot, datë 22.05.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues. Është nënshkruar kontrata me nr.1238/19 prot, datë 23.05.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik “AL.” me NUIS J61..... për 6.695.080 (gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh dhe vlerën prej 8.034.096 (tetë milion e tridhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh dhe afat total realizimi 100 ditë nga lidhja e kontratës. Me shkresën pa numër protokolli, datë 29.05.2019 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme kontratën e nënshkruar. Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr.1238/19 prot datë 28.05.2019, ka të njëjtën numër protokolli me kontratën e nënshkruar, kjo edhe sipas fletës së inventarit të paarkivuar sipas rregullave në fuqi konkretisht ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12 “Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë. Neni 13 Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar”. Parregullsia në vendosjen e numrit të protokollit të shkresave pasi një shkresë duhet të ketë një numër unik protokolli bazuar në nenin 19 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

Me urdhrin nr.83/5 datë 29.05.2019, nr.1238/20 prot (i ndryshuar) është krijuar komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., Sh. B., E. C.. Komisioni me aktverifikimet datë 26.06.2019, datë 01.08.2019, datë 02.09.2019 të pa protokolluara në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” pika 19 “*të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës*” ka marrë në dorëzim shërbimin e realizuar të kontratës me të cilat u realizuan likujdimet e faturës nr.256 datë 29.06.2019, me urdhër transfertën e datës 01.07.2019, faturës nr.316 datë 31.07.2019 me urdhër transfertën e datës 14.08.2019 dhe faturës nr.398 datë 31.08.2019 me urdhër transfertën e datës 09.09.2019.

6.) Procedura e Prokurimit : “Blerje Analizator Spektri” me nr.REF 43813-11-18-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Analizator Spektri”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.294/1, datë 12.11.2019 nr.3964/3 prot Njësia e prokurimit : E. F. – juriste në sektorin e çështjeve juridike T. P. – specialist në sektorin teknik G. M. – specialist në sektorin e inspektimit	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.294, datë 05.11.2019, nr.3964/1 prot me përbërje: T. P. – specialist në sektorin teknik G. M. – specialist në sektorin e inspektimit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.294/2, datë 12.11.2019 nr.3964/4 prot me përbërje: E. D. - drejtor i drejtorisë së planifikimit të frekuencave dhe TIK M. P. – drejtoreshë shërbimeve të brendshme S. Xh. – drejtoreshë në drejtorinë juridike dhe të licencave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4.544.667 (katër milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) TB. shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 4.464.000 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë Shënim:vlara pas korigjimit.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 80.667 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 02.12.2019	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike - L. B. shpk me ofertë ek. 4.075.000 lekë pa tvsh - P. I. shpk me ofertë ek.3.812.876 lekë pa tvsh -TB. shpk me ofertë ek. 4.460.000 lekë pa tvsh
11. Ankimime Nr.4373 prot, dt.11.12.2019 L. shpk Nr.4374 prot, dt.11.12.2019 P. I. shpk Nr.4394 prot, dt.12.12.2019 T.B shpk	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.3964/4 prot datë 18.12.2019	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Vendimi nr.33 datë 21.01.2020
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.3964/22 prot, datë 21.02.2020 midis AMA-s dhe operatorit eko fitues TB.shpk me NUIS K71.... në vlerë 5.356.800 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë me tvsh me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.294/5, datë 25.02.2020, nr.3964/26 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit, me përbërje : Sh. M., Sh. B. dhe E. B. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.3964/27, datë 27.03.2020.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.3964, datë 04.11.2019, nga drejtorja e planifikimit të frekuencave dhe TIK është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

bërë kërkesa për prokurimin “Blerje Analizator Spektri”.

Me Urdhrin nr.294, datë 05.11.2019, nr.3964/1 prot, është krijuar komisioni për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: T. P. – specialist në Sektorin Teknik, G. M. – specialist në Sektorin e Inspektimit

Me relacionin nr.3964/2 prot datë 11.11.2019 nga grupi i punës është hartuar përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlllogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në ofertat të marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, kryetari z.G. S. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.294/1, datë 12.11.2019 (nr.3964/3 prot), me fond limit 4.544.667 (katër milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës: kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë:

E. F. – juriste në Sektorin e Çështjeve Juridike

T. P. – specialist në Sektorin Teknik

G. M. – specialist në Sektorin e Inspektimit

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.294/2, datë 12.11.2019 nr.3964/4 prot me përbërje:

E. D. - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe TIK

M. P. – Drejtore e Shërbimeve të Brendshme

S. Xh. – Drejtore në Drejtorinë Juridike dhe të Liçencave

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.3964/5 prot, datë 15.11.2019.

Njoftimi i kontratës nr.3964/6 prot, datë 18.11.2019 është publikuar në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.47, datë 25.11.2019, faqe 44.

Me shkresën nr.3964/7 prot, datë 02.12.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 3 (tre) operatorë ekonomik:

✓ “L. B.” shpk me NUIS L72..... me ofertë ekonomike 4.075.000 lekë pa tvsh.

✓ “P. I.” shpk me NUIS L51..... me ofertë ekonomike 3.812.876 lekë pa tvsh.

✓ “TB.” shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 4.460.000 lekë pa tvsh.

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.3964/10 datë 05.12.2019 duke mos kualifikuar asnjë operator ekonomik pjesëmarrës.

Me urdhrin nr.294/3 datë 12.12.2019, nr.3964/11 prot Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka pezulluar procedurën për efekt të ankesave të tre operatorëve ekonomike pjesëmarrës.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave njoftoi titullarin dhe operatorët ankues për vendimin e tij në lidhje mospranimin e ankesave së tyre.

Operatorët ekonomike “L. B.” shpk dhe “TB.” shpk në lidhje mospranimin e ankesave së tyre ankuan tek Komisioni i Prokurimit Publik, i cili pas shqyrtimit me vendimin nr.33/2020 datë 21.01.2020, i protokolluar në institucion me nr.202 prot datë 23.01.2020, vendosi:

- mospranimin e ankesës për operatorin ekonomik “L. B.” shpk.
- pranimin e ankesës për operatorin ekonomik “TB.” shpk duke anuluar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e tij duke e kualifikuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, kryetari, me urdhrin nr.294/4 datë 27.01.2020 urdhëroi zbatimin e vendimit nr.33/2020 datë 21.01.2020 të KPP-së.

Komisioni i vlerësimit të ofertave me procesverbalin nr.3964/16 dt.27.01.2020 referuar përcaktimeve ligjore kërkoi nga operatori ekonomik “TB.” shpk korigjimin e gabimit aritmetik i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

cili pranoi gabimin dhe i përcolli ofertën ekonomike të korigjuar në vlerën 4.464.000 lekë pa tvsh. Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.3964/18 prot, datë 04.02.2020 pas mbarimit të afatit të ankimit.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.684/1 prot, datë 20.02.2020 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr.3964/22 prot, datë 21.02.2020 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues "TB." shpk me NUIS K71..... me vlerë 4.464.000 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë pa tvsh e 5.356.800 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë me tvsh, me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Me shkresën nr.768 prot, datë 25.02.2020 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell drejtorisë së shërbimeve të brendshme kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.294/5, datë 25.02.2020, nr.3964/26 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: Sh. M., Sh. B. dhe E. B. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.3964/27, datë 27.03.2020.

Likujdimi është realizuar me urdhër transfertën e datës 06.04.2020 në vlerën totale sipas faturës nr.46 dt.27.03.2020.

7.) Procedura e Prokurimit : "Blerje Automjete ½ fuoristradë" me nr.REF 06282-02-04-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje Automjete ½ fuoristradë"		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.28/1, datë 28.01.2019 nr.448/2 prot Njësia e prokurimit : K. K. – jurist në sektorin e çështjeve juridike T. P. – përgjegjës në sektorin e inspektimeve A. K. – përgjegjës në sektorin e administratës	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.28, datë 23.01.2019, nr.448 prot me përbërje: T. P. – përgjegjës në sektorin e inspektimeve A. K. – përgjegjës në sektorin e administratës	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.28/2, datë 28.01.2019 nr.448/3 prot me përbërje: E. L. – kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes E. H. – anëtar, specialist në sektorin teknik I. H. – anëtar, specialist në sektorin e inspektimeve
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5.000.000 (pesë milion) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) P.A. shpk me NUIS K519..... 4.247.000 (katër milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë) lekë pa tvsh e 5.096.400 (pesë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë me tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 753.000 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 25.02.2019	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike - P. shpk me ofertë ek. 4.900.000 lekë pa tvsh - N. shpk me ofertë ek.4.800.000 lekë pa tvsh P.A. shpk me ofert ek. 4.247.000 lekë
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me me nr.448/12 prot, datë 01.04.2019 P. A. shpk me NUIS K51.... me vlerë 4.247.000 (katër milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë) lekë pa tvsh e 5.096.400 (pesë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë me tvsh me afat realizimi 90 ditë nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: nr.28/5, datë 10.04.2019, nr.3448/15 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit, me përbërje : A. K., Sh. M. dhe A. M. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.448/16 prot, datë 25.04.2019.	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

.-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.386 prot, datë 21.01.2019, drejtorja e mbikqyerjes ka bërë kërkesë për prokurimin “Blerje Automjete”

Me urdhrin nr.28 datë 23.01.2019, nr.448 prot, është krijuar komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: T. P. përgjegjës në Sektorin e Inspektiveve, A. K. – Përgjegjës në Sektorin e Administratës.

Me relacionin nr.448/1 prot datë 28.01.2019 nga grupi i punës është hartuar përlogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në ofertat të marra nga 3 operatorë ekonomik. *Ofertat nuk krijojnë bindjen se i përmbahen specifikimeve të hartuara nga komisioni.*

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.28/1, datë 28.01.2019 nr.448/2 prot, me fond limit 5.000.000 (pesë milion) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

K. K. – jurist në Sektorin e Çështjeve Juridike

T. P. – Përgjegjës në Sektorin e Inspektiveve

A. K. – Përgjegjës në Sektorin e Administratës

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.28/2, datë 28.01.2019 nr.448/3 prot me përbërje:

E. L. – Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

E. H. – anëtar, specialist në Sektorin Teknik

I. H. – anëtar, specialist në Sektorin e Inspektiveve

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.448/4 prot , datë 04.02.2019.

Njoftimi i kontratës nr.448/5 prot datë 04.02.2019 është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.6 datë 11.02.2019 faqe 62.

- ✓ Në pikën 2.3.1 të DST, kapaciteti teknik si dhe procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatohet se, njësia e prokurimit ka vendosur një kriter të kundërt nga përcaktimi ligjor, konkretisht neni 27, pika 4, e VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar: *“Për të provuar përvojën e mëparshme autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit. Në çdo rast vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit”.*

Për formulimin e gabuar të këtij kriteri si dhe specifikimit në vlerë fikse të vëllimit të motorit APP i ka rekomanduar AK të modifikojë sipas kërkesave ligjore përmes një shtojce.

- ✓ Gjithashtu në pikën 2.2.1 procesverbali i njësisë ka pasaktësi me përcaktimet në DST, fq. 25 përsa i përket kriterit *“Vërtetim nga organet tatimore për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit financiare (2015,2016,2017) e cila duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Tre vitet e fundit duhet të përkojnë me vitet 2016,2017,2018.*
- ✓ Gjithashtu procesverbali nuk argumenton me mbështetje ligjore, kriterin teknik të vendosur po nga vetë njësia që kanë të bëjnë :2.3.6 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i mjeteve ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mallrave për një periudhë jo më pak se 4 (katër) vjet nga dorëzimi i mallit.dhe 2.3.9. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha dokumentat për qarkullim (leje qarkullimi + çertifikatë pronësie + targa + taksa të*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

paguara për 1 (një) vit + siguracion TPL).

Njësia e prokurimit ka hartuar shtojcën përkatëse sipas procesverbalit nr.448/7 prot datë 06.02.2019 ku modifikoi kriteret/ specifikimet sipas rekomandimeve të APP-së.

✓ Nuk është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit dhe vlerësimit të saj për të konfirmuar hapat e ndjekur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas përcaktimeve detyruese të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar)

✓ Është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.448/9 prot, datë 11.03.2019 para mbarimit të afatit të ankimit, pasi menjëherë njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit me shkresën e titullarit të AK nr.448/10 prot datë 11.03.2019, e cila nuk është miratuar nga zyrtarët e publikimit të APP-së. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.11, datë 18.03.2019, faqe 242-244 nuk u gjet në dosje dhe i paadministruar sipas fletës së inventarit në dosjen e prokurimit.

✓ U konstatua nga auditimi se procesi i vlerësimit (refereuar veprimeve në sistemin e APP-së) nga ana e KVO-së të përbërë nga E. L., E. H., I. H. ka parregullsi pasi operatori i shpallur fitues P. A. shpk me NUIS K51..... kualifikohet duke mos plotësuar pjesërisht kriterin “Kopje të certifikuara të bilancit për vitet 2016 dhe 2017 të vulosura nga organet tatimore”. Në platformën e prokurimeve si dhe në institucion (pas kualifikimit, para nënshkrimit) OE ka paraqitur bilancin e dorëzuar tek drejtoria rajonale e tatimeve jo të certifikuar nga auditues ligjor.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.448/11 prot, datë 18.03.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr.448/12 prot, datë 01.04.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues “P.A.” shpk me NUIS K51....., me vlerë 4.247.000 (katër milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë) lekë pa tvsh e 5.096.400 (pesë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë me tvsh, me afat realizimi 90 ditë nga lidhja e kontratës.

✓ Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është bërë me datë 09.04.2019 në sistem dhe është botuar në faqen 400, në Buletin e Njoftimeve Publike nr.15, datë 15.04.2019, i cili nuk ndodhet në dosje sipas fletës së inventarit në dosjen e prokurimit. Me shkresën nr.448/14 prot, datë 10.04.2019 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell drejtorisë së shërbimeve kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.28/5, datë 10.04.2019, nr.3448/15 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., Sh. M. dhe A. M. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.448/16 prot, datë 25.04.2019.

Likujdimi është realizuar me dy urdhër transfertat e datës 21.05.2019 respektivisht për faturën nr.8089 dhe nr.8100. Arkivimi i dosjes në sistemin e prokurimeve nuk rezulton të jetë realizuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

8.) Procedura e Prokurimit : “Blerje pajisje elektronike/kompjuterike” me nr.REF 06282-02-04-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pajisje elektronike/kompjuterike”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.110/1, datë 06.05.2019 nr.1612/2 prot Njësia e prokurimit : E. F. – jurist në sektorin e çështjeve juridike Xh.N. – specialiste në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave E.H. - specialist në sektorin teknik/	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.110, datë 15.04.2019, nr.1612 prot me përbërje: Xh. N. – specialiste në sektorin e planifikimit dhe administrimit të frekuencave E. H. - specialist në sektorin teknik	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.110/2, datë 06.05.2019 nr.1612/3 prot me përbërje: E. D. – kryetar, drejtor i drejtorisë së planifikimit të frekuencave dhe TIK E. Y. – anëtar, përgjegjës sektori në dr.e shërbimeve të brendshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		V. A. – anëtar, specialist në sektorin e liçencave
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1.746.073 (një milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) P.S. shpk me NUIS L01....., 1.217.000 (një milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh e 1.460.400 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind) lekë me tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 529.073 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 03.06.2019	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike -B.E. shpk me ofertën ekonomike 1.397.770 lekë pa tvsh -P.S.shpk me ofertën ekonomike 1.217.000 lekë pa tvsh -P. shpk me ofertën ekonomike 1.693.000 lekë pa tvsh (skualifikuar).
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1612/13 prot, datë 29.07.2019 me P.S. shpk me NUIS L01... me vlerë 1.217.000 (një milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh e 1.460.400 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind) lekë me tvsh me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.110/3, datë 16.08.2019, nr.1612/16 prot është krijuar komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: J. S., T. P. dhe G.Sh. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.1612/17 prot, datë 28.08.2019	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.4471 prot, datë 06.11.2018, drejtorja e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK ka bërë kërkesë për blerje “Pajisje elektronike/kompjuterike”, e cila është miratuar me vendimin nr.202 datë 24.12.2018 të Bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2019” ku është parashikuar edhe fondi për këtë objekt prokurimi.

Me urdhrin nr.110, datë 15.04.2019, (nr.1612 prot), është krijuar komisioni për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: Xh. N. – specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave, E. H. - specialist në Sektorin Teknik. Me relacionin nr.1612/1 prot., datë 30.04.2019 nga grupi i punës është hartuar përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlllogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në çmimet e publikuara nga AKSHI dhe për artikujt që nuk janë te lista e publikuar me testim tregu nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i autoritetit kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.110/1, datë 06.05.2019 nr.1612/2 prot, me fond limit 1.746.073 (një milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë, lloji i procedurës kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë:

E. F. – jurist në Sektorin e Çështjeve Juridike

Xh. N. – specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave

E. H. - specialist në Sektorin Teknik

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.110/2, datë 06.05.2019 nr.1612/3 prot me përbërje:

E. D. – Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe TIK

E. Y. – anëtar, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme

V. A. – anëtar, specialist në Sektorin e Liçencave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1612/4 prot, datë 17.05.2019.

Njoftimi i kontratës nr.1612/5 prot datë 22.05.2019 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.21 datë 27.05.2019, faqe 102.

Me shkresën nr.1612/6 prot, datë 03.06.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 3 (tre) operatorë ekonomik:

- “B.E.” shpk me ofertën ekonomike 1.397.770 lekë pa tvsh
- “P.S.” shpk me ofertën ekonomike 1.217.000 lekë pa tvsh
- “P.” shpk me ofertën ekonomike 1.693.000 lekë pa tvsh

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1612/9 prot., datë 10.05.2019 ku operatorët ekonomikë “B.E.” shpk dhe “P.S.” janë kualifikuan, ndërsa “P.” shpk është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit të kërkuara nga AK.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1612/10 prot, datë 17.06.2019 pas mbarimit të afatit të ankimit. Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit me shkresën e titullarit të AK nr.1612/11 prot, datë 19.06.2019, që është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.25, datë 24.06.2019, faqe 330-332.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1612/12 prot, datë 08.07.2019 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues. Në këtë proceverbale citohet sigurimi i kontratës me nr.serie 056813 datë 26.06.2019 në masën 10% të vlerës së kontratës prej 146.040 lekë.

Titulli i Gjetjes:	Zbatimi i kontratës
Situata:	Nga auditimi i nënshkrimit të kontratës rezultoi se: Sigurimi i kontratës me nr.serie 056813, datë 26.06.2019, lëshuar nga “S” në masën 146.040 lekë si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës ka datë lëshimi datën 26.06.2019, i vlefshëm deri më datë 05.08.2019, afat ky që nuk i shërben qëllimit ligjor për të siguruar kontratën, pasi kontrata ka datë nënshkrimi datën 29.07.2019 dhe afat lëvrimit 30 ditë nga nënshkrimi i saj, veprim në kundërshtim me VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 24, ku shprehimisht citohet “ <i>Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj</i> ”.
Kriteri:	VKM-ja nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 24.
Ndikimi/Efekti:	Risku i mospërbushjes së kontratës.
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim të merren masa nga njësia e prokurimit të verifikohet sigurimi i kontratës së përcjellë nga OE fitues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Është nënshkruar kontrata me nr.1612/13 prot, datë 29.07.2019 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues “P.S.” shpk me NUIS L01....., me vlerë 1.217.000 (një milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh e 1.460.400 (një milion e katëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind) lekë me tvsh me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Me shkresën nr.1612/14 prot, datë 01.08.2019 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është bërë me datë 02.08.2019 në sistem dhe është botuar në faqen 400 në buletin e njoftimeve publike nr.31 datë 05.08.2019.

Me shkresën nr.1612/15 prot, datë 07.08.2019 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell drejtorisë së shërbimeve të brendshme kontratën e nënshkruar.

✓ Me urdhrin nr.110/3, datë 16.08.2019, nr.1612/16 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë nga: J. S., T. P. dhe G. Sh. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.1612/17 prot, datë 28.08.2019 (i pafirmosur nga përfaqësuesi i kontraktuesit apo personi i autorizuar i tij), një ditë pas mbarimit të afatit të kontratës, referuar nenit 5 të kontratës ku shprehimisht citohet “Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 30 ditë nga hyrja në fuqi e saj.

✓ Nuk rezultojnë të jenë bërë ndalesa nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Financës) për dorëzim të vonuar sipas nenit 10.1 të kontratës “Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten e mëposhtme ditore: Tarifa ditore do jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës....Penaliteti do të mbahet nga pagesa”.

Likujdimi i faturës P205, dt.28.08.2019 me nr.serie 79346165 është realizuar me datë 02.10.2019 pas mbarimit të afatit 30 ditor për likujdim fature neni 9.2 i kontratës “Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është pranuar malli dhe shërbimi i instalimit dhe vënien në punë të sistemit”.

9) Procedura e Prokurimit : “Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM ” me nr.REF 76140-10-20-2020

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.179, datë 16.10.2020 nr.2920 prot Njësia e prokurimit : K. K. – jurist në sektorin e çështjeve juridike T. P. – specialist në sektorin e monitorimeve të frekuencave E. H. – specialist në sektorin TIK	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.30, datë 04.02.2020, nr.518 prot me përbërje: T. P. – specialist në sektorin e monitorimeve të frekuencave E. H.– specialist në sektorin TIK	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave , nr.182, datë 19.10.2020 nr.2940 prot me përbërje: E. C. – kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes E. Sh. – anëtar, përgjegjës në sektorin e inspektimeve N. D. –anëtare, përgjegjëse në sektorin e monitorimeve
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3.980.000 (tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) TB.shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 3.930.000 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 50.000 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 02.11.2020	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike TB.shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 3.930.000 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.2920/4 prot, datë 20.11.2020 me TB.shpk me NUIS K71..... me vlerë ekonomike 3.930.000 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 4.716.000 (katër milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë me tvsh me afat realizimi 2 (dy) muajve nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.216 datë 24.11.2020, nr.3365 prot është krijuar komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., Sh. M. dhe I. K. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.3365/1 prot, datë 24.12.2020. Likujduar me urdher transfertën e datës 28.12.2020.
--	--

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me vendimin nr.83 datë 08.10.2020 të Bordit të AMA-s “Për një ndryshim në vendimin e AMA-s nr.183 datë 19.12.2019 Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2020”, u shtua zëri buxhetor me objekt: “Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM”.

Me urdhrin nr.30, datë 04.02.2020, (nr.518 prot), është krijuar komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: T. P. – specialist në sektorin e monitorimeve të frekuencave, E. H. – specialist në sektorin TIK.

Me relacionin nr.518/1 prot datë 05.02.2020 nga grupi i punës është hartuar përlogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në nenin 59, pika 2, germa b, e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar).

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.179, datë 16.10.2020 nr.2920 prot, me fond limit 3.980.000 (tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

K. K. – jurist në Sektorin e Çështjeve Juridike

T. P. – specialist në Sektorin e Monitorimeve të Frekuencave

E. H. – specialist në Sektorin TIK

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.182, datë 19.10.2020 nr.2940 prot me përbërje:

E. C. – kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

E. Sh. – anëtar, Përgjegjës në Sektorin e Inspektimeve

N. D. – anëtare, Përgjegjëse në Sektorin e Monitorimeve

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.2920/1 prot , datë 20.10.2020.

Njoftimi i kontratës nr.2920/2 prot , datë 20.10.2020 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.91 datë 26.10.2020 faqe 58-59.

Me shkresën nr.2940/1 prot, datë 02.11.2020 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: TB.shpk me NUIS K71..... KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.2940/2 prot datë 05.11.2020 ku u kualifikua operatori ekonomik i vetëm pjesmarrës.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, sekretari i përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.2940/3 prot, datë 13.11.2020 pas mbarimit të afatit të ankimit. Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit me shkresën e titullarit të AK nr.2920/3 prot, datë 13.11.2020 që është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.105 datë 23.11.2020 faqe 248-249.

✓ Formulari i njoftimit të fituesit ka pasaktësi në datën e njoftimit të klasifikimit e cila është botuar në buletin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.2940/4 prot, datë 16.11.2020 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr. 2920/4 prot, datë 20.11.2020 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues “TB.” shpk me NUIS K71..... me vlerë ekonomike 3.930.000 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 4.716.000 (katër milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë me tvsh me afat realizimi 2 (dy) muajve nga lidhja e kontratës.

Me shkresë nr.2920/5 prot datë 23.11.2020 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është botuar në faqen 297 në buletin e njoftimeve publike nr.111 datë 01.12.2020. Me shkresën nr.3361 prot, datë 24.11.2020 anëtar i njësisë së prokurimit i përcjell drejtorisë së shërbimeve kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.216 datë 24.11.2020, nr.3365 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: A. K., Sh. M. dhe I. K. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.3365/1 prot, datë 24.12.2020.

Formulari i raportimit për zbatimin e kontratës nr.3741 prot datë 29.12.2020.

Likujduar me urdhër transfertën e datës 28.12.2020.

10) Procedura e Prokurimit : “Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM” me nr.REF 95335-05-12-2021

Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM		
1. Urdhër Prokurimi nr.132 datë 05.05.2021 nr.1841 prot Njësinë e prokurimit : E. F. - juriste e sektorit të çështjeve juridike T. P. – specialist në sektorin eteknik Sh. B. – specialist në sektorin e inspektimeve	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLEFL dhe ST me nr.128, datë 04.05.2021 nr.1822 prot me përbërje: T. P. – specialist në sektorin teknik Sh. B. – specialist në sektorin e inspektimeve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Me urdhrin nr.133, datë 05.05.2021 nr.1842 prot me përbërje: E. C. – kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes E. Y. – anëtare, përgjegjës në sektorin e financës A. B. – anëtar, specialist në sektorin e licencave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1.649.500 (një milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) TB.shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 1.648.800 (një milion e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 700 (shtatëqind) lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 24.05.2021 në www.app.gov.al	9.Burimi Financimit nga Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike TB.shpk me NUIS K71....
11. Ankime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.2280/2 prot, datë 25.06.2021 me vlerë 1.978.560 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh	Zbatimi i kontratës: Është ngrit komisioni me urdhrin nr.232 datë 13.10.2021, nr.3331 prot., për marrjen në dorëzim me përbërje : E. D., Xh. N., G. M. (i ndryshuar me urdhrin nr.75 datë 09.03.2022)	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.594 prot, datë 02.02.2021, është bërë kërkesa nga drejtori i planifikimit të frekuencave dhe TIK për objektin e prokurimit të miratuar me vendimin nr.153 datë 24.12.2020 të Bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2021”.

Me urdhrin nr.128, datë 04.05.2021 nr.1822 prot është krijuar komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM” i përbërë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

T. P. – specialist në Sektorin Teknik

Sh. B. – specialist në Sektorin e Inspektimeve

Nga grupi i punës është hartuar përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike. Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve janë realizuar përkatësisht sipas relacionit nr.787/1 prot., datë 08.03.2021 dhe relacionit nr.1822/1 prot datë 05.05.2021 është bazuar në ofertat të marra nga 3 operatorë ekonomik.

✓ Nga auditimi konstatohet se ofertat e mara nga operatorët ekonomik janë pa datë dhe nuk përfshijnë zërat e mirëmbajtjes, duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e llogaritjes së fondit limit, duke mosrespektuar parashikimet e nenit 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar): *“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”*.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.132, datë 05.05.2022 (nr.1841 prot), me fond limit 1.649.500 (një milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : procedurë e hapur e thjeshtuar, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E. F. - juriste e sektorit të çështjeve juridike

T. P. – specialist në Sektorin Teknik

Sh. B. – specialist në Sektorin e Inspektimeve

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.133, datë 05.05.2021 nr.1842 prot me përbërje:

E. C. – kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

Er. Y. – anëtare, Përgjegjëse në Sektorin e Financës

A. B. – anëtar, specialist në Sektorin e Licencave

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1841/1 prot, datë 10.05.2021.

Njoftimi i kontratës nr.1841/2 prot, datë 10.05.2021 nuk është miratuar nga zyrtari i publikimit për pasaktësi në përmbajtjen e njoftimit nga ana e njësisë së prokurimit bazuar në udhëzimin nr.2109/3, datë 02.04.2021 të APP-së referuar ligjit të zbatueshëm. Njësia e prokurimit me njoftimin e anulimit datë 11.05.2021 ka anuluar procedurën në sistem sipas procesverbalit nr.1841/3, datë 11.05.2021 duke e ringarkuar sërish nga fillimi. Njoftimi i kontratës datë 12.05.2021 (sipas procesverbalit të njësisë nr.1841/4 prot, datë 12.05.2021) është publikuar në botimin e njoftimeve publike nr.75, datë 17.05.2021.

Me shkresën nr.1842/1 prot, datë 24.05.2021 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku është paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: “TB.” shpk me NUIS K71..... me ofertë ekonomike 1.648.800 (një milion e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1842/5 prot, datë 27.05.2021 duke kualifikuar operatorin ekonomik “TB.” shpk me NUIS K71.....

Është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1842/6 prot, datë 07.06.2021 pas mbarimit të afatit të ankimit.

✓ Njoftimi i fituesit nr.1841/5 prot datë 09.06.2021 i hartuar nga juristi i njësisë së prokurimit është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.92, datë 14.06.2021, fq.183-184.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.2280/1 prot, datë 15.06.2021 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues. Është nënshkruar kontrata me nr.2280/2 prot, datë 25.06.2021 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik "TB." shpk me NUIS K71..... me vlerë 1.648.800 (një milion e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh e 1.978.560 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh dhe afat realizimi 9 (nëntë) muaj nga lidhja e kontratës. Me shkresën nr.2378 prot., datë 28.06.2021 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është botuar në faqen 287-288 në buletin e njoftimeve publike nr.104 datë 05.07.2021.

Është ngritur komisioni me urdhrin nr.232 datë 13.10.2021, nr.3331 prot për marrjen në dorëzim dhe verifikimin e realizimit të shërbimit me përbërje: E. D., Xh. N., G. M. Nga komisioni u hartua relacioni nr.3331/3 prot datë 18.11.2021, nr.3331/4 prot datë 18.11.2021 për marrjen në dorëzim të shërbimit të faturuar me nr.10126 datë 28.09.2021 likujduar me urdhër transfertën 19.11.2021. Komisioni hartoi relacionin nr.81 prot datë 10.01.2022, për pranimin e shërbimit të faturuar nr.10221 datë 24.12.2021 likujduar me urdhër transfertën 12.01.2022. Komisioni i përbërë N. D., Xh. N., G. M. (i ndryshuar me urdhrin nr.75 datë 09.03.2022) konkretisht tashmë i përbërë N. D., B. H., T. P., E. B., G. M. hartoi relacionin nr.1971/1 prot datë 01.06.2022, për pranimin e shërbimit të faturuar nr.10281 datë 24.03.2022 likujduar me urdhër transfertën 14.06.2022.

Titulli i Gjetjes:	Marrja në dorëzim e shërbimit.
Situata:	Nga auditimi i marrjes në dorëzim të shërbimit rezultoi se: Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar e marrë në dorëzim me vonesë faturat e lëshuara nga OE, edhe pse shërbimi ishte realizuar, duke ndikuar në likuidimin pas afatit 30 ditor të faturës, në kundërshtim me parashikimet ligjore konkretisht nenit 463 të Kodit Civil të RSH dhe ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". Marrja në dorëzim me vonesë të objektit të kontratës solli raportimin me vonesë të "Formularit të raportimit për zbatimin e kontratës nr.2428 prot datë 17.06.2022" në kundërshtim me nenin 125 pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku shprehimisht citohet "Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës" si dhe nenin 107 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar).
Kriteri:	Kodi Civil të RSH nenit 463, ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar) nenin 107.
Ndikimi/Efekti:	Pagesat mbi afatin 30 ditor dhe vonesa në raportimin e "Formularit të raportimit për zbatimin e kontratës".
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim komisionet e marrjes në dorëzim të verifikojnë brenda afateve ligjore mallrat/shërbimet e realizuara nga kontraktuesit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

11) Procedura e Prokurimit : “Blerje pajisje server SAN STORAGE AREA NETWORK” me nr.REF 91509-03-29-2021⁸

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pajisje server SAN STORAGE AREA NETWORK”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.102, datë 26.03.2021 nr.1644 prot NjësiA e prokurimit : E. F. – juriste në sektorin e çështjeve juridike. E. H. – specialist në sektorin teknik në drejtorinë e planifikimit të frekuencave dhe TIK. G. M. - specialist në sektorin e çështjeve juridike.	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.78, datë 08.03.2021, nr.1125 prot me përbërje: E. H. – specialist në sektorin teknik në drejtorinë e planifikimit të frekuencave dhe TIK G. M. - specialist në sektorin e çështjeve juridike.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.103, datë 26.03.2021 nr.1465 prot me përbërje: E. C. – kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes V. A. – anëtare, përgjegjës në sektorin e çështjeve juridike E. B. – anëtar, specialist në sektorin teknik në drejtorinë e planifikimit të frekuencave dhe TIK .
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2.999.457 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) P. S. shpk me NUIS L01..... me ofertë ekonomike 2.603.900 (dy milion e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 395.557 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 12.04.2021	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike - A.B.S. shpk me NUIS K21.... me ofertë ekonomike 2.990.000 lekë pa tvsh (skualifikuar për mosplotësim kriteri) -P.S. shpk me NUIS L01.... me ofertë ekonomike 2.603.900 lekë pa tvsh -S. CO shpk me NUIS K11..... me ofertë ekonomike 2.715.300 lekë pa tvsh
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1464/4 prot, datë 17.05.2021 me P.S. shpk me NUIS L01... me vlerë ekonomike 2.603.900 (dy milion e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh dhe 3.124.680 (tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me tvsh me afat realizimi 25 (njëzet e pesë) ditë nga lidhja e kontratës	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.143 datë 28.05.2021, nr.2142 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: N. D., T. P. dhe Sh. M. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.2142/1 prot, datë 09.06.2021 Likujduar me urdhër transfertën e datës 15.06.2021.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Drejtoria e Mbikqyerjes bazuar në vendimin nr.153 datë 24.12.2020 të Bordit të AMA-s “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2020” paraqiti kërkesë për blerje.

Me urdhrin nr.78, datë 08.03.2021, nr.1125 prot, është krijuar komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: E. H. – specialist në Sektorin Teknik në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK, G. M. - specialist në Sektorin e Çështjeve Juridike.

Me relacionin nr.1125/1 prot datë 24.03.2021 grupi i punës ka hartuar përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përllogaritja e fondit limit sipas shkresës nr.1125/1 prot datë 24.03.2021 është bërë bazuar në relacionin e hartuar nr.3026/1 datë 29.10.2020 ku

⁸ Procedura e Prokurimit : “Blerje pajisje server SAN STORAGE AREA NETWORK” me nr.REF 77498-11-03-2020 anuluar sipas mjoftimit nr.3072/3 date 06.01.2021 sipas nenit 24 pika 1 germa ç e LPP.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- ✓ Nga auditimi konstatohet se ofertat bashkëlidhur janë pa datë duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e llogaritjes së fondit limit si dhe
- ✓ Në kundërshtim me parashikimet ligjore neni 59 i VKM nr.914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar): “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm znj.V. M. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.102, datë 26.03.2021 nr.1644 prot, me fond limit 2.999.457 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : kërkesë për propozim, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E. F. – juriste në Sektorin e Çështjeve Juridike.

E. H. – specialist në Sektorin Teknik në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK.

G. M. - specialist në Sektorin e Çështjeve Juridike.

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.103, datë 26.03.2021 nr.1465 prot me përbërje:

E. C. – kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

V. A. – anëtare, Përgjegjës në Sektorin e Çështjeve Juridike

E. B. – anëtar, specialist në Sektorin Teknik në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK.

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1464/1 prot , datë 29.03.2021.

Njoftimi i kontratës nr.1464/2 prot , datë 29.03.2021 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.49 datë 06.04.2021 faqe 94-95.

Me shkresën nr.1465/1 prot, datë 12.04.2021 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 3 (tre) operatorë ekonomik:

“AB.S.” shpk me NUIS K21..... me ofertë ekonomike 2.990.000 lekë pa tvsh

“P.S. shpk me NUIS L01..... me ofertë ekonomike 2.603.900 lekë pa tvsh

“S. CO” shpk me NUIS K11324003F me ofertë ekonomike 2.715.300 lekë pa tvsh

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1465/4 prot datë 16.04.2021 ku u kualifikuan dy operatorë ekonomik pjesmarrës “P.S.” shpk e “S. CO” shpk.

Është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Sekretari i Përgjithshëm raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr. 1465/5 prot datë 26.04.2021 pas mbarimit të afatit të ankimit. Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit me shkresën e titullarit të AK nr.1464/3 prot, datë 27.04.2021 që është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.66 datë 04.05.2021 faqe 116-117.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1821/2 prot, datë 11.05.2021, KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr. 1664/4 prot, datë 17.05.2021 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues “P.S.” shpk me NUIS L01..... me vlerë ekonomike 2.603.900 (dy milion e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh dhe 3.124.680 (tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me tvsh me afat realizimi 25 (njëzet e pesë) ditë nga lidhja e kontratës. Me shkresën e datës 17.05.2021 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar (i pa protokolluar). Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga Agjencia e Prokurimit Publik është botuar në faqen 289-290 në buletin e Njoftimeve Publike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

nr.79, datë 24.05.2021. Me shkresën nr.1464/7 prot, datë 28.05.2021 anëtar i njësisë së prokurimit i ka përcjellë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.143, datë 28.05.2021, (nr.2142 prot) është krijuar komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: N. D., T. P. dhe Sh. M. i cili ka marrë në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.2142/1 prot, datë 09.06.2021.

Likujduar me urdhër transfertën e datës 15.06.2021.

12) Procedura e Prokurimit : “Blerje karburant gazoil 10 ppm” me nr.REF 19598-02-14-2022

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje karburant gazoil 10 ppm”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.31, datë 07.02.2022 nr.576 prot Njësia e prokurimit : E. F. – juriste në sektorin e çështjeve juridike E. Y. – përgjegjës në sektorin e financës I. H. - specialist në sektorin e inspektimeve	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.26, datë 28.01.2022, nr.514 prot me përbërje: E. Y. – përgjegjës në sektorin e financës I. H. - specialist në sektorin e inspektimeve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.32, datë 07.02.2022 nr.577 prot me përbërje: M. P. – kryetar, drejtor i drejtorisë së shërbimeve të brendshme E. Sh. – anëtar, përgjegjës në sektorin e inspektimeve A. B. – anëtar, specialist në sektorin e licencave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1.558.000 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) G. C. G shpk me NUIS K66..... dhe G. O. G sha me NUIS K76..... me vlerë 1.860.000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me tvsh, me marzh fitimi 12 lekë për litër	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 8.000 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 28.02.2022	9.Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët ekonomike -Bashkimi i operatorëve ekonomike G. C. G. shpk me NUIS K66.... dhe G. O. G. sha me NUIS K76..... me ofertën me marzh fitimi në vlerë absolute 12 lekë pa tvsh për litër -Ka. shpk me NUIS J61..... me ofertën me marzh fitimi në vlerë absolute 18 lekë pa tvsh për litër
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1177/1 prot, datë 28.03.2022 me operatorin ekonomik G. C. G. shpk me NUIS K66..... me vlerë 1.860.000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me tvsh, me marzh fitimi 12 lekë për litër	Zbatimi i kontratës: Nuk është përlogaritur nga AK çmimi në momentin e dorëzimit të mallit siç shprehet qartë në kontratë neni 2 i saj dhe detyron legjislacioni në fuqi. AK është mjaftuar me llogaritjen e realizuar nga kontraktuesi.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.471 prot, datë 26.01.2022, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka bërë kërkesë për blerje “Blerje karburant gazoil 10 ppm” e cila është miratuar me vendimin nr.97 datë 21.12.2021 të bordit “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2022” ku është parashikuar edhe fondi për këtë objekt prokurimi.

Me urdhrin nr.26 datë 28.01.2022, nr.514 prot, është krijuar komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: E. Y. – përgjegjës në Sektorin e Financës, I. H. - specialist në Sektorin e Inspektimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Me relacionin nr.514/1 prot datë 07.02.2022 nga grupi i punës është hartuar përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlllogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në të dhënat e publikuara nga APP dhe me testim tregu nga 3 operatorë ekonomik.

- ✓ *Nga auditimi konstatohet se ofertat e ardhura nga operatorët ekonomik janë pa datë duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e përlllogaritjes së fondit limit.*

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i autoritetit kontraktor, kryetari znj.A. K. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.31, datë 07.02.2022 nr.576 prot, me fond limit 1.558.000 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, lloji i procedurës : procedurë e hapur e thjeshtuar, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E. F. – juriste në Sektorin e çështjeve Juridike

E. Y. – përgjegjës në Sektorin e Financës

I. H. - specialist në Sektorin e Inspektimeve

Është nxjerrë urdhri për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.32, datë 07.02.2022 nr.577 prot me përbërje:

M. P. – Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme

E. Sh. – anëtar, përgjegjës në Sektorin e Inspektimeve

A. B. – anëtar, specialist në Sektorin e Liçencave

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.576/1 prot , datë 14.02.2022.

Njoftimi i kontratës nr.576/2 prot datë 14.02.2022 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.23 datë 21.02.2022 faqe 45-46.

Me shkresën nr.577/1 prot, datë 28.02.2022 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku janë paraqitur 2 (dy) operatorë ekonomik:

- Bashkimi i operatorëve ekonomike “G. C. G.” shpk me NUIS K66..... dhe “G. O. G.” sha me NUIS K76..... me ofertën me marzh fitimi në vlerë absolute 12 lekë pa tvsh për litër.
- “Ka.” shpk me NUIS J61..... me ofertën me marzh fitimi në vlerë absolute 18 lekë pa tvsh për litër.

KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.577/4 prot datë 02.03.2022 ku u kualifikua bashkimi i operatorëve ekonomikë “G. C. G.” shpk me NUIS K66..... dhe “G. O. G.” sha me NUIS K76..... dhe u skualifikua për mosplotësim të kriterit të kualifikimit të kërkuar nga AK. Me shkresën nr.1044 prot datë 07.03.2022 njësia e prokurimit vijoi me njoftimin e fituesit paraprak, i cili u botua në buletin e njoftimeve publike nr.32, datë 15.03.2022.

Është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1034/2 prot, datë 17.03.2022 pas mbarimit të afatit të ankimit. Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit (pas afatit të ankimit) me shkresën e titullarit të AK nr.1160 prot datë 17.03.2022 që është publikuar në buletin e Njoftimeve Publike nr.36, datë 23.03.2022, faqe 155-156.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1034/1 prot, datë 08.03.2022 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Është nënshkruar kontrata me nr.1177/1 prot, datë 28.03.2022 midis AMA-s dhe bashkimi i operatorëve ekonomike “G. C. G.” shpk me NUIS K66..... dhe “G. O. G.” sha me NUIS K76....., përfaqësuar nga Klevis Mehmeti me autorizimin e administratorit të operatorit ekonomik “G. C. G.” shpk datë 07.03.2022 (kopje e të cilit i bashkëlidhet kontratës) me vlerë 1.860.000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me tvsh, me marzh fitimi 12 lekë për litër me afat realizimi nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2022.

- ✓ Referuar përcaktimeve të nenit 88, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kontrata duhet të nënshkruhet nga të dy operatorët e bashkimit, ku citohet shprehimisht “Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”.

Me shkresë nr.1177/2 prot datë 28.03.2022 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga agjencia e prokurimit publik është bërë me datë 30.03.2022 në sistem dhe është botuar në faqen 197 në buletin e njoftimeve publike nr.43, datë 04.04.2022 i cili nuk ndodhet në dosje sipas fletës së inventarit në dosjen e prokurimit.

Me shkresën nr.1352 prot, datë 30.03.2022 anëtari i njësisë së prokurimit i përcjell drejtorisë së shërbimeve të brendshme kontratën e nënshkruar.

- ✓ Plani i zbatimit të kontratës nr.1410 prot datë 04.05.2022 është hartuar dhe përcjellë Agjencisë së Prokurimit Publik pas afateve ligjore konkretisht nenit 124, pika 3, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet: “Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj” dhe nenit 125 “Autoriteti ose enti kontraktor njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për nënshkrimin e planit të zbatimit brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij”, si dhe nenit 107, pika 4, e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Nuk është përlllogaritur nga AK çmimi në momentin e dorëzimit të mallit siç shprehet qartë në kontratë neni 2 i saj dhe detyron legjislacioni në fuqi. AK është mjaftuar me llogaritjen e realizuar nga kontraktuesi.

Likujdimi është realizuar me urdhër transfertën e datës 07.04.2022 për faturën nr.2563, datë 05.04.2022 në vlerën 453.240 lekë dhe urdhër transfertën e datës 21.06.2022 për faturën nr.4264, datë 16.06.2022 në vlerën 1.406.662 lekë.

13) Procedura e Prokurimit : “Blerje Automjeti ” me nr.REF 222462-03-17-2022

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Automjeti”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.77, datë 10.03.2022 nr.1094 prot Njësinë e prokurimit : E. F. – juriste në sektorin e çështjeve juridike T. P. – specialist në sektorin teknik A.K. –përgjegjës në sektorin e administratës	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST me nr.61, datë 24.02.2022, nr.910 prot me përbërje: T. P. – specialist në sektorin teknik A. K. – përgjegjës në sektorin e administratës	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.78, datë 10.03.2022 nr.1095 prot me përbërje: E. C. – kryetar, drejtor i drejtorisë së mbikqyerjes B. H. – anëtar, specialist në sektorin e financës A. B. – anëtar, specialist në sektorin e licencave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4.663.284 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e	6. Oferta fituese (pa tvsh) P. A. shpk me NUIS K51..... 3.740.000 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 923.284 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

tetëdhjetë e katër) lekë		
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 28.03.2022	9. Burimi Financimit Të ardhurat e institucionit	10. Operatorët Ekonomike P. A. shpk me ofert. ek. 3.740.000 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa tvsh
11. Ankime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.1524/1 prot, datë 28.04.2022 P. A. shpk me NUIS K51..... me vlerë 3.740.000 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa tvsh e 4.488.000 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë me tvsh me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.121 datë 09.05.2022, nr.1984 prot është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit të përbërë: E. Sh., Sh. M. dhe E. D. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.1984/1 prot, datë 10.05.2022. Likujduar me urdhrë transfertën e datës 19.05.2022.	

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.462 prot, datë 25.01.2022, Drejtoria e Mbikqyerjes ka bërë kërkesë për prokurimin “Blerje Automjeti”. Kjo kërkesë miratohet me vendimin nr.6 datë 10.02.2022 të Bordit “Për një ndryshim në vendimin e AMA-s nr.97 datë 21.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2022”.

Me urdhrin nr.61, datë 24.02.2022, (nr.910 prot), është krijuar komisioni për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me përbërje: T. P. – specialist në Sektorin Teknik, A. K. – përgjegjës në Sektorin e Administratës.

Me relacionin nr.910/1 prot datë 07.03.2022 nga grupi i punës është hartuar përlogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike.

Përlogaritja e fondit limit sipas shkresës është bërë bazuar në ofertat të marra nga 3 operatorë ekonomik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Kryetari znj.A. K. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.77, datë 10.03.2022 nr.1094 prot., me fond limit 4.663.284 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh, lloji i procedurës : procedurë e hapur e thjeshtuar, prokurim elektronik duke ngarkuar njësinë e prokurimit të përbërë :

E. F. – juriste në Sektorin e çështjeve Juridike

T. P. – specialist në Sektorin Teknik

A. K. – përgjegjës në Sektorin e Administratës

Është nxjerrë urdhrë për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave me nr.78, datë 10.03.2022 nr.1095 me përbërje:

E. C. – kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyerjes

B. H. – anëtar, specialist në Sektorin e Financës

A. B. – anëtar, specialist në Sektorin e Licencave

Është mbajtur nga njësia e prokurimit procesverbali mbi miratimin e dokumenteve standarte të procedurës me nr.1094/1 prot , datë 16.03.2022.

Njoftimi i kontratës nr.1094/2 prot datë 17.03.2022 është publikuar në buletin e agjencisë së prokurimit publik nr.36 datë 23.03.2022 faqe 67-68.

Me shkresën nr.1095/1 prot, datë 28.03.2022 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit ku është paraqitur 1 (një) operatorë ekonomik: “P. A.” shpk me NUIS K51..... KVO-ja ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr.1095/4 prot datë 01.04.2022 ku u kualifikua operatori ekonomik pjesmarrës. Me shkresën nr.1396 prot datë 04.04.2022 njësia e prokurimit vijoi me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

njoftimin e fituesit paraprak i cili u botua në buletin e njoftimeve publike nr.46 datë 11.04.2022. Është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit e ofertave i hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave me shkresën nr.1095/5 prot, datë 11.04.2022 pas mbarimit të afatit të ankimit. Njësia ka ngarkuar në sistem njoftimin e fituesit (pas afatit të ankimit) me shkresën e titullarit të AK nr.1396/1 prot datë 11.04.2022 që është publikuar në buletin e njoftimeve publike nr.50 datë 19.04.2022 faqe 184.

-Lidhja e kontratës

Me procesverbalin nr.1426/1 prot, datë 07.04.2022 KVO-ja ka verifikuar dokumentat e ngarkuara në sistem me ato të dorëzuara fizikisht nga operatori ekonomik fitues.

Është nënshkruar kontrata me nr.1524/1 prot, datë 28.04.2022 midis AMA-s dhe operatorit ekonomik fitues "P. A." shpk me NUIS K51..... me vlerë 3.740.000 (tre milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë pa tvsh e 4.488.000 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë me tvsh, me afat realizimi 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Me shkresë nr.1396/2 prot, datë 29.04.2019 njësia e prokurimit ka hartuar formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar.

✓ Miratimi i publikimit të kontratës së nënshkruar nga Agjencia e Prokurimit Publik është bërë me datë 04.05.2022 në sistem dhe është botuar në faqen 196 në buletin e Njoftimeve Publike nr.59, datë 09.05.2022, i cili nuk ndodhet në dosje sipas fletës së inventarit në dosjen e prokurimit. Me shkresën nr.1906/1 prot, datë 29.04.2022 anëtar i njesisë së prokurimit i përcjell Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme kontratën e nënshkruar.

Me urdhrin nr.121 datë 09.05.2022, (nr.1984 prot) është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të procedurës së prokurimit i përbërë: E. S., Sh. M. dhe E. D. i cili mori në dorëzim objektin e kontratës me shkresën nr.1984/1 prot, datë 10.05.2022.

Likujduar me urdhër transfertën e datës 19.05.2022.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në hartimin e dokumentacionit justifikues të procedurave të prokurimit.
Situata:	Nga auditimi i disa procedurave të prokurimit rezultoi se: - Në pesë dosje prokurimi të audituara referuar akt-konstatimit "Sistem për monitorimin e subjekteve numerike", "Blerje Automjete ½ fuoristradë" "Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM", "Blerje pajisje server San Storage Area Network", "Blerje karburant gazoil 10 ppm". ofertat bashkëlidhur relacionit të përllogaritjes së fondit limit nga operatorët ekonomik janë pa datë duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e llogaritjes së fondit limit në kundërshtim me nenin 59, i VKM nr.914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar): "Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet". - Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Automjete ½ fuoristradë" nga KVO-ja nuk është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit dhe vlerësimit të saj për të konfirmuar hapat e ndjekur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas përcaktimeve detyruese të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar) në dosjen e procedurës së prokurimit "Blerje Automjete ½ fuoristradë". - Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburant gazoil 10 ppm" kontrata ishte e nënshkruar vetëm nga njëri prej OE, ku fitues



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	ishte BOE veprim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 88, pika 5, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, , ku citohet shprehimisht “Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar) neni 59,66 VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e gjurmëve të auditimit
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim punonjësit e ngarkuar në komisione të marrin masa të dokumentojnë proceset si pjesë e dosjes së prokurimit.

Titulli i Gjetjes:	Arkivimi i dosjes
Situata:	Nga auditimi i dosjeve të prokurimit me objekt “Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit sipas strategjisë së komunikimit” dhe “Blerje pajisje server SAN STORAGE AREA NETWORK”, rezultoi se: Parregullsi në vendosjen/ose mosvendosjen e numrit të protokollit të shkresave pasi një shkresë duhet të ketë një numër unik protokollit bazuar në nenin 19 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jositetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12 “Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë. Neni 13 Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

	materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar”.
Kriteri:	Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12, 13 dhe 19.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e gjurmëve të auditimit
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandimi:	Në vazhdim të merren masa që çdo shkresë që krijohet nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës.

7.Zbatimi i dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

(Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi e komunikimi, monitorimi).

Nga audituesit e autorizuar të KLSH-së u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe mbi këtë bazë u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të COSO-s në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), nga ku rezultoi sa vijon:

1. Autoriteti i Mediave Audiovizive është organ i pavarur, i krijuar me ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe që raporton në Kuvendin e Shqipërisë për veprimtarinë vjetore. (Ligji nr. 97/2013, ndryshuar me ligjin nr. 22/2016, datë 10.3.2016; ndryshuar me vendimin nr. 56, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; ndryshuar me ligjin nr. 91/2017, datë 22.5.2017).

Në nenin 6, Kreu II, të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se, “1. AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. AMA është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë. 3. AMA vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”

Për periudhën objekt auditimi, strukturat përgjegjëse dhe shërbimet e në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), kanë zbatuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit: ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021), si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

2. Politikat institucionale janë bazuar në misionin dhe objektin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), të rregulluara nga ligji Nr. 97/2013, datë 04.03.2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. U konstatua se, institucioni ka miratuar Planin Strategjik të Zhvillimit 2017-2019, Strategjinë e Komunikimit 2021-2022 dhe Planin Strategjik 2021-2023, ku gjejnë pasqyrimi misioni, vizioni, analiza e situatës dhe prioritetet si dhe plani i veprimit përkatës.

Në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, veprimtaria vjetore e AMA-s është shqyrtuar e vlerësuar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe sa sipër janë hartuar rezolutatat përkatëse, dërguar zyrtarisht me shkresën nr. 1759, dt. 6.7.2020 për vitin 2019; shkresën nr. 146/4, dt.5.7.2021 për vitin 2020; shkresën nr. 1317/2, dt. 3.6.2022 për vitin 2021.

Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit.

Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 *“Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”*, e cila është e transpozuar plotësisht në ligjin nr. 97/2013, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. (Direktiva 2018/1808), datë 14.11.2018). Këto ndryshime përfshijnë, ndër të tjera, disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve; ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare, rregulla të reja për platformat online, promovimin e veprave evropiane etj.

Nga intervistimi i stafit menaxherial, është bërë me dije se janë masat që, në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, për harmonizimin e legjislacionit të fushës audiovizive me *“acquis communautaire”*, si një detyrim për Shqipërinë dhe aktorët kryesorë të procesit të transpozimit të legjislacionit të BE-së, në fushën e mediave audiovizive, në Republikën e Shqipërisë, ku bëjnë pjesë Kuvendi dhe ministri i linjës, që mbulon fushën e komunikimeve elektronike, ku edhe AMA, jep kontributin e saj në procesin e transpozimit të ndryshimeve në legjislacionin kombëtar.

3. ***Nga ana e Kryetarit të AMA, në cilësinë e titullarit të njësisë publike, për gjithë periudhën objekt auditimi 2019-2022 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim të neneve 8 (pika 8/b), 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar:***

a) Nenin 8, pika 8/b ...Titullarët e njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:... ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

b) Neni 27/2: Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.

si dhe përcaktimet e kreut III, të Manualit “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar,(miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021), ku përcaktohet se:

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, nënvizohet se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

“Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike. GMS përbëhet nga titullari i njësisë (i cili është gjithashtu kryetar i grupit), zëvendës titullarët, NA, NZ dhe nga të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë (niveli me i lartë në vartësi të organizimit të njësisë publike).”

Nga ana e NA dhe NZ ekziston një paqartësi konceptuale në lidhje me organizimin, funksionet dhe detyrat e GMS, pasi në funksion të pyetësorit dhe listës së kërkesave të grupit të auditimit, lidhur me vënien në dispozicion të urdhrit për ngritjen Grupin të Menaxhimit Strategjik, rregulloren e veprimtarisë së GMS, dokumentimin e takimeve dhe vendimmarrjeve të GMS. Nga ana e këtij institucioni, **GMS konfondohet padrejtësisht me funksionet e Sekretariatit Teknik të Bordit**, ndaj për këtë pikë, si dokument referues në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH-së, është shënuar Vendimi i AMA-s nr. 248, datë 21.12.2016 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik dhe përcaktimin e masës së pagesës për pjesëmarrje në Sekretariat Teknik”.

Konstatohet se:

Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe rrjedhimisht nuk janë bërë objekt analize e vlerësimi aspektet kryesore të organizimit dhe funksionalitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm të këtij institucioni, të lidhura me funksionimin e nënsistemit të licensimit, të inspektimit e mbikëqyrjes, të financës, kontabilitetit dhe buxhetimit, të menxhimit të burimeve njerëzore dhe miradministrimit publik etj. si dhe komponentët e raportimit, menaxhimit të riskut, informacionit dhe komunikimit, monitorimit të progresit, etj.,

4. Nga auditimi i kryer në lidhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e **politikave brendshme** të dala në zbatim të ligjit, konstatohet se

A. Rregullorja e AMA është miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive”, ndryshuar me vendimin nr. 120, datë 06.08.2018, të Bordit të AMA-s. Rregullorja është e aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. ku trajtohen aspekte të rregullimeve dhe procedurave mbi organizimin e mbledhjeve të bordit, ushtrimin e veprimtarisë së AMA-s, votimin dhe zbatimin e vendimeve të këtij organi kolegjal, në përmbushje të funksioneve që i njeh ligji. Kështu, rregullorja e brendshme ka përfshirë aspekte të tilla si, funksionet dhe kompetencat e Autoritetit të Medias Audiovizive, si organ kolegjal; Parimet e veprimtarisë së Autoritetit; Thirrja e mbledhjeve të zakonshme të Autoritetit të Mediave Audiovizive; Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve; koha, vendi dhe mënyra e njoftimit; rendi i ditës, drejtimi mbledhjes, kuorumi, dokumentacioni shoqërues i mbledhjeve, format dhe vlefshmëria e vendimeve, roli i sekretariatit teknik, procesverbalet dhe vendimet e mbledhjes, etj.

B. Rezulton se, është miratuar nga ana e AMA-s, edhe Rregullorja për Strukturën Organizative të AMA-s, e cila është një akt nënligjor, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.01.2016 të Bordit të AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Rregullorja për strukturën organizative e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) përcakton norma të zbatueshme dhe kompetencat e AMA-s, të Këshillit të Ankesave, funksionet e Kabinetit, funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe funksionet e organizimit e Drejtorive të ndryshme, si asaj të Programeve, të Planifikimit të Frekuencave dhe IT, Juridike dhe Licencave, funksionet e DSHB, DBNJ dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Konstatim:

Rregullorja e organizmit dhe funksionimit të brendshëm e institucionit, bazuar dhe në kërkesat e Manualit mbi Menaxhimin Financiar e Kontrollin e Brendshëm duhet të përfshijë çështje dhe drejtime të tilla si, objektivat, organizimin, parimet, strukturën organizative, kompetencat, funksionet dhe bashkëpunimin, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Njesisë; funksionet, sekretariatet, përfaqësimin ligjor të institucionit; administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit; komunikimi i brendshëm me rrjet elektronik; dosjet e personelit; **raportimin e urdhrave të kundërshtuar; përshkrimet e punës; mënyrën e mbajtjes së korrespondencës me institucionet e tjera dhe me strukturat e ndryshme brenda njesisë;** përshkrimin e të gjitha drejtorive/strukturave përbërëse të autoritetit. Përshkrimi i çdo drejtorie/strukture duhet të ketë një nen të veçantë; **procedurat standarde të akteve administrative, marrëdhëniet e punës,** etj.

C. Institucioni ka hartuar Kodin e Sjelljes së anëtarëve të AMA-s, i cili është miratuar me Vendimin nr. 56, datë 04.04.2016, "Për miratimin e Kodit të Sjelljes të anëtarëve të AMA-s", i cili është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit.

Nga ana e shërbimeve të AMA-s janë ndjekur dhe monitoruar fushat prioritare dhe aktivitetet e planit të veprimit që shoqërojnë planin strategjik të institucionit të AMA-s, duke hartuar dhe raportet përkatës të monitorimit të këtyre aktiviteteve.

Në dokumentin e projektbuxhetit dhe në formatet e vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë, tregohen objektivat e vendosura në institucion për vitin si dhe në funksion të këtyre objektiveve, prezantohen objektivat për tu arritur si në lidhje me kalimin në transmetimet numerike, monitorimin e shfrytëzimit të spektrit frekuencor audio / audioviziv, kuadrin ligjor, aktet nënligjore dhe politikat, infrastrukturën e informacionit dhe të njohurive, rishikimin e tarifave për licenca/ autorizime dhe shërbime të tjera, veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe përputhshmërisë, rregullimet e teknologjive të reja në shërbimet e transmetimit audio, zhvillimin dhe zbatimin e planit të licencimit për shërbimet e transmetimi, transmetimet e operatorit publik dhe operatorëve të tjerë audiovizivë, shqyrtimin e ankesave, etj.

D. **Institucioni i AMA-s nuk ka hartuar e aprovuar Planin e Veprimit për zhvillimin e përmirësimit të Menaxhimit Financiar dhe Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2021 dhe 2022, në kundërshtim me kërkesat e Kapitullit IV, si dhe aneksin nr.11, të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.**

E. Institucioni i AMA-s nuk përmbush detyrimet për ngritjen e njesisë së sinjalizimit të brendshëm, në referencë të nenit 10/1, të Ligjit nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve" që ka specifikuar se "pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar, dhe subjekti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, sipas këtij ligji" dhe Vendimit KM nr.816, datë 16.11.2016, pasi numri i punonjësve të këtij institucioni për periudhën e audituar është nën 80 punonjës.

5. Në lidhje me përcaktimin e **nëpunësit autorizues (NA) dhe zbatues (NZ)** për institucionin e Autoritetit të mediave Audiovizive, grupi i auditimit konstaton sa më poshtë vijon:

- ✓ **Caktimi i nëpunësit autorizues znj.V. M.,** është bazuar në vendimin e Bordit të AMA-s nr. 27, datë 21.02.2018, (dhe Urdhrin nr. 60 date 21.02.2018 të Kryetarit të AMA-s), ku Znj.V.M. është emëruar në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm. Konfirmimi si Nëpunës




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Autorizues për institucionin e AMA-s, është dhënë sipas shkresës nr. 5873/1, datë 29.03.2018 “Mbi caktimin e nëpunësit autorizues për AMA”, të Ministrisë së Financave.

- ✓ Sipas shkresës nr. 2143 prot, datë 06.06.2017, AMA i është drejtuar Ministrisë së Financave mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues znj. M. P., me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Brendshme, dhe me shkresën e MF nr. 8239/1, datë 16.06.2017 është konfirmuar znj.M.P. në cilësinë e NZ të AMA.

Nga auditimi në AMA, rezulton se nga ana e institucionit të AMA kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 1, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010 i ndryshuar, në lidhje me vendosjen e një hierarkie të përshtatshme dhe të linjave të komunikimit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin sipas të cullës “Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion”.



6. Nga ana e institucionit për periudhës nuk janë marrë masat për përgatitjen dhe dërgimin në Ministrinë përgjegjëse për financat, të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratave të cilësisë dhe Raportet për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Plan Veprimi për MFK, në kundërshtim me nenin 18, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar, që shprehimisht ka parashikuar:

“Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.”

Situata:

Nga ana e këtij institucioni, kërkesës së grupit të audituesve të autorizuar të KLSH-së për vënien në dispozicion të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratës së Cilësisë, Raportit për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Plan Veprimi për zhvillimin e MFK-së, si dokument referues është shënuar se “Në zbatim të ligjit 97/2013, të ndryshuar, AMA raporton vetëm pranë Kuvendit të Shqipërisë, për veprimtarinë vjetore të saj, zhvillimet në fushën e transmetimeve dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

mënyrën se si janë respektuar nga detyrimet ligjore nga subjektet audio/audiovizive publik dhe private. Bashkëlidhur Raportet vjetore 2019-2021 dhe vendimet e AMA-s për miratimin e tyre”.

Audituesit e KLSH sjellin në vëmendje se raportimi në Kuvend bazohet në detyrimet e Nenit 14, pikës 2/ç, të ligjit nr. 97/2013:

Kryetari ushtron këto detyra kryesore: a) organizon, bashkërendon e drejton mbledhjet dhe veprimtarinë e AMA-s. Në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm, drejton veprimtarinë e administratës së AMA-s, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e AMA-s; b) i propozon AMA-s tematikën e mbledhjeve, rendin e ditës, problemet që do të shqyrtohen së bashku me projektvendimet e relacionet përkatëse; c) përfaqëson AMA-n në marrëdhëniet me të tretët dhe me organizatat ndërkombëtare; ç) **raporton në Kuvend për veprimtarinë vjetore të AMA-s.**

dhe nenin 20, pika 14 e këtij ligji:

AMA raporton në fillim të çdo viti për veprimtarinë vjetore të saj, zhvillimet në fushën e transmetimeve dhe mënyrën se si janë respektuar nga rrjeti publik dhe privat detyrimet, që rrjedhin nga ky ligj. **Raportin e paraqet para Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe para Kuvendit në seancë plenare.**

Por, nga ana tjetër, në kuptim të ligjit nr. 10296/ 2010, AMA është pjesë e njësive të qeverisjes qendrore, referuar nenit 4, pika 5 e tij:

“Njësi të qeverisjes qendrore” janë njësitet e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore. Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitet e vartësisë të kontrolluara prej saj.

Për rrjedhojë, nuk janë zbatuar detyrimet e nenit 18 “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, pika 1 e tij, në bazë të cilës.

Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.

Audituesit e pavarur të KLSH-së konstatojnë se nuk janë përmbushur brenda afatit ligjor, detyrimet për hartimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportet vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në referim të detyrimeve të pikës nr. 17, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.11.2008, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitet publike” dhe nenit 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “*deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave*”.

7. Rezultoi se gjatë periudhës 2019 - 2021, në 8 (tetë) raste të shqyrtuara, pjesërisht është vepruar në përputhje me kërkesat e neneve 9, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, Kodin e procedurave Administrative dhe udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

të zbatimit të buxhetit" dhe udhëzimin nr.4, datë 29.1.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Ministrisë së Financave, **për procedurat e delegimit dhe përfaqësimit ligjor.**

Më konkretisht janë ndjekur praktikat e delegimit, trajtuar në Projekt raportin e auditimit, derguar në subjektin e audituar:

Konstatim:

Procedurat e delegimit, nuk janë shoqëruar në çdo rast me raportimin mbi realizimin e detyrave të deleguara, sipas përcaktimeve të Kodit të procedurave Administrative, Ligjit për MFK, Kreut III "Procedura e delegimit sipas autorizimit që delegon", të Udhëzimit nr.4, datë 29.1.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Ministrisë së Financave.

Titullari i njësisë publike mund të delegojë disa nga të drejtat dhe detyrat e mësipërme, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim periodik për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në Aneksin I.

si dhe udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" .

8. Mbi rregullshmërinë e organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik (ST) të AMA-s.

- ✓ Sekretariati Teknik, është ngritur referuar Nenit 2, të Vendimit të AMA nr.248, datë 21.12.2016 "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik të AMA-s dhe përcaktimin e masës së pagesës në Sekretariatin Teknik" dhe në bazë të pika nr. 2 të këtij vendimi, është përcaktuar se, masa e shpërblimit e antarëve të ST është 15 mijë lekë për çdo mbledhje.
- ✓ Rregullorja e Autoritet të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 të Bordit, në Nenin 27, "Sekretariati teknik i Autoritetit të Mediave Audiovizive", ka parashikuar se:

1. Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në funksion të mirëorganizimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjes së organit kolegjal, ngrihet dhe funksionon Sekretariati Teknik, i drejtuar nga **Sekretari i Përgjithshëm dhe dy nëpunës të administratës** të caktuar me urdhër prej tij.
2. Sekretariati Teknik është përgjegjës për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji dhe kjo rregullore për mbledhjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, përgatitjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit, mbajtjen e procesverbalit, zbardhjen, publikimin dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
3. Sekretariati Teknik për ushtrimin e detyrës në funksion të mbledhjes së Autoritetit të Mediave Audiovizive merr shpërblim sipas legjislacionit në fuqi.

Përbërja e Sekretariatit Teknik të AMA për periudhën e audituar, është caktuar / ndryshuar sipas këtyre akteve:

- ✓ Sipas shkresës me nr.164, datë 21.02.2017, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 111, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatin Teknik", të nënshkruar nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, znj.A. Q. është emëruar në ST znj.S. Xh., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të DJ dhe Licencave.
- ✓ Sipas shkresës me nr. 685, datë 101.07. 2017, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 111, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatin Teknik", të nënshkruar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, znj. A. Q. është zëvendësuar znj.L. L., Specialiste e DJL me zj.Xh. H. , Sekretare e Kryetarit.

- ✓ Sipas urdhrorit me nr. 200, datë 30.08.2021, “Për një ndryshim në urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm me nr. 111 prptokolli, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik”, i ndryshuar”, të nënshkruar nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, znj.V. B. është zëvendësuar znj.Xh. H. me znj. E. M. Sekretar i Kryetarit.
- ✓ Sipas urdhrorit me nr. 61, datë 17.02.2021, “Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik”, të nënshkruar nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, znj.V. B. është caktuar znj. E. F., specialiste e Sektorit të Çështjeve Juridike në DJ dhe Licencave si nëpunës i ST.
- ✓ Sipas urdhrorit me nr. 237, datë 19.10.2021, “Për një ndryshim në urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm me nr. 111 prptokolli, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik”, i ndryshuar”, të nënshkruar nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, znj.V. B. është zëvendësuar znj.E. M. me zj.E. R., Sekretar i Kryetarit, si pjesë e ST.
- ✓ Sipas urdhrorit me nr. 249, datë 29.09.2022, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 111, datë 21.12.2016, i ndryshuar”, të nënshkruar nga ana e Kryetarit të AMA-s, znj.A. K. është zëvendësuar znj.S. Xh. me znj.V. A., me detyrë Drejtor i DJL , si anëtar i ST.

Nga ana e institucionit të AMA-s, bazuar në sistemin e dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, rezulton se janë zhvilluar mbledhjet e bordit të AMA-s dhe është kryer pagesa e tyre si dhe e Sekretariatit Teknik për periudhën 2019-6/2022, përkatësisht për:

- 19 mbledhje të zhvilluara në vitin 2019,
- 25 mbledhje të zhvilluara në vitin 2020,
- 25 mbledhje të zhvilluara në vitin 2021 dhe
- 26 mbledhje të zhvilluara për vitin 2022,

Pagesat e antëarëve të bordit të AMA-s janë kryer sipas urdhrave të lëshuar nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi pagesën e anëtarëve të AMA-s “, ku për çdo mbledhje janë shënuar anëtarët e AMA-s dhe ST që kanë marrë pjesë në mbledhje. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme janë aplikuar për Bordin e AMA-s tatimi në burim, kurse për Sekretariatit Teknik paga është bashkuar me shpërblimin për pjesëmarrje në mbledhjet e ST dhe është aplikuar shkalla tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Në mënyrë të detajuar, pagesat e kryera për Sekretariatit Teknik paraqiten si më poshtë vijon:

Në vitin 2019:

Në muajin janar, është kryer pagesa e ST për 1 mbledhje, (3 persona x 15 mijë lekë);
në muajin shkurt, për 3 mbledhje të AMA (3 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin mars, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin prill për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin maj, për 1 mbledhje të AMA (3 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin qershor, për 1 mbledhje të AMA (3 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin korrik, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin gusht, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin shtator, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin tetor, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin nëntor, për 3 mbledhje të AMA (2 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin dhjetor, për 2 mbledhje të AMA (2 persona x 2 x 15 mijë lekë);

Në vitin 2020:

Në muajin janar, është kryer pagesa e ST për 2 mbledhje, (2x 2 persona x 15 mijë lekë);
në muajin shkurt, për 2 mbledhje të AMA (2 x2 persona x15 mijë lekë);



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

në muajin mars, për 2 mbledhje të AMA (2 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin prill për 2 mbledhje të AMA (2 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin maj, për 3 mbledhje të AMA (2 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin qershor, për 3 mbledhje të AMA (3 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin korrik, ska mbledhje të evidentuar.
në muajin gusht, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin shtator, për 1 mbledhje të AMA (3 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin tetor, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin nëntor, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin dhjetor, për 4 mbledhje të AMA (3 persona x 4 x 15 mijë lekë);

Në vitin 2021:

Në muajin janar, është kryer pagesa e ST për 3 mbledhje, (3 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin shkurt, për 4 mbledhje të AMA (3 persona x 4 x 15 mijë lekë);
në muajin mars, **për 4 mbledhje të AMA (4 persona x 4 x 15 mijë lekë);**
në muajin prill **për 4 mbledhje të AMA (4 persona x 4 x 15 mijë lekë);**
në muajin maj, për 1 mbledhje të AMA (3 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin qershor, për 3 mbledhje të AMA (3 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin korrik, për 2 mbledhje të AMA (2 persona x 2 x 15 mijë lekë)
në muajin gusht dhe shtator ; ska mbledhje të evidentuar.
në muajin shtator, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin tetor, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin nëntor, për 2 mbledhje të AMA (2 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin dhjetor, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);

Për 6 mujorin e parë të vitit 2022:

Në muajin janar, është kryer pagesa e ST për 1 mbledhje, (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin shkurt, për 1 mbledhje të AMA (2 persona x 1 x 15 mijë lekë);
në muajin mars, për 3 mbledhje të AMA (2 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin prill për 3 mbledhje të AMA (2 persona x 3 x 15 mijë lekë);
në muajin maj, për 2 mbledhje të AMA (3 persona x 2 x 15 mijë lekë);
në muajin qershor, për 1 mbledhje të AMA (3 persona x 1 x 15 mijë lekë);

Konstatimi:

1. Caktimi pranë organit kolegjal të Autoritetit të mediave Audiovizive, i një Sekretariati Teknik, me tre punonjës për periudhën objekt auditimi (1 Janar 2019 - 30 Qershor 2022, kurse për periudhën Mars-Prill 2021 me 4 punonjës në përbërjen e tij), është veprim në kundërshtim me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, që shprehimisht ka përcaktuar se:

1. Çdo organ kolegjal ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. 2. Kryetari i organit kolegjal, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. 3. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përlikj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes. 4. Kryetari ose çdo anëtar tjetër i organit kolegjal ka të drejtë të bëjë ankime në gjykate kundër vendimeve të marra nga ky organ dhe të kërkojë pezullimin e zbatimit të tij, kur çmon se vendimi është i kundërligjshëm,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

si dhe në tejkalim të pozicioneve të strukturës organike të AMA-s, të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në vlerësimin e audituesve të pavarur të KLSH-së, ngritja e një Sekretariati me 3 punonjës, ku për periudhën objekt auditimi, për të cilin janë kryer pagesat për 70 mbledhje të kryera nga bordi i AMA-s për 2018-2022, (përkatësisht, 11 në vitin 2018, 19 në vitin 2019, 18 në vitin 2020 dhe 22 në vitin 2021 dhe 25 mbledhje gjatë vitit 2022), dhe ku janë kryer pagesa prej 15,000 lekë/mbledhje për çdo anëtar të Sekretariatit Teknik, është në tejkalim të përcaktimeve ligjore të mësipërme, dhe përbën një kosto të pajustificuar dhe shpenzim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Nga ana tjetër, grupi i auditimit sjell në vëmendje se, përgatitja e materialeve të mbledhjes, kryhet nga ana e administratës së Autoritetit.

Gjithashtu, në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblyerjet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”:

“Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion”,

krijimi i një hallke të tillë mbi përcaktimet e strukturës organike është një veprim në shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga Bordi i AMA, pasi struktura organizative është miratuar me vendimin nr. 19/2016, datë 10.3.2016, të Kuvendit, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)”, i ndryshuar.

2. Konstatohet se, me shkresën nr. 249, dt 29.9.2022, të nënshkruar nga ana e Kryetarit të AMA-s znj.A.K., është shfuqizuar shkresa e ish-Sekretarit të Përgjithshëm, përmes së cilës, në përbërje të ST zëvendësohet znj.S.Xh. me znj.V.A. Ky akt është në tejkalim të përcaktimeve të nenit 4, të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Sekretariatit Teknik të Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin nr. 248, datë 21.12.2016 të Bordit, ngj shpreh se,

Sekretariati Teknik përbëhet nga:

-Sekretari i Përgjithshëm i cili drejton dhe mbikëqyr punën e Sekretariatit Teknik dhe
-Dy nëpunës të administratës të caktuar me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm.

1. Nga auditimi rezultoi se, për një 4 mbledhje të zhvilluara gjatë muajit mars 2021 dhe 4 mbledhje të zhvilluara gjatë muajit prill 2021, pagesa e Sekretariatit Teknik është kryer për 4 (katër) persona, bazuar në nenin 4/4, të Vendimit nr.11, dt. 05.02.2021 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin e mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv të fushatës zgjedhore”, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 2, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
2. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e institucionit të AMA-s, rezulton se për periudhën 1.1. 2019 deri më 30.6.2022, në lidhje me Sekretariatit Teknik janë kryer pagesat në shumën prej 3,255 mijë lekë, që e detajuar sipas viteve paraqitet si më poshtë:
 - Për vitin 2019: 780 mijë lekë;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- Për vitin 2020: 945 mijë lekë;
- Për vitin 2021: 1,170 mijë lekë;
- Për 6mujojin I/2022: 360 mijë lekë;

Pagesat e mësipërme përbëjnë një efekt negativ dhe konsiderohen si shpenzim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet për fondet publike në administrim të këtij institucioni shtetëror.

Në lidhje me sa trajtuar në Projekt raportin e Auditimit, me anë të shkresës së AMA-s me nr. 1604 prot, datë 20.4.2023, (protokolluar në KLSH me nr. 896/6 prot., datë 20.4.2023), është paraqitur sqarimi, si më poshtë:

Në lidhje me Rekomandimet e pikës 1:

Sa i takon rekomandimeve të lëna në tërësi për përmirësimin dhe shfuqizimin e akteve nënligjore që përcaktojnë ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik (përmirësim/shfuqizim i nenit 27 të rregullores së AMA-s, rregullores për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik, ...) sjellim në vëmendjen tuaj sa më poshtë:

Më datë 13.04.2023, Kuvendi i RSH-së miratoi projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar. **Në këtë projekt-ligj, është përfshirë një dispozitë e veçantë që rregullon ngritjen, organizimin dhe detyrat e Sekretariatit Teknik të AMA-s, duke marrë në konsideratë specifikat që ka kjo strukturë në funksionalitetin e mbledhjeve të AMA-s, i cili vepron si organ vendimmarrës kolegjal.**

Ligji në fjalë hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe deri në 6 muaj pas hyrjes së tij në fuqi, AMA do të marrë masa për përditësimin e përkatësisht dispozitave të Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive (miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016) që lidhen me këtë strukturë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Periudha e auditimit ka qenë 1.1.2019- 30.6.2022 dhe shkelja e konstatuar i përket kësaj periudhe dhe u është bërë me dije strukturave drejtuese të AMA-s gjatë auditimit si dhe në takimin përmbyllës. Grupi i auditimit, vlerëson faktin që nga ana e subjektit rekomandimi është pranuar dhe do të ndërmerren veprimet korigjuese të nevojshme. Kjo kërkon që AMA të vijojë ta reflektojë kuadrin e rishikuar ligjor në veprimtarinë e përditshme dhe të ndërmerren masa për përditësimin e dispozitave të Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, (miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016).

9. Audituesit e pavarur të KLSH-së konstatojnë se janë përmbushur *pjesërisht* detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e **Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

U audituan me zgjedhje në lidhje me hartimin e risqeve praktikisht dokumentare të vitit 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe nga auditimi u konstatua se:

- ✓ Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe TIK është hartuar dhe miratuar nga ish-Kryetari i AMA z.G. S., dokumenti i regjistrit të risqeve mbi infrastrukturën e TIK, bazuar në rekomandimin e lëna nga ana e KLSH me shkresën nr. 779/39 prot., datë 31.12.2019 dhe nr. 2147, datë 04.08.2020. Gjithashtu është hartuar Udhëzuesi për Menaxhimin e Log-eve me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

nr. 1472 prot., datë 11.06.2020; Regjistri i Risqeve mbi infrastrukturën TIK me nr. 2493 prot., datë 09.09.2020; Regjistri i risqeve të elementëve të identifikuar si risqe të teknologjisë së Informacionit me nr. 2524 prot., datë 08.09.2020. Rezulton se, me vendimin e bordit të AMA nr. 51, datë 27.5.2022 “Për miratimin e politikës së përdorimit të internetit dhe e-mailit në AMA”, si dhe me vendimin nr. 50, datë 27.05.2022 janë miratuar politikat e sigurisë së informacionit në AMA.

Konstatim:

1. **Në institucionin e AMA-s, për periudhën objekt auditimi, nuk është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut (EMR) dhe nuk është caktuar Koordinator i Deleguar të Riskut dhe MKF (KDR; KDMFK), i cili drejton punën për hartimin e regjistrit të konsoliduar të riskut për institucionin, hartimin e planit të veprimit dhe rishikimin e strategjisë së riskut. Sipas përcaktimeve të pikës 1/b, të udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".**

Koordinatori i MFK dhe KR është nëpunësi autorizues (NA) i njësisë publike, i cili mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e MFK dhe koordinimin e riskut, punonjësve pjesë e strukturës së financës"

2. **Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet mbi përcaktimin e regjistrit të riskut për njësitë dhe drejtoritë e tjera të këtij institucioni publik, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296/ 2010 i ndryshuar, Manualit të MFK, si dhe përcaktimet e Nenit 10, "Menaxhimi i riskut lidhur me menaxhimin e aktiveve" të Udhëzimit të AMA me nr. 739, datë 12.12.2018, ku përcaktohet se:**

"Me qëllim që të mirëmbahen dhe evidentohen mungesat e aktiveve në raste dëmtimi të shkaktuar për çfarëdolloj arsye, DPFTIK për pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe sistemet e sigurisë dhe DSHB për aktivet e tjera hartojnë regjistrin e menaxhimit të riskut, i cili përmban identifikimin e risqeve dhe masat e nevojshme për mënjanimin e tyre".

- ✓ Nga ana e shërbimeve të institucionit të AMA-s, vlerësimi i riskut ka përfshirë **vetëm drejtoritë e veçanta dhe shërbimet TIK dhe mungon hartimi i kësaj matrice në shkallë institucioni, shoqëruar me vlerësimet e nevojshmebi nivelin e riskut, dhe mbajtjen e tij në nivelin e oreksit të riskut.**
 - ✓ Nga ana e NA së institucionit të AMA-s nuk janë zbatuar përgjegjësitë për ngritjen e **Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR)**, detyrim i parashikuar në Paragrafin nr. 50, të Aneksit nr. 6, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021 "Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit".
3. **Për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar dhe miratuar dokumenti i Strategjisë për Menaxhimin e Risqeve, në kundërshtim me përcaktimet e neneve 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2), të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.**

Në funksion të kërkesës së grupit të auditimit mbi vënien në dipozicion të Strategjisë së Vlerësimit të risqeve të AMA për periudhën objekt auditimi; është sjellë Raport vlerësimi për infrastrukturën dhe shërbimet TIK në AMA, (protokolluar me nr. 1394 prot., datë 11.04.2022);

10. Nga ana e institucionit të AMA-s zbatohen rregullat dhe **procedurat për mirëadministrimin dhe mbrojtjen e aktiveve**, detyrim i nenit 8, germa "ç", të ligjit nr. 10296/2010. Në zbatim të detyrimeve të pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, nga ana e NA të njësisë publike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

janë miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike. Kështu, institucioni ka një rregullore mbi "Parimet dhe rregullat e përgjithshme për mirëmenaxhimin e aktiveve në AMA", të miratuar me urdhrin nr. 739, datë 12.2.2018, të ish-Kryetarit z.G.S., në të cilën janë detajuar procedurat përkatëse për hartimin e regjistrit kontabël të aktiveve, hyrjen e aktiveve dhe regjistrimin e aktiveve atraktive e vepra arti, inventarizimin, plotësimin e nevojave për aktive, dokumentimin e lëvizjes së tyre, përgjegjësitë e hallkave dhe menaxhimin e riskut në mirëadministrimin, magazinimin dhe marrjen në ngarkim të tyre, rregullat e mirëmbajtjes së aktiveve afatgjata materiale, rregullat për sigurinë fizike të mjedisve të institucionit, etj.etj.

Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar **regjistri i aktiveve**, detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të Kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Audituesit e KLSH konstatojnë se janë iniciuar procedurat e **inventarizimit të pasurisë** dhe të drejtave e detyrimeve, përgjithësisht 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm, më hollësisht, trajtuar kjo çështje tek kapitulli mbi kontabilitetin dhe bilancin kontabël vjetor.

11. Audituesit e pavarur të KLSH konstatojnë se kanë gjetur pjesërisht zbatim detyrimet për përgatitjen e gjurmës së auditimit në lidhje me hartimin dhe zbatimin e buxhetit, pasqyrave financiare vjetore, raportimin vjetor mbi MFK.

Konstatim.

A. Ky dokument është hartuar vetëm për aspektet e brendshme financiare dhe nuk është miratuar e arkivuar Gjurma e Auditimit, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr.10296/2010 i ndryshuar, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik të institucioneve shtetërore për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:

"2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

B. Nuk është hartuar dhe miratuar një gjurmë auditimi mbi mënyrën se si operohet nga hartimi i kërkesave për mallra e shërbime, deri në marrjen në dorëzim të tyre dhe mungon shtrirja e gjurmës së auditimit në të gjitha proceset kryesore që përfshin veprimtaria e institucionit, të tilla si fushën e licensimit dhe dhënies së autorizimit, gjurma e proceseve të inspektimit të përcaktuara në procedurën standarde të punës, gjurma e dokumentacionit për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, kontabilizimit dhe ndjekjes së detyrimeve debitore të subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara / autorizuar dhe subjekteve të palicencuara / autorizuar nga AMA etj., e cila duhet të standardizohet dhe ti nënshtrohet procesit të miratimit, veprime e mosveprime në kundërshtim me parashikimet e nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar:

"Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

së dosjeve.

si dhe kërkesat e Kreut III, Kapitulli III.3, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, të Ministrit të Financave.

Në **fushën e Protokoll - Arkivës dhe Ruajtjes së Informacionit shkresor e elektronik** në institucionin publik AMA, në lidhje me rregullat që lidhen me të drejtën e hyrjes (aksesit) mbi informacionin e zakonshëm e të klasifikuar rezultoi se procedurat për regjimin e qarkullimit shkresor janë përfshirë në “Manualin e regjimit të qarkullimit, përpunimit dhe administrimit shkresor”, dokument i hartuar në Shtator të v.2017. Komisioni i Ekspertizës është ngritur çme urdhrin nr. 123, dt. 17.11.2017 dhe është ndryshuar me nr. 325, datë 19.12.2019, nr. 320 datë 16.12.2019, etj. Bazuar në nenin 7, pika 1 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” Komisioni i Ekspertizës së AMA ka miratuar listën e dokumenteve me afatet e ruajtjes së tyre.

Konstatim:

Nga ana e DP të Arkivave është kryer inspektim në institucionin e AMA-s, ku janë pasqyruar gjetjet kryesore për sekretari-arkivën, sipas pikave të pasqyruara në procesverbalin e mbajtur. Në referim të shkresën nr. 935/3 prot, dtë 25.02.2022, janë konstatuar mangësi e parregullsi të tilla si, nuk përdoret libri i dorezimit mod 4/1, nuk respektohen elementet bazë në shkresat zyrtare, nuk është bërë përpunimi, miratimi dhe hapja e dosjeve sipas pasqyrës emërtuese, nuk është bërë hartimi i listës së veçimit dhe asgjësimit të dokumenteve me afat ruajtje të përkohshëm, nuk janë dorëzuar dokumentet me RHK që kanë plotësuar afatin e maturimit në institucion, etj.

12. Në institucionin e AMA-s janë përgatitur, diskutuar dhe miratuar **Hartat e Punës për Proceset Kryesore (HPKP)**, të cilat shërbejnë si dokument referimi, kontrolli dhe auditimi përmes të cilave, janë dokumentuar aktivitetet e kontrollit të detajuara sipas proceseve të punës dhe procedurave të brendshme. Hartat e Proceseve Kryesore të Punës kanë përfshirë proceset bazë në drejtoritë dhe shërbimeve të AMA-s si p.sh Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe e Licensimit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Mbikëqyrjes, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Marrëdhënieve dhe Jashtë, etj.,
13. Shërbimet e ndryshme të institucionit të AMA-s, si pjesë e aparatit shtetëror, i nënshtrohen legjislacionit në fuqi që rregullon **veprimtarinë administrative dhe funksionet horizontale**, ndaj i gjithë dokumentacioni i administruar pranohet, evidentohet, shpërndahet, dhe arkivohet në afatet e caktuara, sipas parashikimeve të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", po kështu edhe sipas dispozitave specifike në Rregulloren e Brendshme të institucionit, miratuar nga ana e bordit të AMA-s.

Konstatohet se:

Struktura organizative në Institucion reflektohet në një dokument të shkruar, të miratuar nga ana e bordit të AMA-s, me vendimin nr. 19/2016, ndryshuar me vendimin nr. 69, datë 20.4.2018 “Për një ndryshim në vendimin nr. 19/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të punë në Autoritetin e Mediave Audiovizive” dhe që i është bërë me dije të gjithë stafit, me qëllim që të kuptohen drejtë marrëdhëniet epror - vartës, marrëdhëniet mes strukturave të shërbimeve, dhe vendosjen e një sistemi të përshtatshëm për delegimin e detyrave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Është hartuar dhe miratuar ***Mauali i Përshkrimit të Punëve për pozicionet e punës në institucion,*** në përputhje me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit. ***Konkretisht:***

“Përshkrimi i punës miratohet nga:

- a) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për Kryeministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit;*
- b) Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të pavarur, për institucionet e pavarura;*
- c) sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, për ministrinë dhe institucionet në varësi të ministrit;*
- ç) Sekretari i Përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent me të, për njësitë e qeverisjes vendore.”*

Nga auditimi u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës, në mbështetje të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, si dhe pikës nr. 4.1.1., Kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike (DAP) nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Në pikën 14, të Kreut IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, të VKM-së nr.142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”*.

Konstatohet se janë hartuar kalendarët e analizës së nevojave për trajnim (shkresa nr. 795, datë 18.02.2022), bazuar në dokumentin e manualit të politikave të trajnimit dhe atyre zhvilluese e motivuese, për përmirësimin e performancës së stafit.

Autoriteti i Mediave Audiovizive funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 19/2016, datë 10.3.2016, të Kuvendit, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)”, i ndryshuar me vendimin nr. 77/2018, datë 21.6.2018, të Kuvendit. Rezulton se në institucionin e AMA-s gjatë vitit 2021 është kryer inspektimi dhe mbikqyrja e specializuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil, ku është verifikuan procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për periudhën janar 2018 - maj 2021; dokumentet e administruara në dosjen e personelit që provojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, etj.

Përshkrimet e punës së çdo punonjësi. (përshkrimet e punës të punonjësve sipas sektorëve dhe drejtorive janë kryer në përmbledhje të misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës, bazuar në të gjithë elementet e formularit të përshkrimit të punës.

Manualët e Proceseve të Punës (me të cilin janë njohur të gjithë punonjësit pasqyrojnë në kapituj të ndryshëm, proceset e punës, rregullat e etikës, menaxhimin e burimeve njerëzore, kohën e punës dhe pushimit, punësimi, organizimi i drejtorive, linjat e raportimit, bashkëpunimi dhe marrëdhënia me drejtoritë etj. Manuali është njohur nga i gjithë stafi, duke u përcjellë edhe nëpërmjet trajnimeve të brendshme, organizuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

Aktivitetet e kontrollit:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar mbivendosje të detyrave dhe funksioneve.

U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, por rezultojnë një ngarkesë e pa studiuar e punës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme (Sektori i Financës), në kushtet e ndjekjes së shumë detyrave, angazhimeve, detyrimeve për kontabilizimin dhe vjeljen e detyrimeve që lindin si pasojë e parashikimeve të legjislacionit dhe funksionimit të AMA-s në rolin e agjentit tatimor, etj., në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr.32, datë 29/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive”, të nënshkruar nga Ministri i Financave dhe Kryetari i AMA-s.

Identifikimi i nevojave për trajnime, planifikimi dhe kryerja e trajnimeve janë ndjekur dhe trajtuar nga ana e personelit përgjegjës në fushën e MFK. Dosjet për çdo vit objekt auditimi janë administruar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, e cila në fillim të çdo viti harton një kalendar vjetor trajnimesh për nëpunësit në bashkëpunimi me drejtoritë e tjera të AMA-s. Ky kalendar hartohet duke përshtatur rastin për trajnim të nëpunësit me llojin e programit të ofruar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), në të cilin përfshihen tre kategori trajnimesh: - *trajnim i thelluar, trajnim i vazhdueshëm dhe trajnim sipas nevojave*. Të gjitha llojet e trajnimeve janë ndjekur në vijmësi nga Sektori i Burimeve Njerëzore, nëpërmjet komunikimit elektronik e shkresor, deri në çertifikimin e punonjësit. Gjithashtu në funksion të këtij procesi është hartuar “Manuali i politikave të trajnimit dhe atyre zhvilluese, motivuese për përmirësimin e performancës së stafit”, si dhe janë organizuar trajnime brenda stafit, zhvilluar nga Sektori i Burimeve Njerëzore, duke shfrytëzuar eksperiencën e nëpunësve civilë në pozicione drejtuese, por edhe duke u alternuar me nëpunësit e tjerë.

Plotësimi i vendeve vakante me persona që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe eksperiencë, (sa i përket vakancave në pozicionet e punës të krijuara rast pas rasti (ato janë plotësuar në respektim të procedurave ligjore sipas ligjit nr 152/2013 “ Për nëpunësin civil”, duke filluar me shpalljen e pozicionit në faqen zyrtare të AMA-s dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në të cilën janë përcaktuar kriteret e përgjithshme e specifike që përban pozicioni përkatës i shpallur, referuar përshkrimit të punës. Administrimi i shërbimit civil sipas nenit 18 të ligjit “Për nëpunësin civil” bazohet në Planin Vjetor të Pranimit, i cili është kryer në fillim të çdo viti. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil sipas kompetencës ligjore sa i përket zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, ka ushtruar kontroll në AMA, në vitin 2021 duke inspektuar çdo praktikë administrimi në lidhje me punësimin dhe ka paraqitur raportin përfundimtar.

Për nëpunësit civil janë kryer sipas ligjit dy herë në vit vlerësimet e rezultateve në punë.

Informacioni dhe Komunikimi:

Nga auditimi rezultojnë se është miratuar dokumenti i “Strategjisë së komunikimit të AMA-s 2021–2022”, i cili mundëson një udhëzues për transparencën dhe komunikimin me publikun. Dokumenti shoqërohet me një plan veprimi të strukturuar që mundëson zbatimin e saj në praktikë. Konstatohet se nga ana e këtij institucioni botohet rregullisht Raporti Vjetor i veprimtarisë së AMA-s.

NA, NZ, dhe drejtuesit e tjerë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Titullari informohet nga Nëpunësi Autorizues, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme. Funksionimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, ndjekjes së çështjeve të deleguara, etj. AMA përditëson faqen zyrtare në website, ku jepet informacion i zgjeruar dhe i përditësuar për aktivitetin e Institucionit.

Monitorimi

Gjatë periudhës objekt auditimi, nga ana e stafit të AMA janë përgatitur edicionet e **Buletinit Periodik**, që japin një pasqyrë të dinamikës në tregun audio/audioviziv, ku përfshihen dhe tregues me natyrë ekonomiko-financiare, teknike e teknologjike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore të angazhuara etj. Buletini është jo vetëm, një produkt i standardizuar, si ndihmë konkrete për analizuar problematika e prirje brenda një viti ose duke bërë krahasime nga një periudhë në një tjetër, por edhe një material ndihmës jo vetëm për stafet e OSHMA-ve, ku shikohet performanca e subjektit të tyre në raport me të gjithë tregun, ose segmente të caktuara të tij, por edhe si dokument për kërkuesit dhe studiuesit e tregut audio/audioviziv, studentët e gazetarisë e të komunikimit, për institucionet vendase dhe të huaja që monitorojnë dhe mbështesin projekte dhe programe në sektorin mediatik etj.

Në institucionin e AMA-s nuk është ngritur Njësia e Auditimit të Brendshëm. Referuar përcaktimeve të kuadrin rregullator në fuqi, pasi institucioni i AMA, nuk plotëson kushtet dhe përcaktimet e nenit 10, “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm”, të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Nenin 4, paragrafi 22, të ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe pikën nr.3, të VKM nr.83, datë 3.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi, institucioni i AMA-s, për periudhën e audituar ka ndërtuar dhe mirëmbajtur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të vlerësuar pjesërisht efektiv.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

1. Gjetje nga auditimi:

Mungon harmonizimi ndërmjet ligjit nr.97/2013 mbi mediat audiovizive dhe akteve të dala në zbatim të tij, si dhe ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Nevoja e rishikimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore mbi statusin dhe trajtimin financiar të Sekretariatit Teknik të AMA.

1.Caktimi pranë organit kolegjial të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i një Sekretariati Teknik, me 3 (tre) punonjës për periudhën Janar 2019 - Qershor 2022 dhe me 4 (katër) punonjës për periudhën Mars-Prill 2021, është veprim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 2, pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, që shprehimisht ka përcaktuar se, “Çdo organ kolegjial ka **një kryetar dhe një sekretar**, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me perjashtim të rasteve kur me ligj



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

parashikohet ndryshe”, si dhe në tejkalim të pozicioneve të strukturës organike të AMA-s, të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Rezulton se për Sekretariatit Teknik të AMA janë kryer pagesat për 95 mbledhje të zhvilluara nga bordi i AMA-s për 2018-2022, (*përkatësisht, 11 në vitin 2018, 19 në vitin 2019, 18 në vitin 2020 dhe 22 në vitin 2021 dhe 25 mbledhje gjatë vitit 2022*), në shumën prej 15,000 lekë / mbledhje për çdo anëtar të tij, veprim ky në tejkalim të përcaktimeve ligjore të mësipërme, dhe kjo përbën një kosto të pajustifikuar dhe shpenzim pa efektivitet e ekonomicitet të fondeve publike.

Gjithashtu, në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, “*Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion*”. Krijimi i një hallke të tillë mbi përcaktimet e strukturës organike është një veprim në shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga Bordi i AMA, pasi struktura organizative është miratuar me vendimin nr. 19/2016, datë 10.3.2016, të Kuvendit, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)”, i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.Rekomandimi:

1.1. Nga ana e AMA të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, (duke mbajtur parasysh miratimin me datën 13.04.2023, nga ana e Kuvendit të RSH-së, të projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar), nëpërmjet përmirësimit /shfuqizimit të:

- Rregullores së Autoritet të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 të Bordit, e cila në Nenin 27 të saj, ka të përfshirë “Sekretariatit Teknik të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, dhe të
- Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik të AMA-s dhe përcaktimin e masës së pagesës në Sekretariatit Teknik”, miratuar me Vendimin e AMA nr.248, datë 21.12.2016.

Bordi i AMA-s të bashkërendojë dhe harmonizojë këto akte nënligjore me kërkesat e ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

1.2. Nga ana e AMA të merren masat për shfuqizimin e Urdhrit nr. 111, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e nëpunësve në Sekretariatit Teknik”, i ndryshuar dhe të kryhet veprimtaria e institucionit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 i ndryshuar dhe në bashkërendim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Afati: Në vijimësi.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi:

Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave, që sipas përcaktimeve të VKM Nr.468, datë 03.06.2015 janë pjesë e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të këtij institucioni. Autoritetit të Mediave Audiovizive i ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar objekti me emërtimin “*Atelier për Dekorin e Radio Televizionit*”, në zonën kadastrale nr. 8160 me numër pasurie 2/94, me sipërfaqe. totale 10,177 m² dhe sipërfaqe ndërtese



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

6,202 m². Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivet Afatgjata Materiale pasqyrojnë vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksionin e kryer në objektin ndërtimor. Procedurat e transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivit afatgjatë material “Ndërtesa” janë kryer sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, mirëpo mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies për zërin “Ndërtime e konstruksione”, kanë regjistruar vlerën neto prej 82,417 mijë lekë, që i përket rikonstruksioneve të kryera ndër vite.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi:

Duke patur parasysh rëndësinë e këtij procesi për të pasqyruar vlerën e drejtë të këtij aktivi në pasqyrat financiare të institucionit, pasaktësitë e informacionit të mbartur në Autoritetin e Mediave Audiovizive për vlerën e kësaj godine, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që aktivet afatgjata materiale në administrim të institucionit të AMA të pasqyrohen me vlerën e drejtë e të saktë në kontabilitetin e institucionit. *Për sa sipër*, të merren masat për transferimin me dokumentacion të vlerës së Aktivit dhe kryerjen e një procesi vlerësimi të pavarur, duke përcaktuar vlerën e objektit, vlerën e amortizimit dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke evidentuar vlerën e drejtë në kontabilitet në llogarinë 212 “Ndërtesa”, në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 “Aktivet Afatgjata Materiale” dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues të kryhen regjistrimet e vlerës së re të aktiveve të institucionit sipas VKM Nr.468, datë 03.06.2015.

Afati: Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:

Nuk është regjistruar në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare të periudhës së audituar 2019-2022, vlera e trojeve në administrim të institucionit, aspekte këto që ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël për institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, që sipas përlllogaritjeve referuar VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), për zonën kadastrale ZK 8160, sipas 343,524,635 lekë.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Rekomandimi:

2.1. Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të ngrejnë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane, të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.2. Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së llogarisë “Toka, troje dhe terrene” në pronësi dhe administrim të AMA, bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e AMA-s i vlerave të kësaj pasurie, bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesit e pavarur.

Afati: Brenda datës 31.03.2024

3.Gjetje nga auditimi:

Pamjaftueshmëri e marrjes së masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative, arkëtimin e të drejtave mbi debitorët si dhe shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

kundrejt të tretëve, veprime në kundërshtim me germat “g” dhe “gj”, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuar dhe subjekteve të palicencuara/ autorizuar nga AMA, debitorëve dhe klientëve dhe që ka trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht në shumën prej 442 milionë lekë në vitin 2019, 450 milionë lekë në vitin 2020, 446 milionë lekë në vitin 2021 dhe 487 milionë lekë në fund të 6-mujorit të parë 2022.

Më hollësisht,

Bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion të audituesve shtetëror të autorizuar, rezulton se niveli i detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuar dhe subjekteve të palicencuara/ autorizuar nga AMA paraqitet me një trend rritës. Detyrimet e subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara/autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/ autorizuar si dhe të drejtata e tjera të arkëtueshme nga AMA, në fund të vitit 2020 janë për 450,418 mijë lekë, me një rritje nga viti 2019 për 8 milionë lekë:

Gjatë periudhës 2015-2022, nga ana e AMA-s, disa subjekteve për arsye të shkeljeve të ndryshme ligjore të konstatuara, u janë hequr licencat dhe autorizimet, mirëpo deri në momentin e heqjes së licencave, këto subjekte rezultojnë me detyrime financiare të papaguara, detyrime këto të lindura gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencave /autorizimeve dhe të paarkëtuara, duke shtuar mundësinë e parashkrimit të këtyre të drejtave për arkëtim. Rezulton se vlerat e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” ndaj AMA-s, nga ana e subjekteve që kanë qenë pajisuar me licenca dhe autorizimi, por që u janë hequr licencat dhe autorizimet gjatë periudhës 2015-2022, evidentojnë detyrime të konsiderueshme financiare, ku në fund të vitit 2020 ishin për 117 milionë lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqiten për 98 milionë lekë, shuma këto që përfaqësojnë mbi 20 % të llogarive të arkëtueshme vjetore të institucionit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3. Rekomandimi:

3.1. Institucioni i AMA-s të marrë masat e menjëhershme për kryerjen e një analize të thelluar të debitorëve dhe të drejtave për arkëtim të regjistruar në kontabilitet, hartimin e planeve konkrete për ndjekjen dhe vendosjen e tyre në kushtet e arkëtimit, sidomos në kushtet që një pjesë e madhe e tyre kërcënohen nga risku i parashkrimit. Ky proces të shoqërohet me nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre.

3.2. Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar. Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet, (neni 12, pika 2, germa “g”), është përgjegjës për: “garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa arkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij...”, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të AMA-s, të marrin dhe të kërkojnë në rrugë zyrtare e gjyqësore arkëtimin e debive, nëpërmjet ngritjes së padisë me qëllim arkëtimin e këtyre detyrimeve.

3.3. Të hartohet dhe miratohet Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e AMA-s. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrë masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga këto vendime gjyqësore dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me kërkesat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

e legjislacionit për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike, udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Afati: Menjëherë e në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin nr.98 prot, datë 10.01.2022 “Kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve si dhe materialeve të magazinës të Institucionit”, të titullarit të AMA në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresën nr.1388 prot, datë 17.03.2022 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra dhe aktive të dëmtuara. Nga ana e Institucionit nuk është ngritur një komision për procesin e dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit, duke mos e finalizuar deri në fund procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Planifikimi i buxhetit për shpenzimet e investimeve në kategorinë “Studime, kërkime dhe anketime”, që për periudhën objekt auditimit arrijnë deri në 45 % të investimeve vjetore gjithsej, nuk është mbështetur në programimin e treguesve dhe analiza të mirëfillta, pasi nuk janë hartuar preventivat e vlerave të projekteve, nuk janë hartuar fishat e projekteve përpara lancimit të thirrjeve, përcaktimi i vlerave totale të këtyre projekteve është bërë apriori, sipas përvojave të viteve të mëparshme. Mungesa e një kostoimi dhe analize të mjaftueshme e të detajuar për aprovimin e buxhetit për këto kategori të shpenzimeve për investime nga ana e AMA-s, tregon për një planifikim të dobët e të paargumentuar të buxhetit dhe një raportim jo të përshtatshëm. Nga sa më sipër, evidentohen devijime si në numrin e projekteve që inicohen dhe atyre që realizohen efektivisht, ashtu edhe në respektimin e shumave të vëna në dispozicion për kategorinë e projekteve për studime dhe anketime, miratuar në vendimin e AMA për miratimin e buxhetit vjetor.

5.1. Nga auditimi i kyer mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së si dhe intervistat e strukturuar të realizuara me zyrtarët përgjegjës të stafit të AMA-s, rezulton se, anëtarët e AMA në mbledhjen e dt 24.12.2020 kanë propozuar shtimin e zërit “Studime, kërkime dhe anketime” me 4,600 mijë lekë në buxhet, si pakësim nga një zë tjetër i buxhetit të institucionit, por kjo vendimmarrje është kryer pa u thelluar në shpjegimin e arsyeve të këtij transferimi. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e mjaftueshme mbi analizat që Bordi ka bërë përpara aprovimit të buxhetit dhe mosaprovimin e kërkesave fillestare të paraqitura nga ana e Titullarit dhe Nëpunësit Zbatues, etj.

5.2. Nuk përputhet numri dhe vlera e projekteve të realizuara kundrejt atyre të miratuar në planin vjetor të miratuar nga ana e Bordit të AMA-s, dhe për sa sipër, kjo nuk justifikohet me dokumente të mjaftueshme rreth këtyre mospërputhjeve sipas viteve të analizuara.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5. Rekomandimi:**

5.1. Bazuar në faktin se, në llogarinë 202 “*Studime dhe projekte*” janë përfshirë dhe përkthime, anketime, etj., kërkohet një vlerësim të kujdesshëm mbi domosdoshmërinë dhe argumentimin e përfshirjes së tyre në kategorinë e investimeve për “*studime dhe anketime*”; institucioni të adresojë prioritetet e planifikuara sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor mbi menaxhimin e financave publike, në harmoni me afatet kohore të përcaktuara me qëllim që të sigurojnë një shpenzim efikas dhe efektiv të buxhetit të planifikuar duke gjykuar rast pas rasti, mb vlerat, dobinë dhe domosdoshmërinë e projekteve të përzgjedhura; duke arsyetuar nëse një zë apo projekt duhet të përfshihet në grupin e aktiveve afatgjata jomateriale, apo duhet kategorizuar si “shpenzime të ushtrimit”; si dhe vendimarrja e AMA të mbështetet në analiza të mjaftueshme dhe në një dokumentim të plotë të kostos së këtyre projekteve.

5.2. Gjatë hartimit të buxhetit të AMA-s, drejtoritë përgjegjëse, të identifikojnë nivelin e zbatimit të këtyre projekteve/objektivave, në mënyrë që këto projekte të aprovohen në bordin e AMA-s, dhe në vijimësi të merren në analizë për vonesat apo mosrealizimet e tyre. Projekt propozimet për investime të përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara sipas Programit për Investimet Publike dhe ky proces planifikimi i aktiviteteve të diskutohet dhe kalojë në filtrat e brendshëm të drejtorive deri në analizimin nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik të AMA-s, me qëllim realizimin e projekteve më të domosdoshme, më të dobishme dhe me impakt, si dhe të ndihmojnë në zvogëlimin e devijimeve mes planifikimit fillestar dhe realizimit të buxhetit të AMA-s për këto zëra.

Afati: Çdo vit.

6. Gjetje nga auditimi:

6.1. Nga ana e Kryetarit të AMA, në cilësinë e titullarit të njësisë publike, për gjithë periudhën objekt auditimi 2019-2022 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim të neneve 8 (pika 8/b), 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të përcaktimeve të kreut III, të Manualit “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021). Në këto kushte, nuk janë bërë objekt analize e vlerësimi aspektet kryesore të organizimit dhe funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të këtij institucioni, të lidhura me funksionimin e nënsistemit të licencimit, të inspektimit e mbikëqyrjes, të financës, kontabilitetit dhe buxhetimit, të menxhimit të burimeve njerëzore dhe miradministrimit publik etj., si dhe komponentët e raportimit, menaxhimit të riskut, informacionit dhe komunikimit, monitorimit të progresit, etj.

6.2. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet mbi hartimin e regjistrit të riskut për gjithë hallkat dhe drejtoritë e këtij institucioni publik, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296/ 2010 i ndryshuar, Manualit të MFK, si dhe përcaktimet e Nenit 10, “Menaxhimi i riskut lidhur me menaxhimin e aktiveve” të Udhëzimit të AMA me nr. 739, datë 12.12.2018. Në institucionin e AMA-s, vlerësimi i riskut ka përfshirë vetëm drejtoritë e veçanta dhe shërbimet TIK dhe mungon përgatitja e kësaj matrice në shkallë institucioni, shoqëruar me vlerësimet e nevojshme mbi nivelin e riskut, dhe mbajtjen e tij në nivelin e oreksit të riskut, etj. Nuk i janë nënshtruar përditësimit dhe rishikimit dy herë në vit të dokumentit të Regjistrit të Riskut, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

6.3. Nuk është hartuar e miratuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për institucionin e AMA për vitet 2019-2022, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

6. Rekomandimi:

6.1. Nga ana e Bordit të AMA-s, të merren masat që hartohet dhe miratohet dokumenti i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Riskut për vitet 2023-2025.

Afati: Brenda 3 muajsh.

6.2. Shërbimet e AMA-s të marrin masat për hartimin e regjistrit të riskut për gjithë drejtoritë e institucionit si dhe të plotësojnë, azhurnojnë dhe përditësojnë Regjistrin e Riskut për programe dhe objektiva specifike 2 (dy) herë në vit, në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Afati: Çdo 6-mujor.

7. Gjetje nga auditimi:

7.1. Nga ana e Nëpunësit Autorizues të institucionit të AMA-s nuk janë zbatuar përgjegjësitë për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 50, të Aneksit nr. 6, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021 “Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

7.2. Për periudhën objekt auditimi, nuk është caktuar Koordinatori i Deleguar të Riskut dhe MKF (KDR; KDMFK), si dhe nuk është hartuar plani i veprimit të MFK, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1/b, të Udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, të Ministrisë së Financave.

7.3. Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik të institucioneve shtetërore për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, mbi mënyrën se si operohet nga hartimi i kërkesave për mallra e shërbime, deri në marrjen në dorëzim të tyre. Mungon shtrirja e gjurmës së auditimit në të gjitha proceset kryesore që përfshijn veprimtaria e institucionit, të tilla si fushën e licencimit dhe dhënies së autorizimit, gjurma e proceseve të inspektimit të përcaktuara në procedurën standarde të punës, gjurma e dokumentacionit për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, kontabilizimit dhe ndjekjes së detyrimeve debitoare të subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara / autorizuar dhe subjekteve të palicencuara / autorizuar nga AMA etj., e cila duhet të standardizohet dhe ti nënshtrohet procesit të miratimi, veprime e mosveprime në kundërshtim me parashikimet e nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik si dhe kërkesat e Kreut III, Kapitulli III.3, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, të Ministrit të Financave.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7. 1. Rekomandimi:

Nga ana e AMA-s, të merren masat për përgatitjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), të caktohet Koordinatori i Deleguar të Riskut dhe Menaxhimit Financiar e Kontrollit (KDR; KDMFK), si dhe të hartohet e miratohet nga bordi i AMA, dokumenti i planit të veprimit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023 dhe gjurma e auditimit për proceset dhe veprimtaritë kryesore institucionale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

8. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me aktivitetet e kontrollit të brendshëm në fushën e sekretari-arkivës, janë konstatuar mangësi dhe janë pasqyruar gjetjet kryesore nga procesi i inspektimit të kryer nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në institucionin e AMA-s, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim. Në referim të shkresës nr. 935/3 prot, dtë 25.02.2022 të DPA, janë konstatuar mangësi e parregullsi të tilla si, nuk përdoret libri i dorëzimit mod 4/1, nuk respektohen elementet bazë në shkresat zyrtare, nuk është bërë përpunimi, miratimi dhe hapja e dosjeve sipas pasqyrës emërtuese, nuk është bërë hartimi i listës së veçimit dhe asgjësimit të dokumenteve me afat ruajtje të përkohshëm, nuk janë dorëzuar dokumentet me RHK që kanë plotësuar afatin e maturimit në institucion, etj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të hartohen plane konkrete pune në bashkëpunim me përgjegjësin e strukturës së Sekretari - Arkivit dhe të ndiqet respektimi i normativës për punën me dokumentet. Gjithashtu, të merren masat që të njihet gjithë personeli që krijon dokumente me VKLA nr. 4/2017 mbi dokumentin e njehsuar, të regjistrohen evidencat në regjistrin e korrpondences mod.1 të të gjithë dokumenteve të krijuara e të ardhura në institucion; të saktësohet në urdhra/ rregullore, përgjegjësia e materialit arkivor, të mos futen dokumente në arkivë të papërpunuara, të pa inventarizuara dhe pa procesverbal, si dhe të hapen regjistrat për shfrytëzimin e dokumenteve (mod.15).

Afati: në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi:

9.1. Nga ana e institucionit për periudhën e audituar nuk janë marrë masat për përgatitjen dhe dërgimin në Ministrinë përgjegjëse për financat, të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratave e Raporteve për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Planete e Veprimit për MFK-në, në kundërshtim me nenin 18, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.

9.2. Procedurat e delegimit, nuk janë shoqëruar në çdo rast me raportimin mbi realizimin e detyrave të deleguara, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit për MFK, si dhe Kreut III “Procedura e delegimit suipas autorizimit që delegon”, të Udhëzimit nr.4, datë 29.1.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Ministrisë së Financave, si dhe udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" .

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi:

9.1. Nga ana e Kryetarit të AMA të merren masat për hartimin dhe depozitimin tek nëpunësi i parë autorizues, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit pasardhës, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit, Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie publike, për vitin e mëparshëm dhe të Planit të Veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

9.2. Të merren masat nga ana e titullarit të AMA-s, që në çdo rast të delegimit të autoritetit, procedurat e delegimit, të shoqërohen me raportimin mbi realizimin e detyrave të deleguara, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe kuadrit ligjor e nënligjor mbi menaxhimin e financave dhe kontrollin e brendshëm publik.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Afati: Në vijimësi.

10. Gjetje nga auditimi:

Nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, *(shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA)*, nuk janë përmbushur detyrimet ligjore mbi depozitimin e Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitet 2018-2021 në 36 (tridhjetë e gjashtë) raste gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", dhe nuk janë zbatuar sanksionet për kundravajtjet administrative në bazë të nenit 133 "Gjobat", pika 1/a, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Rezulton se për OMSHA, (përkatësisht, për 1 OMSHA për PF të vitit 2018, 26 të vitit 2019, 6 të vitit 2020 dhe 3 të viti 2021), nga ana e AMA për gjithë periudhën e audituar nuk është mbajtur qëndrim nëpërmjet aplikimit të sanksioneve administrative (gjobë), por kjo rezulton vetëm në një rast në vitin 2019, për vendosjen e sanksioneve administrative me gjobë në shumën prej 40 mijë lekë. Këto veprime e mosveprime kanë sjellë mungesën e disiplinimit të ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, *(shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA)*, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore në kohë dhe mos aplikimi dhe mos arkëtimin e këtyre detyrimeve. *(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10. Rekomandimi:

10.1. Institucioni i AMA-s të marrë masat e duhura për administrimin e pasqyrave financiare të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, *(shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA)*, në përmbushur detyrimet ligjore referuar përcaktimeve të nenit 33 "Detyrimet e OSHMA-ve", të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

10.2. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në çdo rast, të mosveprimit nga ana e ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, *(shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA)*, për depozitimin e Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore të fillojë procedurat administrative "Për dënimin me gjobë", në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në AMA rezultoi se, për subjektin shoqëria "M." sh.a, janë ekzekutuar pagesat për vendime gjyqësore në vlerën 100,141,568 lekë. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i evidencës së vënë në dispozicion të audituesve të pavarur të KLSH-së nga ana e strukturave të AMA-s, evidentohen detyrime në vlerë të konsiderueshme ndaj shoqërisë "M." sh.a, e cila ka vijuar korrespondenca shkresore me Përmbaruesin Privat Gjyqësor, por edhe pas shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimeve në vendimin gjyqësor, pretendimet e palës paditëse janë se AMA, është në vonesë si palë debitore në shlyerjen e detyrimit dhe për këtë arsye pretendohet shpërblymi i dëmit, në tejkalim të përcaktimeve të kushteve të marrëveshjeve të dakordësuar midis palëve, përfshirë këtu edhe afatet e shlyerjes.

Nga auditimi i kryer rezulton se, AMA kërcënohet nga risku i pagesave të penalteteve/ kamatëvonesave të pretenduara nga ana e kreditorit, të lidhur me pagesat e kryera për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe marrëveshjeve të dakordësuar. Për periudhën objekt auditimi, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për praktikën e sipërpërmendura, nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga AMA me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e këtij institucioni.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11. Rekomandimi:

11.1. Nga ana e strukturave përgjegjëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat që, të ndiqet me prioritet në gjykatë çështja e padisë së ngritur nga shoqëria “M.” sh.a me nr.2981 akti, ku pretendohet dëmi i shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 2819, dt. 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit.

11.2. Strukturat përgjegjëse të AMA-s të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

11.3. Nga ana e DSHB të AMA të përlllogariten provizionet për rreziqe e dëmtime, në kuadër të procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2023, sipas përcaktimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6 “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi:

Mungesa e hartimit të planit të përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave. Mos ushtrimi i të drejtës ligjore të AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira.

Nga shqyrtimi i procedurave për dhënien e licencave të transmetimeve audio për periudhën objekt auditimi rezulton se në asnjë rast nuk është ushtruar e drejta ligjore e AMA për të çelur kryesisht gara, duke patur parasysh frekuencat e lira. Fakti i mungesës së planit të përdorimit të frekuencave, ka shërbyer si justifikim për të mos çelur asnjë garë kryesisht nga ana e AMA. Ligjvënësi ka përcaktuar si formë të konkurrencës shpalljen e garave nga AMA, duke garantuar në këtë mënyrë objektivitet, transparencë dhe mosdiskriminim. Në kushtet e një zbatimi rigoroz të dispozitave ligjore, duke hartuar planin e përdorimit të frekuencave, në zbatim me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, AMA duhet të kishte mundësinë e përcaktimit të saktë të frekuencave të lira dhe do të ushtronte të drejtën e çeljes së garave kryesisht, kjo nëpërmjet afishimit në fillim të çdo viti kalendarik të planit të përdorimit të frekuencave, duke i dhënë mundësi të gjithë palëve të interesuara për tu njohur me të. Çelja e garave vetëm pas kërkesave të subjekteve të interesuara nuk mund të jetë e vetmja formë e ushtrimit të kompetencave nga ana e AMA.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 97-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi:

AMA të ndërmarë të gjitha procedurat ligjore për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: *Procesverbale të mbledhjes së bordit të AMA të pa firmosura sipas përcaktimeve ligjore.*

Nga shqyrtimi i të gjithë praktikave të vlerësuara, evidentohet se procesverbalet e mbledhjeve të bordit të AMA-s nuk janë të firmosur sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore në fuqi dhe nuk janë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

ruajtur e arkivuar pranë Sektorit të Arkivë - Protokollit, sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve zyrtare. Pavarësisht faktit se organi vendimmarrës e ka shprehur vullnetin nëpërmjet Vendimit nr. 28, datë 22.04.2020, Sekretariati Teknik ka vepruar në mospërputhje me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, mbështetur në përcaktimet e nenit 16, të Ligjit nr.8480, datë 27.05.199 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, do të konsiderohet si i pavlefshëm vendimi i organit kolegjial, në kushtet kur ai hyn në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverballi përkatës.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 97-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi:

Nga ana e AMA-s në çdo rast të mbledhjeve të bordit të ndërmerren masat për të administruar procesverbalet e mbledhjeve sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi:

Mbledhje dhe vendimmarrje të panevojshme të AMA në rastet e autorizimeve dhe rinovimeve të autorizimeve.

Nga auditimi rezulton se, AMA ka aplikuar një *standard të dyfishtë* në shqyrtimin e aplikimeve për marrjen e autorizimeve dhe kërkesave për rinovim të autorizimeve. Më konkretisht,

✓ Në rastin e kërkesave për marrje autorizimi, në mungesë të kuroumit, AMA i ka konsideruar të miratuara pas kalimit të afatit 30 ditor, sipas përcaktimeve ligjore.

✓ Në rastin e aplikimeve për rinovim autorizimi, AMA ka marrë vendim pas kalimit të afatit 30 ditor. Në shkelje të përcaktimeve ligjore AMA ka marr një vendim të panevojshëm në kushtet kur ka qenë jashtë afatit ligjor për tu shprehur dhe përsa kohë aplikimi konsiderohet i miratuar pas kalimit të afatit 30 ditor.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 97-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Nga ana e AMA-s.

AMA të marrë masat për shqyrtimet e aplikimeve brenda afateve ligjore dhe të mos ketë vendimmarrje në tejkalim të afateve ligjore në fuqi. Në të gjithë rastet e vendimmarrjes në tejkalim të afateve ligjore në fuqi të nxirret përgjegjësia individuale e zyrtarëve.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi:

Mungesa e propozimeve për masa administrative në rastet e shkeljes së detyrimeve të nenit 33, të ligjit të AMA nga ana e OSHMA. Vendimmarrje në tejkalim të kompetencave ligjore nga Këshilli i Ankesave.

Referuar periudhës objekt auditimi ka rezultuar se në **93 raste** të ankesave të trajtuara, në të cilat janë konstatuar shkelje të detyrimeve nga ana e OSHMA-ve, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit, cenimin e të drejtave të fëmijëve, komunikime tregtare të ndaluara, Këshilli i Ankesave ka aplikuar si masë administrative **“tërheqje vëmendje”**, masë e cila nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Masa administrative “gjobë” është propozuar vetëm në 6 raste gjatë vitit 2019.

Vendimmarrja e Këshillit të Ankesave nëpërmjet **“tërheqjes së vëmendjes”** është në tejkalim të kompetencave ligjore të këtij organi, pasi çdo vendimmarrje e AMA, në raport me shkeljet e evidentuara nga Këshilli i Ankesave, i përket Bordit të AMA-s.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 97-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

15.1.Rekomandimi: AMA të marrë masat ligjore në rastet e evidentimit të shkeljeve në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave, nga ana e Këshillit të Ankesave.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime e dieta me jashtë vendit, grupi i auditimit ka konstatuar mungesë të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur mandat pagesave tek të gjitha praktikantët e shqyrtuar, (mungon ftesa e vendit organizator pritës dhe draft agjenda e aktivitetit, etj.). Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Financës të marrë masa që, në të gjitha praktikantët për udhëtime e dieta për jashtë shtetit, dokumentit për kryerjen e pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda përkatëse.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sa i përket shpërblimeve të punonjësve për vitin 2021, një nga punonjësit nuk ka përfituar shpërblimin, pavarësisht faktit se në relacionin përkatës pasqyrohet se duhet të përfitonte vlerën prej 38,200 leke (ekuivalente me ½ e pagës), pa asnjë argumentim.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të analizojë rastin dhe në vijimësi të marrë masa për trajtimin e barabartë të punonjësve në rastin e shpërblimeve financiare, ose përndryshe, të dokumentojë dhe argumentojë rastet kur trajtimi është i ndryshëm bazuar në performancë individuale të punonjësit apo shkaqe të tjera të argumentuara.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga drejtuesit e automjeteve, në të gjitha rastet e shqyrtuara, fletë-udhëtimet nuk ishin të plotësuar në mënyrë korrekte, pasi për itineraret e përshkruara, ato plotësoheshin nga shoferët e automjeteve pa u vërtetuar me kundërfirmimin e nëpunësve udhëtues të kryerjes së shërbimit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi:

Nga ana e financës të mbahen aktrakordime të përmuajshme me magazinën, për fletëdaljet e karburantit dhe përputhshmërinë e tyre me "urdhrat e dorëzimit" për të bërë të mundur kontrollin me efektivitet të shpenzimit të karburantit. Komisionet e ngritura për kronometrimin e harxhimit të karburantit për km e përshkuara si dhe drejtuesit të bëjnë kronometrimin e harxhimit të karburantit si për lëvizjet urbane dhe ato interurbane. Në të gjitha rastet fletë udhëtimet të plotësohen për km e përshkruar dhe në përfundim të shërbimit të firmosen nga drejtuesi i automjetit dhe nga personat që kryejnë shërbimin me këtë automjet. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa që çdo fletë-udhëtim i dorëzuar nga shoferët në fund të muajit, të jetë e plotësuar në mënyrë të saktë me të gjithë elementet e nevojshme sic janë *intenerari i udhëtimit të përshkruar, kilometrat e përshkruara, litrat e karburantit të harxhuar për itinerarin e udhëtimit, punonjësi i AMA-s në mënyrë të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe nënshkrimi i tij.*

Afati: Menjëherë e në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit nga ana e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, në procedurat si më poshtë:

✓ *Procedura Blerje boje për fotokopje dhe printerë 2019.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Certifikatat ISO 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërbejnë AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT.

✓ *Procedura Blerje boje për fotokopje dhe printerë 2021.*

Certifikatat ISO 20000-1:2011 lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT nuk gjejnë aspak referim, për sa kohë që nuk i shërbejnë AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me sistemin e menaxhimit të shërbimeve IT.

Procedura Blerje Hard disk te jashtëm 2022.

Certifikatat ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohe që nuk i shërbejnë AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

✓ *Procedura furnizim vendosje drum 2022.*

Certifikatat ISO/EC 27001 : 2013 lidhur me Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit nuk gjejnë aspak referim, për sa kohe që nuk i shërbejnë AK për shërbimin që kërkon të marrë, i cili është blerje mallrash, por i shërben subjektit ofertues, për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të marrë masa për hartimin e kriterëve në përputhje me objektin e prokurimit, në mënyrë që të sigurohet një trajtim i drejtë dhe i barabartë i OE, si dhe të nxitet pjesëmarrja dhe konkurrenca ndërmjet tyre .

Afati: Menjëherë e në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, në ftesën për ofertë, ka vendosur si kriter që në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 2 ose 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, do të jenë të detyruar ta skualifikojnë, konstatuar kjo në procedurat, si më poshtë:

- ✓ *Mirëmbajtje për automjetet, viti 2020.*
- ✓ *Shërbimin e lyerjes së ambienteve të AMA-s, viti 2020.*
- ✓ *Prokurimin e një serveri backup, viti 2020.*
- ✓ *Dezinfektimin të ambienteve të AMA-s, viti 2021.*
- ✓ *Blerje të pajisjeve elektronike, viti 2021.*

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa për shmangien e vendosjes së kriterëve të pambështetura ligjërisht, të cilat çenojnë parimin e vlerësimit të ofertave bazuar në parimet e ekonomicitetit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Vendimarrje e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël duke kualifikuar dhe shpallur fitues Operatorët Ekonomik, pa plotësuar çdo kriter të veçantë të vendosur, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 pika 2 dhe neni 2, neni 40, 59 dhe Udhëzimin e APP nr.3 datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. *Më hollësisht.*

- ✓ Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, ka marrë kërkesë për prokurim me nr.315 prot.,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

me datë 16.01.2019 me lëndë *"Kërkesë për mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit dhe aspirimit"*. Nga auditimi në dokumentat e OE të shpallur fitues "N. E." certifikata e dorëzuar nuk është për sistemet VRF, kriter i vendosur nga AK. Gjithashtu edhe 2 certifikatat e dorëzuara për punonjësit e trajnuar për sistemet VRF nuk janë për sistemet VRF. OE nuk ka dorëzuar listë pagese ose kontrata pune ku të verifikohet se punonjësit e certifikuar janë në marrëdhënie pune me këtë OE.

✓ Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për prokurim me nr.2490 prot., me datë 08.09.2020 me lëndë *"Kërkesë për Shërbimin e lyerjes së ambienteve të AMA-s"*. Nga auditimi konstatohet se certifikata ISO 9001:2015 e dorëzuar nga OE i shpallur fitues B. L. është e subjektit "De." dhe jo e OE fitues B. L.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandimi: Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa ku të kualifikojë dhe shpallë fitues Operatorët Ekonomik pasi të plotësojnë çdo kriter të veçantë të vendosur nga AK në ftesën për ofertë.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i disa procedurave të prokurimit rezultuan të meta e parregullsi si vijon:

- ✓ Në pesë dosje prokurimi të audituara me objekt *"Sistem për monitorimin e subjekteve numerike"*, *"Blerje Automjete ½ fuoristradë"*, *"Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM"*, *"Blerje pajisje server San Storage Area Network"*, *"Blerje karburant gazoil 10 ppm"*, ofertat bashkëlidhur relacionit të përlllogaritjes së fondit limit nga operatorët ekonomik janë pa datë, duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi aktualitetin e ofertës për kohën e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me nenin 59, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar): *"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet"*.
- ✓ Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje Automjete ½ fuoristradë"* nga KVO-ja nuk është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës së prokurimit dhe vlerësimit të saj për të konfirmuar hapat e ndjekur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me përcaktimeve detyruese të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.
- ✓ Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje karburant gazoil 10 ppm"* kontrata është nënshkruar vetëm nga njëri prej OE, ku fitues ishte BOE, veprim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 88, pika 5, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, ku citohet shprehimisht *"Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi"*.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 135-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi:

Në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, të merren masa në vazhdim nga ana e punonjësve të ngarkuar në komisione, për dokumentimin e plotë të proceseve si pjesë e dosjes së prokurimit publik.

Afati: Menjëherë e në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

23. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i marrjes në dorëzim të shërbimit “*Mirëmbajtje e sistemit të qendëruar të monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit Audio FM*”, rezultoi se:

Komisioni i marrjes në dorëzim ka marrë në dorëzim me vonesë faturat e lëshuara nga OE, edhe pse shërbimi ishte realizuar, duke ndikuar në likuidimin pas afatit 30 ditor të faturës, në kundërshtim me parashikimet ligjore konkretisht nenit 463, të .. Kodit Civil të RSH dhe ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Marrja në dorëzim me vonesë të objektit të kontratës ka sjellë raportimin me vonesë të “*Formularit të raportimit për zbatimin e kontratës nr.2428 prot datë 17.06.2022*”, sa vepruar në kundërshtim me nenin 125 pika, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku shprehimisht citohet “*Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës*” si dhe nenin 107, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 135-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi:

Në vazhdim komisionet e marrjes në dorëzim të verifikojnë brenda afateve ligjore mallrat/shërbimet e realizuara nga kontraktuesit, me qëllim shmangien e pagesave mbi afatin 30 ditor dhe vonesave në raportimin e “*Formularit të raportimit për zbatimin e kontratës*”.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi:

Parregullsi në zbatimin e kuadrit nënligjor në fuqi mbi sigurimin e kontratave.

a.Nga auditimi i nënshkrimit të kontratës “*Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio*”, rezultoi se: Sigurimi i kontratës me nr.serie 056813, lëshuar nga “S” sha në masën 146.040 lekë si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, mban datën e lëshimit 26.06.2019, me vlefshmërie deri më datë 05.08.2019, afat ky që nuk i shërben qëllimit ligjor për të siguruar kontratën, pasi kontrata ka datë nënshkrimi datën 29.07.2019 dhe afat lëvrimi 30 ditë nga nënshkrimi i saj, veprim në kundërshtim me nenin 24, të VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku shprehimisht citohet “*Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj*”.

b.Nga auditimi i nënshkrimit të kontratës “*Eventi për 20-vjetorin e AMA-s*”, rezultoi se: Sigurimi i kontratës me nr.serie 070300540026791, datë 19.04.2019 në masën 10% të vlerës së kontratës është lëshuar nga “E.” sha në masën 236.268 lekë, katër ditë pas nënshkrimit të kontratës në kundërshtim me afatin e vendosur nga VKM-ja nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 24, ku shprehimisht citohet “*Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj*”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 135-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

24.1 Rekomandimi:

Të merren masa nga ana e Njësisë së Prokurimit që të verifikohet në vazhdimësi sigurimi i kontratës së përcjellë nga OE fitues, lidhur me vlefshmërinë e saj si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi procedurës së prokurimit për “Shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve”, rezultoi se nuk është hartuar urdhri për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit, veprim në mospërputhje me kërkesat e pikave 42 dhe 43, të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrit të Financave.

Procedurat e pagesave janë ekzekutuar në kundërshtimet me parashikimet e kontratave të nënshkruara, përkatësisht nenin 5.6, ku është përcaktuar se:

“Kontraktuesi do të dorëzojë automjetin e riparuar duke e shoqëruar me këtë dokumentacion a) faturë tatimore që do të plotësohet për riparimet e kryera për automjetin; b) situacion i automjetit të riparuar i firmosur nga kontraktuesi dhe AK (komisioni i ndjekjes së realizimit të shërbimit); c) procesverbali i marrjes në dorëzim i firmosur nga kontraktuesi dhe AK (komisioni i ndjekjes së realizimit të shërbimit);

si dhe aneksin 1, pika 6, ku citohet: “Personat përgjegjës për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe për marrjen në dorëzim të automjeteve të riparuar do të jenë drejtuesit e automjeteve ose persona të autorizuar prej Autoritetit të Mediave Audiovizive”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 135-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi:

Në vazhdim nga ana e AMA-s të hartohen urdhrat përkatës të marrjes në dorëzim për çdo prokurim dhe zbatohen me korrektësi detyrimet mbi marrjen në dorëzim të mallrave apo ndjekjen dhe realizimin e shërbimit.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dosjeve të prokurimit me objekt “Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit sipas strategjisë së komunikimit” dhe “Blerje pajisje server SAN STORAGE AREA NETWORK”, rezultuan:

Parregullsi në vendosjen/ose mosvendosjen e numrit të protokollit të shkresave zyrtare, pasi një shkresë duhet të ketë një numër unik protokollit bazuar në nenin 19, të Normave Tekniko-Profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë; të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës; sa vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12 dhe 13.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 135-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



26.1 Rekomandimi:

Në vazhdim të merren masa që cdo shkresë që krijohet nga subjekti shtetëror Autoriteti i Mediave Audiovizive si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, të evidencohen në regjistrin e korrespondencës sipas një numri referues të veçantë.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

D. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMEVE:

1. Gjetje nga auditimi: *Parregullsi në procedurën e prokurimit të një serveri backup, viti 2020.*

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në ftesën për ofertë ka vendosur si kriter që, në rast se OE nuk kontakton me AK brenda 3 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP, komisioni do të jetë i detyruar ta s'kualifikojë OE. Sa më sipër, KPVV ka vepruar në kundërshtim me piken 15, të Udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 "*Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", të APP-së.

Konstatohet se, OE i renditur në vendin e dytë ka dorëzuar dokumentacionin për procedurën e prokurimit pranë AK, por oferta e tij nuk është hapur dhe OE është skualifikuar pasi OE nuk ka njoftuar AK brenda 3 orëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e ofertuesit të renditur në vendin e dytë dhe rezultoi se dokumentacioni i dorëzuar nga OE "S.C." është konform specifikimeve teknike të vendosura në ftesën për ofertë. Oferta e sjellë nga OE "S.C." është në vlerën 665,880 lekë me TVSH. Referuar me sipër, OE i shpallur fituese "B. E." shpk dhe skualifikimi i OE "S.C." me ofertë më të ulët përbën dem ekonomik në vlerën **174,120** lekë me TVSH (diferenca e ofertave ekonomike të paraqitur nga ana e OE).

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Nga AMA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **174,120 lekë**, nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë më të ulët në procedurën e vitin 2020 "*Kërkesë për Prokurimin e një serveri backup*",

Afati: Menjëherë e në vijimësi

E. MASA ADMINISTRATIVE:

1.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv OMSHA, (publikë e privat, shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), nuk janë përmbushur detyrimet ligjore mbi depozitimin e Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore për vitet 2018-2021 në **36 raste gjithsej**, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/g, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar për OMSHA, (përkatësisht, 1 OMSHA për PF të vitit 2018, 26 të vitit 2019, 6 të vitit 2020 dhe 3 të viti 2021), dhe nga ana e AMA për gjithë periudhën e audituar është mbajtur qëndrim nëpërmjet aplikimit të sanksioneve administrative (gjobë), vetëm në një rast në vitin 2019, për shumën prej 40 mijë lekë, duke sjellë mungesën e disiplinimit për ofruesit e shërbimit mediatik



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

audioviziv (OMSHA) publikë e privat, (shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA), në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore në kohë dhe mos aplikim të sanksioneve apo mos arkëtimin e këtyre detyrimeve.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive të merren masat për vendosjen e sanksioneve ligjore, duke mbajtur parasysh përcaktimet e Kreut XIV “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, Neni 132 “Masat për shkeljet”, pika 2 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, ku është sanksionuar se “AMA vendos sanksionet e parashikuara në ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes”, ndaj të fillojë procesi i dhënies së masave administrative (gjobë), **për 3 (tre) subjekte me nga 40 mijë deri në 400 mijë lekë** për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OMSHA) publikë e privat, shoqëri apo persona fizik të licencuar/ autorizuar nga AMA që janë brenda këtij afati.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

F. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E MENAXHIMIN PA EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE APO TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se caktimi pranë organit kolegjal të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i një Sekretariati Teknik, me tre punonjës për periudhën objekt auditimi (1 Janar 2019 - 30 Qershor 2022), dhe me 4 punonjës në përbërjen e tij (për periudhën Mars-Prill 2021), është veprim në kundërshtim me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, që shprehimisht ka përcaktuar se: “Çdo organ kolegjal ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe...”, si dhe në tejkalim të pozicioneve të strukturës organike të AMA-s, të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Sa më sipër, krijimi i një hallke të tillë mbi përcaktimet e strukturës organike është një veprim në shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga Bordi i AMA-s, pasi struktura organizative është miratuar me vendimin nr. 19/2016, datë 10.3.2016, të Kuvendit, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)”, i ndryshuar.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e institucionit të AMA-s, rezulton se për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022, në lidhje me Sekretariatit Teknik janë kryer pagesat prej 15,000 lekë/mbledhje për çdo anëtar të Sekretariatit Teknik, ose gjithsej në shumën prej **3,255 mijë lekë**, që e detajuar sipas viteve paraqitet si më poshtë:

- Për vitin 2019: 780 mijë lekë;
- Për vitin 2020: 945 mijë lekë;
- Për vitin 2021: 1,170 mijë lekë;
- Për 6muajorin I/2022: 360 mijë lekë;

Pagesat e mësipërme përbejnë një efekt negativ dhe konsiderohen si shpenzim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet për fondet publike në administrim të këtij institucioni shtetëror.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 167-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Nga ana e AMA-s

Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësisë dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej **3,255 mijë lekë** për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, 1.1.2019-30.6.2022, Bordi i AMA-s, në **10 raste gjithsej** ka shfuqizuar sanksionet administrative të dënimit me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, në shumën prej **12,240 mijë lekë**, që përfaqëson rreth 20 % të numrit dhe vlerës së gjobave të vendosura gjatë asaj periudhe, ngaqë ka marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimues duke rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit / institucionit në vlerën prej 12,240 mijë lekë, që është vlera totale e gjobave të shfuqizuara.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Nga ana e AMA-s

Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësi dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej **12,240 mijë lekë** për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se shfuqizimi i masave administrative gjobë për **14 raste të shqyrtuara**, janë kryer në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, duke shkaktuar të ardhura të munguara buxhetit të shtetit / institucionit, si vijon:

3.1. Në 2 (dy) raste gjithsej (1 në vitin 2018, 1 në vitin 2019), ankesat e subjekteve janë pranuar dhe marrë në shqyrtim nga ana e AMA në tejkallim të afatit 30 ditor, për subjektet

- ✓ **T. “H.”** vendosur gjoba Nr.19, datë 11.06.2018 dhe ankimi është me Nr.2561/1, datë 17.07.2018;
- ✓ **Shoqëria “O. N.”**, vendosur gjoba me Nr. 65, datë 17.4.2019 dhe ankimi është me Nr.2003, datë 21.05.2019, (protokolluar në AMA me nr. 1844/1, datë 23.05.2019).

në shkelje të afatit të parashikuar nga pika 4, e nenit 132 “Masat për shkeljet”, të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive” i ndryshuar, që ka përcaktuar se, “*Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit*”.

3.2. Në 9 (nëntë) raste vendimmarrjet e AMA janë në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 132/4 të ligjit 97/2013, ku shprehimisht citohet se, “*AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve*”, për subjektet e mëposhtme:

- ⊕ **Subjekti “Shoqëria “J” shpk:** shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.3211/1, dt 01.10.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.14, dt 16.02.2019, ose pas 4,5 muajsh;
- ⊕ **Subjekti “Shoqëria “U” shpk:** shkresa e ankimit të gjobës është me Nr.3010/1, dt 26/7/2018, Ankim k/vendimit nr.25 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.188, dt 05.11.2018 refuzim ankimi administrativ, ose pas 3 muajsh;
- ⊕ **Subjekti person fizik, A. Sh., T.H.** shkresa e ankimit të gjobës është me Nr. 4540/1 dt 06.12.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 17, dt 06.02.2019, “Shfuqizim i gjobës sipas vendimit nr.28”, ose pas 2 (dy) muajsh;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- ⊕ *Subjekti “T.F.” shpk* shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.2614/1, dt 27.6.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 191, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ , ose *pas 4 muajsh*;
- ⊕ *Subjekti “T. H.”*: shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.2561/1 dt 17.07.2018, dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr. 185, dt 05.11.2018, Refuzim ankimi administrativ, ose *pas 3.5 muajsh*;
- ⊕ *Subjekti “T.Z.” shpk* shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.4539/1 dt 12.12.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.36, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobes sipas vendimit nr.27, ose *pas 2 muajsh*;
- ⊕ *Subjekti “T.H.” shpk* shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.4542/1 dt 14.11.2018 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.37, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobes sipas vendimit nr.30, ose *pas 3 muajsh*;
- ⊕ *Subjekti “T. M.” shpk* shkresa e ankimimit të gjobës është me Nr.1524 /1, dt 18.4.2019 dhe vendimi i AMA-s për shqyrtimin e ankesës mban Nr.93, dt 7.6.2019, Shfuqizim i gjobës sipas vendimit 01, ose *pas 1.5 muajsh*; etj

3.3. Në mjaft raste të analizuara, si arsye për heqjen e sanksioneve administrative me gjobë nga ana e bordit të AMA janë konsideruar shkaqe të tilla si, “*pamundësia financiare*”, “*mosnjohja e ligjit*”, etj, që në thelb nuk përbëjnë një argumentim ligjor për heqjen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e masës së kundërvajtjes administrative që ka ardhur si pasojë e shkeljes me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji ka parashikuar dënim administrativ.

3.4. Rezulton se, në **3 (tre)** raste, për vlerat e gjobave prej **8 milionë lekë**, kundër vendimit të AMA-s është vijuar sërish me ankim në AMA, dhe jo në gjykatë:

Nr	OMSHA	Gjoba të vendosura nga strukturat e AMA per parregullsi e shkelje Nr datë	Masa administrative gjobë në shumën	Ankimi administrativ i Subjektit kundër gjobës/sanksionit	Vendimi i AMA për ankesën e subjektit	Subjekti ka rikërkuar heqjen e sanksionit	Vendimi i AMA-s për rikërkesën
1.	Shoqëria “U” shpk	Nr.25,dt 10.07.2018	5 milion Lekë	Nr.3010/1 dt 26/7/2018 Ankim k/vendimit nr.25	Nr.188, dt 05.11.2018 refuzim ankimi administrativ	Nr. 4512, dt 12.11.2018 Ankim k/vendimit me nr. 188	Nr.16, dt 06.02. 2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.25
2.	T. F.	Nr.18, dt 11.06.2018	1 milion lekë	Nr.2614/1 dt 27.6.2018	Nr. 191, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ	Nr. 5013/1 dt 11.01.2019 Kerkese per rishikim	Nr.34, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.18
3.	T. H.	Nr.19, dt 11.06.2018	2 milion lekë	Nr.2561/1 dt 17.07.2018	Nr. 185, dt 05.11.2018 Refuzim ankimi administrativ	Nr.383, 18.01.2019	Nr.35, dt 15.02.2019 Shfuqizim gjobës sipas vendimit nr.19

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 97/2013, date 4.3.2013, Kreu XIV, “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, Neni 132, “Masat për shkeljet”, pikat nr.1-5, si dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

pikat nr 10-13 , të Nenit 133, “Gjobat”, të po këtij ligji
(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 47-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Nga ana e AMA-s

Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e këtyre rasteve si dhe nxjerrjen e përgjegjëseve, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në të ardhurat e munguara dhe menaxhimin pa efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e veprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për periudhën objekt auditimi.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Vlera prej **1.360.000 lekë** që rrjedh prej masave administrative të marra për 4 (katër) OMSHA, në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, (të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura), do të konsiderohen efekt financiar negativ. Mosdijenja në raport me detyrimet për të dhënë informacion, që rrjedh prej dispozitave ligjore, si dhe fakti se subjektet e justifikojnë me pretendimin se janë të rinj në treg, nuk mund të jetë shkak i arsyeshë ligjor për mosaplikimin e gjobës. Këto pretendime AMA mund t’i konsideronte, në raport me vlerën që do të aplikohet për sanksionimin e masës së gjobës, sipas shkronjës (d) të pikës 2, të nenit 133, të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke qenë se kjo dispozitë parashikon masën e gjobës nga 120.000 deri në 2.000.000 lekë, AMA, (ashtu si ka vepruar Drejtoria Juridike dhe e Licencave), mund të aplikonte masën minimale apo të shkallëzuar të saj. Duke qenë se ligji parashikon qartë masën që duhet të aplikohet nëse provohet fakti i mungesës së njoftimit për ndryshimet në pronësi, arsyetimi i përdorur nga AMA gjatë vendimmarrjes për shqyrtimin e ankimit administrativ është i pabazuar në ligj. Më hollësisht,

- **Gjatë vitit 2019:** u konstatua se **Shoqëria “D&A.E.” sh.p.k.** është sanksionuar për mosdhënie informacioni për ndryshimet në pronësi me vendimin nr. 13, datë 06.05.2019, në masën **1.000.000 (një milion) lekë**. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA me Vendimin nr. 108, datë 11.07.2019.

Referuar procedurës së mësipërme evidentohet se masa administrative e propozuar nga Drejtoria Juridike dhe e Licencave dhe e miratuar me Vendimin nr. 13, datë 06.05.2019 të AMA, lidhet me faktin se ky sanksion është vendosur për shkak të mungesës së dhënies së informacionit për ndryshimet në pronësi, sipas përcaktimeve të nenit 133, pika 2, germa “dh” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Referuar procedurës së shqyrtimit administrativ të konkluduar me vendimin nr. 108, datë 11.07.2019 të AMA, rezulton se arsyetimi për pranimin e ankimit administrativ bazohet të fakti procedimi i iniciuar lidhet me detyrimet financiare të subjektit, për të cilat nuk rezulton më debitor.

Ky arsyetim për pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e gjobës nuk qëndron në kushtet kur objekti i saj është i qartë dhe lidhet me mungesën e dhënies së informacionit. Në këto kushte shfuqizimi i gjobës në vlerën **1.000.000 lekë** është i pabazuar në aktet ligjore dhe përbën efekt negativ financiar.

- **Gjatë vitit 2020,** AMA, ka ndëshkuar 1 subjekt, **Shoqëria “Ch.” sh.p.k.**, me vendimin për dënimin me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA, me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021.

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar pretendimet e tij në ankim lidhen me mungesën e informacionit në lidhje me këtë detyrim. Nëse për çdo masë administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

mosdhënies së informacionit. Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në ligj dhe në prova, vlera **120,000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë** do të konsiderohet si efekt financiar negativ.

- **Gjatë vitit 2021**, AMA ka ndëshkuar 2 subjekte për kundërvajtjen administrative, “Mosnjoftim i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e licencës/autorizimit”, me sanksion gjorbë:

- Me vendimin Nr. 1, datë 02.03.2021, vendosur ndaj **shoqërisë “R-O” sh.p.k.**, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP, OTT, në masën 120,000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 50, datë 26.03.2021.

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar disa pretendime të cilat nuk rezultojnë të provuara në dokumente. Gjithashtu e ka konsideruar një gabim njerëzor dhe si të tillë ka kërkuar pranimin. Nëse për çdo masë administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e mosdhënies së informacionit. Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në ligj dhe në prova, vlera **120,000 (njëqindnjëzet mijë) lekë** do të konsiderohet si efekt financiar negativ.

- Me vendimin Nr. 2, datë 02.03.2021 vendosur ndaj **shoqërisë “S. K.” sh.p.k.**, për subjektin “S. K.”, në masën 120, 000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 41, datë 11.03.2021.

Referuar ankimit administrativ evidentohet që subjekti mungesën e njoftimit nuk e ka të legjitimuar, por ka parashtruar pretendimet e tij në ankim që lidhen me mosnjohjen e ligjit. Nëse për çdo masë administrative të vendosur ndaj subjekteve, do të aplikohet ky standard, AMA nuk do mund të ushtronte detyrimin ligjor që ka për sanksionimin në rastet e mosdhënies së informacionit. Në kushtet kur ky justifikim është një artificë ligjore, e pabazuar në ligj dhe në prova vlera **120,000 (njëqindnjëzet mijë) lekë** do të konsiderohet si efekt financiar negativ.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.5, faqe 97-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Nga ana e AMA-s

Autoriteti i Mediave Audiovizive të analizojë me përgjegjësi procedurat e masave administrative të marra, në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura, për periudhën 2019 - 2022, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën prej **1.360.000 lekë** për periudhën 1.1.2019 deri më 30.6.2022. Autoriteti i Mediave Audiovizive, në shqyrtimet e ankimeve administrative mbi masat administrative ndaj OSHMA, të mbështet në dispozitat ligjore dhe të tregojë objektivitet në shqyrtimin e tyre. AMA të ndër marr nismën për miratimin e një politike/ akti nënligjor për rastet e ndryshimeve në pronësi brenda të njëjtës shoqëri.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 2 ish-punonjës në vlerën totale **4,181,090 lekë**. Vendimi gjyqësor për ish-drejtesen e institucionit znj. E. B., nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga AMA, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve me shkresë nr.1407 prot., datë 05.06.2020 të lëshuara nga përmbartuesit privat duke paguar tarifa përmbartimore, në vlerë totale prej **351,883 lekë**.

Gjithashtu në rastin e znj, E. B., AMA nuk ka ushtruar të drejtën e saj në 2 raste si me poshtë vijon:

- ✓ Të Ankimojë në Gjykatë pezullimin e veprimeve përmbartimore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

- ✓ Të kërkojë në Gjykatë interpretimin se sa është pjesa që do të paguaj AMA dhe sa Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3239 datë 17.12.2019 ka vendosur që: Detyrimet e palëve të paditura, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive ti paguajnë paditësit, E. B., pagën si kryetare e KKRT-së (sot AMA).

Vendimit gjyqësorë janë shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej **4,181,090 lekë**.

Veprimet e sipërme nuk janë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 “Rregullat e njoftimit shkresor të akteve”, ku citohet se “Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve”, neni 451/a ku citon se “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët” dhe neni 510/a “Titujt ekzekutivë”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi.

Nga Autoriteti i Mediave Audiovizive të merren masa për analizimin e përgjegjësi dhe parandalimin e eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike, të rezultuara si pasojë e një akti të paligjshëm, në shumën prej **4,181,090 lekë**, pasi vendimit gjyqësorë janë pagesa në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit dhe që kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së.

Autoriteti i Mediave Audiovizive të analizojë me përgjegjësi procedurat e largimit nga puna dhe të rekrutimit të punonjësve për periudhën 2019 - 2022, dhe të mbajë qëndrimet e duhura për përgjegjësitë individuale të zyrtarëve, për pasojat financiare që rezultojnë nga vendmarrje të gabuara dhe pa shkaqe të arsyeshme e ligjore.

Afati: Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar për periudhën objekt auditimi, u konstatua se për vitin **2019** procedura e kërkesës dhe nxjerrja e urdhërit janë kryer pas kryerjes së orëve shtesë të punës nga dy punonjës. Me shkresën nr.1009/1 prot, datë 26.02.2019 Drejtori i Mbikëqyrjes ka bërë kërkesa për pagesën e orëve jashtë orarit, ndërsa me shkresë nr. 1028 prot datë 27.02.2019 Sekretari i Përgjithshëm ka miratuar pagesë të orëve shtesë për zyrtare për znj. N. D. për datën 16.02.2019 për 6.5 orë dhe E. Ç. për datën 16.02.2019 për 4 orë.

Për vitin **2020** me shkresë nr. 590 prot, datë 11.02.2020 Drejtori i Shërbimeve të Brendshme ka bërë kërkesë drejtuar titullarit të Institucionit për pagesë jashtë orarit për nëpunësin znj, A.K. për datat 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 orë për datat e sipërcituara. Me shkresën nr. 644 prot datë 12.02.2020, titullari i institucionit ka miratuar orët shtesë për 9 punonjës për data 15, 22 dhe 29 shkurt 2020 me nga 8 ore pune për çdo datë, për kryerjen e detyrave funksionale.

Për pasojë vlera prej **217,461 lekë** e paguar për orët shtesë përbën efekt financiar negativ për Autoritet e Mediave Audiovizive.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 19-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit të Mediave Audiovizive të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa efiçencë të buxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në vlerën **217,461 lekë**, mbi pagesat për orët jashtë orarit zyrtar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

Afati: Menjëherë e në vijimësi

G. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 14 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive”, i ndryshuar, nenin 59, pika i dhe 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara nga ana e grupit të auditimit, sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të vlerësojë masën e shkeljeve dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, shkronja “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nga “vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”; “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”; deri në, “Largim nga shërbimi civil”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSE

Anekset janë pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të mëposhtme:

Aneksi nr.1: Llojet e opinionit të aplikuara nga KLSH-ja.

Aneksi nr. 2: Llogaritja e materialitetit sasior bazuar në metodologjinë e Auditimit.

ANEKSI I

LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Në Auditimin e Përputhshmërisë:

a.Opinion i pamodifikuar.

- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe nuk ka konstatuar (për çështjet e audituara) aspekte materiale të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara.

- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të kufizuar, si dhe në bazë të punës së kryer, *asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara.*

b. Opinion i modifikuar.

Jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

kriteret e aplikuara, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

c. Opinion i kundërt.

Jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme/ e plotë, por *devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura*.

d. Refuzim i opinionit.

Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë. Refuzimi i opinionit, është një mohim i përgjegjësisë, pasi *audituesi nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi* për të siguruar një bazë për dhënien e opinionit, *për t'u shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me kriteret e aplikuara, si dhe për të gjykuar nëse efektet e mundshme mund të janë materiale dhe të përhapura*.

ANEKSI II:

PËRLLOGARITJE E NIVELIT TË MATERIALITETIT PËR PASQYRAT FINANCIARE:

Emërtimi i Shpenzimeve 2021	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2.3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	76,378,563	0.70	
Sigurime Shoqërore (601)	10,602,039	0.70	
Mallra e Shërbime (602)	27,816,510	0.70	
Investime të brend. (230-231)	22,567,723	2.00	
Të tjera transfer. korrente (606)	799,281	0.70	
Total	138,164,116		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	2,763,282		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE TIRANË

<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	276,328
Nëntotali	2,486,954
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%
Vlera e precizionit	2,238,258

Përgatiti: Grupi i auditimit, bazuar në të dhënat e disponuara nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme (përlllogaritjet janë kryer bazuar në të dhënat e Pasqyrës së Pozicionit financiar dhe Pasqyrës së Performancës Financiare (PASH), të Bilancit të AMA- s për vitin 2021).